



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI
(Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë)

“BASHKIA KOLONJË”

Tiranë, Korrik 2024

PËRMBAJTJA

<u>I. Përmbledhje ekzekutive</u>	4
1.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	7
II. Hyrja	8
<u>1. Objektivat e auditimit</u>	9
<u>2. Qëllimi i auditimit</u>	10
<u>3. Identifikimi i çështjes</u>	10
<u>4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>	10
<u>5. Përgjegjësitë e audituesve</u>	10
<u>6. Kriteret e vlerësimit</u>	11
<u>7. Standardet e auditimit</u>	11
<u>8. Metodologjia e auditimit</u>	12
<u>9. Dokumentimi i auditimit</u>	13
III. REZULTATET E AUDITIMIT	13
<u>3.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm</u>	13
<u>3.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</u>	22
<u>3.2.6 Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave</u>	32
<u>2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.</u>	41
<u>2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.</u>	65
<u>2.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.</u>	133
<u>2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.</u>	143
<u>2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e IMT –së, të Njësisë Vendore.</u>	150
<u>2.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme</u>	152
IV GJETJE DHE REKOMANDIME	179
<u>ANEKSET</u>	180

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Kolonjë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, planifikimit, realizimit të prokurimeve dhe zbatimit të kontratave të lidhura për punë publike, planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, aktivitetin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 20.02.2024 deri në datën 05.04.2024 u krye auditimi, i cili kishte objekt: “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të Bashkisë Kolonjë” dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2023.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 19 akt-konstatime dhe 2 akt-verifikim. Mbi aktet e mbajtura nga grupi i auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Kolonjë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Kolonjë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve
- mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit, Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 29 gjetje dhe ka dhënë 31 rekomandime, nga ku masa organizative me 23 gjetje dhe 25 rekomandime, 4 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **24,782 mijë lekë**, dhe 2 gjetje-rekomandime në vlerën **79,424 mijë lekë** në fushën e të ardhurave.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ **Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit**

- Në **4 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 24,782 mijë lekë** projektet e investimit me objekt:

- "Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë"

- "Rikualifikim i rrugës "Pali Prifti" Qyteti Ersekë"

- "Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë"

- "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës"

Procedurat e prokurimit publik për punë publike, mallra dhe shërbime:

Në **6 raste** nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2023, u konstatua se, OE është shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT si vijon:

- "Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022",

- "Blerje materiale për ndriçimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022"

- "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës", viti 2022"

- "Ndërtim palestere për kompleksin "Shkolla Qendër Komunitare" për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë"

- "Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023"

- "Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas, viti 2023,FAZA I".

- Në **7 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

- Në **2 rast** mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me: projekti konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga drejtori i Drejtorisë së Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile, gjithashtu, ka kryer dhe aplikimin online për lejen e ndërtimit gjatë orarit të punës; rifreskimin e kartelave të pasurisë gjatë tre muajve të fundit; aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk jam përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht; mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin; mungon projekti as-built; mungojnë fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet.

- Në **2 raste** DPKZHT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me: Mos-marrjen mendimi nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrë (ASHK) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

-Në **3 rast** ka mangësi në lidhje me inspektimin e objekteve me leje ndërtimi të miratuar. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me mos-evidentimin e shmangieve midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar (aksesi për në objekt nuk është realizuar sipas projektit të miratuar).

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të munguara në vlerën **79,424 mijë lekë** nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjare.

- Të ardhura të munguara në vlerën **759 mijë lekë** nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 31 persona debitorë.

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e asetëve**

Nga auditimi rezultoi se, janë 3343 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Kolonjë (Qendër) me VKM. Referuar Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” është bërë një inventarizim i plotë i të gjitha pronave që i janë transferuar organeve të pushtetit vendor duke saktësuar të dhënat mbi këto prona, ku sipas inventarizimit faktik rezultuan 3343 prona.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ Bashkia Kolonjë në lidhje me **zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **24,782 mijë lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve.

▪ Bashkia Kolonjë **në lidhje me të ardhurat**, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **79,424 mijë lekë** nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, familjarë, fermerë, individë etj.,

▪ Nga Drejtoria e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit **në lidhje me lejet ndërtimit**, të merren të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane, ku në çdo rast të ruhen distancat nga kufiri i pronës sipas përlllogaritjes së parashikuar në rregullore. Të kërkojë çdo subjekti që aplikohen për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi dhe të ngarkuar në sistemin elektronik. Në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, të merret mendimi i autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Të marrë të gjitha masat për të përlllogaritur në mënyrë të saktë sipërfaqen ndërtimore me funksion banim e pjesë takuese të sipërfaqeve të përbashkëta për çdo aplikim për pajisje me leje ndërtimi.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2023:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Kolonjë për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin e modifikuar me rezervë” pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë Kolonjë më 31 dhjetor 2023, referuar udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në

seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale por jo të përhapura, ato prekin disa prej llogarive financiare dhe sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Kolonjë. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë: Nga auditimi ka rezultuar se në disa raste, trajtuar hollësisht në Raportin e Auditimit, nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 29,357,127 lekë.

-Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 2,712,442 lekë.

-Llogaria 32 “Inventar i imët” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 1,542,854 lekë.

-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 64,313,025 lekë.

-Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 115,861 lekë.

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 8,552,802 lekë.

-Llogaria 26 “Aktivet Afatgjata Financiare” është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 625,621 lekë.

-Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore” është paraqitur e mbivlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 55,777 lekë.

b- Për drejtimin e Bashkisë Kolonjë mbi auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Kolonjë për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Opinionin:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Bashkia Kolonjë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar/kualifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë

përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Bashkisë Kolonjë rezultuan:

-Bashkia Kolonjë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2023, në kenë vlerën **79,424 mijë lekë**.

Në 7 raste nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, për punë publike, mallra dhe shërbime, u konstatua se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike.

Në 6 raste nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se, OE është shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT.

- Në 2 raste DPKKZHU dhe Bashkia Kolonjë nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me: Mos-marrjen mendimi nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrë (ASHK) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

-Në 3 rast ka mangësi në lidhje me inspektimin e objekteve me leje ndërtimi të miratuar. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me mos-evidentimin e shmangieve midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar (aksesi për në objekt nuk është realizuar sipas projektit të miratuar).

I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 186/1 Prot, datë 20.02.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 20.02.2024 deri në datën 05.04.2024, në subjektin Bashkia Kolonjë u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.H. I – Përgjegjës Grupi
- 2.R. L– Anëtar
- 3.K. H. – Anëtar
- 4.R. Fuçia – Anëtar
- 5.B. B. – Anëtar
- 5.A. K. – Anëtar
- 6.A. S. – Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Kolonjë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuarra dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Kolonjë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Kolonjë dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
4. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV-së.
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Kolonjë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Kolonjë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Kolonjë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- “VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, i ndryshuar.
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme".
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Kolonjë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik";
- ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar".
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Kolonjë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale².

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon³.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

² ISSAI 1315

³ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Pika 1.1 e programit të auditimit. *“Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi”.*

Ky auditim u krye në zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Kolonjë si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të MFK-së në mënyrë të detajuar argumentohet si më poshtë:

1. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është bazë e menaxhimit të fondeve dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm i cili përmban:

-Njësia publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlera etike.

-Nëpunësit e Bashkisë Kolonjë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në zbatim të rregullores së brendshme të miratuar me vendim nr.28, datë 29.04.2020 për organizimin dhe funksionimin e institucionit të bashkisë, me shkresën nr. 2747 prot., datë 02.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë është miratuar Kodi i Etikës për vitin 2022 i cili aplikohet dhe zbatohet nga administrata qendrore dhe njësitë administrative.

Me vendimin nr. 157, datë 15.12.2023 është miratuar rregullorja e brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Kolonjë.

-Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, punonjësit kanë mangësi, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë të dobëta. Në vitet 2022-2023 nuk janë zhvilluar trajnime të stafit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Veprime këto në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, pika 3.1.

-Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë Kolonjë, ato regjistrohen pranë Zyrës së Koordinatorit të së drejtës së informimit dhe të drejtës me publikun

me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

-Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 mujor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

-Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

-Për vitet 2022-2023 nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Nga njësitë e varësisë ka raporte 6 mujore për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

-Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

-Me vendim nr.117 datë 15.12.2021 është miratuar kalendari për programin buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxheti vjetor 2023. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Referuar të dhënave të paraqitura nga pyetëtori, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat disponohen procesverbale të takimeve të tyre, me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjesat me publikun.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Për vitin 2022 është miratuar numri total i punonjësve dhe niveli i pagave në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë me VKB nr. 111, datë 26.11.2021, me Urdhrin nr.13, datë 12.01.2022 të titullarit është miratuar struktura e bashkisë.

-Organigrama e Bashkisë Kolonjë është e ndërtuar në mënyrë të tillë që, 1 nënkryetar dhe 7 drejtuesit e Drejtorive kryesore bashkë me Administratorët e NJA e Titullarët institucioneve të varësisë varen direkt nga Kryetari, ku dhe llogaridhënia është direkt tek Kryetari i Bashkisë në vijë horizontale dhe jo vertikale.

-Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Nëpunësit e Bashkisë Kolonjë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit (inspektor terreni, punonjës bujqësie, topograf, inxhinier pyjesh, inspektor pyje, punonjës sporti etj.) i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut II, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, ku citohet:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;
- Një sistem për vlerësimin e performancës;

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Punë është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre, nëpërmjet Komitetit të Përhershëm të Pranimit i ngritur me Urdhrin nr.125, datë 10.03.2022 me nr.1200 prot, datë 10.03.2022 “Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë”. Për vitin 2022 janë kryer procedura rekrutimi për 34 pozicione pune në shërbimin civil dhe për 52 vende pune administrative.

Mbi politikat dhe praktikat e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe linjat e raportimit. Nuk ka përkrahje detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës.

-Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për sa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

-Me Urdhrin nr. 18, nr.166 prot, datë 17.01.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe caktimin e kordinatorit të GMS dhe riskut, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika b, neni 27, pika 2.

-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Nga ana e titullarit janë nxjerrë urdhërat nr.566, 567, 568, datë 27.10.2021 “Për delegim kompetencash”, Urdhëri nr.582 , datë 31.10.2022 “Për zëvendësim kompetencash” të kryetarit të bashkisë me nënkryetaren”.

2. MENAXHIMI I RISKUT

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve

që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut. Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinator i Riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësiave të tij, nëpunësi autorizues mund ti delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinimin e riskut, punonjësve që janë pjesë e strukturës së financës, funksion i cili nuk është i deleguar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura. Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë dhe më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe për kontrollimin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

Bashkia Kolonjë ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut me shkresën Nr. Prot. 1003, datë 28.02.2022, e cila përditësohet çdo dy vjet. Personi përgjegjës për ndjekjen, monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie është titullari i bashkisë Kolonjë.

3. AKTIVITET E KONTROLLIT

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, përfshirë edhe shitjen e pronës, urdhër-shërbimet, dhe kryerja e pagesës, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa. Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit. Sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare. Të gjithat angazhimet likuidimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike", parashikohet se: Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës. Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen,

vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës.

Për vitin 2022-2023 Bashkia Kolonjë ka miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20.

- Bashkia Kolonjë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 20.

4. MONITORIMI

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura. Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efikente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit; një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës. Në deklaratë, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar. Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësim në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Me shkresën nr. 595 prot., datë 28.02.2022, nga Bashkia Kolonjë është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Me shkresë nr. 595/1 prot., datë 28.02.2022, Bashkia Kolonjë ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli, në përputhje me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 “Pyetësi i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Gjithashtu konstatohet se, nuk ka raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Plani i veprimit për ecurinë e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitet 2022-2023 është protokolluar me shkresën nr.1003, datë 28.02.2022.

5. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.

- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.

- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.

- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet. Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Në Bashkinë Kolonjë shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. F. F., ish-Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

1.2 Auditi i Brendshëm

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për organizimin e njësisë e auditit të brendshëm u konstatuan parregullsitë si mëposhtë:

-Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm

Për vitet 2022-2023 NJAB ka funksionuar me 2 auditues sipas strukturës organizative të konfirmuar nga Titullari i Bashkisë Kolonjë, me Urdhërin nr.13 datë 12.01.2022, veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

1. Karta e auditimit: NJAB në Bashkinë Kolonjë, duke mos qenë një strukturë e mirëfilltë nuk ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

2. Plani strategjik i viteve 2022-2023: Plani Strategjik i Auditimeve për vitet 2022-2023, është hartuar dhe miratuar me Nr. 5010 Prot, date 15/10/2021.

3. Programi i auditimeve të brendshme për vitet 2022-2023 referuar Planit Strategjik, MSZH, Drejtoria e Financës, Urbanistika, Njësitë Administrative (Qëndër-Ersekë, Qendër-Leskovik, Barmash-Novoselë dhe Mollas-Çlirim), Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Policia Bashkiake , Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit , i cili është miratuar nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mbi bazën e planit vjetor dhe me urdhër të titullarit Drejtoria e Sherbimit Social.

4. Raportimi vjetor për veprimtarinë e vitit 2022 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, drejtoria e Harmonizimit, raporti i auditit të brendshëm të bashkisë Kolonjë me shkresën nr.908 prot, date 14.02.2023.

5. Dosjet e përhershme të auditimit të brendshëm të Bashkisë Kolonjë janë mbajtur të plotësuara e të administruara në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në to është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

6.Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Kolonjë konstatohet se për vitet 2022-2023 ka pasur në strukturën e saj dy auditues. Në vitin 2023 është larguar z. F.Z. dhe është zëvendësuar me znj. L. S.. Më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

-Vlerësimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Poliçan:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2022 sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 6 auditime nga të cilat janë realizuar 6 auditime në masën 100%, konkretisht është audituar:

1.MSZH,

2.Drejtoria e Financës,

3.Urbanistika,

4.Njësitë Administrative (Qëndër-Ersekë, Qendër-Leskovik, Barmash-Novoselë dhe Mollas-Çlirim),

5.Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

6.Policia Bashkiake.

-Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, Sektori Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2023 sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 4 auditime nga të cilat janë realizuar 2 auditime në masën 50%, konkretisht është audituar:

1.Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve,

2.Drejtoria e Shërbimeve Publike,

3.Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit,

4.Drejtoria e Shërbimit Social (me urdhër të titullarit).

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, Drejtoria e Financës dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

-Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se; për vitin 2022 nga 20 masa të rekomanduara, janë pranuar 20 (njëzetë) rekomandime, nga këto 16 (gjashtëmbëdhjetë) rekomandime janë zbatuar, 4 (katër) rekomandime janë në proces zbatimi. Për vitin 2023 nga 14 masa të rekomanduara, janë pranuar 14 (katërbëdhjetë), nga këto 11 (njëmbëdhjetë) janë zbatuar dhe 3 (tre) janë në proces zbatimi.

-Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, planifikimi, realizimi i programit vjetor të auditimit si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit, ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi.

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Karta e Auditimit të Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitet 2022-2023;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Organizimi i Njësisë së Auditit të Brendshëm

Në bazë të Vendimit të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, nuk është krijuar e plotë njësi e auditimit të brendshëm. Për **vitet 2022-2023** NJAB ka funksionuar me 2 auditues sipas strukturës organizative të konfirmuar nga Titullari i Bashkisë Kolonjë, me Urdhërin nr.13 datë 12.01.2022.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 3 “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”.

1. NJAB në Bashkinë Kolonjë, duke mos qenë një strukturë e mirëfilltë *nuk ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12, pika c, neni 14 pika b.*
2. Plani Strategjik i Auditimeve për vitet 2022-2023, është hartuar dhe miratuar me Nr. 5010 Prot, date 15/10/2021.
3. Programi i auditimeve të brendshme për vitet 2022-2023 referuar Planit Strategjik, MSZH, Drejtoria e Financës, Urbanistika, Njësitë Administrative (Qëndër-Ersekë, Qendër-Leskovik, Barmash-Novoselë dhe Mollas-Çlirim), Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, i cili është miratuar nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mbi bazën e planit vjetor dhe me urdhër të titullarit Drejtoria e Sherbimit Social.
4. Raportimi vjetor për veprimtarinë e vitit 2022 është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, drejtoria e Harmonizimit, raporti i auditit të brendshëm të bashkisë Kolonjë me shkresën nr.908 prot, date 14.02.2023.
5. Dosjet e përhershme të auditimit të brendshëm të Bashkisë Kolonjë janë mbajtur të plotësuara e të administruara në përputhje me kërkesat e Kapitullit VI të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në to është përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.
6. Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Kolonjë konstatohet se për vitet 2022-2023 ka pasur në strukturën e saj dy auditues. Në vitin 2023 është larguar z. F.Z. dhe është zëvendësuar me znj. L. S.. Më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Struktura e njësisë AB për vitet 2022-2023

Nr	Periudha 2022-2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	I. J.	Auditues	Financë/Ekonomi	28 vjet	7	2018	Po
2	F.Z.	Auditues	Financë	27 vjet	6	2018	Po (I larguar)
3	L. S.	Auditues	Drejtësi	5 muaj	5 muaj	Jo	Në periudhë prove, me status

Burimi: NJAB Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se këta punonjës janë kontraktuar referuar nenit 10, pika ç e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015,” Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” si më poshtë cituar:

ç) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Punonjësit e strukturës së auditit të brendshëm rezultojnë të certifikuar 2/3 dhe kanë kryer trajnime të vijueshme për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015” Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Çertifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm” deri në periudhën e daljes në pension (viti 2016).

Vlerësimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kolonjë

Sipas planit Strategjik të viteve 2022-2023 i nënshtrohen auditimit të plotë, MSZH, Drejtoria e Financës, Urbanistika, Njësitë Administrative (Qendër-Ersekë, Qendër-Leskovik, Barmash-Novoselë dhe Mollas-Çlirim), Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Policia Bashkiake , Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, i cili është miratuar nga Përgjegjësi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm mbi bazën e planit vjetor dhe me urdhër të titullarit, është audituar Drejtoria e Shërbimit Social.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë, emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2022 sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 6 auditime nga të cilat janë realizuar 6 auditime në masën 100%, konkretisht është audituar:

- 1.MSZH,
- 2.Drejtoria e Financës,
- 3.Urbanistika,
- 4.Njësitë Administrative (Qendër-Ersekë, Qendër-Leskovik, Barmash-Novoselë dhe Mollas-Çlirim),
- 5.Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,
- 6.Policia Bashkiake.

-Për periudhën 2022, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, Sektori Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për vitin 2023 sipas planifikimit vjetor, janë planifikuar për tu kryer 4 auditime nga të cilat janë realizuar 2 auditime në masën 50%, konkretisht është audituar:

1. Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve,
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike,
3. Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit,
4. Drejtoria e Shërbimit Social (me urdhër të titullarit).

-Për periudhën 2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, Drejtoria e Financës dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm “*Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit*”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. I. Kryetar i Bashkisë, z. F. F., ish-Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

2. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2022 dhe 2023;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022-2023;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 dhe 2023-2025 u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavanëve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr130 datë 30.12.2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Korce me shkresën nr1293/1 prot date 05.01.2022

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 80,915 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 124,983 mijë lekë, transfertat specifike ka vlerën 114,396 lekë dhe Investime nga FZHR në vlerën 219,819 mijë lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 540,113 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 540,113 mijë lekë.

-Buxheti i vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Në hartimin e buxhetit vjetor Bashkia Kolonjë ka përfshirë edhe fondet e kushtëzuara, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, ku përcaktohet që: “Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve që nuk janë transferuar ose deleguar tek njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk janë të ardhura vendore dhe nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këto fonde përdoren vetëm për financimin e funksionit të deleguar, projekte të veçanta dhe sipas llogarisë ekonomike për të cilin është dhënë ose sipas përcaktimeve të legjislacionit apo marrëveshjes”.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2022 sipas tabelave në vijim:

Llog	Emërtimi	Buxheti Faktik 2021	Faza e I PBA 2022	Faza e II PBA 2022	Projekt Buxhet 2022
600	Paga	143,030	155,536	155,536	153,824
601	Sigurime Shoqërore	23,620	25,975	25,975	25,769
602-604	Mallra dhe Shërbime të Tjera	99,987	94,339	93,339	98,714
605	Transferata Korente të Huaja	0	0	0	0
606-609	Trans per Buxh. Fam. & Individ	114,652	5,378	5,378	3,500
466	Garanci punimesh	3,609			
I	Shpenzime Korrente	384,698	281,228	280,228	281,807
230	Kapitale të Patrupëzuara				
231	Kapitale të Trupëzuara	570,155	110,379	111,379	38,487
231	Investime FZHR				219,819
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	46,046	110,379	111,379	258,306
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	616,201	110,379	111,379	258,306
III	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limiti				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		1,000,899	391,607	391,607	540,113

Planifikimi i shpenzimeve kapitale nga te ardhurat vendore për vitin 2022 është bërë si vijon:

-Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2022 nga të ardhurat e veta dhe transfertë e pakushtëzuar është në vlerën 38,487 mijë lekë.

-Total, planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2022 është parashikuar në vlerën 258,306 mijë lekë burimi i të ardhurave të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar.

Gjatë vitit 2022, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2021). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2023 sipas tabelave në vijim:

Llog	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	137,827	154,531	154,531	171,182
601	Sigurime Shoqërore	22,872	25,857	25,857	27,765
602-604	Mallra dhe Shërbime të Tjera	105,503	99,965	99,965	98,391
606-609	Trans per Buxh. Fam. & Individ	123,198	3,599	3,599	3,200
I	Shpenzime Korrente	392,236			
230	Kapitale të Patrupëzuara	943			
231	Kapitale të Trupëzuara	419,222			

231	Investime FZHR	0	0	0	0
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	45,313	44,468	44,468	43,580
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	419,222			
II	Shpenzime Kapitale	464,535			
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	865,861	328,420	328,420	344,028

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr.147 datë 22.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Korce me shkresën nr1155/1 prot date 09.01.2023

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 82,000 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 143,275 mijë lekë, transfertat e pakushtëzuar sektoriale ka vlerën 118,457 mijë lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 344,028 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 344,028 mijë lekë.

-Buxheti i vitit 2023 është miratuar i balancuar dhe pa deficiente.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale nga te ardhurat vendore për vitin 2023 është bërë si vijon:

-Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2023 nga të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar është në vlerën 43,580 mijë lekë.

-Total, planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 258,306 mijë lekë burimi i të ardhurave të ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtëzuar.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura për vitin 2022-2023.

Tabela për vitin 2022

000/lekë

Planifikimi i të ardhurave 2022		Planifikimi i shpenzimeve 2022	
Burimi i të ardhurave		Emërtimi i zërave	
Të ardhura të planifikuara për vitin 2022	80,915	600 Paga	153,824
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm nga viti 2021		601 Sigurime shoqërore dhe shend.	25,769
Total të ardhurat e veta	80,915	602 Shpenzime operative	98,514
Transfertë e pa kushtëzuar dhe specifike e trashëguar nga viti i mëparshëm 2022		604 Transferime korrente te brendshme	200
Transfertë e pakushtëzuar 2023	124,983	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	
Transfertë specifike	114,396	230-231 Investime	38,487
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	239,379	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,500
Totali të Ardhurave	320,294	Totali Shpenzimeve	320,294

Burimi: Bashkia Kolonjë.

Tabela për vitin 2023

000/lekë

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave		Emërtimi i zërave	
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	82,000	600 Paga	171,182
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm nga viti 2022		601 Sigurime shoqërore dhe shend.	27,675
Total të ardhurat e veta	82,000	602 Shpenzime operative	98,391
Transfertë e pa kushtëzuar dhe specifike e trashëguar nga viti i mëparshëm 2022		604 Transferime korrente te brendshme	200
Transfertë e pakushtëzuar 2023	143,571	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	
Transfertë specifike	118,457	230-231 Investime	43,580
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	262,028	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,000
Totali të Ardhurave	344,028	Totali Shpenzimeve	344,028

Burimi: Bashkia Kolonjë.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, është marrë në konsideratë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Kolonjë dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Gjatë vitit 2022 janë miratuar vendimet e Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr 48 datë 17.05.2022 është miratuar e buxheti shtese në vlerën **23,006 mijë lekë** për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2021.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Kolonjë si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2022, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në tabelat e mëposhtme

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe 2023 me të ardhurat e veta të Bashkisë Kolonjë dhe transfertën e pakushtëzuar paraqitet në aneksin 2.2 bashkëlidhur raportit të auditimit

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kolonjë, konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022-2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Kolonjë ka diferenca me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2022, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 320,294 mijë lekë, buxheti i rishikuar ka vlerën 930,124 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 853,195 mijë lekë ose në masën 89%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 168,068 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 160,159 mijë lekë ose në masën 95%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 120,301 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 98,006 mijë lekë ose në masën 81%.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 128,373 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 123,198 mijë lekë ose në masën 96 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 506,085 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 464,535 mijë lekë ose në masën 92 %.

-Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Kolonjë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2022 kanë diferenca me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën **341,028 mijë lekë**, buxheti i rishikuar ka vlerën **716,023 mijë lekë**, ndërsa realizimi është në vlerën **643,952 mijë lekë** ose në masën 90%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën **201,233 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **192,889 mijë lekë** ose në masën 96%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën **137,378 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **113,344 mijë lekë** ose në masën 83%.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën **122,851 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **117,279 mijë lekë** ose në masën 95 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **250,962 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **217,753 mijë lekë** ose në masën 87 %.

Niveli i realizimit të investimeve krahasuar me planin të planifikuar, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për **vitin 2022** investimet janë planifikuar në vlerën **506,085 mijë lekë** dhe realizuar **464,535 mijë lekë** ose në masën 92 %, ndërsa për vitin **2023** zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231), është planifikuar në vlerën **250,962 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **217,753 mijë lekë** ose në masën 87 %.

Veprimet opo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 46 “Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendore”, ku përcaktohet që: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2022-2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor përkatës si dhe nenin. 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Kolonjë z. **E. I., si dhe znj. G. D.**, me detyrë Drejtore e Financës.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta:

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit për virin 2022 dhe 2023 paraqitet në aneksin 2.3 bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit:

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2022 ka vlerën 80,915 mijë lekë ndërsa realizimi ka vlerën 66,089 mijë lekë ose në masën 81.7%.

Gjatë viti 2023 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Kolonjë është në vlerën 59,825 mijë lekë.

Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si mëposhtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën 19,234 mijë lekë;
- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 31,686lekë;
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 8,905 mijë lekë.

Buxheti faktik i vitit 2022 është në vlerën 856,861 mijë lekë duke mos përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK. Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Kolonjë me të ardhurat e veta mbulon 6,9% të buxhetit vjetor 2022. Të dhënat e mësipërme për vitin 2022, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta 2023:

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2023 ka vlerën **82,000 mijë lekë** ndërsa realizimi ka vlerën **63,942 mijë lekë** ose në masën 78.1%.

Gjatë viti 2023 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Kolonjë është në vlerën **65,846 mijë lekë**.

Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si mëposhtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën **20,192 mijë lekë**;
- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 32,767 mijë lekë;
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 12,887 mijë lekë.

Buxheti faktik i vitit 2023 është në vlerën 645,154 mijë lekë duke mos përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK.

Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Kolonjë me të ardhurat e veta ka mbuluar 10% të buxhetit vjetor 2023. Të dhënat e mësipërme për vitin 2023, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë:

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 6, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.

Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente. Në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për Emergjencat Civile ” të ndryshuar, të nenit 29 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të pikës III/3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ndërsa fondit i kontigjencës parashikohet për herë të parë filluar

nga viti 2017 dhe në vijim. Ndryshe nga sa më sipër, fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të bashkisë, filluar nga viti 2020.

Në VKB nr. 130 datë 30.12.2021 është miratuar për vitin 2022 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total lekë, si vijon:

- fondi rezervë dhe i kontigjences nga granti në vlerën **3,000** mije lekë;

- fondi rezervë dhe i kontigjences nga të ardhurat në vlerën **500** mije lekë;

Me VKB nr 38 date 29.03.2022 “Per miratimin e ndihmes financiare per perballimin e shpenzimeve te varrimit nga Fondi Rezerve” miratuar me shkresen e Prefektures nr 330/2 date 12.04.2022 u be rishikimi i fondit rezerve me 108 mije leke shpenzim ky i kryer me urdher shpenzimin nr 445 date 07.06.2022.

Me VKB nr 85 date 26.08.2022 per rishperndarjen e fondeve buxhetore si dhe bazuar ne proces verbalin e mbajtur nga shefi i MZSH dhe punonjesit e tij ne daten 05.08.2022 ne lidhje me difektin e njeres prej zjarrfikeseve te Bashkise Kolonje u be rialokim i vleres prej 900 mije leke per rregullimin e difektit, miratuar ky vendim me shkresen e Prefektures nr 801/1 prot date 06.09.2022 shpenzim ky i kryer me urdher shpenzimin nr 835 date 17.10.2022 ne vleren 886 mijë lekë.

Me VKB nr. 112 date 22.09.2022 për rishperndarjen e fondeve buxhetore si dhe bazuar në kërkesën me nr. 200 prot date 31.08.2022 Drejtoria Rajonale Korce, Grupi Operativ Kolonje për zevendesimin e rrjetit te ndricimit rrugor ajror ne tre lagje te fshatit Starje u be rialokimi i vleres 1,100 mije leke shpenzim ky i realizuar me urdher shpenzimin nr 890 date 2.10.2022 ne vleren 774 mije leke. Totali i rialokimeve nga fondi rezerve dhe i kontigjences arriti ne vleren 2,108 mije leke. Vlera e mbetur sipas dhe situacionit te shpenzimeve e pa rialokuar nga fondi rezerve dhe i kontigjences 1,392 mije leke.

Ne zbatim te shkreses nr 3100 date 21.06.2022 per Bashkine Kolonje eshte akorduar fondi prej 7,621,824 leke ne formen e transfertes se kushtezuar .Me VKB nr 76 date 15.07.2022 “Per nje shtese ne vendimin nr 48 date 17.05.2022 per miratimin e bushetit shtese te bashkise kolonje per vitin 2022 ,detajimin dhe perdorimin e fondit te kushtezuar per mbrojtjen civile” është bërë ndarja e ketij fondi si mëposhtë:

-Ndihme familjare per familjet e demtuara ne vlere 200,000 leke

-Marrje masash per rikonstrukcion urash ne vleren 3,960,000 leke

-Mbulim i shpenzimeve per perballimin e fatkeqesive natyrore ,lidhur me kalueshmerinë e pandërprere te rrugeve rurale ne vleren 3,464,824 leke.

-Bazuar në VKB nr.131 datë 30.12.2021 miratuar me shkresën e prefekturës nr 1293/1 prot date 05.01.2022 “Ndihme financiare shtetases, Znj.L. S. për përballim të shpenzimeve te varrimit, realizuar me urdhër shpenzimin nr.518 date 29.06.2022 ne vlerën 200,000 lekë.

-Me VKB nr 46 date 17.05.2022 shpenzime per perballimin e fatkeqesive natyrore, lidhur me kalueshmërine e pandërprerë të rrugeve rurale, miratuar nga prefektura me shkresen nr 518/2 prot date 30.05.2022 dhe faktuar me urdher shpenzimet nr 460,461 date 14.06.2022 ne vleren 1,951,387 leke.

-Me VKB nr 49 date 17.05.2022 miratuar me shkresen e prefektures nr 518/2 date 30.05.2022 realizuar me urdher shpenzimin nr 553 date 07.07.2022 ne vleren 1,072,080 leke.

-Ne baze te VKB nr 76 date 15.07.2022 miratuar me shkresen nr 701/1 prot date 25.07.2022 “Rehabilitim pacarela Mesicke””ne vleren 840,000 leke shpenzim ky i realizuar me urdher Shpenzimin nr 736 date 08.09.2022 .

-Me urdher shpenzimin nr 1061 dhe 1062 date 21.12.2022 si dhe ne baze te VKB nr 137 date 01.12.2022 miratuar nga prefektura me shkresen nr 1079/1 prot date 14.12.2022 u realizuan shpenzimet :895,200 lekë per blerje materiale qe do i sherbejne strukturave te emergjencave civile,dhe 1,107,600 lekë për urën pasarelë, fshati Blush.

-Me urdhër shpenzimin nr.1107 datë 28.12.2022 në vlerën 1,104,000 lekë u realizua shpenzimi për rehabilitim, mbrojtje lumore, bazuar në VKB nr.137 datë 01.12.2022 miratuar nga prefekti me shkresën nr.1079/1 prot datë 14.12.2022

-Me urdhër shpenzimin nr.1106 datë 28.12.2022, bazuar dhe në shkresën nr 1606/4 datë 18.11.2022 u realizua shpenzimi “Ndihmë financiare për familjet e prkura nga tërmeti” në vlerën 26,457 lekë.

Vlera totale e realizuar nga fondi i kushtezuar arrin vlerën 7,196,724 lekë.

VITI 2023

Në VKB nr. 147 datë 22.12.2022 është miratuar për vitin 2023 fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total lekë, si vijon:

- Fondi rezervë dhe i kontigjences nga granti në vlerën **3,000** mijë lekë

-Me VKB nr 18 date 27.02.2023 dhe miratuar me shkresën e prefekturës nr 235/1 prot date 07.03.2023 u be rialokimi në vlerën **1,376,160** lekë, vendim ky bazuar ne kerkesat e drejtove te disa shkollave per nderhyrje te menjehershme ne keto institucione ,shpenzim ky i vertetuar dhe me urdhër shpenzimin nr.248 datë 06.04.2023 në vlerën 1,113,600 lekë, si dhe në kerkesën e drejtorisë së shërbimeve për blerje kripë, për mirëmbajtjen e rrugëve nga rreshjet e deborës, me urdhër shpenzimin nr 243 date 05.04.2023 në vlerën 262,560 lekë.

-Me VKB nr. 35, datë 23.03.2023 dhe shkresën e prefekturës nr.317/1 prot datë 07.04.2023 për mbulimin e shpenzimeve për perballimin e fatkeqësive natyrore, lidhur me kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale në vlerën **1,499,971** nr.322 datë 04.05.2023 .

-Me VKB nr.119 datë 30.10.2023 miratuar nga prefektura me shkresën nr. 954/1 datë 10.11.2023 ne vleren **78,000** lekë ,”Ndihme financiare familjeve ne nevojë’realizuar me urdher shpenzimin nr. 1086 date 20.12.2023.

Pa alokuar nga ky fond mbetet vlera prej **45,869** leke, vlerë e cila rakordohet dhe me situacionin e dhjetorit të 2023.

Ne zbatim te shkreses nr 1702 date 29.03.2023 si dhe në zbatim te ligjit nr 84/2022 “Per Buxhetin e vitit 2023”, për Bashkinë Kolonjë është akorduar fondi prej **3,398,715** leke ne formën e transfertës së kushtëzuar. Me VKB nr.39 datë 24.04.2023 “Për detajimin dhe përdorimin e fondit te kushtëzuar për mbrojtjen civile” Bashkia Kolonje për vitin 2023 u bë ndarja e ketij fondi :

-Ndihmë financiare per familjet e dëmtuara ne vleren 200,000 leke, ose 5.8% e buxhetit total për MC (Mbrojtje Civile).

-Për mirmbajtjen në gadishmëri të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe rezervuarve, në vlerën 450,000 leke, ose 13.2 % e buxhetit total për MC (Mbrojtje Civile).

-Shpenzime për marrjen e masave ;

1-Rehabilitim ne infrastrukture ne vleren 600,000 lekë.

2-Rehabilitim Mbrojtje lumore ne vleren 658,715 lekë ose 37% në total e buxhetit për MC (Mbrojtje Civile).

-Mbulimin e shenzimeve per perballimin e e fatkeqesive natyrore ,lidhur me kalueshmerine e panderprere te rrugeve rurale ne vleren 960,000 leke ,ose 28% e buxhetit total per MC, (Mbrojtje Civile).

-Blerje materiale te ndryshme qe i sherbejne veprimtarise se strukturave te emergjencave civile ne vleren 530,000 leke,ose 16% e buxhetit total për MC, (Mbrojtjes Civile).

-Me urdher shpenzimin nr 370 date 18.05.2023 është realizuar shpenzimi ne vleren **850,920** leke, “Rehabilitim i rrugës në fshatin Radat si pasojë e shkarjes nga rreshjet e shiut.

-Me urdhër Shpenzimin nr 495 date 20.06.2023 në vlerën **516,002** lekë është realizuar shpenzimi “Rehabilitim i Urës së Lashovës.

Me urdhër Shpenzimin nr.500 datë 23.06.2023 është realizuar shpenzimi ne vleren **360,000** leke “Blerje materiale te ndryshme per punonjesit e zjarfikses “ në mbeshtetje të MC (Mbrojtjes Civile).

-Me urdher shpenzimin nr.696 date 29.08.2023 është realizuar shpenzimi ne vleren **152,400** “Blerje materiale te ndryshme per punonjesit e emergjencave civile’

Me urdher Shpenzimin nr 936 date 07.11.2023 është realizuar shpenzimi në vleren **424,200** lekë “Mirmbajtje zhbllokim rezervuari Barmash, Borove, Makerz.

Me urdher shpenzimin nr 940 date 07.11.2023 është realizuar shpenzimi ne vlerën **533,992** lekë “Prita malore fshati Starje.

-Me urdhër shpenzimin nr 1155 date 29.12.2023 si dhe bazuar ne VKB nr 136-145 datë 07.12.2023 “Ndhme financiare familjeve shtepitë e të cilëve janë demtuar nga stuhia e erërave të forta të dates 3-4.11.2023 në vlerën **194,800** lekë.

- Me urdher shpenzimin nr 1169 date 29.12.2023 si dhe bazuar ne VKB nr 146-148 date 07.12.2023 “Ndhme financiare familjeve shtepite e te cileve u demtan nga stuhia e ererave te forta te dates 3-4.11.2023 ne vleren **54,275** leke.

Vlera totale e realizuar e fonndit te kushtezuar per Bashkine Kolonje per vitin 2023 arrin ne vleren **3,086,589** leke.

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit:

Në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, përcaktohet që:

Pika 19. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për përgatitjen, kontrollin e brendshëm financiar publik, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit, për të gjitha funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pika 20. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore i paraqet këshillit, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tre raporte katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Pika 22. Nëpunësi autorizues publikon raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në faqen zyrtare të njësisë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit dhe një kopje e tyre i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pika 23. Nëpunësi autorizues, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit duhet të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, raportet katër mujore dhe vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare.

Për vitin 2022-2023

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, konstatohet se nga Bashkia Kolonjë për vitin 2022-2023 administrohen raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit të shtetit, si janë realizuar dhe përcjellë shkresat në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Detyrimet e prapambetura viti 2022-2023

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kolonjë, përkatësisht Drejtorinë e Financës, është konstatuar se: nga analiza e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në **pasqyrën PF22** anekset e raportit. Gjendja e llogarisë 401- 408 në shumën 12,863,221 lekë përbëhet nga fatura të palikujduara. Për vitin 2023 ka diferenca midis vlerës së detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE dhe me vlerën e identifikuar nga grupi i auditimit, shumë e cila duhej paraqitur është 12,863,221 lekë, e analizuar si më poshtë.

Fatura të palikujduara të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor janë në vlerën 12,863,221 lekë sipas tabelës si më poshtë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në tabelën më poshtë.

Objekti	Operatori Ekonomik	Nr.fat	Data	Shuma
	S. K.			19,000
	Argjendri "P. "			22,000
	G. C.			16,000
	A. K.			157,200
Materiale Ndricimi LED Leskovik	A. Shpk	76/2022	21.10.2022	7,550,381
Karburant dhe vaj	O. Shpk	5682/2023		867,000
Karburant dhe vaj	O. Shpk	6279/2023	27.10.2023	1,960,000
Karburant dhe vaj	O. Shpk	8483/2023		5,360
Karburant dhe vaj	O. Shpk	3022/2023	03.05.2023	88,500
Plan Mbarështimi	E. C.		02.10.2023	1,874,650
H. Z.	T shpk	270	04.03.2021	137,110
Mirembajtje Automjeteve	T SHPK	520,521	10.09.2018 14.09.2018	120,915
Blerje Pellet per ngrohje	A shpk	82	19.11.2018	45,105
Totali				12,863,221

Burimi: Të nxjerra nga grupi i auditimit.

-Stoku i detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me shkresën Nr. 817 prot, datë 13.02.2023 është në vlerën 303,130 lekë dhe përbëhet nga 3 fatura tatimore raportimi i stokut nuk tregon gjendjen reale dhe është raportuar në kundërshtim me udhëzimin Nr.37 datë 06.10.2020.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF 28** më poshtë.

Lloji i detyrimit	Viti i krijimit	Operatori Ekonomik	Shuma në lekë
H. Z.	Nr.270 dt 04.03.2021	T shpk	137,110
Mirembajtje Automjeteve	Nr. 520 date.10.09.2018 Nr.521 date.14.09.2018	T shpk	120,915
Blerje Pellet per ngrohje	Nr. 82 date.19.11.2018	A shpk	45,105
Total			303,130

Burimi: Bashkia Kolonjë

Konkluzione:

Këto veprime janë jo në përputhje me parimet, udhëzimet dhe rregullat kontabël për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare, dhe sistemin buxhetor për të cilat auditimi gjykon se kanë ndikuar në mosparaqitjen e vërtetë dhe të sinqertë, të saktë dhe të besueshme të pasqyrave financiare për shpenzimet e kryera për vitet paraardhëse duke rritur detyrimet në këtë mënyrë në vitet pasardhëse pasi, regjistrimi i transaksioneve/veprimeve është bërë kur janë paguar dhe jo kur ato kanë ndodhur si ngjarje pra duke vepruar mbi baza cash në lidhje me këto shpenzime dhe jo mbi parimin e të drejtave dhe detyrimit të konstatuar. Kjo ka ardhur si pasojë e marrjes së angazhimeve duke mos patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve por mbahen të pa regjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse kanë patur dijeni për këto detyrime dhe duke mos patur fonde në dispozicion, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Këto veprime çojnë në prishjen e hallkave të kontrollit të brendshëm në lidhje me parandalimin dhe detektimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, "Kryerja e pagesave", dhe nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", pikën 164, Udhëzimin Nr.37 datë 06.10.2020.

Veprimet apo mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Kolonjë z. E. I., si dhe znj. G. D., me detyrë Drejtore e Financës.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Bashkia Kolonjë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 323 mijë lekë, vlera i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve S. G. në vlerën 573 mijë lekë dhe për H. Z. në vlerën 137 mijë lekë. Si rezultat i

fenomenit të mos likujdimit në kohë të detyrimeve kontraktuale Bashkia Kolonjë ka administruar vendimin gjyqësor nr. 28 datë 30.10.2020 dhe vendimin nr.270 datë 04.03.2021 me objekt dëmshpërblim page të, prej të cilit gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 323 mijë lekë, ndërsa vlera 137 mijë lekë është detyrim për tu shlyer në vijim.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Veprimet apo mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Kolonjë z. E. I., si dhe znj. G. D., me detyrë Drejtore e Financës.

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Finances për vitin 2022-2023, në lidhje me investimet publike, rezultoi se, nuk ka financim projektsh nga FSHZH/FZHR

2.6. “Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor. u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat në lidhje me arkëtimet e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së taksave. Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e tatim-taksave.

I.Struktura e Drejtorisë së të ardhurave dhe tatim-taksave, Bashkia Kolonjë.

Për vitin 2022-2023 është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sectorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe drejtoria e të ardhurave dhe tatim-taksave (në vijim DATT).

-DATT ka në përbërjen e saj, 1 drejtor, 5 specialist dhe 3 inspektor. Gjithashtu në NJA Leskovik është i punësuar 1 specialist për taksat, në varësi organizative të DATT.

Struktura e DATT Bashkia Kolonjë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022-2023 pasqyrohet si më poshtë:

Struktura organizative e Drejtorisë të ardhurave dhe tatim taksave.

Nr.	Emër Mbiemer	Pozicioni	Date fillimi	
			Ndryshimi gjatë 2022-2023 nëse ka pasur	
1	S. L.	Drejtor	19.10.2020	Nuk ka
2	L. K.	Specialiste	11.09.2015	Nuk ka
3	B. C.	Specialiste	11.03.2019	Filluar ne finance shtator 2022
4	D.M.	Specialiste	11.03.2019	Filluar ne finance 13.02.2023
5	R. T.	Specialist	22 .07. 2020	Nuk ka
6	B. N.	Specialiste	13 .11. 2023	Nuk ka
7	J.Z.	Inspektor	07.05.2021	Nuk ka
8	F. Q.	Inspektor	23 .07. 2020	Larguar 26.06.2023
9	F. D.	Inspektor	21.10. 2022	Nuk ka

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë

-DATT Bashkia Kolonjë, për vitin 2022-2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Kolonjë nga taksat dhe tarifave.

II.Taksat dhe Tarifave e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Kolonjë.

Përgjatë vitit 2022-2023, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

-Paketa fiskale për vitin 2022-2023 është miratuar me VKB përkatëse dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë .

-Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2022-2023, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përllogaritjen e taksës dhe tarifës dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se për disa lloje taksash dhe tarifash nuk është përcaktuar sektori që do të bëjë përllogaritjen dhe sektori që do të ndjekë vjeljen e taksës ose tarifës përkatëse. Gjithashtu konstatohet se në raste të caktuara për një lloj takse ngarkohet i njëjti sektor për përllogaritjen, faturimin dhe vjeljen e taksës. Situatë e mësipërme ndigon negativisht në aktivitetin e bashkisë në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave, pasi krijohet mundësia për mbivendosje të funksioneve, mos identifikim të saktë të përgjegjësisë për veprimin/mosveprimin, paqartësi dhe vonesë në zbatimin e paketës fiskale etj. Mangësitë e mësipërme janë konstatuar në taksën e ndikimit në infrastrukturë, kontrollit veterinar, tarifën e tregtimit, parkimit, licencë/certifikatë në fushën e transportit, shërbimit nga institucionet e arsimit, kulturës, sportit, muzetë, tarifën për ujitjen dhe kullimin, shërbimet administrative, gjueti dhe peshkim, zhvillimin e turizmit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “F” në pikën 4 në nenin 9, nenin 20 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Regjistrat për të gjitha kategoritë e taksapaguesve mbahen në tabela exeli sipas llojit të tyre dhe jo me sistem informatik të licensuar, çka nuk jep siguri për mbajtjen, përllogaritjen dhe administrimin e saktë e numrit të secilës kategori, si debitorëve dhe atyre të cilët taksohen dhe tarifohen.

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në nenin 62 të rregullores së brendshme të Bashkisë Kolonjë, mbanë përgjegjësi z. S. L, Drejtor i DATT.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Kolonjë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmbledhur janë aplikuar/mbledhur 36 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2022-2023 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

1.Biznes;

2.Ambulant;

3.Familjar;

4.Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përfshirë institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifave vendore, si dhe numri i tyre.

Pasqyra.Nr.2.Biznese dhe institucione.

Nr	Lloji	2022	2023
1	Biznesi i Madh	46	53
2	Biznesi i Vogël	204	208
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	5	5
4	Institucione	23	23
	Total	278	289

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave në mijë lekë, për vitin 2022-2023, pasqyrohen në aneksin nr. 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për vitin 2022 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **80,915 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **66,089 mijë** lekë, ose 81% / rreth 14,826 mijë lekë më pak nga plani, ndërsa në vitin 2023 janë planifikuar 82,000 mijë lekë dhe janë realizuar **63,942** mijë lekë, ose 78 % dhe 18,058 mijë lekë më pak se plani vjetor.

Referuar aneksit nr. 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit vihet re për disa lloje taksash dhe tarifash nuk planifikohet saktë niveli i arkëtimit/nuk ndryshon planifikimi, pavarsisht se në vitin 2022-dhe 2023 janë realizuar të ardhura, konkretisht për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tabelës dhe reklamës, konkretisht:

- në vitin 2022 kjo taksë është planifikuar 360 mijë lekë dhe janë arkëtuar 595 mijë lekë, ndërkohë që përsëri në vitin 2023, kjo taksë është planifikuar në vlerën 360 mijë lekë dhe realizimi është 531 mijë lekë; tarifa e peshkimit; të ardhura nga fondi pyjor me qira; tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore; dhënia me qira e aseteve të bashkisë.

-Veç sa më sipër, nga auditimi i planit të të ardhurave për vitin 2022-2023, konstatohet se DATT, planifikon të arkëtojë detyrime të prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore për kategorinë “familjar”, të cilat i përkasin periudhës 2011-2020.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a)” dhe “e” nenit 5 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

a- Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.

e- Detyrimet tatimore të pambledhura në kohë, prej më shumë se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, nuk përfshihen në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në projektbuxhetin për vitin buxhetor pasardhës. Përdorimi i të ardhurave shtesë nga mbledhja e detyrimeve tatimore të pambledhura në kohë i nënshtrohet procesit të rishikimit të buxhetit vjetor, sipas përcaktimeve të nenit 46 të këtij ligji.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S. L., Drejtor i DATT.

Debitorët sipas kategorive të tyre 2022-2023

III.1. Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.

Njësia Administrative	Progresive deri në 01.01.2022		Krijuar brenda vitit 2022		Progresive mbetur deri në 31.12.2022	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
Erseke	136	7,180,371	35	98,614	142	7,566,340
Qender	4	279,845	2	117,820	1	338,955
Barmash			1	83,120	1	83,120
Njesia Leskovik	8	1,116,179	1	153,852	9	1,269,931
Qender Leskovik	1	47,510	1	47,510	2	862,000
Institucione	1	754,139	3	203.040	3	95,179
Total	150	9,378,044	42	1,540,446	157	10,215,525

Debitorë progresiv deri në 31.12.2023

Njësia Administrative	Progresive deri në 01.01.2023		Krijuar brenda vitit 2023		Progresive mbetur deri në 31.12.2023	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë

Erseke	142	7,566,340	36	1,117,947	151	7,989,194
Qender	2	338,955	7	266,850	7	538,434
Barmash	1	83,120	1	88,760	1	80,120
Mollas			1	120,120	1	12,120
Njesia Leskovik	9	1,269,931	1	147,259	8	1,296,501
Qender Leskovik			2	188,294	2	188,294
Institucione	3	957,179	3	221,688	3	1,178,867
Total	157	10,215,525	51	2,150,918	173	11,391,530

Në tabelën e mësipërme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve (biznes) për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

-Në krahasim me fundin e vitit 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitore me **2,150,918 lekë**.

Menaxhimi i borxhit tatimor për bizneset nga taksat e tarifat vendore.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga DATT, rezulton se në fund të **vitit 2022** kanë qenë debitor 46 subjekte të biznesit të madh në vlerën progresive **5,271,484** lekë duke përfshirë dhe kamatëvoneesën në shumën **607,128** lekë, 108 subjekte të biznesit të vogël në vlerën progresive **4,071,464** duke përfshirë kamatëvonesën në shumën **234,863** lekë dhe 2 institucione në vlerën **927,059** lekë.

-Në fund të **vitit 2023** në mënyrë progresive rezultojnë debitor, 52 subjekte të biznesit të madh në vlerë progresive **5,901,108** lekë debi principale, kamatëvonesë në vlerën **676,433** lekë, 122 subjekte të biznesit të vogël në vlerën **4,066,748** lekë debi principale dhe **234,715** lekë kamatëvonesës., 2 institucione në vlerën **1,118,627** lekë.

Konkretisht **gjatë vitit 2022 janë krijuar 42 subjekte debitor** për vlerën **1,540,446** lekë, ndërsa për vitin 2023 janë krijuar **51 subjekte debitorë** për vlerën **2,150,918** lekë. Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga DATT Bashkia Kolonjë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, konstatohet se nuk janë marrë masa shtrënguese të plota. Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitore në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Veprimet apo mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj. Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S. L., Drejtor i DATT.

Subjektet qiramarrës

N r	Subjekt	Aktiviteti	Forma	Institucio ni miratues	Tipi i aktit	Afati/vite	Vlera e kontrates lek/vit	Siperfaqe ha	pagesa 2022	Debi 2022	Debi 2023
-----	---------	------------	-------	------------------------	--------------	------------	---------------------------	--------------	-------------	-----------	-----------

1	G.	Bimesi	Qera	Bashkia Kolonje	Kontrate	99	44,610	7.4	0	44,610	44,610
2	F.	Agroturizim	Qera	Bashkia Kolonje	Kontrate	10	140,110	0.8758	0	140,110	140,110
3	Thaka G	Aktivitet	Qera	Bashkia Kolonje	Kontrate	10	31,120		0	31,120	31,120
4	Shuma	431,680								215,840	215,840

Debia e Heceve 2022-2023

Nr	Subjekti	Nipt	Detyrimi 2022	Paguar	DEBI mbetur 2023
1	E. shp.k	L.....K	1,393,225	0	1,393,225
2	C. sh.p.k	J.....V	144,250	0	144,250
3	C. sh.p.k	J.....V	126,808	0	126,808
4	H. sh.p.k	L.....D	576,950	567,950	0
5	Shuma		2,232,233	567,950	1,664,283

Nga auditimi i marrëdhënieve kontraktore të Bashkisë Kolonjë me palët e treta, për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, konkretisht të respektimit të detyrimit kontraktor për pagesën e qirasë (për vitin 2022-2023), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se:

Përgjatë vitit 2022-2023, rezultojnë debitor ndaj Bashkisë Kolonjë, subjektet, si më poshtë vijon:

- G. në vlerën **89,220 lekë** për periudhën e qirasë nga data 28.03.2022 deri më datë 28.03.2023.
- F. në vlerën **280,220 lekë** periudhën e qirasë nga data 30.05.2022 deri më datë 30.05.2023 dhe 30.05.2023 deri më 30.05.2024
- T. -G në vlerën **62,240 lekë** për periudhën 2022-2023.
- T. A. në vlerën **1,983,700 lekë** detyrim i mbartur para vitit 2020.
- P. A. në vlerën **535,375 lekë**, detyrim i mbartur para vitit 2020.
- E. P. shpk në vlerën **1,393,225 lekë** për periudhën deri më 23.08.2023.
- C. shpk në vlerën **271,058 lekë**. Detyrime të mbetura nga viti 2021.

Disa prej subjekteve të mësipërme (si G. , F., T. A., E., C. kanë marrë me qira sipërfaqe pasurie të paluajtshme në fond pyjor/kullosor, detyrimi i të cilëve, bazuar në përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, mbledhet nga drejtoria e shërbimit pyjor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbartimit.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Neni 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”.

-Neni 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë Kolonjë.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z. A. J., Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, pranë Bashkisë Kolonjë, si dhe për subjektet e tjera që kanë marrë me qira tokë bujqësore, mbanë përgjegjësi, z. S. L., Drejtor i DATT.

Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e planifikimit zhvillimit dhe kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Korçë.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **759,486 lekë** për 31 persona. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Kolonjë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Kolonjë të jetë drejtuar ASHK Dega Korçë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksë e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Drejtorin e PZHT, Bashkia Kolonjë

Debitorët Familjarë

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, për vitin 2022-2023 janë taksuar 8206 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohet si më poshtë:

Pasqyra.Nr.8

Numri total i familjeve të taksuara për dy vite së bashku.

Nr	Njësi Administrative	Familje të taksuara
		2022-2023
1	Qendër	2930
2	Mollas	2174
3	Barmash	694
4	Navosele	738
5	Clirim	980
6	Leskovik	600
7	Qender Leskovik	90
	TOTAL	8206

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kolonjë, Drejtorinë e Tatim Taksave pranë kësaj bashkie, e qëllim vlerësimin nëse nga DAT Bashkia Kolonjë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga STTV Bashkia Kolonjë me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile.

-Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Kolonjë dhe NJA janë 6,507 familje, ndërkohë në vitin 2022-2023 janë taksuar gjithësej 8,206 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kolonjë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, ndriçimit, dhe turizmit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë dhe mesatarizuar tarifën), për numrin e familjeve të patakshuara, do të kishim **900 lekë * 4,808 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,327,200 lekë** planifikuar dhe më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DATT Bashkia Kolonjë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 7.3.2018¹, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultoi se për arkëtimin e taksave të familjeve Bashkia Kolonjë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A Ersekë, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Kolonjë. Grupi i auditimit bëri kërkesë për numrin e familjeve, të cilat janë të pajisura me matës (pra kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë) ku rezultoi se 1861 familje nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë, ç’ka do të thotë se taksat dhe tarifave vendore për këtë numër familjesh arkëtohen vetëm kur familjet marrin shërbime të ndryshme, si vërtetime etj, të paguajnë taksat dhe tarifave familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Kreu II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë. Neni 62 dhe 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë Kolonjë.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S. L., Drejtor i DATT.

Toka bujqësore sipas kategorisë dhe njësive administrative.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore sipas DATT Bashkia Kolonjë janë 11215.5 Ha, nga të cilat 6,709 Ha sipërfaqe shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Kolonjë.

Nr	NJA	Tokë Bujqësorë Gjithsej/HA	Sipërfaqja e tokës, ndarë me AMTP	Sipërfaqja e tokës së pandarë
1	Qender Ersekë	3,811.7 ha	2,679	1,132
2	Mollas	3,099.8 ha	1,837	1,262
3	Barmash	751 ha	453	298
4	Novosele	826 ha	627	199
5	Clirim	1,310 ha	714	596
6	Erseke	129 ha	78	51
7	Leskovik	483 ha	321	162
8	Qender Leskovik	805 ha	570	299
	Total	11,215	7,279	3,999

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga DAT Bashkia Kolonjë, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Kolonjë

Kategoria e tokës	Sip/HA Qendër	Sip/HA Mollas	Sip/HA Barmash	Sip/HA Novosele	Sip/HA Clirim	Sip/HA Erseke	Sip/HA Leskovik
Kategoria II							
Kategoria III							
Kategoria IV							
Kategoria V							
Kategoria VI							
Kategoria VII	2679	1837	453	627	714	78	321
Kategoria VIII							
e. Totali sip. ha sipas planifikimit	6709						

Debitorët progresiv për taksën e tokës bujqësore deri më datë 31.12.2022

NJ.A.	Familje me tokë bujqësore 01.01.2022	Debitortë të krijuar gjatë vitit 2022	TOTAL DEBIA PROGRESIVE / Lek			
			Maturimi	Likujdimi	Debia	Total 2011-2022
Qender	1380	972,892	1,748,630	871,896	928,709	11,274,771
Mollas	1047	891,882	1,258,610	392,578	866,198	10,146,439
Navosele	361	305,970	409,955	111,090	298,795	2,308,492
Barmash	347	194,918	315,399	110,631	204,288	1,271,776
Clrim	477	429,701	485,703	55,047	430,627	4,409,728
Erske	197	138,502	50,645	19,376	31,269	148,820
Leskovik	330	264,869	224,000	194,097	29,973	241,604
Qender Leskovik	100	54,416	250,600	212,173	38,427	620,066
Shuma	4,239	3,253,150	4,743,542	1,966,888	2,828,286	30,421,696

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë

Debia Progressive në çelje të vitit 2023 deri më datë 31.12.2023

NJ.A	Familje me tokë bujqësore. Nr	TOTAL DEBIA PROGRESIVE Total 2011-2022	Maturimi	Likujdimi	Debia	TOTAL DEBIA PROGRESIVE Total 2011-2023
Qender	1380	11,274,771	1,748,419	810,093	938,326	11,295,818
Mollas	1047	10,146,439	1,262,160	411,317	850,843	10,502,826
Nvaosel	361	2,308,492	408,875	105,980	302,895	2,581,865
Barmash	347	1,271,776	311,510	84,847	226,635	1,541,221
Clirimi	477	4,409,728	485,703	44,056	440,762	4,790,598
Erske	197	148,820	50,645	23,177	27,468	147,590
Leskovik	330	241,604	224,000	193,470	30,530	258,333
Qender Leskovik	100					
		620,066	250,600	208,026	42,574	90,527
Shuma	4,231	30,421,696	6,757,912	1,800,966	2,860,033	33,281,729

Sa më sipër, duke patur në konsideratë sipërfaqen, kategorinë dhe vlerën për Ha të tokës bujqësore për çdo NJA konstatohet se, planifikimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2022-2023 është i saktë por debia e krijuar është në nivele të larta dhe përbën pothuajse 50% të totalit të borxhit të krijuar.

Debitor progresiv dhe debia e vitit 2022, kategoria familje, në nr dhe lekë (pa përfshirë taksën e tokës bujqësore).

Njësi Administrative	Progresiv deri në 31.12.2021 Pa taksën e tokës vitit 2021		Familje Debitorë krijuar 2022		Progresiv deri në vitin 2022 Pa taksën e tokës vitit 2022	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
Qendr	661	9,815,991	645	837,460	645	10,361,524
Mollas	702	8,558,712	712	885,271	712	9,277,241
Barmash	76	761,755	84	158,652	84	1,065,518
Nvosel	263	161,612	250	183,373	250	2,009,697
Clirim	391	3,568,771	113	93,639	113	3,979,101
Leskovik	282	1,459,622	58	202,353	343	1,258,505
Qender Leskovik	81	300,835	23	69,888	80	213,972
TOTAL	2456	24,627,298	1,885	2,430,636	2,227	28,165,558

Debitor progresiv dhe debia e vitit 2023, kategoria familje, në nr dhe lekë (pa përfshirë taksën e tokës bujqësore).

Njësi Administrative	Progresive deri në 31.12.2022 Pa taksën e tokës vitit 2022		Familje Debitorë krijuar 2023		Progresiv deri në vitin 2023 Pa taksën e tokës	
	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë

Qendër	645	10,361,524	624	557,759	624	10,373,357
Mollas	712	9,277,241	669	645,255	669	9,606,283
Barmash	84	10,655,518	94	125,472	94	1,314,586
Nvosel	250	2,009,697	263	139,425	263	2,278,970
Clirim	361	3,979,101	116	113,062	116	4,349,836
Leskovik	343	1,258,505	40	239,640	231	1,216,721
Qender Leskovik	80	213,972	29	60,640	79	236,479
TOTAL	2,227	28,165,558	1,835	1,881,253	2076	29,376,232

Burimi: DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në auditimin e ushtruar në DATT Kolonjë konstatohet se: Në fillim të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 2,227 familje debitorë për vlerën **28,165,558** lekë dhe në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive janë 2,067 familje debitorë për vlerën **29,376,232** lekë, ç'ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme. Për familjet që kanë në posedim tokë bujqësore për vitin 2022 rezultojnë se në celje të vitit 2022 kanë qenë 4,239 familje të cilët në fund të vitit 2022 rezultojnë me detyrime të krijuara nga vitet 2011-2022 në shumën **30,421,696** lekë. Gjatë vitit janë shtuar **2,860,033** lekë ku kanë rritur vlerën e debisë progresive e cila paraqitet në shumën **33,281,729** lekë total.

-Sa i përket familjeve debitore, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë në kundërshtim me pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. S. L., Drejtor i DATT.

Konkluzione të përgjithshme.

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Kolonjë në vlerën totale **79,424 mijë** lekë në progresiv.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve në vlerën 62,657

mijë lekë, ku vetëm për vitin 2022-2023 janë krijuar debitorë në vlerën 10,000 mijë lekë.

2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën 11,391 mijë lekë, ndërsa për vitin 2022-2023 janë krijuar 2,013 mijë lekë.

3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 759 mijë lekë.

4. Të ardhura të munguara nga qiramarrësit në vlerën 4,615 mijë lekë.

-Për vitin 2022-2023 ka ecuri lidhur me masat shtënguese por gjithsesi në nivele të ulëta vendosje apo ekzekutimi. Masat shtënguese nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkakun e mos mbledhjeve të detyrimeve. Analiza dhe planet operacionale janë një hap i cili duhej dhe duhet të jetë në të ardhmen në fokus si indikator orientues për vijimin e marrjes së masave me qëllim arkëtimin e detyrimeve për secilin debitor, biznes i madh i vogël apo cdo lloj debitori. Trendi i rritjes së detyrimeve të pa paguara mbetet akoma i lartë dhe për pasojë ka sjellë të ardhura të munguara, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Kolonjë, të ardhura këto që mund të përdorëshin nga Bashkia për investime në infrastrukturë dhe rritjen e shërbimeve me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve të kësaj bashkie.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Kolonjë, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:

z. S. L., Drejtor i DATT;

z. A. J., Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit;

z. M. T., Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore **z. E. I.**, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

(Sa më sipër subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacion mbi Projekt Raportin e auditimit)

3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet.

I. Përshkrimi i situatës.

Auditimi u krye sipas programit të auditimit

it, pika 3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë. Nën-pikat:

3.1. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme“, ndryshuar me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

3.2. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

3.3. Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

3.4. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë.

• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Bashkia Kolonjë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operationet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Kolonjë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

• Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Bashkia Kolonjë ka tre njësi shpenzuese Aparatin e Bashkisë, Qendrën e Kulturës dhe Klubin Sportiv. Për vitin 2023 ka hartuar Pasqyrat Financiare njësia shpenzuese Bashkia Kolonjë dhe dy njësitë e varësisë.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Kolonjë për vitin 2023 (të cilat përfshijnë pasqyrat financiare ushtrimore të vitit 2023 të Bashkisë Kolonjë, të Qendrës së Kulturës dhe ato të Klubit Sportiv) janë të nënshkruara nga z. E. I. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. G. D.me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Kolonjë në datë 26.03.2024, brenda afatit ligjor.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, permban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Kolonjë për aktivitetin ekonomiko- financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, nuk janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2023 nuk rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; **Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 2,983,459,57 lekë dhe për vitin 2023 është 3,132,324,407 lekë.**

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënçërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Kolonjë në 31.12.2023, sipas formatit F1, është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=2,966,309,184 lekë.**

- Aktivet 3,132,346,658 lekë

- Detyrimet 166,037,474 lekë
- Aktivitet Neto 2,966,309,184 lekë

Aktivitet afatshkurtra:

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **259,313,805 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 103,800,178 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 59,919,475 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 95,594,152 lekë

Fondi i Konsoliduar:

Llogaria 101 “Teprica (Fondi I akumuluar/Deficit i akumuluar)

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 2,917,352,587 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zërat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	4,500	2,783,085,420	Çelje
Amortizim i vitit	87,807,745	190,009,843	Investime + Dhurime
		2,712,442	Ndryshim i gjendjes së inventarit
Shuma	87,812,245	2,975,807,705	Shuma
Shuma		2,887,994,460	

Burimi: Bashkia Kolonjë

Sipas tabëlës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc është mbivlerësuar në vlerën 29,357,127 lekë. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimit të MFE Nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 103,278,538 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në shumën 36,069,298 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 69,921,682 lekë.

Lëvizjet e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në **pasqyrën PF3** në anekset e projekt raportit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 103,278,538 lekë nuk kuadron me llogaritë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” dhe 466 “Mjete në ruajtje” për vlerën 2,712,442 lekë

Fondet e papërdorura për vitin 2023 janë si më poshtë:

1-Trasferte e pakushtëzuar dhe specifike viti 2023 e papërdorur 24,355,973 lekë.

2-Të ardhurat viti 2023 të papërdorura 8,981,430 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 33,337,403 fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2023.

Llogaria 85 është nënvlerësuar në shumën 2,712,442 lekë

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Pika 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pika 50. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkangjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kolonjë në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 57,207,033,lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 6,340,667 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët ” në vlerën 50,866,366 lekë.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kolonjë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 59,919,475,lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 7,584,755 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët ” në vlerën 52,334,70 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-2,712,442 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën -2,712,442 lekë

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 7,584,755 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Llogaria 312 “Materiale” përputhet me ditarin e magazinës.

Pasqyra PF5: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 312 “Materiale”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	6,340,667
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	67,296,340
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	66,052,252
Gjendja në 31.12.2023	7,584,755

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 32 “Inventar i imët ”, ka vlerën 52,334,720 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 32 “Inventar i imët”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	50,866,366
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	1,978,121
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	2,052,614
Gjendja në 31.12.2023	50,791,866

Burimi:Bashkia Kolonjë

Gjendja e llogarive të mësipërme nuk është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Sipas ditarit të magazinës llogaria 32 “Inventar i imët” rezulton në fund të vitit 50,791,866 lekë.Për llogarinë 32 “Inventar i imët” rezulton diferencë në vlerën 1,542,854 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.e klasës 3“Gjendje inventari qarkullues”, paraqitet në **pasqyrën PF4** në anekset e raportit.

Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2023 të llogarisë 32 “Inventar i imët”

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, dhe udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhiin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2023, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e Titullarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.657 datë 05.12.2023 për ngritjen e komisionit të inventarizimit. Sipas urdhrin të mësipërm inventari i aktiveve do të zhvillohet në afatin kohor 05.12.2023 deri në 31.12.2023.

Me urdhrin nr.62 datë 25.01.2024 nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhrin për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të aktiveve të dëmtuara.

Me urdhrin nr.63 datë 25.01.2024 nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhrin për ngritjen e komisioneve të asgjësimit.

Komisioni për asgjësimin e aktiveve është i përbërë nga punonjës të ndryshëm në përputhje me udhëzimin Nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Komisioni i inventarizimit i ngritur me Urdhrin Nr.657, datë 05.12.2023 nga Titullari i Bashkisë Kolonjë ka kryer inventarizimin e asetëve të Bashkisë Kolonjë dhe ka vlerësuar asetet të cilat janë të dëmtuara ose të amortizuara sipas tabelës përmbledhëse.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **pasqyrën PF7** në anekset e raportit.

Komisioneve i Vlerësimit të Aktiveve të Dëmtuara i ngritur me urdhër nr.62, datë 25.01.2024 nuk ka ndjekur procedurën për vlerësimin e aktiveve të njësisë në kundërshtim me pikën 104 , “Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: a. nese eshte i nevojshem apo jo per veprimtarine e njesise; b. nese nuk rezulton i nevojshem per njesine, a eshte ne gjendje te mire fizike dhe ka mundesi perdorimi te metejshem ne njesi te tjera; c. nese duhet te nxirret perfundimisht jashte perdorimit nepermjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF5** në anekset e raportit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 është në shumën 62,094,115 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në shumën 63,308,707 e cila përbëhet nga një pjesë e debitorëve të trashëguara nga ish-komunat dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite.

Pasqyra PF9: Detajet e nënrubrikës ,lëvizjet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	62,094,115
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	
Gjendja në 31.12.2023	63,308,707

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 62,682,163 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 64,313,025.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF11: Detajet e nënrubrikës “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Emërtimi i llogarive	2023	2022
Klientë e llogari të ngjashme llog. 411	1,872	1,872
Personeli,paradhënie,deficite,gjoba llog. 423,429	1,002,446	1,370,507
Debitorë të ndryshëm llog. 468	63,308,707	62,094,115
Totali	64,313,025	63,466,494

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është rregjistruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë

nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (detyrime) paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme

Në rubrikën 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik, paraqrafti 21, shtohet pika c me përmbajtjes:

c)Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t’u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16, administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njëjësive si më poshtë:

-Për konstatimin paraprak të të drejtave për t’u arkëtuar debitohe llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritjes të ardhura për tu marrë”.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 31,281,127 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 31,281,127 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF10: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	2023	2022
Llogari 401-408	14,465,771	20,022,661
Paga personeli llog 42	11,892,886	10,154,760
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	582,393	545,460
Sigurime shoqërore llog.435	3,551,793	3,018,014
Sigurime shëndetësore llog.436	485,154	411,997
Kreditor të ndryshëm llog 467	303,130	303,130
Totali	31,281,127	34,456,022

Burimi:Bashkia Kolonjë

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 17,964,613 lekë. Lëvizjet e llogarisë 202 “Aktivet afatgjata jo materiale” për vitin 2023 paraqiten në pasqyrën më poshtë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF12: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata jo materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	15,993,732
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	5,004,800
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	3,149,780
Gjendja në 31.12.2023 (D)	17,848,752

Burimi:Bashkia Kolonjë

-Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” sipas regjistrit analitik është në vlerën 17,848,750 lekë e cila nuk kuadron me vlerën e regjistruar në bilanc 17,964,613 lekë.

Regjistri i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” nuk është mbajtur në mënyrë analitike për çdo projekt sipas vitit të hyrjes, vlerës së blerjes por projektet e çdo viti janë bashkuar në 1 zë e cila

është në kundërshtim me Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar pika 30.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, paraqiten në shumën 2,813,352,016 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 2,713,009,438 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 190,009,843 lekë, shtesa që kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje , në Bashkinë Kolonjë dhe NJ.A Administrative si dhe pakësimet nga amortizimi dhe lëvizjet brenda aktiveve në shumën 87,812,245 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF13: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale” viti 2022.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2021	Shtesa 2022	Amortizim 2022	Pakësime 2022	Gjendja me 31.12.2022
210	Toka,Troje,Terrene	3,330,850	0	0	0	3,330,850
211	Pyje, Kullota, Plantacione	25,909,872	0	0	0	25,909,872
212	Ndërtime e Konstruksione	567,893,712	15,111,944	24,996,227	0	558,009,429
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,052,133,276	1,030,345,163	37,006,976	0	2,045,471,463
214	Instalime dhe paisje	36,944,903	16,047,608	9,345,997	0	43,646,514
215	Mjete Transporti	23,632,377	0	2,982,003	0	20,650,374
218	Inventar Ekonomik	16,440,378	5,030,796	5,471,180	9,058	15,990,936
	Shuma	1,726,285,368	1,066,535,511	79,802,383	9,058	2,713,009,438

Burimi:Bashkia Kolonjë

Pasqyra PF14: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale” viti 2023.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim 2023	Pakësime 2023	Gjendja me 31.12.2023
210	Toka,Troje,Terrene	3,330,850	0	0	0	3,330,850
211	Pyje, Kullota, Plantacione	25,909,872	0	0	0	25,909,872
212	Ndërtime e Konstruksione	558,009,429	7,939,767	23,959,917	0	541,989,279
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,045,471,463	169,055,015	45,326,346	0	2,169,200,132
214	Instalime dhe paisje	43,646,514	4,405,101	8,045,850	4,500	40,001,265
215	Mjete Transporti	20,650,374	3,060,000	2,997,602	0	20,712,772
218	Inventar Ekonomik	15,990,936	545,160	4,328,250	0	12,207,846
	Shuma	2,713,009,438	185,005,043	84,657,965	4,500	2,831,316,629

Burimi:Bashkia Kolonjë

1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene” është paraqitur në bilanc në vlerën 3,330,850 lekë në fund të vitit 2022..Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2023 dhe është rregjistruar në bilanc në vlerën 3,330,850 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik.Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar analitikisht por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite në kundërshtim me SKK 5(i përditësuar), Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është paraqitur në bilanc në vlerën 25,909,872 lekë në fund të vitit 2022..Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2023 dhe është rregjistruar në bilanc në vlerën 25,909,872 lekë në kundërshtim me SKK 5 (i përditësuar), Aktivët afatgjata materiale dhe aktivët afatgjata jomateriale, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

3. Llogaria 212 “ Ndërtesa dhe konstruksione” cila pasqyron gjendjen 192 aseteve për llogari të Bashkisë Kolonjë, në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 558,009,429 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me një vlerë neto 541,989,279 lekë. Diferenca në ulje vlere prej 16,020,150 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2023 nga viti 2022.

Kjo rritje në vlerë vjen për shkak të kapitalizimit të investimet e kryera në vitin 2023.

Kapitalizimi për vitin 2023 është në vlerën 7,939,767 lekë për objektet si më poshtë:

- 1-Rikonstruksion çatia (shtesa 487,309 lekë)
- 2-Banesa sociale Leskovik (shtesa 714,992 lekë)
- 3-Përmirësim i banesave ekzistuese Bashkia Kolonjë (shtesa 2,145,079 lekë)
- 4-Riparim fasade shkolla 9 vjeçare (838,800 lekë)
- 5-Rikonstruksion pallati viti 2021 (4,052,067 lekë)
- 6-Materiale Qendra multifunkionale (shtesa 2,301,168 lekë)
- 7-Mbikqyrje punimesh (shtesa 835,844 lekë)
- 8- Mbikqyrje punimesh (shtesa 52,200 lekë)
- 9- Mbikqyrje punimesh (shtesa 368,145 lekë)
- 10- Mbikqyrje punimesh (shtesa 196,230 lekë)

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, paraqitet në **pasqyrën PF15** në anekset e raportit.

Sipas rregjistrimit analitik është në vlerën 549,456,627 lekë e cila nuk kuadron me vlerën e rregjistruar në bilanc 558,009,429 lekë. Për kontabilizimin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” për 4 procedura mbikqyrje punimesh me vlerë 1,452,419 lekë janë rregjistruar në llogari analitike të ndara dhe jo duke ju bashkuar objektit të investimit është vepruar në kundërshtim me SKK 5 “Aktivët afatgjata materiale dhe jo materiale”. Ku citon:

“Kuai i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, *Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese, vetëm dhe vetëm nëse (a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike; (b)përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme; dhe (c)shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të një njësie ekonomike raportuese, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.* SKK 5 “Aktivët afatgjata materiale dhe jo materiale” pika 43

“ *Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar (duke përfshirë këtu aftësinë e tyre për të marrë pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike). Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor”.*

4. Llogaria 213 “ Rrugë,rrjete,vepra ujore” cila pasqyron gjendjen 124 aseteve për llogari të Bashkisë Kolponjë, në fund të vitit 2022 rezulton me një vlerë neto 2,045,471,463 lekë dhe në fund të vitit 2023 rezulton me një vlerë neto 2,169,200,132 lekë. Diferenca në rritje vlere prej

123,728,669 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2023 nga viti 2022. Llogaria 213 “Rrugë,rjete,vepra ujore”, paraqitet në **pasqyrën PF16** në anekset e raportit.

Kapitalizimi për vitin 2023 është në vlerën 169,055,015 lekë për objektet si më poshtë:

- 1-Rrjeti i shpërndarjes të furnizimit me ujë (shtesa 139,486,029 lekë)
- 2-Rehabilitim i sheshit hyrës të Rehovës (3,186,206 lekë)
- 3-Materiale shtrim pllaka guri Leskovik (2,696,960 lekë)
- 4-Rikonstruksion trotuarësh (2,499,120 lekë)
- 5- Rikonstruksion trotuarësh (2,980,000 lekë)
- 6-Materiale shtrim pllaka guri (1,176,000 lekë)
- 7-Shtim i sipërfaqeve të gjelbra (453,600 lekë)
- 8-Vend depozitimi i kafshëve të ngordhura (594,000 lekë)
- 9-Prita (553,100 lekë)
- 10-Lera (524,500 lekë)
- 11-Rikualifikim Pali Prifti (14,905,500 lekë)

5. Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve te transportit në pronësi të Bashkisë Kolonjë më datë 31.12.2023 në shumën 20,712,772 lekë.

Kjo llogari është shtuar në vlerën 3,060,000 për blerjen e 1 mjeti.Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 2,997,602 lekë.Rritja neto e llogarisë 215 “Mjete transporti” për vitin 2023 është në vlerën 62,398 lekë.

Pasqyra PF17: Detajet e nënrubrikës “*Mjete transporti*”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	20,650,374
Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	3,060,000
Pakësimet gjatë vitit 2023 (K)	2,997,602
Gjendja në 31.12.2023	20,712,772

Burimi:Bashkia Kolonjë

6. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Kolonjë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kolonjë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 12,207,846 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventari ekonomik” ka zbritur me vlerën 3,783,090 lekë.

Pasqyra PF18: Detajet e nënrubrikës “*Inventar ekonomik*”.

Lëvizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2023, vlera në lekë	
Çelje në 01.01.2021	15,990,936
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	545,160
Dalje (K)	4,328,250
Gjendja në 31.12.2023	12,207,846

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Kolonjë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën(891,416,549) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (87,807,745) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Lëvizja e llogarisë 219“Amortizimi i AAGJM & AAJM”, paraqitet në **pasqyrën PF19** në anekset e raportit.

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Kolonjë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivitet Afatgjata Financiare

Titulli gjetjes:Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 “Aktivitet Afatgjata Financiare”

Situata: Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2022 dhe 2023 në vlerën 0 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël 2023 është paraqitur në vlerën zero siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

-Bashkia Kolonjë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 7% të aksioneve të “K” SH.A me NUIS“K.....O” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Mbledhja,transporti,administrimi,depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale.”. Numri i aksioneve është 226 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,740,300 lekë.Nga këto Bashkisë Kolonjë i përkasin 15.82 aksione me kapital në vlerë monetare 261,821 lekë

-Bashkia Kolonjë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 3.64% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë” sh.a me NUIS“M24431001N” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 3,638 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 363,800 lekë.

Vlerat e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit në asnjë rast nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023 ,më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesmarrje”.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 625,621 lekë dhe investori është Bashkia Kolonjë.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivitet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne Pjesmarrje me vlerë kontabël 625,621 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.

4. Investimet:

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 41,716,224 lekë Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 41,716,224 lekë, përkatësisht 0 lekë në llogarinë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 41,716,224 lekë në llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale”.

Pasqyra PF 20: Investimet sipas kontratave të lidhura në vitet 2022-2023 të cilat janë në proces punimesh.

Emërtimi	Operatori Ekonomik	Nr.Fature	Dt.Fature	Shuma
Rivitalizimin e Qendrës Multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë	A. Shpk	57/2022	25.07.2022	612,660
Rivitalizim I Qendres Multifunkionale	A. Shpk	57/2022	25.07.2022	3,000,000
Rikonstruksion Kanali Gostivisht	Z. Shpk	43/2022	21.11.2022	6,650,000
Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022	Z. Shpk	5/2023	16.03.2023	3,040,000
Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022	Z. Shpk	25/2023	02.09.2023	4,085,000
Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023	R. Shpk, B. Shpk	7/2023	27.12.2023	21,058,924
Materiale Rruga e llixhave Sarandapor (dhurimet)				3,269,640
Totali				41,716,224

Burimi: Bashkia Kolonjë

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Kolonjë më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF21: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

Llogaritë		Viti 2023	Viti 2022	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	14,465,771	20,022,661	(5,556,890)
42	Detyrime ndaj personelit	11,892,886	10,154,760	1,738,126
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	582,393	545,460	36,933
435	Sigurime shoqërore	3,551,793	3,018,014	533,779
436	Sigurime shëndetsore	485,154	411,997	73,157
467	Kreditor të ndryshëm	303,130	303,130	0
Total		31,281,127		

Burimi: Bashkia Kolonjë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është në vlerën 14,465,771 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Kolonjë më 31.12.2023. Analiza e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në **pasqyrën PF22** anekset e raportit.

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 14,465,771 lekë përbëhet nga fatura të palikujduara. Fatura të palikujduara të cilat kanë kaluar afatin 60 ditor janë në vlerën 12,863,221 lekë dhe përbëhen nga 13 fatura tatimore sipas tabelës si më poshtë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF 23** më poshtë.

Objekti	Operatori Ekonomik	Nr.fat	Data	Shuma
	S. K.			19,000
	Argjendri “P.”			22,000
	G. C.			16,000
	A. K.			157,200
Materiale Ndricimi LED Leskovik	A. Shpk	76/2022	21.10.2022	7,550,381

Karburant dhe vaji	O. Shpk	5682/2023		867,000
Karburant dhe vaji	O. Shpk	6279/2023	27.10.2023	1,960,000
Karburant dhe vaji	O. Shpk	8483/2023		5,360
Karburant dhe vaji	O. Shpk	3022/2023	03.05.2023	88,500
Plan Mbarështimi	E. C.		02.10.2023	1,874,650
H. Z.	T shpk	270	04.03.2021	137,110
Mirembajtje Automjeteve	T SHPK	520,521	10.09.2018 14.09.2018	120,915
Blerje Pellet për ngrohje	A shpk	82	19.11.2018	45,105
Totali				12,863,221

Burimi:Bashkia Kolonjë

Stoku i detyrimeve të prapambetura të raportuar në MFE me shkresën Nr. 817 prot, datë 13.02.2023 është në vlerën 303,130 lekë dhe përbëhet nga 3 fatura tatimore raportimi i stokut nuk tregon gjendjen reale dhe është raportuar në kundërshtim me udhëzimin Nr.37 datë 06.10.2020. Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF 28** më poshtë.

Lloji i detyrimit	Viti i krijimit	Operatori Ekonomik	Shuma në lekë
H. Z.	Nr.270 dt 04.03.2021	T shpk	137,110
Mirembajtje Automjeteve	Nr. 520 date.10.09.2018 Nr.521 date.14.09.2018	T SHPK	120,915
Blerje Pellet për ngrohje	Nr. 82 date.19.11.2018	A shpk	45,105
Total			303,130

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Kolonjë, paraqitet në vlerën 11,892,886 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe jane paguar ne muajin janar 2024 ne shumen 11,892,886 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF24** më poshtë.

Urdhër Shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
7	05.01.2024	Planifikimi ,menaxhimi,administ	1,923,780
8	05.01.2024	Sherbimet e policise vendore	288,276
9	05.01.2024	Sherbimi Bujqesor	291017
10	05.01.2024	Planifikimi Urban	192,959
11	05.01.2024	Arsimi baze + Parashkollorin	2,200,107
12	05.01.2024	Arsimi Parauniversitar+konvikt	604,897
13	05.01.2024	Menaxhimi i infrastruktures+ujitj	250,753
14	05.01.2024	Administrimi Pyje+Kullota	622,172
15	05.01.2024	Mbrojtja nga zjarri	820,162
16	05.01.2024	Rrjeti Rrugor Rural	325,511
17	05.01.2024	Mbrojtja Civile	229,271
18	05.01.2024	Perkujdesi Social	306,696
19	05.01.2024	Menaxhimi i Mbetjeve	1,330,724
20	05.01.2024	Sherbimet Vendore Publike	1,335,979
21	05.01.2024	Strehimi	43,017
22	12.01.2024	Gjendja Civile	224,055
	05.01.2024	Arti, Kultura dhe Turizmi	763,200
	05.01.2024	Sporti	140,310
Totali			11,892,886

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 582,393 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar

ne Janar 2024.

Sipas analizës së pasqyrës së më poshtë vlera e paguar sipas urdhër shpenzimeve është 567,393 lekë. Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” është mbivlerësuar për shumën 15,000 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF25** më poshtë.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
5	05.01.2024	Tatim Page	532,151
2	05.01.2024	Tatim Page	28,677
2	05.01.2024	Tatim Page	6,565
Shuma			567,393

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 3,551,793 lekë.

Sipas analizës së pasqyrës së më poshtë vlera e paguar sipas urdhër shpenzimeve është 3,496,016 lekë. Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” është mbivlerësuar për shumën 55,777 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF26** më poshtë.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
3	05.01.2024	Sigurime Shoqërore 9.5%	1,256,896
1	05.01.2024	Sigurime Shoqërore 15%	1,984,570
1	05.01.2024	Sigurime Shoqërore 9.5%	82,991
1	05.01.2024	Sigurime Shoqërore 15%	131,038
1	05.01.2024	Sigurime Shoqërore 9.5%	15,714
1	05.01.2024	Sigurime Shoqërore 15%	24,810
Shuma			3,496,016

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 436, “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetsore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 485,154 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF27** më poshtë.

Urdher shpenzimi		Përshkrimi	Shuma në lekë
Nr	Data		
2	05.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7%	224,915
4	05.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7%	224,915
1	05.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7%	14,851
1	05.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7%	14,851
1	05.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7%	2,812
1	05.01.2024	Sigurime Shëndetsore 1.7%	2,812
Shuma			485,156

Burimi:Bashkia Kolonjë

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Kolonjë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 69,921,682 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për vlerën e mësipërme nuk kemi informacion analitik dhe rakordim me Degën e Thesarit Kolonjë.

- Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Kolonjë më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 61,111,260 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 69,921,682 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Në lidhje me shtesat apo pakësimet për këtë llogari, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion.

Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë për llogarinë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, Grupit të Auditimit i ka është vendosur në dispozicion vetëm informacion për ngurtësimet e garancive nga viti 2020-2023 por nuk kemi informacion për çngurtësimet dhe për vlerën reale të kësaj llogarie. Gjithashtu nuk kemi informacion për garanci përpara vitit 2020 të cilat ju ka kaluar afati dhe mund të jene akoma të ngurtësuara.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Nga Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e garancive të bllokuara.

Në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Pika 30: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50: “Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: “Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”

Llogari 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në datën 31.12.2023, është regjistruar në vlerën 303,130 lekë.

Në mënyrë analitike, Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në fund të vitit 2023 është paraqitur në Pasqyrën PF28 më poshtë:

Lloji i detyrimit	Viti i krijimit	Operatori Ekonomik	Shuma në lekë
H. Z.	Nr.270 dt 04.03.2021	Tshpk	137,110
Mirembajtje Automjeteve	Nr. 520 date.10.09.2018 Nr.521 date.14.09.2018	T SHPK	120,915
Blerje Pellet per ngrohje	Nr. 82 date.19.11.2018	A shpk	45,105
Total			303,130

Burimi:Bashkia Kolonjë

3.4 e programit të auditimit “Në zbatim të pikës 3.4 të programit të auditimit, “Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës”.

Lista e pronave të paluajtshme Bashkia Kolonjë e miratuar me listë përfundimtare me vendim Nr.366, datë 13.05.2011. Lista e inventarit me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 497 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë), prona të klasifikuara në kategori sikurse janë:

Në përdorim

- Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji;

Në pronësi,

- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës,
- Prona që përdoren në fushën e shërbimit social,
- Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive,
- Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik,
- Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik,
- Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore,
- Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike),
- Varrezat publike
- Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.

-Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Qendër Ersekë e miratuar me listë përfundimtare me vendim Nr.247, datë 27.03.2013. Lista e inventarit me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 496 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë), përmban 380 prona.

-Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Leskovik/Qendër Leskovik, të transferuara me VKM nr. 379, datë 08.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim. Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë përfundon me numrin rendor 420 (katërqind e njëzet), e cila përmban 420 prona.

-Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Novoselë/Barmash e miratuar me listë me vendim Nr.482, datë 16.04.2008, Nr.368, datë 01.04.2009, përmban 912 prona.

-Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Mollas/ Çlirim e miratuar me listë me vendim Nr.1087, datë 23.07.2008, me vendim Nr.253 përmban 1157 prona.

-Lista e pyjeve dhe kullotave të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” ku numri i pronave pyje dhe kullota që ka Bashkia Kolonjë është 1739, me sipërfaqe totale **46,942.97 ha**.

-Nga Bashkia Kolonjë gjatë viteve 2022-2023 nuk janë ngritur grupe pune për të bashkëpunuar me DVASHK Korçë, në lidhje me regjistrimin e pronave sipas listës së aseteve të miratuara me VKM, për Bashkinë dhe Nj/Administrative. Gjithashtu, lidhur me listat e pronave të paluajtshme në njësitë administrative nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020, Neni 37 “Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore 1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. 2. Procedura e përditësimit mbështetet në: a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së; b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës. Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit

që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj. 3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se; me ndarjen e re territoriale Bashkisë Kolonjë i janë shtuar 4 njësi Administrative.

-Bashkia Kolonjë

-Njësia/A Qendër Ersekë

-Njësia/A Leskovik/Qendër Leksovik

-Njësia/A Novoselë/Barmash

-Njësia/A Mollas/Çlirim

Nga auditimi rezultoi se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27,28, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.**

Përmbledhëse e pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve, përkatëse të njësive administrative dhe Bashkisë Kolonjë

Tabela 1: Numri i pronave të Bashkisë Kolonjë dhe i njësive administrative

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara	Nr. i Pronave në proces regjistrimi	Prona të paregjistruara
1	Bashkia Kolonjë	497	-	-	497
2	Nj/A Qendër Ersekë	380	7	2	371
3	Nj/A Leskovik/Qendër Leskovik	420	1	-	419
4	Nj/A Novoselë/Barmash	912	-	-	912
5	Nj/A Mollas/ Çlirim	1157	11	2	1,144
	Totali	3,366	19	4	3,343

Siç shihet nga tabela e mësipërme, bashkia Kolonjë ka regjistruar 19 prona në DVASHK Korçë dhe ka në proces regjistrimi 4 prona.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga drejtoria e financës, në lidhje me trojet, ndërtesat dhe sheshet publike, nuk kemi raste të zaptimit të trojeve në administrim të Bashkisë Kolonjë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit nga strukturat e bashkisë rezultoi se; në strukturën aktuale organizative të bashkisë Kolonjë nuk ka drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, detyrat e të cilës i kryen drejtoria e Financës, drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, si dhe drejtoria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural. Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.**

Përsa i përket këtyre pronave nga bashkia Kolonjë rezultoi se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave janë të patrajtuara nga ana e DVASHK Korçë, ka mungesë të ardhurash për të bërë aplikim në kadastër.

-Rezultoni se bashkia Kolonjë nuk ka kryer veprimet sipas VKM nr. 600, datë 13.10.2021, Ligjit nr.10296 /Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për ngritjen e grupeve të punës për marrjen

në dorëzim dhe regjistrimin për një numër të madh të pronave sipas tabelës së mësipërme, çka bën të paqartë numrin e tyre sipas listave të inventarëve. Përsa i përket verifikimit në terren nëse këto prona janë të lira apo të zaptuara ose dhe të tjetërsuara nga palë të treta, nuk janë kryer verifikime.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji Nr.20, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,

3.4.2. Administrimi i sipërfaqeve kullimore dhe inventarizimi Pyje/kullota

Referuar VKM-së nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, lista e inventarit fillon me numrin rendor 1(një) dhe mbaron me numrin rendor 1739(njëmijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë), ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”, Bashkia Kolonjë ka në pronësi 27,302 ha kullota. Këto kullota administrohen nga “Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave” dhe sipërfaqe të caktuara të tyre jepen me qira në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si, Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 2 datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”.

-Nga auditimi rezulton se, bashkia Kolonjë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, është pajisur me certifikatë pronësie për sipërfaqet pyjore, kullimore dhe shkëmbore që administrohen vetëm në rastet kur ka pasur qiradhënie të këtyre pronave.

-Nga auditimi rezultoi se, bashkia Kolonjë gjatë vitit 2022 dhe 2023 **ka të certifikuar 317.6 ha sipërfaqe pyjore dhe kullimore.**

- Nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27,28, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

Në fondin Pyjor në bashkinë Kolonjë dhe Nj/A, nga informacioni që kemi marrë nga DPK janë miratuar 37 kontrata sezonale për vitin 2022 dhe 47 për vitin 2023, me afat 6 mujor, me objekt “Kullota” dhe “Kositje bari”, duke gjeneruar të ardhura në vlerën **3,325,180** lekë.

Nga auditimi i këtyre kontratave rezultoi se nuk është zbatuar procedura e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, pasi të gjitha dosjet e subjekteve qiramarrës të kullotave nuk janë plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar sipas Udhëzimit të sipërpërmendur, ku mungon procesverbali i dorëzimit të parcelave të marra me qira.

Tabela 2: Plani dhe realizimi i të ardhurave nga kullotat e dhëna me qira për periudhën 01.10.2021 deri 31.12.2023

Emërtimi	Kapaciteti i kullotave në/krerë gjithsej	Kullota gjithsej/ha	Planifikimi i të ardhurave	Sip. e dhënë me kontratë	Spi. me faturë	Krerë te kontraktuar	Të ardhurat Nga kullota
Kullota Verore 2023	49,511	16,000	3,700,000	3,400		14,000	1,828,210
Dhen	46,334					12,130	
Dhi	1,899					800	
Të Trasha	1,268					1,070	
Kullota Verore 2022	49,511	16,000	3,700,000	2,600		11,300	1,496,970
Dhen	46,334					10,000	

Dhi	1,899				400	
Të Trasha	1,268				900	
Totali Viti 2022+2023	49,511	16,000		6,000	25,300	3,325,180
Dhen	46,334				22,130	
Dhi	1,899				1,200	
Të Trasha	1,268				1,970	

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezulton se të ardhurat nga kullotat për vitin 2022 janë realizuar në masën **40.45%**, nga **3,700,000 lekë të planifikuara janë realizuar 1,496,970 lekë**.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezulton se të ardhurat nga kullotat për vitin 2023 janë realizuar në masën **49.4%**, nga **3,700,000 lekë të planifikuara janë realizuar 1,828,210 lekë**.

Mosarritja e objektivave vjen si rezultat i disa problematikave që DPK ka, që janë:

- Mungesa e manaxhimit të zonave kadastrale,
- Vështirësi në përcaktimin e kufijve.

-Tokat e lira bujqësore

Referuar të dhënave që administron Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (DBZHR), Bashkia Kolonjë ka gjithsej 11,210 ha tokë bujqësore, nga të cilat 7,220 ha është marrë nga banorët me AMTP dhe 3,990 ha është tokë e pa ndarë në pronësi të bashkisë.

Tabela 3: Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Kolonjë

Nr.	Njësia Administrative	Tokë gjithsej	Tokë e marrë me AMTP (ha)	Sipërfaqe e pandarë në pronësi të bashkisë (ha)
1	NjA Erseke	121	78.7044	42.2956
2	NjA Leskovik	483.857	321.926	161.931
3	NjA Q. Erseke	3811.7	2679.5	1132.2
4	NjA Mollas	3099.8245	1837.4788	1262.3457
5	NjA Çlirim	1310.6152	714.8609	595.7543
6	NjA Novosele	826.3108	627.3486	198.9622
7	NjA Barmash	751.3864	453.6921	297.6943
8	NjA Q. Leskovik	805.7184	506.7018	299.0166
Shuma		11210.4123	7220.2126	3990.1997

Gjithashtu rezulton se DBZHR gjatë vitit 2022-2023 ka lidhur vetëm 1 kontratë me afat 99 vjeçar për dhënie me qira të tokës bujqësore. Kjo tokë do të përdoret nga qiramarrësi për mbjellje kulturore arrore. Referuar sipërfaqes totale të panadarë në tabelën e mësipërme rezulton se; nuk është bërë menaxhimi me efikasitet, ekonomicitet dhe efektivitet i kësaj sipërfaqe, duke sjellë mungesë të ardhurash për bashkinë Kolonjë. Veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 36, pika a).

Tabela 4: Lista e kontratave të girasë bashkia Kolonjë për vitin 2022-2023

Nr.	Bashkia Kolonjë	Fshati	Afati i kontratës	SIP	Aktiviteti	Fillimi Kontratës	Mbarimi Kontratës	Detyrimi vjetor + kamatë
	Emër Mbiemër		Vjet					Paguar (lekë të rinj)
1	M.	Starje	99	1.83 ha	Dhënie në përdorim të tokës bujqësore për mbjellje kulturore arrore	03.04.2023	02.04.2122	11,895
SHUMA								

1.Subjekti “M.”, kontratë qiraje me Nr. 1932 prot., datë 12.04.2023 për “Dhënien në përdorim të tokës bujqësore”, lidhur ndërmjet bashkisë Kolonjë përfaqësuar nga Z. E. I. dhe subjektit “M.” përfaqësuar nga Z. F. Q.. Kjo kontratë është me afat 99 vjeçar. Sipërfaqja e marë me qira është 1.83 ha në zonën kadastrale 3510, fshati Starje, Kolonjë. Kjo sipërfaqe meret me qira për mbjellje kulturë arrore.

Sipas kontratës referuar UKM Nr.1, datë 18.07.2012, “Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” tarifa e pagesës për sip. 1.83 ha do të jetë 11,895 lekë në vit. Nga auditimi i kësaj kontrate rezultoi në përputhje me kushtet e përcaktuara në UKM Nr.1, datë 18.07.2012, “Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” si dhe ligjit Nr.8312, datë 26.03.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”.

- Rezultoi se në territorin e bashkisë Kolonjë ushtrojnë aktivitet 11 Shoqëri Koncesionare të prodhimit të hidro energjisë një pjesë e të janë pajisur me kontratë qiraje sipas tabelës vijuese; Grupi i auditimit bëri verifikimin e lejeve aktive të paraqitura në faqen zyrtare të AKBN-së ku konstatohet se; këto leje nuk përputhen plotësisht me kontratat e paraqitura nga subjekti bashkia Kolonjë.

Lejet e paraqitura në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Tabela 5: Lista e HEC-ve në territorin e Bashkisë Kolonjë

Subjekti	Aktiviteti	Forma	Ekonomia	Ngastra	Sip ha	Përdorimi i territorit	Pronësia	Linja Elektrike Km	Gjatësia e kanalit km	Vlera e kontratës që ka qenë lek/vit
C. shpk	HEC	Koncesion	Çlirim	95a, 98a, 100a, 120a, 121a, 121c	1.192	Pyll, Inproduktive	Bashkia Kolonjë	-	6.5	144,250
C. shpk	HEC	Koncesion	Çlirim	102a, 104a, 105a, 106a	0.8328	Pyll	Bashkia Kolonjë	-		128,706
C. shpk	HEC	Koncesion	Çlirim	96a, 101a, 111a		Pyll	Bashkia Kolonjë	-		35,200
F.	HEC	Koncesion	Çlirim	108a, 110a, 111a	0.948	Pyll	Bashkia Kolonjë	1.9	-	311,020
H. sh.p.k Korçë	HEC	Koncesion	Qarr-Kozel	110a	0.1	Pyll	Bashkia Kolonjë	-	-	44,789
H. sh.p.k Korçë	HEC	Koncesion	Qarr-Kozel	107a, 107c	0.2845	Pyll, Djerr	Bashkia Kolonjë	-	0.85	105,852
Hec T.	HEC	Koncesion	Ballabanov	53,54,57,58	2.9832	Pyll	Bashkia Kolonjë	9.6	-	-
R.	HEC	Koncesion	EK,EP Qendër Ersekë	18,19,23 dhe 20,26	-	Pyll, Kullotë	Bashkia Kolonjë	2.32	1.39	676,620
M.	HEC	Koncesion	EKP Çlirim	16b, 16c, 17c, 17d, 18c, 18d, 85a, 86a, 9	-	Pyll, Kullotë	Bashkia Kolonjë	3.112	5.69	1,393,225
S.	HEC	Koncesion	EKP Qendër-Gramoz		0.666		Bashkia Kolonjë	-	5.9	940,498 dhe vitet e tjera 899,080
B.	HEC	Koncesion	EP Barmash, EP Piskal	85 Barmash, 28 Piskal			Bashkia Kolonjë		1.35	67,750
Totali										

Burimi: Bashkia Kolonjë, përgatiti grupi i auditimit

Nga auditimi me zgjedhje për hartimin dhe nëshkrimin e kontratave si dokumentacioni shoqëruar rezultoi si mëposhtë:

1.Subjekti “C.” shpk me NIPT J.....V, ka lidhur kontrata qiraje me Ish-Komunë Mollas dhe ish-Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Kolonjë, datë 07.09.2011 me objekt marrje me qira nga fondi pyjor prej 2.3440 ha e cila është pjesë e fondit pyjor publik, ekonomia pyjore Çlirim. Qëllimi i përdorimit

është “Për ndërtimin e hidrocentralit, Qafzezë”. Afati i kontratave është për 10 vite, vlera e qirasë vjetore është 306,258 lekë. Raporti mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e sipërfaqeve fond pyjor dhe kullor në pronësi publike për ndërtimin e HEC Qafzezë, është mbajtur në datën 06.02.2020.

Nga auditimi i kësaj kontratë konstatohet se:

- Bazuar në raportin e hartuar mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e sipërfaqeve fond pyjor dhe kullor në pronësi publike për ndërtimin e HEC-it Qafzezë, raport i kryer në datën 06.02.2020, konstatohet se tarifa e përcaktuar është prej 1,315,930 lekë/vit të fondit pyll, shkurre për kontratat me afat 10 vjet, e përcaktuar sipas VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” lidhja nr. 2 “Tarifat dysHEME për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj.).

- Me urdhër të Titullarit të Institucionit Bashkia Kolonjë z.E. I., me nr.427, datë 25.11.2019 është ngritur Grupi i Punës për realizimin e raportit tekniko-ekonomik të sipërfaqeve në përdorim nga fondi pyjor kullor të marra nga HEC-i Qafzezë, në përbërje të cilit janë: z.E. C., z.A. J. dhe z.R. N..

Grupi i punës ka hartuar raportin teknik përkatës me nr.366/1 datë 06.02.2020, i firmosur prej tyre si dhe i miratuar nga Titullari i Insitucionit, ku nga matjet e kryera në terren kanë përcaktuar sipërfaqet e shfrytëzuara në pronësi publike të Bashkisë Kolonjë për Hec-in Qafzezë, ndërtuar nga subjekti C. shpk.

- Shuma e përlllogaritur nga raporti teknik sipas sipërfaqeve në përdorim është si më poshtë:

a)Vlera e përdorimit në lek/vit $0.033 \text{ ha} = 3,630 \text{ lekë}$

Trungishte $0.033 \text{ ha} \times 110,000 = 3,630 \text{ lekë}$

a.1)Vlera e përdorimit për tubacion/kanalin në $9.9 \text{ km} = 1,315,930 \text{ lek}$

Trungishte $0.036 \text{ km} \times 175,000 = 6,300 \text{ lekë}$

Cungishte $5.4 \text{ km} \times 145,000 \text{ lekë} = 783,000 \text{ lekë}$

Kullota $0.8 \text{ km} \times 145,000 = 116,000 \text{ lekë}$

Inproduktive $3.7 \text{ km} \times 110,000 = 407,000 \text{ lekë}$

Nisur nga matjet dhe përfundimet e kryera nga grupi i mësipërm pjesë e Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Kolonjë, vlera në total për qiranë vjetore është **1,315,930 lekë**. Nga auditimi rezulton se ky subjekt prej tre vjetësh ushtron aktivitetin pa pasur një kontratë të vlefshme me bashkinë, si rezultat shuma **3,947,790 lekë** ($1,315,930 \text{ lekë/vit} \times 3 \text{ vjet} = 3,947,790$) konsiderohet **efekt financiar për buxhetin e Bashkisë Kolonjë**.

Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27, pika 5, neni 36, pika 1, nënpika a).

VKM nr.54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu VI, “Monitorimi i Kontratave”.

2.Subjekti “F.” shpk me NIPT J.....V, ka lidhur kontratë qiraje me ish-Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Kolonjë, datë 26.08.2023 me objekt marrje me qira nga fondi pyjor prej 1.379 ha e cila është pjesë e fondit pyjor publik, ekonomia pyjore Çlirim. Qëllimi i përdorimit është “Për ndërtimin e hidrocentralit, Qarr”. Afati i kontratës është për 10 vite, vlera e qirasë vjetore është **311,020 lekë**. Raporti mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e sipërfaqeve fond pyjor dhe kullor në pronësi publike për ndërtimin e HEC Qarr, është mbajtur në datën 26.02.2020.

Nga auditimi i kësaj kontratë konstatohet se:

- Bazuar në raportin e hartuar mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e sipërfaqeve fond pyjor dhe kullor në pronësi publike për ndërtimin e HEC-it Qarr, raport i kryer në datën 26.02.2020, konstatohet se tarifa e përcaktuar është prej 1,315,930 lekë/vit të fondit

pyll, shkurre për kontratat me afat 10 vjet, e përcaktuar sipas VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” lidhja nr. 2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullësorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj.).

- Me urdhër të Titullarit të Institucionit Bashkia Kolonjë z.E. I., me nr.428, datë 25.11.2019 është ngritur Grupi i Punës për realizimin e raportit tekniko-ekonomik të sipërfaqeve në përdorim nga fondi pyjor kullësor të marra nga HEC-i Qarr, në përbërje të cilit janë: z.E. C., z.A. J. dhe z.R. N..

Grupi i punës ka hartuar raportin teknik përkatës me nr.365/1 datë 06.02.2020, i firmosur prej tyre si dhe i miratuar nga Titullari i Insitucionit, ku nga matjet e kryera në terren kanë përcaktuar sipërfaqet e shfrytëzuara në pronësi publike të Bashkisë Kolonjë për Hec-in Qarr, ndërtuar nga subjekti F. shpk.

- Shuma e përlllogaritur nga raporti teknik sipas sipërfaqeve në përdorim është si më poshtë:

a)Vlera e përdorimit në lek/vit

Trungishte 0.018 ha x 175,000=3,150 lekë

a.1)Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në 0.7 km=101,500 lek

Cungishte 0.7 km x 145,000 lekë=101,500 lekë

a.2)Vlera e përdorimit për tubacion/kanalin në 2.5 km=362,500 lek

Cungishte 2.5 km x 145,000 lekë=362,500 lek

Nisur nga matjet dhe përfundimet e kryera nga grupi i mësipërm pjesë e Drejtorisë së Pyjeve në Bashkinë Kolonjë, vlera në total për qiranë vjetore është **467,150 lekë.**

Subjekti	Nipti	Kontrata	Afati Kontratës	Sipërfaqja e dhënë me qira në ha	Vlera qirasë e kontratës së mëparshme	Vlera e qirasë së rillogaritur sipas raportit teknik	Vite në përdorim	Detyrimi referuar kontratës vjetër	Detyrimi i rillogarit me raportin teknik	Pagesa të kryera	Detyrimi i mbetur
					a	b	c	d=a*c	e=b*c	f	g=e-f
F.	J.....V	Ish-DPK-së Kolonjë, datë 26.08.2013	26.08.2013-25.08.2023 (10 vjecar)	1.379 Ha	311,020	467,150	10 vite	3,110,200	4,671,500	3,110,200	1,561,300

Në tabelën e mësipërme pasqyrohet vlera vjetore e qirasë së lidhur ish-Drejtorinë e shërbimit pyjor Kolonjë, prej 311,020 lekë në vit, për periudhën 10 vjeçare të kontratës është kryer gabim dhe në shkelje të VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” lidhja nr. 2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullësorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11,” pasi vlera e duhur dhe e rillogaritur është 467,150 lekë në vit ose për 10 vite 4,671,500 lekë (vlerë kjo e cila bazohet në raportin tekniko-ekonomik të kryer nga Drejtoria e Pyjeve në Bashkinë Kolonjë).

Duke zbritur pagesat e kryera nga ky subjekt nga fillimi i afatit të kontratës deri në 25.08.2023, në shumën prej 3,110,200 lekë, diferenca (4,671,500 lekë – 3,110,200 lekë) = prej **1,561,300 lekë, përbën efekt financiar për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.**

Veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” lidhja nr. 2 “Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullësorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11,” Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj.).

3.Subjekti “HEC-T.” shpk me NIPT L.....A, ka lidhur kontratë qiraje me bashkinë Kolonjë, datë 04.03.2019 me objekt marrje me qira nga fondi pyjor prej 2.9832 ha e cila është pjesë e fondit

pyjor publik, ekonomia pyjore Ballabanovë. Qëllimi i përdorimit është “Për ndërtimin e hidrocentralit, T.”. Afati i kontratës është për 10 vite, vlera e qirasë vjetore është **563,517.5** lekë. Raporti mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e sipërfaqeve fond pyjor dhe kullor në pronësi publike për ndërtimin e HEC T., është mbajtur në datën 21.01.2020.

Nga auditimi i kësaj kontrate konstatohet se:

- Bazuar në raportin e hartuar mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e sipërfaqeve fond pyjor dhe kullor në pronësi publike për ndërtimin e HEC-it T., raport i kryer në datën 21.01.2020, konstatohet se tarifa e përcaktuar është prej **1,400,500 lekë/km/vit të fondit pyll, shkurre për kontratat me afat 10 vjet, e përcaktuar sipas VKM nr 391, datë 21.06.2006** “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” lidhja nr. 2 “Tarifat dysHEME për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gazi, tensioni elektrik etj.).
- Me urdhër të Titullarit të Institucionit Bashkia Kolonjë z.E. I., me nr.16, datë 21.01.2020 është ngritur Grupi i Punës për realizimin e raportit tekniko-ekonomik të sipërfaqeve në përdorim nga fondi pyjor kullor të marra nga HEC-i T., në përbërje të cilit janë: z. E. C., z. A. J. dhe z. R. N.. Grupi i punës ka hartuar raportin teknik përkatës me nr.170 datë 20.01.2020, i firmosur prej tyre si dhe i miratuar nga Titullari i Insitucionit, ku nga matjet e kryera në terren kanë përcaktuar sipërfaqet e shfrytëzuara në pronësi publike të Bashkisë Kolonjë për Hec-in Qarr, ndërtuar nga subjekti F. shpk.
- Shuma e përlllogaritur nga raporti teknik sipas sipërfaqeve në përdorim është si më poshtë:
a. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në 9.6 km=1,400,500 lek
 Trungishte 3.06 km x 175,000=535,500 lekë
 Cungishte 1.91 km x 145,000 lekë=276,950 lekë
 Shkurre 0.53 km x 145,000=76,850 lekë
 Kullota 1.72 km x 145,000=249,400 lekë
 Inproduktive 2.38 km x 110,000=261,800 lekë
 Nisur nga matjet dhe përfundimet e kryera nga grupi i mësipërm pjesë e Drejtorisë së Pyjeve në Bashkinë Kolonjë, vlera në total për qiranë vjetore është **1,400,500 lekë.**

Subjekti	Nipti	Kontrata	Afati i Kontratës	Sipërfaqja e dhënë me qira në kontratë	Vlera e qirasë së kontratës së mëparshme	Vlera e qirasë së rillogaritur sipas raportit teknik	Vite në përdorim	Detyrimi referuar kontratës së vjetër	Detyrimi rillogaritur me raportin teknik	Pagesa të kryera	Detyrimi i mbetur
				<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d=a*c</i>	<i>e=b*c</i>	<i>f</i>	<i>g=e-f</i>	
HEC-T. L.....A		Bashkia Kolonjë, datë (10 vjeçar) 04.03.2019	01.01.2019-31.12.2028	2.9832 km	563,517.5	1,400,500	5 vite	2,817,587.5	7,002,500	2,817,587.5	4,184,912.5

Në tabelën e mësipërme pasqyrohet vlera vjetore e qirasë së lidhur bashkia Kolonjë, prej 563,517.5 lekë në vit, për periudhën 10 vjeçare të kontratës është kryer gabim dhe në shkelje të VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” lidhja nr. 2 “Tarifat dysHEME për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullorë publik për ushtrimin e veprimtarive”, pika 11, ”, pasi vlera e duhur dhe e rillogaritur është 1,400,500 lekë në vit ose për 10 vite 14,005,000 lekë (vlerë kjo e cila bazohet në raportin tekniko-ekonomik të kryer nga Drejtoria e Pyjeve në Bashkinë Kolonjë).

Duke zbritur pagesat e kryera nga ky subjekt nga fillimi i afatit të kontratës deri në 31.12.2023, në shumën prej 2,817,587.5 lekë, diferenca (7,002,500 lekë – 2,817,587.5 lekë) = prej **4,184,912.5 lekë, përbën efekt financiar për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.**

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar, me VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006” përsa i përket arkëtimit të të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullosore dhe inproduktive që ndodhen në territorin e Bashkisë Kolonjë. Referuar pikës 2; lidhjes nr.2, pika 6/1 dhe pika 11/1 të VKM nr.1064, 22.10.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.06.2006, Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” në të përcaktohet që:

Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kullosor publik, zbatohen tarifet dysHEME, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

LIDHJA NR.2 “Tarifat dysHEME për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lekë/ha/vit**

1 vit 2-5 vjet 6-10 vjet, 1 Inproduktive 540,000 / 495,000 / **440,000**

Pika 11. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gaz, tensioni elektrik etj.)

Nr. Përdorimi i territorit Tarifa si pas kohëzgjatjes së kontratës **lekë/km/vit**

1 vit 2-5 vjet 6-10 vjet,

1 Pyll trungishte 240,000 / 220,000 / **175,000**

2 Pyll cungishte 190,000 / 176,000 / **145,000**

3 Pyll shkurre 190,000 / 176,000 / **145,000**

4 Kullota 190,000 / 176,000 / **145,000**

5 Tokë me bimësi pyjore, djerr 160,000 / 145,000 / **110,000**

6 Inproduktive 150,000 / 145,000 / **110,000**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, z. E. I. me detyrë Kryetar i Bashkisë Kolonjë, z. A. J. ish Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, z. E. A. ish Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, z. G. E. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2023. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Kolonjë". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM, nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM

3.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Tabela nr. 1. Të dhënat mbi regjistrin e realizimit të procedurave periudha 01.01.2022 – 2023, në lekë

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Viti 2022					
Procedurë e hapur;	3	53,034,608	51,274,740	1,759,868	3%
Procedurë e hapur e thjeshtuar	13	47,491,096	41,305,678	6,185,418	13%
Kërkesë për propozime;	3	52,321,365	15,572,469	36,748,896	70%
Prokurim me vlerë të vogël.	49	27,866,426	23,929,459	3,936,967	14%
SHUMA	68	180,713,495	132,082,346	48,631,149	27%

Burimi i të dhënave: Bashkia Kolonjë punoi grupi i Auditimit.

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa TVSh	Kontrata pa TVSh	Fondi total i kursyer pa TVSh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
Viti 2023					
Procedurë e hapur;	2	76,583,579	73,246,119	3,337,460	4%
Procedurë e hapur e thjeshtuar	8	50,057,020	46,695,883	3,361,137	7%
Prokurim me vlerë të vogël.	65	37,305,538	34,221,153	3,084,385	8%
SHUMA	75	163,946,137	154,163,155	9,782,982	6%

Burimi i të dhënave: Bashkia Kolonjë punoi grupi i Auditimit.

Procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2022 janë si më poshtë vijon:

1. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur,Punë” REF-36436-07-15-2022 Urdhër prokurimi nr. 10 datë. 15.07.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. Projektuesi S. Shpk	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.391 dhe nr.3538 prot datë.15.07.2022 1.A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik 2.A. C. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.392 dhe nr.3539 prot datë.15.07.2022 1.E. Z. Kryetar 2.A. J. Anëtar 3.A. D. Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 21,712,685 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 20,447,582 lekë pa tvsh		6. Diferenca me fondin limit 1,265,103 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 03/08/2022	8. Burimi Financimit Fonde të miratuara nga buxheti i Bashkisë Kolonjë viti 2022, sipas vendimit të këshillit bashkiak kolonjë nr.130, datë.30.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”, vendimit të këshillit bashkiak nr.122, datë.15.12.2021 “Për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Kolonjë”		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender,1 OE b) S’kualifikuar 0 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja në muaj 4 (katër) ose ditë □□□ Ose Fillon nga nënshkrimi i kontratës dhe mbaron më 4 (katër) muaj	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.4427 Prot dhe Nr.10, Data e kontratës.15.09.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka Rekomandime nga APP - JO			

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Preventivi është hartuar nga projektuesi **S. Shpk**, konstatohet se ka përcaktuar fondin limit referuar V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e cila rezulton të jetë **21,712,685 lekë pa Tvsh**.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngjitur me Urdhër Nr.**391** dhe nr.**3538** prot datë.**15.07.2022** përbërë prej (**1. A. T. Person** përgjegjës për prokurimin publik , **2. A. C. Anëtare**, **3. M. T. Anëtar**), të cilat janë evidentuar në proces verbalin Nr.**3542** prot,datë.**15.07.2022**. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret e paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Në pikën 2.3.3 është kërkuar Staf kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

- 1) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- 2) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- 3) Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- 4) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit**.
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklaratë të duhet të përcaktojë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier Ndërtimi), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, shprehimisht: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”. Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve është mbi vlerën 30,000,000 000 (tridhjetë milionë) lekë

Për Inxhinierin e Mjedisit duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi” lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa që inxhinieri i mjedisit të jetë i pajisur me çertifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisi” është e zaturuar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

b. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Pyjesh
- 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Për Inxhinierin e Pyjeve duhet të jetë i pajisur me:

- Çertifikatë për shërbime profesionale për zbatime lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kërkesa prej 2 inxhinierësh si staf mbështetës, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish referuar procesverbalin të argumentimit nr. 3542 prot, datë.15.07.2022, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Në pikën 2.3.4 DST kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Fadromë	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator 0.25 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator 0.5 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Motosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Depozitë uji deri në 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator thellësie	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Vibrator sipërfaqësor	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Paisje niveluese për nivelimin e shtresave të betonit (helikopter)	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Betoniere 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Total station	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Gps për matje topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Armaturë ose Betonforma	m ²	min 500 m ²	Në pronësi ose me qera
19	Motorsharrë	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Pompë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Fabrikë betoni jo më larg se 60 km nga objekti	copë	1	Në pronësi ose me qera ose akt-marreveshje furnizimi

22	Paisje për hekurthyes (tranxhe/electrobango)	copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Kulle/ballonë ndriçimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Kontener Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera

Në pikën 2.3.4 nga AK kërkohet që OE të disponojë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës “minimumi 7 – maksimumi 10 ton”, gjithashtu është kërkuar Autopomp betoni – Kërkesa e AK duke vendosur kufirin maksimal për kapacitetin mbajtës të kamionit është e pa argumentuar, pasi një kërkesë e tillë kufizon një OE që mund të ketë kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton (11 apo 12 ton) dhe kriteri i mësipërm e kufizon të marrë pjesë në garë. Gjithashtu kërkohet Autopomp betoni është e pa argumentuar referuar procesverbalin të argumentimit nr. 3542 prot,datë.15.07.2022, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Ndër të tjera, në pikën 2.3.4 “Për fabrikën e prodhimit të asfalto-betonit të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit ,për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e asfalto-betonit.

Në lidhje me kërkesat e sipërcituara, vlerësojmë se: a) kriteri i sipërcituar i distancës prej 60 km në mënyrë direkte dhe indirekte cenon konkurrencën në rastin e një OE i cili disponon kriterin për një distancë më të madhe se 60 km por në të njëjtën kohë garanton materialin me të njëjtat kushte dhe specifikime teknike, çka në mënyrë indirekte cenon konkurrencën kur bëhen të detyrueshme me pasojë skualifikimi për OE pjesëmarrës në garë, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Sa më sipër për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. A. T. person përgjegjës për prokurimin publik, znj. A. C. Anëtare, dhe z. M. T. Anëtar.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar proces verbalit nr. 2, të datës 03/08/2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	Z. Shpk ,me nius L.....O	20,447,582 lekë pa tvsh	Kualifikuar

Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **Z. shpk**, ku në datën.09/08/2022 është mbajtur proces verbali nr.3 si dhe në datën. 18/08/2022 është mbajtur proces verbali nr.4 i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në SPE në datën.19/08/2022.Pas përfundimit të afateve të ankimimit nga ana e **KVO** është proceduar me **Raportin përmbledhës**. Sipas këtij Raporti përmbledhës Titullari i AK me shkresën nr.4427 Prot dhe kontrata Nr.10, data 15.09.2022 për vlerën **20,447,582 lekë pa tvsh** dhe

vlerën **24,537,099 lekë me tvsh**, dhe me afat **4 (katër) muaj** duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **OE Z. ShPK** i shpallur fitues, rezulton se referuar listë pagesave të Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe sipas formularit 8, ka deklaruar staf drejtues teknike

1. z. E. R. me profesion Ing. Hidroteknik, drejtues teknik; 2. z. I. B. me profesion Ing. Mjedisi, drejtues teknik; 3. z. M. C. me profesion Ing. Gjeodet, drejtues teknik; 4. z. A. S. me profesion Ing. Pyjesh, stafi mbështetës i inxhinierëve; 5. z. K. P. me profesion Ing. Hidrogjeolog, stafi mbështetës i inxhinierëve; 6. z. H. L. me profesion Teknik Ndërtimi, stafi teknik; 7. z. E. A. me profesion Teknik i mesëm Pyjesh; 8. z. D. O. me profesion Teknik i mesëm Hidraulik; 9. z. K. L. me profesion Karpentier; 10. z. S. K. me profesion Karpentier; 11. z. L. S. me profesion Sharxhi; 12. z. Z. C. me profesion Murator; 13. z. F. P. me profesion Murator; 14. z. R. M. me profesion Gurëpunues; 15. z. D. K. me profesion Shofer; 16. z. G. B. me profesion Manovrator; 17. z. P. G. me profesion Manovrator; 18. z. M. Z. i pajisur me certifikatë “Për punime gjelbërimi dhe mbjellje pemësh e shkurre dekorative”; 19. z. P. Z. i pajisur me certifikatë “Për Punime në prani uji”

Nga auditimi rezulton se punëonjësit e sipërcituara janë të angazhuar tek procedura “*Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës", viti 2022*”, sipas kontratës nr. 3650 prot., datë 27.07.2022 me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës e cila është mbyllur me datë 25.11.2022 sipas njoftimit të përfundimit të punimeve.

OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

1. Kamioncina Ford Ranger me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...I, Nr. i lejes së qarkullimit TRDB....; 2. Kamioncina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...LA, Nr. i lejes së qarkullimit MMCJNKB40FD....;

Mjetet e mara me qera

1. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...DU sipas kontratës nr. 198 rep, nr. 90 kol datë 27.04.2022; 2. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...PG sipas kontratës nr. 201 rep, nr. 93 kol datë 28.04.2022; 3. Autovinci me targa TR....B, sipas kontratës nr. 7061 rep, nr. 4713 kol datë 02.08.2022;

Nga auditimi rezulton se mjetet e sipërcituara janë të angazhuar tek procedura “*Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës", viti 2022*”, sipas kontratës nr. 3650 prot., datë 27.07.2022 me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës e cila është mbyllur me datë 25.11.2022 sipas njoftimit të përfundimit të punimeve.

Ndër të tjerat referuar formularit nr 8 të vetëdeklarimit **OE Z. ShPK** i shpallur fitues nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 pasi mjetet 1. Kamioncina Ford Ranger me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...I, Nr. i lejes së qarkullimit TRDB....; 2. Kamioncina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...LA, Nr. i lejes së qarkullimit MMCJNKB40FD.... të deklaruar nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST.

Ndër të tjerat OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 të DST pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8 nga OE “Z.” SHPK, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë për përdorim veriak konkretisht.

1. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...DU sipas kontratës nr. 198 rep, nr. 90 kol datë 27.04.2022 e nënshkruar ndërmjet me subjektin “z. O. Ç.” dhe shoqërisë “MF Z.” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

2. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...PG sipas kontratës nr. 201 rep, nr. 93 kol datë 28.04.2022 e nënshkruar ndërmjet me subjektin “A.” dhe shoqërisë “Z.” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

3. Autopomp betoni “MAN” me targa K...B sipas kontratës nr. 7060 rep, nr. 4712 kol datë 02.08.2022 e nënshkruar ndërmjet me subjektin “F.” SHPK dhe shoqërisë “Z.” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik

3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;

b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;

c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;

d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;

e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;

f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me

mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikatën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “Z.” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. E. Z. Kryetar, z. A. J. Anëtar dhe znj. A. D. Anëtare.

2. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Blerje materiale për ndricimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për ndricimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar,Mallra” REF-37137-07-26-2022 Urdhër prokurimi nr.10datë.15.07.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. inxh. nci. M. T.	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.409 dhe prot nr.3685 datë.27.07.2022 1.A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik 2.A. C. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.410 dhe nr.3686 prot datë.27.07.2022 1.E. Z. Kryetar 2.A. J. Anëtar 3.A. D. Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 10,000,000 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 9,625,317 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 374,683 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 10/08/2022	8. Burimi Financimit Fonde të vëna në dispozicion, sipas vendimit të këshillit bashkiak nr.130, datë.30.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”, dhe vendimit të këshillit bashkiak nr.122, datë.15.12.2021 “Për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Kolonjë”, i detajuar në tre vite si mëposhtë: Financimi për vitin 2022 është 1,666,667 lekë pa tvsh Financimi për vitin 2023 është 3,333,333 lekë pa tvsh Financimi për vitin 2024 është 5,000,000 lekë pa tvsh		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) S’kualifikuar 0 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka Rekomandime nga APP - JO	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.4429 Prot dhe Nr. 11, Data e kontratës. 15.09.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

-Me shkresën nr. 3645 prot datë 26.07.2022 kërkesë për blerje materiale për ndriçimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022, e paraqitur nga Drejtori i Shërbimeve Publike z. E. Z. duke paraqitur bashkëlidhur preventivin përkatës të hartuar nga Ing. **M. T.** për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se ka përcaktuar fondin limit.

Referuar relacionit dhe specifikimeve teknike me objekt “Rinovimi dhe rritje performance p ër ndriçimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë

- Në dosje nuk administrohet urdhër i titullarit për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e nevojave për blerje materiale elektrike, mungon procesverbali/relacioni për verifikimin në terren etj., të cilat kanë nevojë për materiale elektrike, skicat, planimetri, foto, të sipërfaqeve apo objekteve për të cilat nevojiten materialet elektrike shoqëruar me sasisht e materialeve.

Nuk ka një relacion përfundimtar i cili do të argumentonte në mënyrë të detajuar sipas zërave volumin e punimeve që do të kryen si dhe nevojën për materiale elektrike.

Sa sipër nga AK nuk dokumentohet argumentimi i volumit të mallrave që nevojiten, veprime këto në kundërshtim kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 34, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 12, pika 4, Neni 7, Neni 76, **pika 2-Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.**

Pika 3- Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. **M. T.** me detyrë Drejtor i Urbanistikës dhe z. E. I. me detyrë Titullar i AK.

Në hartimin e specifikimeve teknike për zërin “Kabëll elektrik FG160R16”, nuk është argumentuar teknikisht përse është kërkuar specifikisht kyloj zëri, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 36, pika 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 78, pika 2, ku citohet: “Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit .Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësive së prokurimit.”

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. **M. T.** me detyrë Drejtor i Urbanistikës

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”: Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhër Nr. **409** dhe nr.**3685** prot datë.**27.07.2022** përbërë prej (**1.** A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik , **2.** A. C. Anëtare, **3.** M. T. Anëtar), të cilat janë evidentuar në proces verbalin Nr. **3689** prot,datë.**27.07.2022**, të cilat janë si më poshtë;

Në pikën 2.3.5 të DST kërkohet që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë si staf mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Ing. Elektrik 1 (një)

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë të vlefshme.
- Diploma ose dëshmi kualifikimi
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërise minimalisht në **muajin e fundit**.
- Të jetë i pajisur me çertifikatë “Për auditues energjistik”.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Në DT është kërkuar: 1 ing Elektrik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), **të jetë i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë** “Auditues Energjie (i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë) është i tepërt dhe i pargumentuar dhe jo në përputhje me përcaktimet.

Bazuar në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 125.2015 “Për efincencën e energjisë” parashikohet se: “ 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:

- a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie;
- b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efincencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efincencës së energjisë.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

- a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni;
- b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.”

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efincencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 124.2015 “Për efincencën e energjisë”, AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë përpara hapjes së procedurës së prokurimit.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Auto kosh	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kenotron	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Meger 2500v	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Terrameter	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Kambaleca	copë	10	Në pronësi ose me qera

Në lidhje me këtë kërkesë nuk është argumentuar numri dhe tonazhi i mjetet dhe pajisjet të kërkuara referuar preventivit dhe llojit të procedurës në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të

VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Sa më sipër për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. A. T. person përgjegjës për prokurimin publik, znj. A. C. Anëtare, dhe z. M. T. Anëtar.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar proces verbalit nr. 2, të datës 10/08/2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	A. shpk me numer NIUS J.....V	9,625,317 lekë pa tvsh	Kualifikuar

Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **A. shpk**, ku në datën.12/08/2022 është mbajtur proces verbali nr.3 si dhe në datën. 24/08/2022 është mbajtur proces verbali nr.4 i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në SPE në datën.24/08/2022. Sipas Raportit përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 (një) operatorë pjesëmarrës. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “A.” shpk në vlerën **9,625,317 lekë pa tvsh**, për të cilën është lidhur kontrata Nr.4429 Prot dhe Nr. 11, Data e kontratës.15.09.2022 për vlerën **9,625,317 lekë pa tvsh** dhe vlerën **11,550,380 lekë me tvsh**, dhe me afat **4 (katër) muaj** duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 Operatori/et ekonomik në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për produktet e kërkuara vërtetim ose deklaratë ose autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit, vërtetuar me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit - **distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar **si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit**).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **A. ShPK** i shpallur fitues, sipas formularit 8, ka deklaruar se disponon autorizim nga Firma S., por ky autorizim është i pa vlefshme sepse prezantimi i ofertave për materiale të ndryshme duhet të vinte nga Firma S..

Gjithashtu në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion Firma S. është i autorizuar të shpërndaj listën e produkteve të firmës prodhuese “L.”, por nuk mundet të nënshkruaj kontrata dhe të ofroj çmime preferenciale në emër të firmës prodhuese “L.”. Dokumenti të cilin shqyrton KVO është dokumenti në gjuhën Angleze Dokumenti në gjuhë të huaj i pa përkthyer dhe noterizuar nuk duhet të ishte ngarkuar fare në dokumentet e operatorit ekonomik dhe kjo nuk përbën mangësi të dokumentacionit për të cilën KVO nuk duhet ta kishte marë në konsiderat.

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “A.” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. E. Z. Kryetar, z. A. J. Anëtar dhe znj. A. D. Anëtare.

3. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: *“Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”.*

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: <i>“Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”.</i>			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur,Punë” REF-27924-05-09-2022 Urdhër prokurimi nr.6 datë.09.05.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. projektuesi T. Shpk	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.223 dhe nr.2217 prot datë.09.05.2022 1.A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik 2.A. C. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.223 dhe nr.2217 prot datë.09.05.2022 E. Z. Kryetar S. R. Anëtare E. C. Anëtar
4. Fondi Limit (pa tvsh) 17,455,256 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 16,960,491 lekë pa tvsh		6. Diferenca me fondin limit 494,765 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 10/06/2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kolonjë viti 2022, sipas vendimit të këshillit bashkiak kolonjë nr.130, datë.30.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”, vendimit të këshillit bashkiak nr.122, datë.15.12.2021 “Për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Kolonjë”, kontratës së Grantit të nënshkruar midis Fondacionit PZHRSH dhe Bashkisë Kolonjë referuar thirrjes për aplikime për Skemën e Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionin , Programin për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100 Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender,1 OE b) S’kualifikuar 0 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja në muaj 4 (katër) ose ditë □□□ Ose Fillon nga nënshkrimi i kontratës dhe mbaron më 4 (katër) muaj	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.3650 Prot dhe Nr.7, Data e kontratës.27.07.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka Rekomandime nga APP - PO			

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Preventivi është hartuar nga projektuesi **T. Shpk** për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se ka përcaktuar fondin limit referuar V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratiminin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e cila rezulton të jetë **17,455,256 lekë pa Tvsh.**

Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjencia e Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentat standarte të tenderit me objekt: “Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”.me fond limit **17,455,256** (dyzet e njëmilion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh**

ISHTE	BËHET
<p>2.3.3 Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet</p> <p>c. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:</p> <p>Inxhinier Ndërtimi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik 1 (një) Inxhinier Elektrik 1 (një) Inxhinier Mekanik 1 (një) Inxhinier Mjedisi 1 (një) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (një)</p> <p>Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë punë e noterizuar Diploma Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit.</p> <p>Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier Ndërtimi),i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". <u>Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.</u></p> <p>Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”.(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).</p> <p>Për 1 (një) prej drejtuesve teknike të mësipërm të shoqërisë duhet të jetë i pajisur me: “Certifikatën e Audituesit Energjitik”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.</p> <p>Për Inxhinierin Elektrik duhet të jetë i pajisur me: Certifikatë për Sisteme Kontrolli dhe Komandimi, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e</p>	<p>2.3.3 Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet</p> <p>Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:</p> <p>Inxhinier Ndërtimi 1 (një) Inxhinier Hidroteknik 1 (një) Inxhinier Elektrik 1 (një) Inxhinier Mjedisi 1 (një) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (një)</p> <p>Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë punë e noterizuar Diploma Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit.</p> <p>Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier Ndërtimi),i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". <u>Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.</u></p> <p>Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).</p> <p>Për 1 (një) prej drejtuesve teknike të mësipërm të shoqërisë duhet të jetë i pajisur me: “Certifikatën e Audituesit Energjitik”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.</p> <p>Për Inxhinierin Elektrik duhet të jetë i pajisur me: Certifikatë për Sisteme Kontrolli dhe Komandimi, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.</p>

<p>Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.</p> <p>Për Inxhinierin e Mjedisit duhet të jetë i pajisur me: Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.</p> <p>Certifikate si “Përgjegjës për dëmet në mjedis” gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.</p> <p>Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentet e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Për Inxhinierin e Mjedisit duhet të jetë i pajisur me:</p> <p>Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.</p> <p>Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>
<p>Në kapacitetin teknik 2.3.3 gërma g riformulohet si mëposhtë :</p> <p>g. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 33 (Tridhjetetë) persona për muajin e fundit, të vërtetuar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për muajin e fundit. • Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit. <p>(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).</p> <p>Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Në kapacitetin teknik 2.3.3 gërma g riformulohet si mëposhtë :</p> <p>g. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 32 (Tridhjetedy) persona për muajin e fundit, të vërtetuar me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për muajin e fundit. • Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit. <p>(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).</p> <p>Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>
<p>Në kapacitetin teknik 2.3.3.gërma h riformulohet si mëposhtë :</p> <p>h. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) • OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018 (ose ekuivalente) • ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) • PAS 99-2012 (ose ekuivalente) • ISO 1452-1:2009 (ose ekuivalente) • ISO 50001:2018 (ose ekuivalente) <p>(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).</p> <p>Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi komformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të</p>	<p>Në kapacitetin teknik 2.3.3.gërma h riformulohet si mëposhtë :</p> <p>h. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) • OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018 (ose ekuivalente) • ISO 14001:2015 (ose ekuivalente) • PAS 99-2012 (ose ekuivalente) • ISO 1452-1:2009 (ose ekuivalente) <p>(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).</p> <p>Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi komformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.</p>

lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. VO: Nëse çertifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .	VO: Nëse çertifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .
--	--

- Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhër nr.223 dhe nr.2217 prot datë.09.05.2022 përbërë prej (1. A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik , 2. A. C. Anëtare, 3. M. T. Anëtar), të cilat janë evidentuar në proces verbalin Nr.2249/1 prot, datë.09.05.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

1. NP– 1 A Punime gjurmimi në tokë
2. NP– 2 A Ndërtime Civile dhe industriale
3. NP – 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
4. NP – 7 A Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.
5. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1. NS– 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
2. NS– 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
3. NS– 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
4. NS– 14 A Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.
5. NS– 18 A Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. *(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).*

Referuar licensave profesionale NP-7 A “Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje”, NP– 12 A “Punime të Inxhinierisë së Mjedisit”, NP – 4 A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”, NS– 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”, NS– 14 A Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj. si dhe NS– 18 A “Punime topogjeodezike”, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2.3.3 Stafi kryesor e mbështetes, punonjesit, çertifikimet

d. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

- 5) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- 6) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- 7) Inxhinier Elektrik 1 (një)
- 8) Inxhinier Mjedisit 1 (një)

9) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklaratë të duhet të përcaktojë **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", shprehimisht: "Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi". Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin.t Teknik të punimeve Të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e AK që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar.

Për 1 (një) prej drejtuesve teknike të mësipërm të shoqërisë duhet të jetë i pajisur me:

- "Certifikatën e Audituesit Energjetik", lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.

Në DT është kërkuar: 1 prej punonjës si drejtuesve teknik, të jetë i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë "Auditues Energjie (i pajisur me certifikatë për auditimin e energjisë).

Bazuar në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 125.2015 "Për eficientësin e energjisë" parashikohet se: " 4. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:

a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie;

b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë.

5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij neni;

b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm."

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi "Preventivin e punimeve", "Relacionin Teknik", "Specifikimet Teknike", "Grafikun e punimeve" dhe "Projektin e Zbatimit".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të eficientës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të eficientës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 124.2015 “Për eficientën e energjisë”, AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë përpara hapjes së procedurës së prokurimit.

Për Inxhinierin Elektrik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë për Sisteme Kontrolli dhe Komandimi, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Kërkesa që inxhinieri Elektrik të jetë i pajisur me “Certifikatë për Sisteme Kontrolli dhe Komandimi” nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjrisht referuar procesverbalin të argumentimit nr. 2249/1 prot, datë.09.05.2022, nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Për Inxhinierin e Mjedisit duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Kërkesa që inxhinieri i mjedisit të jetë i pajisur me certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” është ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

e. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (një) Inxhinier Pyjesh
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni ose IT ose Elektronik

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Për Inxhinierin e Pyjeve duhet të jetë i pajisur me:

- Çertifikatë për shërbime profesionale për zbatime lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Për Inxhinierin Telekomunikacioni ose IT ose Elektronik duhet të jetë i pajisur me:

- Çertifikatë për “CCNA Routing and Sëitching” ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Numri prej 4 inxhinierësh si staf mbështetës, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish referuar procesverbalin të argumentimit nr. 2249/1 prot, datë.09.05.2022, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Në DST është kërkuar që Operatori/et ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 32 (Tridhjetë e Dy) persona për muajin e fundit** sipas rekomandimeve të APP.

Kërkesa për një punësim mesarat prej 32 punonjës për muajin e fundit nga data e hapjes. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, pretenduar sipas: pikës 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

AK ka të drejtën për të kërkuar fuqinë punëtore minimale për të cilën OE duhet ta disponojnë në monumentin e zhvillimit të procedurës, por pa përcaktuar periudhë kohore se për sa kohë duhet të disponohet ky numër. Për AK është më se e mjaftueshme që në momentin e paraqitjes së ofertave të disponojë fuqinë punëtore vërtetuar kjo me vërtetimin nga administrata tatimore të muajt të fundit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Fadromë	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Autokulle me kosh (Autoashensor)	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Betoniere 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Armaturë ose Betonforma	m ²	min 500 m ²	Në pronësi ose me qera
9	Vibrator	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Paisje niveluese shtresash (helikopter)	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Total station	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Gps për matje topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Motorsharrë	copë	1	Në pronësi ose me qera

15	Kulle/ballonë ndriçimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
----	------------------------	------	---	------------------------

Në pikën 2.3.4 nga AK kërkohet që OE të disponojë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës “minimumi 7 – maksimumi 10 ton”, Kërkesa e AK duke vendosur kufirin maksimal për kapacitetin mbajtës të kamionit është e pa argumentuar, pasi një kërkesë e tillë kufizon një OE që mund të ketë kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton (11 apo 12 ton) dhe kriteri i mësipërm e kufizon të marrë pjesë në garë, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Sa më sipër për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. A. T. person përgjegjës për prokurimin publik, znj. A. C. Anëtare, dhe z. M. T. Anëtar.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar proces verbalit nr. 2, të datës 10.06.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	Z. Shpk , me nius L.....O	16,960,491 lekë pa tvsh	Kualifikuar

Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **Z. shpk**, ku është mbajtur proces verbali nr. 3 datën.16.06.2022 si dhe proces verbali nr.4 datën.01.07.2022 është mbajtur i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në SPE në datën.06.07.2022. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 (një) operatorë pjesëmarrës Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK ka lidhur kontrata Nr.3650 Prot dhe Nr.7, Data e kontratës.27.07.2022 për vlerën **16,960,491 lekë pa tvsh** dhe vlerën **19,927,289 lekë me tvsh**, dhe me afat **4 (katër) muaj** duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Situata 2. Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

Referuar formularit nr. 8 të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit fizik të paraqitura nga **OE Z. ShPK** i shpallur fitues nuk **përmbush kriterin e pikës 2.3.4 pasi mjetet** 1. Kamioncina Ford Ranger me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...I, Nr. i lejes së qarkullimit TRDB....; 2. Kamioncina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...LA, Nr. i lejes së qarkullimit M.....D.... të deklaruara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST.

Ndër të tjerat OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8 nga OE “**Z.**” SHPK, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë për përdorim veriak konkretisht.

1. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...DU sipas kontratës nr. 198 rep, nr. 90 kol datë 27.04.2022 e nënshkruar ndërmjet me subjektin “z. O. Ç.” dhe shoqërisë “MF Z.” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

2. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...PG sipas kontratës nr. 201 rep, nr. 93 kol datë 28.04.2022 e nënshkruar ndërmjet me subjektin “A.” dhe shoqërisë “Z.” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

3. Autopomp betoni “MAN” me targa K...B sipas kontratës nr. 7060 rep, nr. 4712 kol datë 02.08.2022 e nënshkruar ndërmjet me subjektin “F.” SHPK dhe shoqërisë “Z.” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

- a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
- b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
- c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
- d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
- e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
- f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij

nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “Z.” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. E. Z. Kryetar, z. E. C. Anëtar dhe znj. S. R. Anëtare.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Kolonjë mbi Akt konstatimin nr. **9** të mbajtur më **datë 05.04.2024** janë dërguar observacione nga bashkia Kolonjë me shkresën nr. 1161/1 prot., datë 18.04.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 186/7 prot., datë 22.04.2024, të cilat janë ridërguar me shkresën nr. 3080 datë 26.06.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 186/14 prot., datë 26.06.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit Njësia e prokurimit

-Në lidhje me trajtimin se nuk jemi në kushtet kur preventivi duhet të jetë mbi vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë dhe në kundërshtim të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 të kërkesës 2.3.3/a të DST për deklarim nga administratori për drejtuesin teknik të punimeve në objekt sqarojmë se nuk është urdhër por udhëzim i KM për të cilin grupi i auditimit nuk është i autorizuar nga KLSH në programin e auditimit për ta përdorur si kriter për vlerësim në auditim. Duke qenë udhëzim nuk imponon AK mbi përcaktimet por vetëm e udhëzon që do të thotë që AK mund të orientohet apo udhëzohet nga përcaktimet e këtij udhëzimi dhe jo domodoshmërisht të zbatojë ato pikë për pikë. Tjetër aspekt i këtij vlerësimi është fakti që AK ka kërkuar deklarim për drejtuesin teknik dhe jo për përgjegjësin teknik të kantierit të cilit i referohet kriteri i trajtuar në aktkonstatim, konkretisht pika 2.1 e udhëzimit me përmbajtje “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensia e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Në lidhje me pikën për **Inxhinierin e Mjedisit i cili duhet të jetë i pajisur me:**

- Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Ku ju citoni se kjo kërkesë është ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi),dhe nuk është në përputhje me nenin 7 dhe 77 të ligjit nr.162, datë.23.12.2020 “Për prokurimin

publik” i ndryshuar dhe pikë 4 të nenit 39 të VKM nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar.

-Në lidhje me trajtimin se kriteri nuk është në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e kontratës ju sqarojmë se kjo kërkesë është argumentuar plotësisht në proces verbalin e hartimit të kriterëve si më poshtë vijon:

Inxhinieri Mjedisi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të gjelbërimit lidhur me zërat e preventivit ,gjithashtu është i nevojshem që të identifikojë,vlerësojë dhe të japë masa për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis, kryesisht gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i pajisur me:

Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Kërkesa përse **Inxhinieri i Mjedisit** të jetë i pajisur me çertifikatë “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me çertifikatë **Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me ndikimin në mjedis për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Në respektim të nenit 20 pika 4 të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë”,

si dhe Në nenin 6 pika 1 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se:

“ Projekt” është:

a) zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;

b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve, duke përfshirë njëherazi edhe projektin e procedurës së prokurimit .

Njësia e prokurimit gjykon se operatori ekonomik që do të shpallet fitues i kontratës së prokurimit në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në respekt të parashikimeve që rrjedhin nga **neni 20 pika 4** dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve në kuptim të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë. Sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor se subjekti njëherazi duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues është një kriter në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk tejkalon qëllimin e autoritetit kontraktor dhe nuk shfaq diskriminim mes ofertuesve.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhej pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensia e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Pyjesh i pajisur me Çertifikatë për shërbime profesionale për zbatime lëshuar nga Ministria e Mjedisit, kjo kërkesë është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit,pasi referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuara në preventivin e zbatimit konkretisht:janë përfshirë prerje e sistemim pemësh me diameter ø 10 - 20 cm dhe ø 21 - 40 cm, si dhe mbjellje peme (tipi bredh) **85 copë**, Fidane shkurre dekorative "Oleander" **490 copë** si dhe **Fidane Peme dekorative 85 copë** .proces për të cilin nevojitet ekspertiza e **1 (një) Inxhinier Pyjesh** dhe OE duhet të

disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **Pyjesh**.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Hidrogeolog është parë e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak se objekti që do të ndërtohet ndodhet shumë afër një lumi në toka të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **Hidrogeolog**, i cili do të monitorojë dhe vlerësojë ndërtimin e kanalit kryesisht veprës së marrjes dhe pllakës të themelit në lidhje me shtresat gjeologjike. Pra referuar zërave në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit të propozuar është parashikuar që projekti kalon nëpër formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizen e një inxhinieri **Hidrogeolog**.

Të gjitha punimet për veprën e marjes duhet të bëhen në prezencë të hidrogjelogut në mënyrë që të merren rezultatet e parashikuara në projekt. Në këto kushte realizimi me sukses i të gjithë procesit kryhet nëpërmjet disponimit nga ana e operatorëve ekonomik të kapaciteteve teknike të përcaktuara në kriteret kualifikuese në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhej pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

- Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.
- Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.
- Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

-Në lidhje me trajtimin ku shpreheni se AK ka kërkuar që OE të disponojnë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 7 – maksimumi 10 ton ,duke vendosur kufirin maksimal 10 ton për kapacitetin mbajtës kjo kërkesë kufizon operatorët ekonomik për të marrë pjesë në garë, **nuk qëndron** , përsa kohë AK ju ka krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia dhe kontrata me qira. Nëse një operator ekonomik do të ishte i interesuar kishte dy opsione dhe nuk do të kufizoheshë për plotësimin e këtij kriteri.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhej pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Kërkesat e mësipërme janë hartuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr.629 datë.15.07.2015, manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar VKM nr.629 datë.15.07.2015, “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, është bërë përllogaritja teknike e mjeteve/ makinerive/ pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës ku ndër të tjera kemi kërkuar dhe argumentuar:

Kamion vetëshkarkues.

Mjet që përdoret për transportin e materialeve bazuar në zërin e preventivit transport dheu, transport materiale ndërtimi, kërkohet 1 kamion vetëshkarkues.

Autopompë betoni

Mjet që përdoret për shpërndarjen e betonit gjatë procesit të betonimit.

Fabrikë betoni

Prodhimi i betonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në bazë të preventivit janë 392 m³ beton për tu sjellë në kantier.

Në lidhje me vendosjen e kriterit Fabrikë betoni jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit kemi argumentuar teknikisht si mëposhtë vijon:

Nën nocionin transport të betonit nënkuptohet bartja e betonit nga vendi i prodhimit deri te vendi i vendosjes / shtruarjes të betonit.

Transporti është faktor shumë i rëndësishëm i cili ka ndikim të madh mbi cilësinë e betonit.

Elementet themelore në bazë të cilëve planifikohet transporti janë: lidhja e parakohshme dhe segregacioni i betonit. Përveç kësaj, transporti duhet të jetë i shpejtë, racional, të sigurojë mbrojtje nga avullimi i ujit, rrjedhja e qumështit të çimentos etj.

Transporti i betonit prej fabrikës për beton deri te punishtja quhet transport i jashtëm, kurse transportimi i betonit në vetë punishten quhet transport i brendshëm.

Këtu përfshihet transportimi nga repartet e punishtes dhe vendit për ri ngarkim deri te vendi ku betoni vendoset.

Largësia e fabrikës për beton deri te punishtja mund të jetë 50 e më tepër kilometra. Në distanca të këtilla transporti mund të kryhet vetëm me mjete transportuese nga tipi i automjeteve rrugore siç janë: Kamionët mikser të ashtuquajtur autobetoniere .

Kriteri i vendosur në pjesën e kapacitetit teknik në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së fabrikës së prodhimit të betonit **jo me larg se 60 km**, është një kriter i drejtë dhe jopërrjashtues, përse kohë ju ka krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia, tek kontrata me qira dhe akt-marreveshje furnizimi. Njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm nuk është diskriminues, nuk sjell kufizimin e pjesëmarrësve pasi OE mund të përzgjedhin pika të furnizimit me beton dhe inertet brenda rrezes prej **60 km** vijë rrugore, në drejtim të aksit Ersekë - Tiranë si dhe në drejtim të aksit Ersekë - Leskovik - Gjirokastër duke mundur më shumë se një opsion.

Referuar disa auditimeve të KLSH në institucione të tjera ku ndër të tjera nuk është shprehur për largësinë e vendodhjes së fabrikës por për mënyrën e disponimit (statusit) gjë të cilën ne e kemi parashikuar dhe ju kemi krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia, tek kontrata me qira dhe akt-marreveshje furnizimi

Oëndrimi i grupit të auditimit.

Observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Kolonjë, gjatë fazës së auditimit në terren

Pretendimi i subjektit KVO

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i ngritur me urdhër Nr.392 dhe nr.3539 prot datë.15.07.2022 i përbërë prej E. Z. Kryetar , A. J. Anëtar, A. D. Anëtare.

Lidhur me këtë konstatim tuaj ku citoni se OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, duam të prapësojmë se stafi i përdorur në procedurën tenderuese “**Rehabilitimit të Portës Hyrëse të Rehovës**”, nuk ka interferuar në asnjë moment punimet dhe kushtet e kontratës me objekt: “**Rikonstruksionit të kanalit vaditës Fshati Gostivisht**”. Kontrata e objekti në fjalë është lidhur pothuajse pas dy muajve nga procedura tjetër dhe një pjesë e atij stafi referuar dhe grafikut të punimeve e kishin kryer detyrën dhe punën e caktuar konkretisht në “**Rehabilitimin e Portës Hyrëse të Rehovës**” dhe në këto kushte janë përdorur nga OE “Z.” në procedurën e dytë atë të “**Rikonstruksionit të kanalit vaditës Fshati Gostivisht**”, punimet e të cilit ritheksojmë dhe një herë kanë filluar pas rreth 2 muajsh, në datë 15/09/2022.

Gjithashtu dëshirojmë t'iu vëmë në dijeni të faktit se, distanca mes objektit të parë të ndodhur në fshatin **Rehovë** dhe objektit të dytë të ndodhur në fshatin **Gostivisht** të cilët ju përkasin të dyja procedurat tenderuese është jo më shumë se **10 km**, çka ka lejuar OE “Z. shpk” të përdorë stafin dhe mjetet e tij në të dy procedurat pa u bërë pengesë për përmbushjen e kushteve të Kontratave sipas parashikimeve.

Lidhur me konstatimin tuaj ju sqarojmë se, në kriteret kualifikuese të përcaktuara në **pikën 2.3.3** të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar që punonjësit, nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, por është përcaktuar vetëm fakti se :*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Procedura tenderuese konkretisht ajo me objekt “**Rehabilitimit të Portës Hyrëse të Rehovës**” siç dhe pranohet nga ana Juaj është realizuar brenda afateve të përcaktuara në Kontratë, duke mos pasur asnjë shkelje të Kontratës apo duke mos kërkuar zgjatje të afatit të punimeve ndaj AK nga ana e OE.

I referohemi gjithashtu qëndrimeve dhe praktikave ligjore të mbajtura nga K.P.P ne vendimin **Nr.391/2023** me nr.**688/8 prot datë 18/05/2023** si dhe vendimin **Nr.827/2021** me nr.**1518/9 prot date 01/11/2021** mbi angazhimin e stafit në dy procedura tenderuese.

Lidhur me këtë konstatim tuaj ku citoni se OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet referuar mjeteve të marra me qira të cilat rezultojnë të jenë të angazhuara edhe në procedurën “**Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë “Porta e Rehoves”,viti 2022**”, sqarojmë se për arsyet e mëposhtme mjetet e përmendura nuk kanë interferuar në përdorim dhe në realizimin e punimeve:

1. Distanca mes objektit të parë të ndodhur në Rehovë dhe objektit të dytë të ndodhur në Gostivisht të cilët ju përkasin të dyja procedurat tenderuese është jo më shumë se 10 km, çka ka lejuar OE “Z.” të përdorë stafin dhe mjetet e tij në të dy procedurat pa u bërë pengesë për përmbushjen e kushteve të Kontratave sipas parashikimeve.

2. Procedura tenderuese konkretisht ajo me objekt“**Rehabilitimit të Portës Hyrëse të Rehovës**” siç dhe pranohet nga ana Juaj është realizuar brenda afateve të përcaktuara në Kontratë, duke mos pasur asnjë shkelje të Kontratës apo duke mos kërkuar zgjatje të afatit të punimeve ndaj AK nga ana e OE. Gjithashtu i referohemi qëndrimeve dhe praktikave ligjore të mbajtura nga K.P.P ne vendimin **Nr.391/2023 me nr.688/8 prot datë 18/05/2023** si dhe vendimin **Nr.827/2021 me nr.1518/9 prot datë 01/11/2021** mbi angazhimin e mjeteve në dy procedura tenderuese.

Lidhur me këtë konstatim tuaj ku citoni se OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4, për realizimin e kontratës, pasi mjetet konkretisht kamionçina Ford Ranger me kapacitet deri në 3.5 ton me targë AA...I dhe kamionçina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targë AA...LA të deklaruar nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST

Referuar këtij konstatim, pavarësisht se nga ana Juaj nuk janë cituar specifikimet teknike konkrete sipas DST – ve, dëshirojmë të propozojmë se këto mjete janë tërësisht sipas përcaktimeve teknike, *pasi kriteret e përcaktuara në DST kanë qënë konkretisht: Kamionçine me kapacitet mbajtës maksimal 3.5 ton, mjete të cilat nga ana e OE janë deklaruar, kjo referuar formularit 8 dhe për to është dorëzuar dhe dokumentacioni i plotë*, duke plotësuar kriterin e kërkuar nga AK, dhe konstatimi juaj nuk qëndron.

Në Akt Konstatimin nr.9 nga ana Juaj është arsyetuar ndër të tjera se nuk përmbushen kriteret e **pikës 2.3.4** pasi një pjesë e mjeteve të përdorura nga OE në këtë procedurë tenderi të marra me qera janë për përdorim vetjak dhe se nuk disponojnë certifikatë për dhënie me qera të mjeteve për të tretë. E për rrjedhojë kjo është në kundërshtim me nenin 81 pikat 1,2,3,4,5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi mjeteve” i ligjit 8378 datë 22/07/1998 “Kodi Rrugor” në R. Shqipërisë, i ndryshuar.

Lidhur me këtë konstatim të Audituesave, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen Tuaj se referuar nenit 81 pika 6, ky nuk është një detyrim i OE, por i pronarëve të mjeteve, të cilët në dijeninë tonë si AK certifikatën sipas kësaj dispozite dhe paragrafi e disponojnë.

Por le të sjellim në vëmendjen Tuaj se çfarë parashikon paragrafi 6 i kësaj dispozite:

Neni 81 Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

Pas marrjes së lejes së përkohshme të transportit nga organet e Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse në rreth, mjetet e transportit të mallrave mund të shfrytëzohen në raste të jashtë zakonshme dhe përkohësisht për transport njerëzish. Leja e përkohshme e transportit lëshohet vetëm mbi bazën e kërkesës së titullarit të pushtetit lokal. Leja e përkohshme e transportit lëshohet nga organet përkatëse në varësi të Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse, për autobuzët e destinuar për t'u dhënë me qira me drejtues mjete, të cilët mund të përdoren në raste të jashtëzakonshme dhe me urdhëresë të Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse në shërbime në linjë dhe anasjelltas.

Për të përligjur çfarë ka konstatuar Institucioni Juaj në këtë Akt Konstatimi se nuk përmbushen kriteret e pikës 2.3.4 ju i referoheni Ligjit Nr.8308, datë 18/03/1998 “PËR TRANSPORTET RRUGORE”, I ndryshuar dhe konkretisht në KREU III. 1 “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë” Neni 41 “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Për sa i përket këtij referimi dëshirojmë të prapesojmë se OE nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor, referuar ligjit Nr.162/2020 për “Prokurimin Publik” i ndryshuar, të jetë i detyruar të përmbushë kritere përtej atyre të përcaktuara në DST, neni 77 i këtij ligji, ku referuar këtyre të fundit të gjitha mjetet e përdorura në këtë procedurë tenderi kanë specifikimet teknike sipas kriterëve të përcaktuara në DST.

KVO ka vepruar me korrektësi në vlerësimin e OE pjesëmarrës dhe ka shpallur fitues OE më cilësor jo vetëm për sa i përket plotësimit të kërkesave të DST por dhe çmimit më të leverdisshëm si dhe duke patur parasysh që kontrata është zbatuar me korrektësi e cilësi si dhe është siguruar efica dhe efektiviteti e kësaj vepe ndaj AK.

Kualifikimi i **OE Z. Shpk** nuk ka sjellë shkelje të barazisë në tender për operatorët pjesëmarrës, efekt negativ financiar apo dem ekonomik për autoritetin kontraktor, **ndaj kërkojmë marrjen parasysh të këtij observacioni dhe refektimin e tij në raportin paraprak të auditimit.**

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Kolonjë, gjatë fazës së auditimit në terren

4. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rivitalizimin e Qendrës Multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rivitalizimin e Qendrës Multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar,Punë” REF-21201-03-03-2022 Urdhër prokurimi nr.4 nr.3243 prot., datë.27.06.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. Inxh. M. T. nr.Liç.K	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.103 nr.1000 prot, datë.28.02.2022 1.A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik 2.A. C. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.352 nr.3238 prot, datë.27.06.2022 1.E. M. Kryetare 2.E. Z. Anëtar 3.S. R. Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 7,513,466 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 7,268,342 (Shtatëmilionedyqindegjashhtëdhjetëetëmijë etreqindedyzetëdy) lekë pa tvsh		6. Diferenca me fondin limit 245.124 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 23 / 03 / 2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kolonjë viti 2022, sipas vendimit të këshillit bashkiak nr.130, datë.30.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2022”, dhe vendimit të këshillit bashkiak nr.122, datë.15.12.2021 “Për miratimin e projekt-buxhetit afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Kolonjë”, i detajuar në tre vite si mëposhtë: Financimi për vitin 2022 është 2,500,000 lekë pa tvsh Financimi për vitin 2023 është 2,506,733 lekë pa tvsh		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) S’kualifikuar 0 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të			

marrëveshjes kuadër,31.12.2024	Financimi për vitin 2024 është 2,506,733 lekë pa tvsh	
10.Ankimime AK-s'ka/ka; APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.3475 Prot dhe Nr.6, Data e kontratës.12.07.2022	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK
Rekomandime nga APP - PO		Nuk ka

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogaritjen e Fondit Limit”:

Preventiviti është hartuar nga specialisti i fushës, ing. M. T. anëtar i njësisë së prokurimit i ngritur me urdhër nr.103 dhe nr.1000 prot datë.28.02.2022 ka përcaktuar fondin limit referuar V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e cila rezulton të jetë 7,513,466 lekë pa Tvsh.

- Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngitur me Urdhër nr.103 nr.1000 prot, datë.28.02.2022 përbërë prej 1. A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik, 2. A. C. Anëtare, 3. M. T. Anëtar, të cilat janë evidentuar në proces verbalin nr. 1190 prot të datës.10.03.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret e paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Në pikën 2.3.3 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet

f. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

10) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Të jetë i pajisur me çertifikatë “Për auditues energjistik” në ndërtesa.
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**). Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**

Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma ”a” të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”.(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje**).

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklaratë të duhet të përcaktojë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier Ndërtimi**), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, shprehimisht: “Drejtuesi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”. Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve**

Ndër të tjerat në DST është kërkuar që Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- OHSAS 18001:2007 ose **ISO 45001-2018** (ose ekuivalente)
- ISO 14001:2015 (ose ekuivalente)
- PAS 99-2012 (ose ekuivalente)

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet, si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës, kërkesat për disponimin e certifikatave të mëspërme nuk përmbushin përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Vinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Betoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Depozite Uji min 500 lit	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrjetë mbrojtëse për punime në fasadë)	m ²	min 700 m ²	Në pronësi ose me qera

Në pikën 2.3.4 nga AK kërkohet që OE të disponojë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës “minimumi 7 – maksimumi 10 ton”, – Kërkesa e AK duke vendosur kufirin maksimal për kapacitetin mbajtës të kamionit është e pa argumentuar, pasi një kërkesë e tillë kufizon një OE që mund të ketë kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton (11 apo 12 ton) dhe kriteri i mësipërm e kufizon të marrë pjesë në garë, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Sa më sipër për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. A. T. person përgjegjës për prokurimin publik, znj. A. C. Anëtare, dhe z. M. T. Anëtar.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **1 OE**, për të cilët, referuar proces verbalit nr. 2, të datës 23.03.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	A. shpk me NIUS L.....I	7,268,342 lekë pa tvsh	Kualifikuar

Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **A. shpk** ku në datën **10.05.2022** është mbajtur proces verbali nr.5 i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në **SPE** në datën **10.05.2022**. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë në vlerën **7,268,342 lekë pa tvsh**, për të cilën është lidhur kontrata Nr.3475 Prot dhe Nr.6, datë **12.07.2022** për vlerën **7,268,342 lekë pa tvsh** dhe vlerën **8,722,010 lekë me TVSH**, dhe me afat **2 (dy) muaj** ose **8 (tetë) javë** duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2023 janë si më poshtë vijon:

1. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: "Ndërtim palestere për kompleksin "Shkolla Qëndër Komunitare" për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë".

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim palestere për kompleksin "Shkolla Qëndër Komunitare" për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur,Punë" REF-81019-09-25-2023 Urdhër prokurimi nr.7 datë.07.09.2023	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. projektuesi K. Shpk	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.473 dhe nr.4203 prot datë.07.09.2023 1.G. D. Person përgjegjës për prokurimin publik 2. J. H. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.474 dhe nr.4204 prot datë.07.09.2023 E. Z. Kryetar S. R. Anëtare A. D. Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 56,323,750 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 53.998.391 lekë pa tvsh		6. Diferenca me fondin limit 2,325,358.5 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 12/10/2023	8. Burimi Financimit Fonde buxhetore sipas urdhërit nr.237 datë.15.05.2023 të ministrisë së arsimit dhe Sportit për "Shpërndarjen e financimit për projektet e reja,me cikël financimi 2023-2024 nga programet "Arsimi Bazë" dhe "Arsimi i Mesëm",për Infrastrukturën Shkollore",referuar shkresës nr.3124/5 datë.09.06.2023 dhe nga fondet e buxhetit të Bashkisë Kolonjë, i detajuar në dy vite 2023-2024.		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender,3 OE b) S'kualifikuar 2 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja në muaj 7 (shtatë) ose ditë □□□ Ose Fillon nga nënshkrimi i kontratës dhe mbaron më 7 (shtatë) muaj	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.5884 Prot dhe Nr.12, Data e kontratës.06.12.2023.		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka
10.Ankimime AK-s'ka/ka; APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka Rekomandime nga APP - PO			

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit":

Preventivit është hartuar nga projektuesi **K. Shpk** për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se ka përcaktuar fondin limit referuar V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015 "Për

miratiminin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e cila rezulton të jetë **56,323,750 lekë pa Tvsh.**

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

- Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngitur me Urdhër nr.473 dhe nr.4203 prot datë.07.09.2023 përbërë prej 1. G. D. Person përgjegjës për prokurimin publik , 2. J. H. Anëtare, 3. M. T. Anëtar, të cilat janë evidentuar në proces verbalin Nr.4203/1 prot,datë.25.09.2023. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kritere të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Në pikën 2.3.2 është kërkuar që Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë,të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate,të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

6. NP– 1 A Punime gërmimi në tokë
7. NP– 2 A Ndërtime civile dhe industriale
8. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

6. NS– 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
7. NS– 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
8. NS– 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
9. NS– 9 A Punime strukturore speciale.
10. NS– 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit..
11. NS– 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
12. NS– 18 A Punime topogjeodezike
13. NS– 19 A Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë
14. NS– 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.(*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje*).

Referuar licensave profesionale NS- 9 A “Punime strukturore speciale.”, NS– 20 A “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë”, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Në pikën 2.3.3 është kërkuar që stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

g. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

- 1) Arkitekt 1 (një)
- 2) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (një)

- 3) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist 1 (një)
- 4) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik 1 (një)
- 5) Inxhinier Mekanik profili Konstruksione metalike 1 (një)
- 6) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- 7) Inxhinier Elektrik 1 (një)
- 8) Inxhinier Telekomunikacioni 1 (një)
- 9) Inxhinier Mjedisi 1 (një)

Numri prej 9 inxhinierësh në staf si drejtues teknik, është i fryrë dhe ul konkurrencën në procedurë. OE mund të marrë staf edhe të punësuar me kontratë. Gjithashtu sa i përket kërkesës së AK që stafi i punonjësve të jetë i pasqyruar në listë pagesa, kjo kërkesë kufizon numrin e shoqërive pjesëmarrëse që nuk zotërojnë staf teknik të përhershëm (gjë që reflektohet në listë pagesat e shoqërisë), por që kanë mundësinë t'a sigurojnë këtë staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontratës objekt prokurimi.

➤ **Në lidhje me kërkesën për arkitekt, sqarojmë se** në dokumentet e procedurës së prokurimit AK ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”, duke i vënë në dispozicion, informacionin operatorëve ekonomikë pjesëmarrës mbi projektin të cilët këto të fundit do të zbatojnë në rast të fitimit të kontratës. Disponueshmëria si pjesë e stafit teknik të një arkitekti në fazën e zbatimit të punimeve, ku ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkuar referuar kritereve të veçanta të kualifikimit pjesë të stafit teknik, inxhinierët, si ndërtimi, hidroteknik, mekanik, gjeodet, elektrik, mjedisi, gjeolog, shkon përtej synimit të AK dhe njëherazi nuk është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës. Disponueshmëria e një arkitekti referuar natyrës së punimeve dhe duke marrë në konsideratë faktin se AK ka parashikuar në mënyrë të detajuar projektin e zbatimit, specifikimet teknike, nuk shfaqet e nevojshme në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve.

Në DT është kërkuar: OE duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar. certifikuar si:

- 1 Auditues energjie , (i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjisë)
- 1 punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

➤ Në nenin 16 pika 4 dhe 5 të ligjit nr.125.2015 “Për efincencën e energjisë” parashikohet se: “4. **Auditimi energjetik** është i detyrueshëm për: a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie; b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për Efiçencën e Energjisë për nxitjen dhe përmirësimin e efiçencës së energjisë. 5. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: a) çdo 3 vjet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij neni; b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.”

Në dokumentet e procedurës së prokurimit, AK ka publikuar njëherazi “Preventivin e punimeve”, “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike”, “Grafikun e punimeve” dhe “Projektin e Zbatimit”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi, konstatohet se në asnjë rast AK nuk ka parashikuar në “Relacionin Teknik”, “Specifikimet Teknike” kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga auditues energjetik të licencuar. Gjithashtu AK nuk ka parashikuar si zë të veçantë kryerjen e shërbimit të auditimit të efiçencës së energjisë. Sa më sipër, kriteri i mësipërm i vendosur nga AK në kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë AK. Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.124.2015 “Për efincencën e energjisë”, AK në çdo moment mund të kryejë procesin e auditimit energjetik me një procedurë të veçantë

➤ Në lidhje me këtë kërkesë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” sqarohet se eksperiencia të tilla të kërkuara nga NJHDT nuk janë kusht i nevojshëm për të dëshmuar se OE ka kapacitetin e nevojshëm për ekzekutimin e kontratës. Këto janë kërkesa shtesë dhe të pa argumentuara duke mos qenë të lidhura ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit. Si të tilla ato nuk kanë vend për të qenë kritere kualifikuese.

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin.t Teknik të punimeve Të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e AK që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar.

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Numri prej 2 inxhinierësh si staf mbështetës, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht referuar procesverbalin të argumentimit nr. 3542 prot,datë.15.07.2022, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Betoniere min 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Depozite uji 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Ngjeshes /Kompaktor	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Tranxhe per kthim hekuri	copë	1	Në pronësi ose me qera

10	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Gjenerator	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Total station	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Gps për matje topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Saldatrice /Motosaldatrice	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Kompresor ajri	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Makineri për bashkimin e tubave PEX	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Fabrike betoni jo me larg se 60 km	copë	1	Në pronësi / qira ose kontratë furnizimi

Në pikën 2.3.4 nga AK kërkohet që OE të disponojë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës “minimumi 7 – maksimumi 10 ton”, gjithashtu është kërkuar Eskavator me zinxhira – Kërkesa e AK duke vendosur kufirin maksimal për kapacitetin mbajtës të kamionit është e pa argumentuar, pasi një kërkesë e tillë kufizon një OE që mund të ketë kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton (11 apo 12 ton) dhe kriteri i mësipërm e kufizon të marrë pjesë në garë. Gjithashtu kërkohet Eskavator me zinxhira është e pa argumentuar referuar procesverbalin të argumentimit nr. 4203/1 prot, datë.25.09.2023, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Ndër të tjera, në pikën 2.3.4 “Për fabrikën e prodhimit të asfalto-betonit të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit, për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e asfalto-betonit.

Në lidhje me kërkesat e sipërcituara, vlerësojmë se: a) kriteri i sipërcituar i distancës prej 60 km në mënyrë direkte dhe indirekte cenon konkurrencën në rastin e një OE i cili disponon kriterin për një distancë më të madhe se 60 km por në të njëjtën kohë garanton materialin me të njëjtat kushte dhe specifikime teknike, çka në mënyrë indirekte cenon konkurrencën kur bëhen të detyrueshme me pasojë skualifikimi për OE pjesëmarrës në garë, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë me një laborator testimi të betonit dhe hekurit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose nderkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent, SSH EN 6892-1:2019 ose ekuivalent.

Sa më sipër për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. G. D., person përgjegjës për prokurimin publik, znj. J. H. Anëtare, dhe z. M. T. Anëtar.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **3 OE**, për të cilët, referuar proces verbalit nr. **2**, të datës **12.10.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	Z. Shpk ,me nius L....O	53,998,391.52 lekë pa tvsh	Kualifikuar
2	R. Shpk ,me nius L....H	55,429,661.06 lekë pa tvsh	S'kualifikuar; <i>Nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, dokumentacionin, ligjor, ekonomike-financiar dhe teknik.</i>
3	F.Shpk ,me nius M....Q	56.512.595,17 lekë pa tvsh	S'kualifikuar; <i>Nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, dokumentacionin, ligjor, ekonomike-financiar dhe teknik.</i>

Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **Z. shpk**, ku në datën **24.10.2023** është mbajtur proces verbalit nr.**3** si dhe në datën **30.10.2023** është mbajtur proces verbalit nr.**4** i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në **SPE** në datën **09.11.2023**. Pas përfundimit të afateve të ankimimit nga ana e **KVO** është proceduar me **Raportin përmbledhës** me nr.**5824** prot datë **04.12.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **3 (tre)** operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar **2 (dy) OE** dhe janë kualifikuar **1 (një) OE**. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me nr.**5824/1** prot datë **04.12.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë në vlerën **53.998.391,52 lekë pa tvsh**, për të cilën është lidhur kontrata Nr.**5884** Prot dhe Nr. **12**, Data e kontratës **06.12.2023** për vlerën **53.998.391,52 lekë pa tvsh** dhe **64,030,874 lekë me tvsh** me afat duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me përfundim në **7 (shtatë) muaj**.

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

1. Kamioncina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targa AA...LA, Nr. i lejes së qarkullimit MMCJNKB40FD.... nuk është sipas përcaktimeve të DST.

Mjetet e mara me qera

1. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...DU sipas kontratës nr. 198 rep, nr. 90 kol datë 27.04.2022; 2. Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7-10 ton me targa AA...PG sipas kontratës nr. 286 rep, nr. 132/1 kol datë 28.04.2023; Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10 ton me targa AA...KA sipas kontratës nr. 1261 rep, nr. 723 kol datë 30.09.2021 janë për përdorim vetiak jo për të tretë.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 "Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet se:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:

- a) dhënien me qira pa drejtues mjete;
- b) dhënien me qira me drejtues mjete dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
- c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
- d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
- e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
- f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

7. Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë”.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se:

3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “Z.” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

“3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. E. Z. Kryetar, z. A. J. Anëtar dhe znj. A. D. Anëtare.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Kolonjë mbi Akt konstatimin nr. **12** të mbajtur më **datë.05.04.2024** janë dërguar observacione nga Bashkia Kolonjë me shkresën nr. 1164/1 prot., datë 18.04.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 186/9 prot., datë 22.04.2024, të cilat janë ridërguar me shkresën nr. 3080 datë 26.06.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 186/14 prot., datë 26.06.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit Njësia e prokurimit:

Në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar:

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë,të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate,të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

9. NP– 1 A Punime gjurmimi në tokë
10. NP– 2 A Ndërtime civile dhe industriale
11. NP– 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

15. NS– 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
16. NS– 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
17. NS– 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
18. NS– 9 A Punime strukturore speciale.
19. NS– 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit..
20. NS– 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
21. NS– 18 A Punime topogjeodezike
22. NS– 19 A Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë
23. NS– 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.."

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. ku shpreheni se kategoritë e kërkuara licencës nuk përputhen me zërat e punimeve konkretisht

NS-9 Punime strukturore speciale

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Ju sqarojmë se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkojnë me kategorinë e licencës NS-9 dhe NS-20 si mëposhtë:

Punime strukturore speciale (NS- 9 A) konsiderohen ndërtimi i objektit i destinuar për trasmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Referuar hartës së re sizmike, i gjithë territori i Shqipërisë konsiderohet me sizmicitet të lartë, por zona e Kolonjës dhe Korçës vitet e fundit kanë patur aktivitet sizmik më të shtuar. Kjo referuar termeteve të njëpasnjëshme të vitit 2019 që goditen rajonin juglindor dhe shkatërruan e demtuan mbi 100 banesa.

Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë (NS- 20 A) përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse. Projekti për ndërtimin e objektit në fjalë përfshin një raport konstruktiv të mirëfillte, por në mënyrë që të zbatohet me korrektësi, nevojitet patjetër një relacion gjeologjik për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik.

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.."

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga

operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **janë paraqitur rekomandime** nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë dhe janë dhënë sqarimet e sipërcituara.

b.Në pikën **a** të akt-konstatimit **nr.12**, për auditimin e procedurës së Prokurimit me objekt **“Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qëndër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë”**, në lidhje me hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim ku shpreheni se janë të paargumentuara , ju paraqesim kontestimet tona si mëposhtë vijon:

Në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar:

2.3.3 Stafii kryesor e mbështetes, punonjesit, çertifikimet

h. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

- | | | |
|-----|---|---------|
| 10) | Arkitekt | 1 (një) |
| 11) | Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder | 1 (një) |
| 12) | Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist | 1 (një) |
| 13) | Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik | 1 (një) |
| 14) | Inxhinier Mekanik profili Konstruksiione metalike | 1 (një) |
| 15) | Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| 16) | Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| 17) | Inxhinier Telekomunikacioni | 1 (një) |
| 18) | Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit**.
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues.**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**

Në rast deklarimi të rremë do të vepohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 “Për Prokurimin Publik”.(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Për 1(një) prej drejtuesve të mësipërm duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë “Për auditues energjistik” në ndërtesa, e lëshuar nga Agjensia për Efiçensën e Energjisë në përputhje me VKM Nr.407 ,datë.19.06.2019.

Për inxhinierin mekanik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë “Për sistemet e Ngrohjes-Ftohjes”, e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Për Inxhinierin e Telekomunikacionit duhet të paraqitet edhe:

- *Certifikate CISCO CCNA (Cisco Certified Netëork Associate)* ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

-Në lidhje me faktin se numri prej 9 inxhinierësh në staf si drejtues teknik është i fryrë dhe ul konkurrencën ju sqarojmë se i kemi argumentuar në mënyrë të saktë pasi ky objekt është i ri dhe ekspertiza e secilit prej inxhinierëve është shumë e rëndësishme duke argumentuar si më poshtë vijon:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP” , ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të këtë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj si dhe vendimin Nr.312, datë.5.5.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ligjin nr.124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar, ligji nr. 116/2016 “Për performance e energjisë së ndërtesave si dhe Vendimi Nr.407, datë.19.6.2019, “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet çertifikata e audituesit energjitik”.

Janë kërkuar inxhinier e mësipërm për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike dhe të grafikut të punimeve që do të zbatohen si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit.

Arkitekti duhet për zbatimin e saktë të punimeve të ndarjeve dhe interireve të brendshme dhe zbatimin sipas detajeve arkitektonike të fasadës lidhur me zërat e preventivit të punimeve.

Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi dhe për realizmin e saktë të kuotave, referuar preventivit.

Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Strukturist duhet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndërtohet, referuar specifikimeve në projektin konstruktiv persa i perket lidhjes se struktures metalike me bazamentin prej betoni b/a, traret lidhes b/a, brezat b/a, arkitraret b/a, kollonoat monolite b/a, soletat dhe hekurin e ndërtimit per perforcimin e ketyre strukturave mbajtese dhe lidhese.

Inxhinier Ndertimi i Profilit Gjeoteknik duhet pasi ekspertiza e nje inxhinieri te tille eshte e diktuar ngushtesisht me proceset e punes te parashikuara qartesisht ne projekt – preventiv. Per me teper duke patur parasysh qe punimet do te kryen ne nje zone me sismicitet te larte vertetuar kjo dhe nga termeti i fundit i vitit 2019 kujdesi dhe nevoja per staf te kualifikuar aq me teper per stafin tekniko – inxhinierik qe ka te beje me shkencat e tokes si inxhinieri gjeoteknik eshte e qarte.

Inxhinieri Gjeoteknik ndjek dhe vlereson punimet e germimit deri ne tabanin e themelit per te evidentuar nese ka terren apo zona te paqendrueshme dhe propozon menyren e stabilizimit te tyre ne rast se paraqiten te tilla. Prania e domosdoshme e inxhinierit Gjeoteknik kerkohet per percaktimin e karierave te materialeve qe do te perdoren ne veper duke filluar nga shtresat e themelit dhe deri tek materialet qe do te perdoren ne bazamentin e objektit, ndjek dhe verifikon kapacitetin e terrenit dhe lidhjen e tij me llojin e zgjedhur te themelit.

Inxhinier Mekanik Profili Konstruksione Mekanike duhet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndërtohet, referuar specifikimeve në projektin konstruktiv persa i perket krijimit dhe lidhjes se struktures metalike.

Nje strukture metalike ne rastin e nje kapanoni përgjithësisht eshte e perbere nga këto elemente:

•Profile te ndryshme prej kryesisht prej çeliku

- Saldime
- Bullona
- Ribatina
- Elemente te ndryshme mekanizmesh (kur kërkohen operacione te ndryshme, lëvizje)
- Si edhe përpunim te ndryshme (tornime, frezime, kalandrime, etj)

Te gjitha elementet e mësipërm janë element te cilët janë ne kompetencën e nje inxhinieri mekanik. Gjithashtu këto elemente gjate llogaritjeve te tyre do te konsiderohen si ne ngarkime statike, ashtu edhe ne ngarkime

dinamike apo ne mbingarkesat e castit, ku edhe ne kete rast nje inxhinier mekanik i ketij profili ka formimin e duhur per ti llogaritur ato.

Inxhinieri Hidroteknik duhet për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidrosanitare, sistemit te furnizimit me uje dhe sistemit te shkarkimit te ujerave te zeza dhe te shiut, referuar preventivit.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar preventivit.

Inxhinieri i Telekomunikacionit duhet për zbatimin e saktë të punimeve, pasi referuar preventivit te punimeve te zbatimit, nuk kemi vetem instalimet elektrike por edhe instalime per te cilat nuk perputhet ekspertiza e ing elektrik, por duhet ajo e njeing telekomunikacioni per faktin qe kemi instalim sistem kamerash, sistem komunkimi te te dhenave (plus ky i nderthurur edhe me sistemet kundra zjarrit, sinjalizimit etj). Kerkoet inxhinieri elektronik/telekomunikacion i cili do te ndjeke te gjithe instalimet e rrjetit data, referuar preventivit te punimeve te zbatimit.

Inxhinieri i Mjedisit duhet për zbatimin e saktë të punimeve të objektit q që do të ndërtohet për secilin nga zërat e punimeve të mjedisit. Zbatimi i projektit nuk duhet të ketë pasoja negative në mjedisin e zonës. Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis dhe gazrave në ajër, për kanalet e drenazhimit të ujërave, rreth perimetrit të zonës së punimeve. Gjithashtu jane parashikuar te kryhen punime gjelberimi dhe sisteme te jashtme si mbjellja e fidaneveve dhe shkurreve dekorative, stola dekorativ druri etj.

Për 1(një) prej drejtuesve të mësipërm duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë “Për auditues energjistik” në ndërtesa,e lëshuar nga Agjensia për Efiçensën e Energjisë në përputhje me VKM Nr.407 ,datë.19.06.2019.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) prej drejtuesve teknike të jetë i pajisur me certifikatë “Për auditues energjistik” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me certifikatë për auditimin e energjise,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me efiçensën e energjisë për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për efiçencën e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

a. çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm”.

Sqarojmë se referuar zërave të preventivit, raporti paraprak i eficencës së energjisë nuk është hartuar në fazën e projektimit,kështu që bëhet e nevojshme prezenca e Audituesit të Energjisë në fazën e zbatimit”.

Për inxhinierin mekanik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë “Për sistemet e Ngrohjes-Ftohjes”,e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Kërkesa sa më sipër është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e nje ing mekanik te trajnuar persa i perket instalimit te sistemit te ngrohjes me te gjithe komponentet perberes te ketij sistemi.

Për Inxhinierin e Telekomunikacionit duhet të paraqitet edhe:

- *Certifikate CISCO CCNA (Cisco Certified Network Associate)* ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licensuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ky certifikim konfirmon njohuritë dhe aftësitë e një kandidati në lidhje me bazat e rrjetit, aksesin në rrjet, lidhjen dhe shërbimet IP, bazat e sigurisë dhe automatizimin dhe programueshmërinë. Kerkesa sa me siper eshte e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit si lidhjet e internetit dhe telefonise, instalimi sistemit te vezhgimit IP, sistemi smart i MNZ etj.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Ndërtimit jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë është e rëndësishme pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për pjesën e sheshit, zbërthimin e projektit të zbatimit, punimet e përgjithshme të ndërtimit etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve .

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier gjeolog është parë e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak se objekti është ndërtim i ri në toka të buta dhe me qëndrueshmëri të ulët dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **gjeolog**, i cili do të monitorojë dhe vlerësojë ndërtimin e ri kan dhe pllakës të themelit në lidhje me shtresat gjeologjike.Pra

referuar zërave në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit të propozuar është parashikuar që projekti kalon nëpër formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e një inxhinieri **gjeolog**. Të gjitha punimet duhet të bëhen në prezencë të gjeologut në mënyrë që të merren rezultatet e parashikuara në projekt. Në këto kushte realizimi me sukses i të gjithë procesit kryhet nëpërmjet disponimit nga ana e operatorëve ekonomik të kapaciteteve teknike të përcaktuara në kriteret kualifikuese në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

-Në lidhje me kërkesën që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë/në në stafin e tij 1 (një) punonjës që të disponojë dëshmi trajnimi si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës

- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit**.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Gjithashtu mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rrezikët, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës.

Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” dhe “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

-Në lidhje me kërkesën që Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë minimalist në listëpagesat e muajit të fundit punonjës të specializuar / të kualifikuar, ku përfshihet stafi sipas pikës 2.3.3 gërma a,b,c si mëposhtë:

a. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë/në në stafin e tij 1 (një) punonjës që të disponojë dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj .

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës

- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma c dhe ç ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, **për 1 (një) punonjës** që të disponojë dëshmi trajnimi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit,mbi sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhej pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Në lidhje me kërkesën që Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”* në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP” , ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të këtë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj si dhe vendimin Nr.312, datë.5.5.2010,“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, ligjin nr.124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar,ligji nr. 116/2016 “Për performance e energjisë së ndërtesave si dhe Vendimi Nr.407,datë.19.6.2019,“Për miratimin e procedurës,të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin,të cilit i lëshohet çertifikata e audituesit energjitik”.

Janë kërkuar inxhinier e mësipërm për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit ,projektit, specifitimeve teknike dhe të grafikut të punimeve që do të zbatohen si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Ndërtimit jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë është e rëndësishme pasi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që

prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për pjesën e sheshit, zbërthimin e projektit të zbatimit, punimet e përgjithshme të ndërtimit etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve .

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier gjeolog është parë e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak se objekti është ndërtim i ri në toka të buta dhe me qëndrueshmëri të ulët dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **gjeolog**, i cili do të monitorojë dhe vlerësojë ndërtimin e ri kan dhe pllakës të themelit në lidhje me shtresat gjeologjike. Pra referuar zërave në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit të propozuar është parashikuar që projekti kalon nëpër formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e një inxhinieri **gjeolog**. Të gjitha punimet duhet të bëhen në prezencë të gjeologut në mënyrë që të merren rezultatet e parashikuara në projekt. Në këto kushte realizimi me sukses i të gjithë procesit kryhet nëpërmjet disponimit nga ana e operatorëve ekonomik të kapaciteteve teknike të përcaktuara në kriteret kualifikuese në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Në lidhje me pikën për **Inxhinierin e Mjedisit i cili duhet të jetë i pajisur me:**

- Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Ku ju citoni se kjo kërkesë është ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e e dokumentave teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), dhe nuk është në përputhje me nenin 7 dhe 77 të ligjit nr.162, datë.23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikë 4 të nenit 39 të VKM nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Në lidhje me trajtimin se kriteri nuk është në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me atfësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e kontratës ju sqarohet se kjo kërkesë është argumentuar plotësisht në proces verbalin e hartimit të kriterëve si më poshtë vijon:

Inxhinieri Mjedisit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të gjelbërimit lidhur me zërat e preventivit ,gjithashtu është i nevojshem që të identifikojë,vlerësojë dhe të japë masa për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis, kryesisht gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i pajisur me:

Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Kërkesa përse **Inxhinieri i Mjedisit** të jetë i pajisur me certifikatë “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me certifikatë **Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me ndikimin në mjedis për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”

Në respektim të nenit 20 pika 4 të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë”,

si dhe

Në nenin 6 pika 1 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Projekt” është:

a) zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;
b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve, duke përfshirë njëherazi edhe projektin e procedurës së prokurimit .

Njësia e prokurimit gjykon se operatori ekonomik që do të shpallet fitues i kontratës së prokurimit në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në respekt të parashikimeve që rrjedhin nga **neni 20 pika 4** dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve në kuptim të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë. Sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor se subjekti njëherazi duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit

kontraktues është një kriter në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk tejkalon qëllimin e autoritetit kontraktor dhe nuk shfaq diskriminim mes ofertuesve.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarohet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensia e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

b.Në pikën **a** të akt-konstatimit **nr.12**, për auditimin e procedurës së Prokurimit me objekt “**Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qëndër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë**”, në lidhje me hartimin e **kritereve të veçanta për kualifikim** ku shpreheni se kërkesa për Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton dhe Eskavator me zinxhirë nuk janë argumentuar teknikisht duke kufizuar OE, ju paraqesim kontestimet tona si mëposhtë vijon:

Në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Betoniere min 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Depozite uji 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Ngjeshes /Kompaktor	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Tranxhe per kthim hekuri	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Gjenerator	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Total station	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Gps për matje topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Saldatrice /Motosaldatrice	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Kompresor ajri	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Makineri për bashkimin e tubave PEX	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Fabrike betoni jo me larg se 60 km	copë	1	Në pronësi / qira ose kontratë furnizimi

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi **58 copë**
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 copë.

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqese:

a) Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).

b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.

c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.

d) Për fabrikën e prodhimit të betonit

a) në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, bashkë me Aktin e Miratimit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .

ose

b) në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për fabriken e prodhimit të **betonit**.

ose

c) në rast të akt-marreveshjes së furnizimit të paraqitet akt-marreveshja e furnizimit me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentat e kerkuara me sipër për fabriken e prodhimit të **betonit**.

Ajo duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit, për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e betonit. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e këtyre dokumentave përbën kusht për skualifikim.

e) Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Për përmbushjen e këtij kritერი, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i **ndryshuar**, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr.629 datë.15.07.2015, manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre dhe me anë të këtij kritერი kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar VKM nr.629 datë.15.07.2015, “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/ makinerive/ pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës, nevojiten:

Emri i mjetit	Njesi	Sasi
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton		

	copë	2
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	2
Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	1
Eskavator me zinxhir	copë	1
Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1
Betoniere min 150 litra	copë	2
Depozite uji 5000 litra	copë	1
Ngjeshes /Kompaktor	copë	1
Tranxhe per kthim hekuri	copë	1
Matrapik	copë	1
Gjenerator	copë	2
Total station	copë	1
Gps për matje topografike	copë	1
Saldatrice /Motosaldatrice	copë	2
Kompresor ajri	copë	2
Makineri për bashkimin e tubave PEX	copë	1
Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1
Fabrike betoni jo me larg se 60 km	copë	1

Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës min 10 ton dhe kapacitet mbajtës min 7–max 10 ton, Mjet që përdoret për transportin e materialeve bazuar në zërin e preventivit transport dheu,transport materiale ndërtimi.

Eskavator me zinxhir

Mjet që përdoret për punime gërmimi dhe hapjen e materialit të shtresave.

Fabrikë betoni

Prodhimi i betonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në bazë të preventivit është një sasi e madhe betoni për tu sjellë në kantier.

Në lidhje me vendosjen e kriterit Fabrikë betoni jo më larg se **60 km** nga sheshi i ndërtimit argumentojmë teknikisht si mëposhtë vijon:

Nën nocionin transport të betonit nënkuptohet bartja e betonit nga vendi i prodhimit deri te vendi i vendosjes / shtruarjes të betonit.

Transporti është faktor shumë i rëndësishëm i cili ka ndikim të madh mbi cilësinë e betonit.

Elementet themelore në bazë të cilëve planifikohet transporti janë: lidhja e parakohshme dhe segregacioni i betonit. Përveç kësaj, transporti duhet të jetë i shpejtë, racional,të sigurojë mbrojtje nga avullimi i ujit, rrjedhja e qumështit të çimentos etj.

Transporti i betonit prej fabrikës për beton deri te punishtja quhet transport i jashtëm,kurse transportimi i betonit në vetë punishten quhet transport i brendshëm.

Këtu përfshihet transportimi nga repartet e punishtes dhe vendit për ri ngarkim deri te vendi ku betoni vendoset.

Largësia e fabrikës për beton deri te punishtja mund të jetë 50 e më tepër kilometra. Në distanca të këtilla transporti mund të kryhet vetëm me mjete transportuese nga tipi i automjeteve rrugore siç janë:Kamionët mikser të ashtuquajtur autobetoniere .

Kriteri i vendosur në pjesën e kapacitetit teknik në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së *fabrikës së prodhimit të betonit jo me larg se 60 km*, është një kriter i drejtë dhe jopërgjashtues, përsa kohë ju ka krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia, tek kontrata me qira dhe akt-marreveshje furnizimi. *Njësia e prokurimit gjykon se kriteri i mësipërm nuk është diskriminues,nuk sjell kufizimin e pjesëmarrësve pasi OE mund të përzgjedhin pika të furnizimit me beton dhe inertet brenda*

rrezes prej 60 km vijë rrugore, në drejtim të aksit Ersekë - Tiranë si dhe në drejtim të aksit Ersekë - Leskovik - Gjirokastrë duke mundësuar më shumë se një opsion.

Referuar disa auditimeve të KLSH në institucione të tjera ku ndër të tjera nuk është shprehur për largësinë e vendodhjes së fabrikës por për mënyrën e disponimit (statusit) gjë të cilën ne e kemi parashikuar dhe ju kemi krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia, tek kontrata me qira dhe akt-marreveshje furnizimi.

Konkluzioni se kërkesat e mësipërme nuk janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës nuk qëndron për arsyet e trajtuara më sipër për çdo pikë .

-Konkluzioni nga grupi i auditimit se **kriteret e veçanta për kualifikim** të vendosura në DST e procedurës së prokurimit konstatohen shkelje të legjislacionit të prokurimit publik ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nuk qëndron pasi kërkesat për kualifikim janë plotësisht në lidhje të ngushtë me natyrën dhe objektin e prokurimit. AK nuk mund të tolerojë kapacitetet teknike e profesionale të cilat nuk do jepnin garanci për zbatimin e kontratës.

Gjykojmë se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Njëkohësisht theksojmë se kërkesat për kualifikim për objekte prokurimi për punë të kësaj natyre janë standartizuar pothuajse dhe aplikohen në të gjitha AK prandaj dhe në LPP këto dokumente janë emërtuar standarde pasi i referohen praktikave më të mira. Në të njëjtën kohë, AK ka vlerësuar maksimalisht kriteret për një pjesë të tyre ka insistuar për shkak të natyrës së objektit të prokurimit. Në këtë aspekt insistimi i AK për disa kritere është i drejtë edhe për faktin se nuk ka asnjë kontestim apo kundërshtim të tyre nga OE në fazën e shpalljes së njoftimit të kontratës sipas kërkesave të LPP .

Hartimi i kriterëve për kualifikim nuk ka sjellë shkelje të barazisë në tender për operatorët pjesëmarrës, efekt negativ financiar apo dem ekonomik për autoritetin kontraktor, **ndaj kërkojmë marrjen parasysh të këtij observacioni dhe refektimin e tij në raportin paraprak të auditimit.**

Për sa cituam, **legjitimohemi** të përcaktojmë kërkesa të veçanta për kualifikim për të vërtetuar se operatorët ekonomik zotërojnë kapacitetet e duhura, reputacionin dhe besueshmërinë për realizimin me sukses të kontratës si dhe **për garantimin se punët e prokuruar do të realizohen konform parametrave të kërkuara.**

Oëndrimi i grupit të auditimit.

Observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Kolonjë, gjatë fazës së auditimit në terren. Gjithashtu në observacionet e paraqitura është vendosur kriteret e veçanta të kualifikimit të pa argumentuara.

Pretendimi i subjektit KVO

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i ngritur me urdhër Nr. 474 dhe nr.4204 prot datë.07.09.2023 i përbërë prej E. Z. Kryetar , S. R. Anëtare, A. D. Anëtare.

Lidhur me këtë konstatim tuaj ku citoni se OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4, për realizimin e kontratës, pasi mjetet konkretisht kamionçina kamionçina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targë AA...LA të deklaruara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST dhe mjetet e marra me qera :Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 7- 10 ton me targë AA...DU,Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 7- 10 ton me targë AA...PG,Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 10 ton me targë AA...KA,nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST.

Referuar këtij konstatim, pavarësisht se nga ana Juaj nuk janë cituar specifikimet teknike konkrete sipas DST – ve, dëshirojmë të prapsojmë se këto mjete janë tërësisht sipas përcaktimeve teknike, **pasi kriteret e përcaktuara në DST kanë qënë konkretisht: Kamionçine me kapacitet mbajtes maksimal 3.5 ton, mjete të**

cilat nga ana e OE janë deklaruar, kjo referuar formularit 8 dhe për to është dorëzuar dhe dokumentacioni i plotë, duke plotësuar kriterin e kërkuar nga AK, dhe konstatimi juaj nuk qëndron.

Edhe pse gjetjet e pretenduara nga ana Audituesave në këtë Akt Konstatimi janë të njëjta me ato të Akteve të tjera të relatuara dhe kundërshtuara, duam gjithashtu të prapsojmë dhe një herë sepso në kete Akt Konstatim nga ana Juaj është arsyetuar ndër të tjera se, OE nuk përmbush kriteret e pikës **2.3.4 pasi një pjesë e mjeteve të përdorura nga OE në këtë procedurë tenderi të marra me qera janë për përdorim vetjak dhe se nuk disponojnë certifikatë për dhënien me qera të mjeteve për të tretë.**

Në Akt Konstatimin nr.12 nga ana Juaj është arsyetuar ndër të tjera se nuk përmbushen kriteret e **pikës 2.3.4** pasi një pjesë e mjeteve të përdorura nga OE në këtë procedurë tenderi të marra me qera janë për përdorim vetjak dhe se nuk disponojnë certifikatë për dhënien me qera të mjeteve për të tretë. E për rrjedhojë kjo është në kundërshtim me nenin 81 pikat 1,2,3,4,5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi mjeteve” i ligjit 8378 datë 22/07/1998 “Kodi Rrugor” në R.Shqipërisë, i ndryshuar.

Lidhur me këtë konstatim të Audituesave, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen Tuaj se referuar nenit 81 pika 6, ky nuk është një detyrim i OE, por i pronarëve të mjeteve, të cilët në dijenine tonë si AK certifikatën sipas kësaj dispozite dhe paragrafi e disponojnë.

Por le të sjellim në vëmendjen Tuaj se çfarë parashikon paragrafi 6 i kësaj dispozite:

Neni 81 Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

Pas marrjes së lejes së përkohshme të transportit nga organet e Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse në rreth, mjetet e transportit të mallrave mund të shfrytëzohen në raste të jashtë zakonshme dhe përkohësisht për transport njerëzish. Leja e përkohshme e transportit lëshohet vetëm mbi bazën e kërkesës së titullarit të pushtetit lokal.

Leja e përkohshme e transportit lëshohet nga organet përkatëse në varësi të Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse, për autobuzët e destinuar për t’u dhënë me qira me drejtues mjete, të cilët mund të përdoren në raste të jashtëzakonshme dhe me urdhëresë të Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse në shërbime në linjë dhe anasjelltas.

Për të përligjur çfarë ka konstatuar Institucioni Juaj në këtë Akt Konstatimi se nuk përmbushen kriteret e pikës 2.3.4 ju i referoheni Ligjit Nr.8308, datë 18/03/1998 “PËR TRANSPORTET RRUGORE”, I ndryshuar dhe konkretisht në KREU III. 1 “TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË” Neni 41 “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Për sa i përket këtij referimi dëshirojmë të prapsojmë se OE nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor, referuar ligjit Nr.162/2020 për “Prokurimin Publik” i ndryshuar, të jetë i detyruar të përmbushë kritere përtej atyre të përcaktuara në DST, neni 77 i këtij ligji, ku referuar këtyre të fundit të gjitha mjetet e përdorura në këtë procedurë tenderi kanë specifikimet teknike sipas kriterëve të përcaktuara në DST.

Dhe ne si komision i vlerësimit të ofertave nuk mund të dalim apo bëjmë vlerësime përtej kërkesave të vendosura nga AK.

Ndaj dhe qëndrimi ynë si komision në lidhje me sa është konstatuar nga ana e Audituesave në Akt Konstatimin Nr.9, në lidhje me OE “Z.”sh.p.k, është i pa bazuar në ligj dhe në dokumentacionin e verifikuar po nga vetë Audituesit e KLSH – së.

Për sa më sipër, konkluzioni i audituesve të KLSH se **OE Z. Shpk** është kualifikuar në kundërshtim me Rrpp dhe LPP, si dhe nuk ka vlerësuar drejt shoqërinë pjesëmarrëse në garë d **nuk qëndron** pasi **OE** ka paraqitur dokumentacion kualifikues dhe vlerësimi i ofertes fituese është bërë në mbështetje të të LPP, RrPP, dhe DST.

KVO ka vepruar me korrektësi në vlerësimin e OE pjesëmarrës dhe ka shpallur fitues OE më cilësor jo vetëm për sa i përket plotësimit të kërkesave të DST por dhe çmimit më të leverdisshëm si dhe duke patur parasysh që kontrata është zbatuar me korrektësi e cilësi si dhe është siguruar efica dhe efektiviteti e kësaj veprë ndaj AK.

Kualifikimi i **OE Z. Shpk** nuk ka sjellë shkelje të barazisë në tender për operatorët pjesëmarrës, efekt negativ financiar apo dem ekonomik për autoritetin kontraktor, **ndaj kërkojmë marrjen parasysh të këtij observacioni dhe refektimin e tij në raportin paraprak të auditimit.**

Qëndrimi i grupit të auditimit.

Observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Kolonjë, gjatë fazës së auditimit në terren

2. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur,Punë” REF-81298-09-26-2023 Urdhër prokurimi nr.8datë.22.9.2023	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. projektuesi S. Shpk	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.499 dhe nr.4465 prot datë.22.09.2023 1.A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik 2.J. H. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.500 dhe nr.4466 prot datë.22.09.2023 E. Z. Kryetar S. R. Anëtare A. D. Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 20,259,829 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 19,247,727 lekë pa tvsh		6. Diferenca me fondin limit 1,012,102 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 30/10/2023 7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja në muaj 4 (katër) ose ditë □□□ Ose Fillon nga nënshkrimi i kontratës dhe mbaron më 4 (katër) muaj	8. Burimi Financimit Fonde buxhetore sipas vkm nr 260 datë 27.04.2023 Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe te autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve sipas njësive te vetëqeverisjes vendore.		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 2OE b) S’kualifikuar 1 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP-s’ka/ka; KPP-s’ka/ka Rekomandime nga APP - PO	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.5883 Prot dhe Nr.11, Data e kontratës.06.12.2023.		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka 13.Përgjigje Kërkesës nga OE PO

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlogaritjen e Fondit Limit”:

Preventivit është hartuar nga projektuesi **S. Shpk** për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se ka përcaktuar fondin limit referuar V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e cila rezulton të jetë **20,259,829 lekë pa Tvsh.**

- Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhër nr.499 dhe nr.4465 prot datë.22.09.2023 përbërë prej (1. A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik , 2. J. H. Anëtare, 3.M. T. Anëtar), të cilat janë evidentuar në proces verbalin Nr.4465/1 prot,datë.26.09.2023. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Në pikën 2.3.2 është kërkuar që 2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

1. NP- 1 A Punime gjurmimi në tokë
2. NP- 5 A Punime nëntokësore, ura e vepra arti
3. NP- 7 A Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.
4. NP- 9 A Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime
5. NP- 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

1. NS- 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
2. NS- 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
3. NS- 18 A Punime topogjeodezike

Referuar punimeve të përfshira në dokumentet teknike të procedurës (preventivit), rezulton se zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e disa kategorive të kërkuara nga AK. Sa më sipër, sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008, konstatohen pika licence të cilat nuk kanë lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës. ***Në asnjë rast nuk ka një argumentim nga ana e NJP se për cilat zëra konkretë të preventivit kërkohet një lloj licence e caktuar.***

-Kërkesa e AK në lidhje me pikën e licencës **NP-12** (Punime të inxhinierisë së mjedisit), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës. Në rastin konkret, specifika e kësaj licence, lidhur me ndikimin në mjedis, i përket një faze më të hershme të planifikimit të projektit nga AK dhe jo zbatimit të tij. Në këtë rast, sipas VKM-së Nr.42, datë 16.1.2008, licenca NP-12 konsiderohet për punime: ***“ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik”.***

-Kërkesa e AK në lidhje me pikën e licencës **NS-4** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese), konstatohet se nuk ka lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës.

2.3.3 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet

i. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

19) Inxhinier Topograf ose Gjeodet ose Markshajder 1 (një)

20) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

21) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

22) Inxhinier Mjedisit 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**), i cili të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". ***Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.***

Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 "Për Prokurimin Publik".(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklaratë të duhet të përcaktojë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier Ndërtimi), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", shprehimisht: "Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi". Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve

Në DT është kërkuar: OE ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin.t Teknik të punimeve Të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

➤ Kërkesë jo në përputhje me nenin 7 dhe 38 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i ndryshuar si dhe referuar rregullave të prokurimit publik dhe legjislacionit të fushës përkatëse, kërkesa e AK që punonjësit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shëndetit në punë të figurojnë në listë pagesa, të figurojnë në licencën e shoqërisë dhe të kenë dëshmitë përkatëse, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe aspak në përputhje me ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar.

Ndër të tjera, në pikën 2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Kërkesa që Operatori ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës që të jetë i pajisur me certifikatë për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" është ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumenteve teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi), nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës"

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamioncine me kapacitet mbajtës max 3.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Fadromë	copë	2	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator 0.25 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator 0.5 m ³	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera

8	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Motosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Depozitë uji deri në 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator thellësie	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Vibrator sipërfaqësor	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Paisje niveluese për nivelimin e shtresave të betonit (helikopter)	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Betoniere 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Total station	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Gps për matje topografike	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Armaturë ose Betonforma	m ²	min 500 m ²	Në pronësi ose me qera
19	Motorsharrë	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Pompë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Fabrikë betoni jo më larg se 60 km nga objekti	copë	1	Në pronësi ose me qera ose akt-marreveshje furnizimi
22	Impiante për thyerje dhe seleksionim materiale inertesh jo me larg se 60 km nga objekti e paisur leje mjedisore kodi III.1.B	copë	1	Në pronësi ose me qera ose akt-marreveshje furnizimi
23	Paisje për hekurthyes (tranxhe/elektrobango)	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Kulle/ballonë ndriçimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera

- Ndër të tjera, në pikën 2.3.5 “Për fabrikën e prodhimit të asfalto-betonit **a**) në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, bashkë me Aktin e Miratimit të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit .ose **b**) në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentet e kërkuara me sipër për fabrikën e prodhimit të asfalto-betonit. ose **c**) në rast të kontratës së furnizimit të paraqitet kontrata e furnizimit me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e fabrikës së bashku me dokumentet e kërkuara me sipër për fabrikën e prodhimit të asfalto-betonit. Ajo duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit ,për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e asfalto-betonit. Mosparaqitja ose pavlefshmëria e këtyre dokumenteve përbën kusht për skualifikim”.

Në lidhje me kërkesat e sipërcituara, vlerësojmë se: a) kriteri i sipërcituar i distancës prej 60 km në mënyrë direkte dhe indirekte cenon konkurrencën në rastin e një OE i cili disponon kriterin për një distancë më të madhe se 60 km por në të njëjtën kohë garanton materialin me të njëjtat kushte dhe specifikime teknike; b) kriteret e sipërcituara në lidhje me “leja mjedisore Kodi III 1 B, planimetri dhe dokumentacion që vërteton pronësinë ” eventualisht i adresohen palëve të treta, çka në mënyrë indirekte cenon konkurrencën kur bëhen të detyrueshme me pasojë skualifikimi për OE pjesëmarrës në garë. **Sugjerime për ndryshimin e kriterëve** i janë dhënë AK edhe nga ana e APP-së por ato nuk janë marrë parasysh të gjitha. Gjithsesi, monitorimi dhe rekomandimet eventuale të APP-së në fazën fillestare të procedurës së prokurimit nuk ezaurojnë (shterojnë) mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit “Për prokurimin publik”, po ashtu nuk zhveshin nga përgjegjësia anëtarët e komisioneve përkatëse.

Në lidhje sa më sipër, konstatohet se janë vendosur pika license jo në përputhshmëri me volumin dhe natyrën e objektit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Në DST është kërkuar 2.3.7. Operatori ekonomik duhet të këtë kontrate me një laborator testimi të betonit dhe hekurit, i cili duhet të jete i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent, SSH EN 6892-1:2019 ose ekuivalent.

*Kriteret e sipërcituara në lidhje me “Një laborator testimi të betonit dhe hekurit, i cili duhet të jete i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN 12390-3:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12350-2:2019 ose ekuivalent, SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent, SSH EN 6892-1:2019”, i adresohen palëve të treta, çka në mënyrë indirekte cenon konkurrencën kur bëhen të detyrueshme me pasojë skualifikimi për OE pjesëmarrës në garë. **Sugjerime për ndryshimin e kriterëve** i janë dhënë AK edhe nga ana e APP-së por ato nuk janë marrë parasysh të gjitha. Gjithsesi, monitorimi dhe rekomandimet eventuale të APP-së në fazën fillestare të procedurës së prokurimit nuk ezaurojnë (shterojnë) mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit “Për prokurimin publik”, po ashtu nuk zhveshin nga përgjegjësia anëtarët e komisioneve përkatëse.*

Ndryshimi i dokumentave të tenderit

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, janë paraqitur rekomandime nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentet standarde të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë referuar emailit të datës 3 Oct 2023 të cilat janë marrë në konsideratë pjesërisht.

Njëësia e Prokurimit me shkresën nr. 4840 prot datë 09.10.2023 ka bërë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarde të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt : **Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023**, si më poshtë vijon:

Në kapacitetin teknik pika **2.3.4**, gërma **f** riformulohet si mëposhtë :

ISHTE

j. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in për zërat e preventivit:

- **Tabo celiku,**
- **Saraqineskë**
- **Hekur ndertimi periodik**
- **Gabiona me rrjetë teli të zinguar**

për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi **autorizim prodhuesi** ose **marrëveshje bashkëpunimi** ose **kontrate furnizimi noteriale** (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis **ofertuesit dhe prodhuesit** ose midis **ofertuesit - distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Për Hekur ndertimi periodik,

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit në përputhje me standartin EN 10080 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Përsa i përket shufrave të hekurit të ndertimit*).

Për Tub Çeliku dhe Saraqineskë

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet ose certifikatat e testimit EN 10204 sipas metodës EN 10255 ose ekuivalente (*Për tubot e çelikut*) **nga prodhuesi ose** nga laboratorë të çertifikuar nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit kjo **në mbështetje të ligjit nr.32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve e instalimeve nën presion”.**(*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje*).

Për zërin Bar për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi **autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi ose kontrate furnizimi noteriale** (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis **ofertuesit dhe prodhuesit** ose midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë **nga prodhuesi ose distributori** Çertifikate fitosanitare & origjine për bimët.

Për rastin kur kontrata është lidhur me distributorin e autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e shoqërisë prodhuese me distributorin.

(Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .)

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

BEHËT

k. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in për zërat e preventivit:

- **Tubo celiku,**
- **Saraqineskë**
- **Hekur ndertimi periodik**
- **Gabiona me rrjetë teli të zinguar**

për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi **autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi** ose **kontrate furnizimi noteriale** (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis **ofertuesit dhe prodhuesit** ose midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje*).

Për Hekur ndërtimi periodik,

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë certifikata/test raporti nga laboratorë të certifikuar ose deklarata e konformitetit në përputhje me standartin EN 10080 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Përsa i përket shufrave të hekurit të ndërtimit*).

Për Tub Celiku dhe Saraqineskë

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet ose certifikatat e testimit EN 10204 sipas metodës EN 10255 ose ekuivalente (*Për tubot e çelikut*) **nga prodhuesi ose** nga laboratorë të certifikuar nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit kjo **në mbështetje të ligjit nr.32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve e instalimeve nën presion”.**(*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje*).

Për zërin Bar për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të paraqesi **autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi ose kontrate furnizimi noteriale** (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis **ofertuesit dhe prodhuesit** ose midis **ofertuesit -distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë **nga prodhuesi ose distributori** Çertifikate fitosanitare & origjine për bimët.

Për rastin kur kontrata është lidhur me distributorin e autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që vërteton lidhjet e shoqërisë prodhuese me distributorin.

(Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .)

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Në lidhje me *materialet Tub Celiku dhe Saraqineskë* pika **2.3.4**, gërma **f** kapaciteti teknik certifikatat/standartet e kërkuara referuar nenit **36** të LPP, pika **3/b** autoriteti kontraktor **do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane** dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në kapacitetin teknik pika **2.3.8**, rivlerësohet dhe:

HIQET

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- *Plan organizimin e punimeve të objektit ku të reflektoj të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementët e tjerë që kërkon një plan organizimi të mirëfilltë.*
- *Planin e sigurisë në kantier për punimet në objekt në format sipas VKM nr. 692 datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.*

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **është paraqitur 1 (një) kërkesë për sqarim nga 1 (një) operator ekonomik** nëpërmjet sistemit elektronik duke kërkuar rishikim dhe sqarime për **zerat e preventiv**.

Njësia e prokurimit pasi u njoh me problematiken vendosi të bëjë modifikime duke sqaruar zerat e preventiv nepermjet analizave përkatëse dhe duke i ngarkuar në sistemin elektronik bashkëngjitur

dokumentacionit për tender **shtojcën nr.2** me nr.**4840/1** prot datë.**23.10.2023** duke shtyrë edhe afatin e fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë **1 OE**, për të cilët, referuar proces verbalit nr. **2**, të datës **30.10.2023**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	<i>BOE R. SHPK me nius L....H DHE B. SHPK me nius L.....O</i>	19.247.727 lekë pa tvsh	Kualifikuar
2	Z. Shpk ,me nius L.....O	19.822.539 lekë pa tvsh	S'kualifikuar;

Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik **R. SHPK dhe B. SHPK**, ku në datën.**02.11.2023** është mbajtur proces verbali nr.**3** si dhe në datën.**13.11.2023** është mbajtur proces verbali nr.**4** i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në **SPE** në datën.**13.11.2023**. Pas përfundimit të afateve të ankimit nga ana e **KVO** është proceduar me **Raportin përmbledhës** me nr.**5825** prot datë.**04.12.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **2 (dy)** operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar **1 (një) OE** dhe janë kualifikuar **1 (një) OE**. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me nr.**5825/1** prot datë.**04.12.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë në vlerën **19.247.727 lekë pa tvsh**, për të cilën është lidhur kontrata Nr.**5883** Prot dhe Nr. **11**, Data e kontratës.**06.12.2023** për vlerën **19.247.727 lekë pa tvsh** dhe **23,097,272 lekë me tvsh** me afat duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me përfundim në **4 (katër) muaj**.

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE B.” shpk dhe “R.” shpk i shpallur fitues, rezulton nuk përmbush kriterin e përgjithshme “*Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr pjesë për të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit*”.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit për bashkimin e përkohshëm të shoqërive datë 19.10.2023, operatori ekonomik “B.” shpk do të realizojë 81.37% ndërsa operatori “R.” shpk do të realizojë 18.63% të punimeve. Në marrëveshjen e mësipërme vihet re se nuk janë të ndara specifikisht zë për zë sipas llojit të punimeve se cilat punime do të kryen nga secili operator duke ju referuar liçensave respektive të operatorëve dhe eksperiencës së kaluar në të shkuarën e tyre. Kjo marrëveshje midis palëve nuk duhet të ishte marrë në konsideratë nga AK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE B.” shpk dhe “R.” shpk i shpallur fitues, rezulton nuk përmbush kriteret e **pikës 2.2.1 dhe pikës 2.2.2**. Nga shqyrtimi i dokumentave të paraqitura në SPE vihet re se operatori ekonomik “R.” shpk ka paraqitur vetëm bilanc për vitin 2022 ndërkohë që duhet të paraqiste bilance për 3 vite të fundit. Gjithashtu OE “R.” shpk nuk ka paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020-2021-2022**.

Rezulton se shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE referuar Akt-Marrëveshjes “Për Mbështetje me staf e makineri” të nënshkruar ndërmjet shoqërisë B. shpk dhe shoqërisë Beqiri shpk është në kundërshtim me dokumentat standarte të tenderit, **Konkretisht në pikën 2.16. “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”** Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik

ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE B.” shpk dhe “R.” shpk, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. E. Z. Kryetar, znj. S. R. Anëtar dhe znj. A. D. Anëtare.

3. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas, viti 2023,FAZA I”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas,viti 2023,FAZA I”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Punë” REF-85605-10-27-2023 Urdhër prokurim nr.11datë.28.9.2023	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit. projektuesi L. Shpk	2 Njësia e Prokurimit Urdhër nr.525 dhe nr.4624 prot datë.28.09.2023 1. A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik 2.J. H. Anëtare 3.M. T. Anëtar	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr.526 dhe nr.4625 prot datë.28.09.2023 1. E. Z. Kryetar 2. S. R. Anëtare 3. A. D. Anëtare
4. Fondi Limit (pa tvsh) 10,991,667 lekë pa Tvsh	5. Oferta fituese, vlera fituese: 9.711.266,25 lekë pa tvsh		6. Diferenca me fondin limit 1,280,400.75 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 10/11/2023 7/2 Kohëzgjatja e kontratës: Kohëzgjatja në muaj 4 (katër) ose ditë □□□ Ose Fillon nga nënshkrimi i kontratës dhe mbaron më 4 (katër) muaj	8. Burimi Financimit Vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kolonjë sipas vendimeve të këshillit bashkiak kolonjë nr.140, datë.22.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2023”, si dhe nr.157,datë.22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Kolonjë”,të konfirmuar sipas shkresë nr. 1155/1 prot datë.09.01.2023 nga institucioni i prefektit të qarkut Korçë. Financimi për vitin 2023 është 2,658,333 lekë pa tvsh. Financimi për vitin 2024 është 4,166,667 lekë pa tvsh. Financimi për vitin 2025 është 4,166,667 lekë pa tvsh.		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender,1OE b) S’kualifikuar 0 /OE, c) Kualifikuar 1 /OE
10.Ankimime AK-s’ka/ka; APP–s’ka/ka; KPP-s’ka/ka Rekomandime nga APP - JO	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.6104 Prot dhe Nr.13, Data e kontratës.20.12.2023.		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Preventivit është hartuar nga projektuesi L. Shpk për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se ka përcaktuar fondin limit referuar V.K.M nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratiminin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre", e cila rezulton të jetë **10,991,667 lekë pa Tvsh.**

- Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i ngitur me Urdhër nr.525 dhe nr.4624 prot datë.28.09.2023 përbërë prej (1. A. T. Person përgjegjës për prokurimin publik , 2. J. H. Anëtare,3.M. T. Anëtar), të cilat janë evidentuar në proces verbalin Nr.4624/1 prot,datë.27.10.2023, Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

6.NP– 1 A Punime gërmimi në tokë

7.NP– 2 A Ndërtime Civile dhe industriale.

8.NP– 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

9.NP– 5 A Punime nentokesore, ura e vepra arti.

10. NP– 7 A Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

4.NS– 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

5.NS– 6 A Sinjalistika rrugore jo ndricuese

6.NS– 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

7.NS– 14 A Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj

8.NS– 18 A Punime topogjeodezike.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.(*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje*).

Referuar licensave profesionale NP-7 A “Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje”, NP– 5 A “Punime nëntokësore, ura e vepra arti”, NP – 4 A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”, NS– 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”, NS– 14 A Impiante të brëndshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV, etj. si dhe NS– 18 A “Punime topogjeodezike”, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2.3.3 Stafi kryesor e mbeshtetes, punonjesit, çertifikimet

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

11) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (**Inxhinier Ndërtimi**). Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**

Në rast deklarimi të rremë do të vepohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 "Për Prokurimin Publik".(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje**).

Në pikën 2.3.3 nga AK kërkohet që OE me anë të një deklaratë të duhet të përcaktojë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë (Inxhinier Ndërtimi), për gjatë gjithë afatit të zbatimit të objektit të kontratës dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera - Sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", shprehimisht: "Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi". Pra sa më sipër nuk jemi në kushtet kur preventivi i punimeve

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Bitumatriçe	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Minieskavator	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Rul ngjeshës	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Betoniere min 150 litra	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Depozite uji 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Fabrike asfaltbetoni jo me larg se 60 km	copë	1	Në pronësi / qira ose kontratë furnizimi

Në pikën 2.3.4 nga AK kërkohet që OE të disponojë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës "minimumi 7 – maksimumi 10 ton",– Kërkesa e AK duke vendosur kufirin maksimal për kapacitetin mbajtës të kamionit është e pa argumentuar, pasi një kërkesë e tillë kufizon një OE që mund të ketë kamion me kapacitet mbajtës mbi 10 ton (11 apo 12 ton) dhe kriteri i mësipërm e kufizon të marrë pjesë në garë, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Ndër të tjera, në pikën 2.3.4 *“Për fabrikën e prodhimit të asfalto-betonit të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndërtimit ,për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e asfalto-betonit.*

Në lidhje me kërkesat e sipërcituara, vlerësojmë se: a) kriteri i sipërcituar i distancës prej 60 km në mënyrë direkte dhe indirekte cenon konkurrencën në rastin e një OE i cili disponon kriterin për një distancë më të madhe se 60 km por në të njëjtën kohë garanton materialin me të njëjtat kushte dhe specifikime teknike, çka në mënyrë indirekte cenon konkurrencën kur bëhen të detyrueshme me pasojë skualifikimi për OE pjesëmarrës në garë, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”

Sa më sipër për veprime apo mosveprime ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. A. T. person përgjegjës për prokurimin publik, znj. J. H. Anëtare, dhe z. M. T. Anëtar.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar proces verbalit nr. 2, të datës 10.11.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomik	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	S. Shpk ,me nius K.....W	9.711.266,25 lekë pa tvsh	Kualifikuar

*Nga KVO është bërë vlerësimin dhe klasifikimin i ofertës së paraqitur nga nga operatori ekonomik **S. Shpk**, ku në datën.**20.11.2023** është mbajtur proces verbali nr.**3** si dhe në datën.**23.11.2023** është mbajtur proces verbali nr.**4** i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në sistem me atë të paraqitur në mënyrë fizike. Pas verifikimit është proceduar me formularin e njoftimit të fituesit të publikuar në **SPE** në datën.**29.11.2023**.Pas përfundimit të afateve të ankimimit nga ana e **KVO** është proceduar me **Raportin përmbledhës** me nr.**6027** prot datë.**14.12.2023**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga **1 (një)** operator pjesëmarrës janë s'kualifikuar **0 (zero) OE** dhe janë kualifikuar **1 (një) OE**. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK me nr.**6027/1** prot datë.**14.12.2023** ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë në vlerën **9.711.266,25 lekë pa tvsh**, për të cilën është lidhur kontrata Nr.**6104** Prot dhe Nr. **13**, Data e kontratës.**20.12.2023** për vlerën **9.711.266,25 lekë pa tvsh** dhe **11.653.519,50 lekë me tvsh** me afat duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me përfundim në **4 (katër) muaj**.*

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE **S. Shpk** i shpallur fitues, rezulton nuk përmbush kriteret e **pikës 2.3.3**. Rezulton se shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE referuar Akt-Marrëveshjes “Për Mbështetje me staf e makineri” të nënshkruar ndërmjet shoqërisë **S. Shpk** dhe shoqërisë **S. shpk** datë 09.11.2023 është në kundërshtim me dokumentat standarte të*

tenderit, **Konkretisht në pikën 2.16. “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”** Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE **S. Shpk**, si dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

“3.Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje z. E. Z. Kryetar, znj. S. R. Anëtar dhe znj. A. D. Anëtare.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Kolonjë mbi Akt konstatimin nr. **11 dhe 14** të mbajtur më **datë.05.04.2024** janë dërguar observacione nga bashkia Kolonjë me shkresën nr. 1663/1, 1666/1 prot., datë. 18.04.2024 dhe protokollur në KLSH me shkresën nr 186/8 prot., datë. 22.04.2024, të cilat janë ridërguar me shkresën nr. 3080 datë 26.06.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 186/14 prot., datë 26.06.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit Njësia e prokurimit:

Ju sqarohet se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkohë me kategorinë e liçensës **NP-4** si mëposhtë:

Punime shtresash për shtrim me pllaka tipi 1 të rruges

Shtrese çakelli t=15cm, përhapur e ngjeshur makineri

Shtrese stabilizant t=15cm

Struktura monolite betoni C 12/15,t = 15 cm

Shtrese pllake guri (10x10)cm,t = 6 cm

Punime shtresash për shtrim me pllaka tipi 2 të rruges

Shtrese çakelli t=15cm, përhapur e ngjeshur makineri

Shtrese stabilizant t=15cm

Struktura monolite betoni C 12/15,t = 10 cm

Shtrese pllake guri I bardhe (rugicat)

Punime për brezat dhe bordurat

Struktura monolite betoni C 12/15 poshte bordurave dhe brezave

Struktura monolite betoni e lemuar C 25/30

F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm

Bordure guri (6x25) cm

Mur guri mbajtes e themele, Ilaç çimento M25

NP- 4 Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

Ju sqarojmë se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkojnë me kategorinë e liçensës NP-7 si mëposhtë:

Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm me kapak si trotuari

F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm

NP-7 Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Ju sqarojmë se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkojnë me kategorinë e liçensës NP-12 si mëposhtë:

Mbjellje peme (tipi bredh) me d= 15-20 cm

F.V Stola betoni te veshur me derrase (sipas detajit)

Mbjellje bari

F.V Kosh mbeturinash (sipas detajit)

NP-12 Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Nisur dhe nga fakti që fshati Rehovë është kategorizuar si **Qendër Historike** nga Ministria e Kulturës , AK nuk mund të tolerojë kapacitetet teknike e profesionale të cilat nuk do jepnin garanci për zbatimin e kontratës.

Ju sqarojmë se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkojnë me kategorinë e liçensës NS-1 si mëposhtë:

Prishje shtresa betoni (te lapidari)

Prishje struktura prej guri

Germim dheu me ekskavator goma, 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke

Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te zakonshme

Transport me auto deri 5.0 km

NS -1 Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, **përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.**

Ju sqarojmë se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkojnë me kategorinë e liçensës NS-14 si mëposhtë:

V. Shtyllë cilindrike me lartesi 5.5 m, D1-79mm. + ndricues led 60 WAT duke perfshire te gjithë aksesoret "V .Ndricues te jashtem lulishte 230V / Lartësia : 60cm

Fuqia : 1x60W / Materiali : Alumin+ qelq / Numri i llambave : 1 / Shkalla e mbrojtjes : IP65"

F.V. tub fleksibel me 2 shtresa D=63mm per elektrik

F.V tuba te brinjezuar d110 te rruga

Pusete kontrolli 50 x 50, h = 100 cm

F.V. Kabell FG7OR 0.6/ 1KV, 5x6mm²

Kabell P.V.C. 3x1,5mm²

NS- 14 Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Ju sqarojmë se referuar preventivit të punimeve janë planifikuar zërat të cilët përkojnë me kategorinë e liçensës NS-18 .

Jemi para faktit që po kryhen punime rrugore dhe është mëse e domosdoshme kategoria e liçensës NS-18.

Punime topogjeodezike konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) prej drejtuesve teknike të jetë i pajisur me çertifikatë “Për auditues energjitik” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me çertifikatë për auditimin e energjisë ,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me efizienzën e energjisë për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për efizienzën e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

a) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm”.

Sqarojmë se referuar zërave të preventivit, raporti paraprak i efikasitetit të energjisë nuk është hartuar në fazën e projektimit,kështu që bëhet e nevojshme prezenca e Audituesit të Energjisë në fazën e zbatimit”.

-Në lidhje me trajtimin se nuk jemi në kushtet kur preventivi duhet të jetë mbi vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë dhe në kundërshtim të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 të kërkesës 2.3.3/a të DST për deklaram nga administratori për drejtuesin teknik të punimeve në objekt sqarojmë se nuk është urdhër por udhëzim i KM për të cilin grupi i auditimit nuk është i autorizuar nga KLSH në programin e auditimit për ta përdorur si kriter për vlerësim në auditim. Duke qenë udhëzim nuk imponon AK mbi përcaktimet por vetëm e udhëzon që do të thotë që AK mund të orientohet apo udhëzohet nga përcaktimet e këtij udhëzimi dhe jo domosdoshmërisht të zbatojë ato pikë për pikë. Tjetër aspekt i këtij vlerësimi është fakti që AK ka kërkuar deklaram për drejtuesin teknik dhe jo për përgjegjësin teknik të kantierit të cilit i referohet kriteri i trajtuar në aktkonstatim, konkretisht pika 2.1 e udhëzimit me përmbajtje “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, **konkretisht për Drejtuesin Teknik i cili duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.**

Lidhur me kërkesën që 1 (një) prej drejtuesve teknike të mësipërm të shoqërisë duhet të jetë i pajisur me“Certifikatën e Audituesit Energjistik”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019, ju sqarojmë se :

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) prej drejtuesve teknike të jetë i pajisur me certifikatë “Për auditues energjistik” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me certifikatë për auditimin e energjiave ,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me efikasitetin e energjisë për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen: çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm”.

Sqarojmë se referuar zërave të preventivit, raporti paraprak i efikasitetit të energjisë nuk është hartuar në fazën e projektimit,kështu që bëhet e nevojshme prezenca e Audituesit të Energjisë në fazën e zbatimit”.

Lidhur me kërkesën që Inxhinieri Elektrik duhet të jetë i pajisur me“Certifikatë për Sisteme Kontrolli dhe Komandimi, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ju sqarojmë se :

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensia e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, **konkretisht që Inxhinieri Elektrik duhet të jetë i pajisur me**“Certifikatë për Sisteme Kontrolli dhe Komandimi.

Në lidhje me pikën për **Inxhinierin e Mjedisit i cili duhet të jetë i pajisur me:**

- Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Ku ju citoni se kjo kërkesë është ezauruar në fazën e hartimit të studimit dhe projektimit të objektit dhe konkluzionet e nevojshme janë pjesë e dokumentave teknike (specifikimeve teknike dhe projektit në përgjithësi),dhe nuk është në përputhje me nenin 7 dhe 77 të ligjit nr.162, datë.23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikë 4 të nenit 39 të VKM nr.285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar.

-Në lidhje me trajtimin se kriteri nuk është në përpjestim dhe të lidhur ngushtë me atfësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e kontratës ju sqarojmë se kjo kërkesë është argumentuar plotësisht në proces verbalin e hartimit të kriterëve si më poshtë vijon:

Inxhinieri Mjedisit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të gjelbërimit lidhur me zërat e preventivit ,gjithashtu është i nevojshëm që të identifikojë,vlerësojë dhe të japë masa për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis, kryesisht gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i pajisur me:

Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Kërkesa përse **Inxhinieri i Mjedisit** të jetë i pajisur me certifikatë “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” është e lidhur ngushtesisht me zërat e parashikuara në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit dhe është e nevojshme dhe shumë e domosdoshme ekspertiza e një punonjësi i pajisur me certifikatë **Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**,për të ndjekur çdo proces pune që ka lidhje me ndikimin në mjedis për realizimin me sukses të projektit që do të kryhet.

Kërkesa është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të *ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”*

Në respektim të nenit 20 pika 4 të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë”,

si dhe Në nenin 6 pika 1 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se:

“ Projekt” është:

a) zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;

b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve, duke përfshirë njëherazi edhe projektin e procedurës së prokurimit .

Njësia e prokurimit gjykon se operatori ekonomik që do të shpallet fitues i kontratës së prokurimit në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në respekt të parashikimeve që rrjedhin nga **neni 20 pika 4** dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve në kuptim të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë. Sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa e autoritetit kontraktor se subjekti njëherazi duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues është një kriter në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk tejkalon qëllimin e autoritetit kontraktor dhe nuk shfaq diskriminim mes ofertuesve.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve. Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensia e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, **konkretisht që Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i pajisur me “ Certifikatë për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10 440, datë7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” lëshuar nga Ministria e Mjedisit.**

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Pyjesh i pajisur me Çertifikatë për shërbime profesionale për zbatime lëshuar nga Ministria e Mjedisit, kjo kërkesë është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, pasi referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: janë përfshirë prerje e sistemim pemësh me diametër $\varnothing > 76$ cm, si dhe mbjellje peme (tipi bredh) me $d= 15-20$ cm **120 copë**, proces për të cilin nevojitet ekspertiza e **1 (një) Inxhinier Pyjesh** dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **Pyjesh**.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Gjeolog është parë e domosdoshme dhe e nevojshme për shkak se objekti që do të ndërtohet ndodhet shumë afër objekteve ekzistuese, dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier Gjeolog, i cili do të monitorojë dhe vlerësojë ndërtimin e pilotave dhe pllakës të themelit në lidhje me shtresat gjeologjike, për info point. Pra referuar zërave në preventivin e punimeve të zbatimit të projektit të propozuar është parashikuar që projekti kalon nëpër formacione gjeologjike që kërkojnë ekspertizën e një inxhinieri gjeolog.

Kërkesa sa më sipër për 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni ose IT ose Elektronik i pajisur me Çertifikatë për “CCNA Routing and Sëitching” ose ekuivalent, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kjo kërkesë është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, pasi referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht: janë përfshirë instalime TIK dhe OE duhet të disponojë si **staf mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), një inxhinier **Telekomunikacioni ose IT ose Elektronik**.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhet pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

- Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë**.

- Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë

Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

• Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë, konkretisht për 4 katër inxhinier si staf mbështetës.**

d.Në pikën **a** të akt-konstatimit **nr.11**, për auditimin e procedurës së Prokurimit me objekt **“Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës”,** në lidhje me hartimin e **kritereve të veçanta për kualifikim** ku shpreheni se kërkesa AK ka kërkuar për realizimin e punimeve një punësim mesatar prej **32 punonjës** i cili nuk është i argumentuar teknikisht , ju paraqesim kontestimet tona si mëposhtë vijon:

AK nuk ka kërkuar për realizimin e punimeve një punësim mesatar prej **32 punonjës, por** referuar manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre me VKM nr.629 datë.15.07.2015, “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, për zbatimin e saktë të projektit,sasia e orëve të punës është **18,734.42 op : 8 = 2,341.80 dp : 120 dp = 19.52 puntorë.****Bashkëlidhur po ju paraqesim llogaritjen e punonjësve.**

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

-Në lidhje me trajtimin ku shpreheni se AK ka kërkuar që OE të disponojnë kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 7 – maksimumi 10 ton ,duke vendosur kufirin maksimal 10 ton për kapacitetin mbajtës kjo kërkesë kufizon operatorët ekonomik për të marrë pjesë në garë,**nuk qëndron** , përsa kohë AK ju ka krijuar operatorëve ekonomikë një gamë opsionesh që variojnë nga pronësia dhe kontrata me qira.Nëse një operator ekonomik do të ishte i interesuar kishte dy opsione dhe nuk do të kufizoheshe për plotësimin e këtij kriteri.

Kërkesa po të ishte e ekzagjeruar do të kontestohet të paktën qoftë dhe nga një OE i vetëm për të cilin mund të bëhej pengesë gjë që nuk ka ndodhur. Kërkesa ka të bëjë jo me faktin nëse i plotësojnë apo jo OE pjesëmarrës në tender por me gjykimin nga AK për të mobilizuar në zbatimin e kontratës kapacitete të mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore për zbatimin korrekt të kontratës së punimeve.

Ju sqarojmë se gjatë afatit të njoftimit të kontratës **nuk është paraqitur asnjë kërkesë për sqarim** nga operatorët ekonomik të interesuar në platformën elektronike të prokurimit mbi dokumentat standarte të tenderit të publikuara pranë Autoritetit Kontraktor, **Bashkia Kolonjë.**

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim** pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Vërehet se gjatë afatit të njoftimit të kontratës, **nuk janë paraqitur rekomandime** nga agjensisa e prokurimit publik mbi hartimin e kriterëve të vendosura në dokumentat standarte të tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kolonjë, konkretisht për kapacitetin teknik të mjeteve.**

Pretendimi i subjektit KVO

Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i ngritur me urdhër Nr.223 dhe nr.2217 prot datë.09.05.2022 i përbërë prej E. Z. Kryetar , S. R. Anëtare, E. C. Anëtar.

Lidhur me këtë konstatim tuaj ku citoni se OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.4, për realizimin e kontratës, pasi mjetet konkretisht kamionçina Ford Ranger me kapacitet deri në 3.5 ton me targë AA...I dhe kamionçina Mitsubishi L200 me kapacitet deri në 3.5 ton me targë AA...LA të deklaruar nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST

Referuar këtij konstatim, pavarësisht se nga ana Juaj nuk janë cituar specifikimet teknike konkrete sipas DST – ve, dëshirojmë të prapsojmë se këto mjete janë tërësisht sipas përcaktimeve teknike, **pasi kriteret e përcaktuara në DST kanë qënë konkretisht: Kamionçine me kapacitet mbajtes maksimal 3.5 ton, mjete të cilat nga ana e OE janë deklaruar, kjo referuar formularit 8 dhe për to është dorëzuar dhe dokumentacioni i plotë,** duke plotësuar kriterin e kërkuar nga AK, dhe konstatimi juaj nuk qëndron.

Në Akt Konstatimin nr.11 nga ana Juaj është arsyetuar ndër të tjera se nuk përmbushen kriteret e **pikës 2.3.4** pasi një pjesë e mjeteve të përdorura nga OE në këtë procedurë tenderi të marra me qera janë për përdorim vetjak dhe se nuk disponojnë çertifikatë për dhënien me qera të mjeteve për të tretë.E për rrjedhojë kjo është në kundërshtim me nenin 81 pikat 1,2,3,4,5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi mjeteve” i ligjit 8378 datë 22/07/1998 “Kodi Rrugor” në R.Shqipërisë, i ndryshuar.

Lidhur me këtë konstatim të Audituesave, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen Tuaj se referuar nenit 81 pika 6, ky nuk është një detyrim i OE, por i pronarëve të mjeteve, të cilët në dijeninë tonë si AK çertifikatën sipas kësaj dispozite dhe paragrafi e disponojnë.

Por le të sjellim në vëmendjen Tuaj se çfarë parashikon paragrafi 6 i kësaj dispozite:

Neni 81 Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve

Pas marrjes së lejes së përkohshme të transportit nga organet e Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse në rreth, mjetet e transportit të mallrave mund të shfrytëzohen në raste të jashtë zakonshme dhe përkohësisht për transport njerëzish. Leja e përkohshme e transportit lëshohet vetëm mbi bazën e kërkesës së titullarit të pushtetit lokal. Leja e përkohshme e transportit lëshohet nga organet përkatëse në varësi të Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse, për autobuzët e destinuar për t'u dhënë me qira me drejtues mjeti, të cilët mund të përdoren në raste të jashtëzakonshme dhe me urdhëresë të Ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse në shërbime në linjë dhe anasjelltas.

Për të përligjur çfarë ka konstatuar Institucioni Juaj në këtë Akt Konstatimi se nuk përmbushen kriteret e pikës 2.3.4 ju i referoheni Ligjit Nr.8308, datë 18/03/1998 “PËR TRANSPORTET RRUGORE”, I ndryshuar dhe konkretisht në KREU III. 1 “TRANSPORTI I MALLRAVE ME QIRA DHE PËR TË TRETË” Neni 41 “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

Për sa i përket këtij referimi dëshirojmë të prapësojmë se OE nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor, referuar ligjit Nr.162/2020 për “Prokurimin Publik” i ndryshuar, të jetë i detyruar të përmbushë kriteret përtej atyre të përcaktuara në DST, neni 77 i këtij ligji, ku referuar këtyre të fundit të gjitha mjetet e përdorura në këtë procedurë tenderi kanë specifikimet teknike sipas kriterëve të përcaktuara në DST.

KVO ka vepruar me korrektësi në vlerësimin e OE pjesëmarrës dhe ka shpallur fitues OE më cilësor jo vetëm për sa i përket plotësimit të kërkesave të DST por dhe çmimit më të leverdisshëm si dhe duke patur parasysh që kontrata është zbatuar me korrektësi e cilësi si dhe është siguruar efica dhe efektiviteti e kësaj vepre ndaj AK.

Kualifikimi i **OE Z. Shpk** nuk ka sjellë shkelje të barazisë në tender për operatorët pjesëmarrës, efekt negativ financiar apo dem ekonomik për autoritetin kontraktor, *ndaj kërkojmë marrjen parasysh të këtij observacioni dhe refektimit të tij në raportin paraprak të auditimit.*

Oëndrimi i grupit të auditimit.

Observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Kolonjë, gjatë fazës së auditimit në terren.

Për zbatimin e dispozitave ligjore mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik të blerjeve me vlera të vogla.

- Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2023, Bashkia Kolonjë ka realizuar në total 104 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 54,347,104 lekë pa Tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate 51,025,540 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje nga 104 procedura të realizuara me fond limit 54,347,104 lekë pa Tvsh janë audituar 14 procedura me fond limit 10,855,644 lekë pa Tvsh, ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Referuar procedurave të realizuara nga Bashkia Kolonjë dhe të publikuara në Sistemin Prokurimit Elektronik për vitin 2022 ka realizuar 5 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 4,844,377 lekë pa Tvsh duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me vlerë të lartë

-Procedura me objekt “Blerje Materiale për Meremetime të godinave të arsimit parashkollor Shkolla fshati Shalës, Starje Qendër dhe Vodice në Bashkinë Kolonjë për vitin 2022.”, me urdhër prokurimi nr. 11 datë 10.05.2022, me fond limit 823,500 lekë pa Tvsh.

-Procedura me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e shkollave ,kopshteve dhe çerdheve viti 2022”, me fond limit 833,333 lekë pa Tvsh.

-Procedura me objekt “Blerje materiale për Rrethimin e Varrezave Publike fshati Starje e Pobicke si dhe Fusha Sportive ne Bashkinë Kolonjë për vitin 2022” me urdhër prokurimi nr. 28 datë 09.08.2022, me fond limit 565,744 lekë pa Tvsh.

-Procedura me objekt “Blerje Materiale për riparimin e lulishtes 1-maji qytetit e Ersekës në Bashkinë Kolonjë për vitin 2022” me urdhër prokurimi nr. 40 datë 24.10.2022, me fond limit 832,500 lekë pa Tvsh.

-Procedura me objekt “Blerje Materiale për urën e varur [pacarelë] në fshatin Blush, Njësia Administrative Çlirim, Bashkia Kolonjë viti 2022” me urdhër prokurimi nr. 50 datë 02.12.2022, me fond limit 998,450 lekë pa Tvsh.

-Procedura me objekt “Blerje materiale për urën e varur ,pacarele fshati Mesiçkë Njësia Administrative Novosele Bashkia Kolonjë vitit 2022” me urdhër prokurimi nr. 27 datë 04.08.2022, me fond limit 790,850 lekë pa Tvsh

Procedurat e mësipërme të cilat janë zhvilluar me procedurë prokurimi blerje të vogël i përkasin të njëjti objekt prokurimi blerje materiale ndërtimi.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura, Bashkia Kolonjë për vitin 2023 ka realizuar 3 procedura prokurimi për blerje materiale elektrike me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 2,979,700 lekë pa Tvsh duke shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit dhe duke mos i kryer këto procedura me vlerë të lartë.

Konkretisht, tre procedura

-Procedura me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e ndriçimit rrugor në qytetin e Leskovikut për shkak të dëmtimit të linjës nga shkarkimet e fuqishme elektrike (rrufet) të datës 26.05.2023 ne Bashkia Kolonjë”, me urdhër prokurimi nr. 35 datë 12.06.2023, me fond limit 980,000 lekë pa Tvsh.

-Procedura me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e ndriçimit rrugor në qytetin e Ersekës për shkak të dëmtimit të linjës nga shkarkimet e fuqishme elektrike (rrufet) të datës 25.06.2023 në Bashkia Kolonjë” me urdhër prokurimi nr. 40 datë 24.07.2023, me fond limit 997,700 lekë pa Tvsh.

- Procedura me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e ndriçimit rrugor, arsimin parashkollor dhe parauniversitar viti 2023 Bashkia Kolonjë viti 2023” me urdhër prokurimi nr. 16 datë 23.03.2023, me fond limit 1,000,000 lekë pa Tvsh.

Procedurat e mësipërme të cilat janë zhvilluar me procedurë prokurimi blerje të vogël i përkasin të njëjti objekt prokurimi blerje materiale elektrike.

-Në 2 raste faturat tatimore nuk janë likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 2 raste për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim transporti për nevojat e ekipit të futbollit Gramozi dhe të Grupit Folklorikë në Bashkinë Kolonjë 2022”, me fond limit 404,200 lekë pa Tvsh me operatorë ekonomik të shpallur fitues “ER-Trans” 385,000 lekë me Tvsh, nuk disponohet një procesverbal i cili duhej të mbahej nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla ku bashkëlidhur të evidentohet lista e nënshkruar nga të gjithë personat që kanë marrë këtë shërbim.

Për procedurën e prokurimit me objekt “Transporti i sportistëve për fazën e dytë 2021-2022 të Klubit të Futbollit Gramozi ”, me fond limit 154,0000 lekë pa Tvsh, me operatorë ekonomik të shpallur fitues ER-Trans 153,000 lekë me Tvsh, nuk disponohet një procesverbal i cili duhej të mbahej nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla ku bashkëlidhur të evidentohet lista e nënshkruar nga të gjithë personat që kanë marrë këtë shërbim.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56, pika 1, 2, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36 dhe

42, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 7 dhe pikat 11-12.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. I. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. S. L., znj. L. J., z. E. Z., z. F. Q., z. A. T. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla sipas periudhave respektive.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Kolonjë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t’u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelë:

Nr	Emërtimi I investimit të kryer	Vlera e investimit me TVSH sipas kontratës	Operatori Ekonomik	Data e fillimit të punimeve sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim të kantierit të ndërtimit	Afati I punimeve sipas kontratës	Nr. dhe data e kontratës	Data e përfundimit të punimeve sipas kontratës	Data e marrjes në dorëzim të investimit (procesverbali I kolaudatorit dhe grupit të marrjes në dorëzim)
1	Rikualifikimi i Rrugës Pali Prifti, Qyteti Ersekë, Bashkia Kolonjë	41,794,654	BOE Z. Shpk dhe K. Shpk	16.07.2021	07.04.2022	Nr. 3420 Prot Data 12.07.2021	07.04.2022	27.06.2022
2	Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës", viti 2022	19,927,289	Z. Shpk	27.07.2022	25.11.2022	Nr. 3650 Prot Data 27.07.2022	25.11.2022	26.12.2022
3	Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022	24,537,099	Z. Shpk	15.09.2022	15.01.2022	Nr. 3650 Prot Data 27.07.2022	15.01.2022	

Mbështetur sa më sipër, është kryer auditimi i zbatimit të punimeve për periudhën e auditimit 01.01.2022 deri 31.12.2023, për 3 (pesë) kontrata për punë publike në shumën totale **86,259,099** lekë pa TVSH ose **103,510,850** lekë me TVSH.

Në zbatim të pikës së programit të auditimit, mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u shqyrtua dokumentacioni tekniko-ligjor i ndodhur në dosjet e zbatimit ku, në vijim po pasqyrojmë Problematikat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "**Rikonstruksioni i i digës së Rezervurit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë**" viti 2023, rezultoi se:

- Me shkresën e Bashkisë Kolonjë nr. 263/1 prot., datë 07.02.2023 “*Dërgim i Projekteve të Bashkisë Kolonjë*”, dërguar pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në cilësinë e Sekretarit Teknik të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, ka përcejllë kërkesën dhe materialin teknik për financimin e projekteve “*Prita Malore Mësiçkë, Taç Poshtë – Kolonjë*” dhe “*Punime për riparimin e digës së rezervurit të Gjonçit*”. Bazuar në Vendimin e

Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore nr. 3, datë 14.02.2023 “Për miratimin e projekteve fituese” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 260 datë 27.04.2023 “Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, si dhe vendimit të AK për zbatimin e projekteve, sipas njësisë të vetëqeverisjes vendore” projektet “Prita Malore Mësiçkë, Taç Poshtë – Kolonjë” dhe “Punime për riparimin e digës së rezervurit të Gjonçit”, përzgjidhen si projekte fituese për programin “Emergjencat Civile” 2023. Më pas ngarkohet njësia e qeverisjes vendore Bashkia Kolonjë si AK për zbatimin e projekteve, ku kërkohet ndjekja e procedura prokuruese si dhe përmbushja e detyrimeve të caktuara për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

Vlera e miratuar për Bashkinë Kolonjë është 24,311,795 lekë me TVSH me afat kryerje 4 muaj. Fondi i emergjancave civile, kalohet në rregjistrin e parashikimeve për vitin 2023 dhe me kod projekti 18AZ901, ku realizohet prokurimi publik me nr. REF-81298-09-26-2023 dhe shpallet fitues BOE “R.” & “B.” shpk. Projekti parashikon rikonstrukcion dhe punime të ndryshme për riparimin e digës së rezervuarit të Gjonçit, duke përfshirë punime si prerje bimesh, rrafshim skarpate, riparim kalldrëmi, punime në kurorën e digës si ndërtimi i parapetit B/a, shtresë çakëlli, shtresë stabilizanti, punime për riparimin e ujëlëshuesit, punime për riparimin e shkarkuesit katastrofik duke përfshirë edhe një urë 4 m mbi të. Në digë ka punime të tjera si vendosje reperash topografik, vendosje pajisjesh pjezometrike për matjen e nivelit të ujit, vendosje pajisje inklinometër vertikal për monitorimin e devijimit të mundshëm në drejtimin vertikal të digës, mbjellje skarpatës së poshtme etj. Në lidhje me ndërtimin e pritave malore në fshatrat “Prita Malore Mësiçkë, Taç Poshtë – Kolonjë”, përfshihen punime si ndërtimi i gabionave me rrjetë të zinguar (1 x 1 x 1.5 m) si dhe punime gjurmimi me eskavator dhe punime mbushje me zhavor pas mureve. - Objekti i kontratës “Rikonstrukcioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë”, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 5885 prot., datë 06.12.2023, me nr. REF-81298-09-26-2023, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë, përfaqësuar nga E. I. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik BOE “R.” & “B.” shpk, përfaqësuar nga administratorët E. K. dhe A. L.. Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të BOE datë 19.10.2023, operatorët ekonomik kanë rënë dakord të realizojnë bashkim të përkohshëm të shoqërive, ku shoqëria “R.” shpk do të kryejë 18.63 % të punimeve dhe shoqëria “B.” shpk do të kryejë 81.37 % të volumit të punimeve. Me anë të autorizimit të përfaqësimit të shoqërive datë 19.10.2023, operatori “B.” shpk, autorizon operatorin “R.” shpk me përfaqësues ligjor E. K., të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive në realizimin e kontratës. Referuar Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), neni 1.10 “Përgjegjësia e përbashkët dhe solidarë” citohet se nëse kontraktori është Bashkim Operatorësh Ekonomik, të gjithë këta operatorë ekonomik do të jenë bashkarisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj AK për përmbushjen e dispozitave të kontratës. Kontrata është nënshkruar bazuar nënve 850 – 876 dhe në vazhdim të Kodit Civil i RSH, Ligjit 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimit Publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; dokumentacioni i tenderit dhe oferta ekonomike, të cilat janë pjesë e kontratës së zbatimit. Vlera e kontratës është 23,097,273 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 4 muaj duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Preventivi dhe lloji i kontratës bazuar në nenin 7 të KVK dhe dokumentave të tenderit, është kontratë me çmim njësie (kontratë me matje), ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Bazuar në nenin 8 të kontratës pika 8.1 thuhet se: “Kontraktori duhet të paguhet nga AK për punime të realizuara, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara”. Referuar kontratës së punimeve nr. 5885 prot., datë 06.12.2023, neni 5 “Mbikëqyrësi i punimeve” pika 5.6 citon se: *mbikëqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t’i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij*

tek drejtuesi i projektit. Referuar nenit 2 “Praktikat e ndaluara” pika 2.2 citon se: nëse AK gjatë zbatimit të kontratës, ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

- Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 6040 prot., datë 15.12.2023, me Nr. REF-89854-12-06-2023 të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Kolonjë, përfaqësuar nga E. I. dhe Operatorit Ekonomik “V.” shpk, me përfaqësues ligjor M. S., me nr. License MK. datë 03.09.2021 “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh të zbatimit” lëshuar nga MIE. Referuar kontratës së shërbimit citohen të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësit si më poshtë: Pika 2. Mbikëqyrësi përgjigjet për ndërtimin e objektit në përputhje me projektin dhe kushtet teknike të zbatimit; pika 3. Njofton me shkrim për çdo problem që mund të lind gjatë zbatimit të punimeve; pika 4. Duhet të ruaj dhe kontrollojë të gjitha dokumentet e përcaktuara në Ligjin 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”; Pika 17. Mbikëqyrësi është përgjegjës për fondin e veprës. Situacionet e paraqitura nga kontraktori pas kryerjes së punimeve në faza të ndryshme mund të paguhen nga Investitori vetëm pasi të jenë shqyrtuar dhe firmosur nga mbikëqyrësi i punimeve; Pika 20. Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore Investitori ka të drejtë t’i urdhërojë mbikëqyrësit pezullimin e punimeve dhe i lind e drejta të kryej prishjen e kontratës duke kërkuar dëmshpërblim mbikëqyrësit. Vlera e shërbimit të mbikëqyrjes është 486,235 lekë pa TVSH, e cila nuk është likuiduar nga Bashkia Kolonjë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion referuar Urdhër shpenzimit nr. 1117 datë 27.12.2023, konstatohet se deri më datë 05.04.2024, referuar protokollit të Bashkisë Kolonjë për muajin Dhjetor 2023 të administruar nga grupi i auditimit, nuk disponohet Akti Dorëzimit të sheshit të ndërtimit i cili duhet të mbahej midis palëve. Nuk disponohet asnjë dokument në lidhje me Njoftimin për fillimin e punimeve në objekt, por disponohet vetëm Vendimi i Kryetarit të Bashkisë E. I., Nr. 51 datë 27.12.2023 “Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh”.

Në vendimin Nr. 51 datë 27.12.2023, miratohet deklarata e kryerjeve të punimeve të riparimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes, për objektin e rezervuarit të Gjonçit dhe mbrojtje lumore. Ngarkohen autoritetet përgjegjëse të inspektimit të respektojnë vendimin dhe Afati kohor i lejës është 12 muaj nga data e lëshimit të saj. Deklarata është nënshkruar elektronikisht nga A. D. me detyrë specialist topograf (sistemi GIS), G. E. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit rural, M. T. me detyrë Drejtor i Urbanistikës dhe Kryetari i Bashkisë E. I.. Referuar Urdhërit të Xhirimit nr. 1117 datë 27.12.2023, dokumentet bashkëlidhur shpenzimit janë: Urdhri i Prokurimit nr. 4468 prot. Datë 22.09.2023; Kontrata nr. 5885 prot., datë 06.12.2023; Likuidimi i faturës nr. 7/2023 prot., datë 27.12.2023; Kërkesë për pagesë nr. 6183 prot., datë 27.12.2023; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 698 datë 27.12.2023. Pra deklarata për kryerje punimesh është firmosur 21 ditë më vonë nga data e lidhjes së kontratës. Me shkresën e sipërmarrësit “R.” shpk nr. 15 prot., datë 27.12.2023, protokolluar në Bashkinë Kolonjë nr. 6183 prot., datë 27.12.2023 (21 ditë pas lidhjes së kontratës), drejtuar vetëm mbikëqyrësit të punimeve, por jo për dijeni Bashkisë Kolonjë, kërkohet likuidimi i situacionit nr. 1 i punimeve datë 27.12.2023 në vlerën prej 22,167,288 lekë me TVSH.

Duke zbritur 5 % garancinë e punimeve në masën 1,108,364 lekë, vlera për tu likuiduar është 21,058,924 lekë me TVSH. Kërkesa për likuidim nga kontraktori BOE "R." & "B." shpk, është me gabime të theksuara dhe të paargumentuara, si numri i kontratës së punimeve i cili nuk përputhet me numrin e kontratës në fjalë, si dhe duke vendosur emër tjetër kontraktori për kontratën e fituar prej tij. Konkretisht është vendosur gabimisht emri i Kontraktorit BOE “Z.” shpk dhe “K.” shpk, të cilët janë fitues në tjetër procedurë në Bashkinë Kolonjë, veprime të cilat nuk argumentohen në lidhje me korrespondencat e palëve. Situacioni pjesor nr. 1 është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve M. S. si përfaqësues i shoqërisë “V.” shpk, kontraktorit dhe Kryetarit të Bashkisë Kolonjë E. I.. Situacionit pjesor nr. 1, në masën 96 % të punimeve, ku nuk disponohet

asnjë relacion bashkëlidhur apo raport mbi ecurinë e punimeve pas 21 ditësh nga lidhja e kontratës dhe në të njëjtën ditë për lejimin e kryerjes së punimeve sipas vendimin Nr. 51 datë 27.12.2023 të Bashkisë. Vlera e situacionit të mësipërm ishte e pamundur të realizohej në masën 96 % të kontratës dhe kjo dëshmon për një fiktivitet pagesash, duke favorizuar drejtëpërdrejtë kontraktorin e punimeve. Gjithashtu me Urdhërin nr. 698 datë 27.12.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë E. I., urdhërohet të bëhet pagesa e situacionit nr. 1 në masën 96 % të punimeve në vlerën 22,167,288 lekë me TVSH, ku ngarkohet Drejtoria e Financës për zbatimin e urdhërit. Sa më sipër Me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë E. I., Nr. 51 datë 27.12.2023 “Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh”, miratohet kryerja e punimeve të riparimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes, për objektin e rezervuarit të Gjonçit dhe mbrojtje lumore si dhe me Urdhërin nr. 698 datë 27.12.2023 të Kryetarit të Bashkisë, urdhërohet pagesa për situacion pjesor. Pra konstatohen veprime/mosveprime në datën 27.12.2023 për favorizim të drejtëpërdrejtë të BOE, duke kryer likuidim për punime të pa kryera e të pa filluara, çka ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Kolonjë, Kontraktorin dhe Mbikëqyrësin e Punimeve. Me veprimet e mësipërme, nga palët është shkëlur Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, VKM nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar si dhe Ligjin 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” si dhe vetë kontrata e punimeve nr. 5885 prot., datë 06.12.2023, me nr. REF-81298-09-26-2023. Nga verifikimi i situacionit nr. 1, (ku nuk disponohet asnjë librezë masash por vetëm situacioni me vlerat përkatëse) dhe verifikimit në terren datë 03.04.2024 nga grupi i auditimit të KLSH-së, i përbërë nga H. I., A. K., A.S., në prezencë të Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit rural G. E. dhe Drejtorit të Urbanistikës M. T. në Bashkinë Kolonjë në rezervuarin e Gjonçit dhe pritave malore, u konstatua se nuk ishte realizuar asnjë punim.

- Më datë 06.04.2024, referuar kontratës së zbatimit, përfundon edhe afati i zbatimit të kontratës dhe nga ana e BOE "R." & "B." shpk, nuk është realizuar asnjë zë pune duke mos ngritur as kantierin e punimeve. Pra, pas 4 muajsh nga nënshkrimi i kontratës, nuk ishte realizuar asnjë punim dhe nuk ishte marrë asnjë masë nga Bashkia Kolonjë, kjo gjë ka çuar në përfitimin e padrejtë të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën **21,058,924 lekë me TVSH**, e cila përbën Dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 01, datë 05.04.2024, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Kolonjë).

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë z. E. I. me nr. 1655/1 prot., datë 18.04.2024, të protokolluara në KLSH me nr. 186/6 prot. Datë 22.04.2024, mbi pretendimet e Akt konstatimit nr. 01 datë 05.04.2024, të cilat janë ridërguar me shkresën nr. 3080 datë 26.06.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 186/14 prot., datë 26.06.2024, si më posht vijon:

Pretendimi i subjektit:

- Në observacionin e Kryetarit të Bashkisë citohen kushtet e kontratës së punimeve neni 1.10 “Përgjegjësia e përbashkët solidarë”, neni 6 “Përgjegjësitë e kontraktorit”, kontrata e mbikëqyrjes dhe ligji pëgjji për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, i cili shkarkon përgjegj, i cili shkarkon përgjegjësitë e veprimeve tek sipërmarrësi dhe tek mbikëqyrësi. Në lidhje me Vendimin e deklaratës paraprake e cila korrespondon me datën e pagesës, sqarohet se për shkak të angazhimeve të ndryshme bashkiake, ky vendim është realizuar me vonesë pasi është detyrë ligjore pajisjz me këtë dokument. Nisur nga kjo situatë janë marrë masat dhe ndarë përgjegjësitë së bashku me stafin e bashkisë duke monitoruar dhe kontrolluar punimet për këtë objekte cila deri në datën e observacionit janë realizuar në masën 80% duke nisur nga ndërtimi i pritave malore në fshatrat Mësiçkë dhe Taç i poshtëm të cilët janë realizuar 100 % dhe punimet në digën e Gjonçit janë realizuar në masën 60%.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga Kryetari i Bashkisë në observacion, vihet re se nuk ka asnjë dokumentacion shtesë provues mbi pretendimet e shprehura apo kundërshtime ligjore sa i përket përgjegjësi si Autoritet Kontraktor. Komentet nuk kanë asnjë mbështetje ligjore, rrjedhimisht observacioni nuk mund të merret në konsideratë.

Në lidhje me observacionet e dërguara nga sipërmarrësi i punimeve z. E. K. me nr. 5 prot., datë 12.04.2024, të protokolluara në KLSH me nr. 186/12 prot. Datë 22.04.2024, mbi pretendimet e Akt konstatimit nr. 01 datë 05.04.2024.

Pretendimi i subjektit:

- Në observacionin e kontraktorit sqarohet se punimet e pritave malore në fshatin Taç poshtëm dhe Mësiçkë kanë filluar menjëherë që në datën 06.12.2023 duke realizuar zërat sipas preventivit, hapje themeli për ndërtimin e gabioneve. Këto punime u realizuan me shpejtësi brenda 14 ditësh pasi ishin në periudhë dimri dhe zona mund të shkaktonte devijime të favorshme të lumenjve megjithëse deklarata për kryerjen e punimeve ka dalë në datën 27.12.2023, për këtë arsye është prerë fatura po njëjtën datë. Me qëllim që të realizoheshin punimet në kohë, por për shkak të kushteve atmosferike gjatë muajit Dhjetor deri në 15 Mars 2024, ka qenë i pamundur realizimi i punimeve në objekt. Gjatë kohës së auditimit shoqëria po mobilizohesh për të realizuar punimet brenda datës 27.04.2024, referuar afatit 4 muaj sipas deklaratës së kryerjes së punimeve sipas Vendimit të Kryetarit nr. 51 datë 27.12.2023. Bashkëlidhur ndodhen foto të realizimit të punimeve. Në observacion sqarohet se punimet për realizimin e zërave të preventivit në digën e rezervuarit të Gjonçit do të realizohen pjesërisht pasi rezervuari nuk mund të boshatiset në këtë periudhë sepse është shumë e vështirë të mbushet sërish me ujë dhe boshatisja do të rrezikonte banorët e zonës gjatë procesit të vaditjes.

Kontraktori sqaron se nuk ka përfutur fonde publike, duke mos dashur të zbatojë punimet apo kontratën, por kushtet atmosferike dhe vështirësia për të realizuar punimet kanë krijuar situatën.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga kontraktori në observacion, vihet re se janë bashkëlidhur dokumentacione shtesë provuese mbi realizimit të punimeve, pas fazës së dorëzimit të Akt konstatimit nr. 1 datë 05.04.2024. Argumentimet e mësipërme nuk mund të merren në konsideratë pasi referuar protokollit të Bashkisë Kolonjë, nuk disponohet asnjë dokumentacion në lidhje me pezullimin apo zgjatjen e punimeve. Paguesa e kryer është në masën 96 %, e cila konsiston në vlerën e plotë të kontratës, ku është shkelur vetë kontrata e sipërmarrjes referuar kushteve të saj, rrjedhimisht komentet nuk kanë asnjë mbështetje ligjore, rrjedhimisht observacioni nuk mund të merret në konsideratë.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës", rezultoi se:

- Projekti parashikon ndërhyrje të integruar që përbën rehabilitimin e një hapsire publike në hyrjen e fshatit Rehovë dhe kthimin e fshatit në pikë reference për aktivitete sociale-kulturore. Projekti parashikon punime në pjesën e sheshit, me shtrim pllaka guri, punime gjelbërimi, ndricimi dhe punime për info point. Projekti është realizuar nga shoqëria "T." shpk, me administrator Engjiell Caka. Me vendimin nr. 1 datë 09.01.2023 të Bashkisë Kolonjë miratohet leja e Infrastrukturës për objektin Porta e Rehovës. Objekti i kontratës "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës", është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3650 prot., datë 27.07.2022, me Nr. REF-27924-05-09-2022, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Kolonjë, përfaqësuar nga E. I. dhe Operatorit Ekonomik "Z." shpk, përfaqësuar nga administratori A. Z.. Vlera e kontratës është 19,927,289 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 4 muaj duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës. Preventivi dhe lloji i kontratës bazuar në nenin 9 të KVK dhe dokumenteve të tenderi, është kontratë me çmim njësie. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 36111 prot., datë 22.07.2022, me Nr. REF-35236-07-04-2022 të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Kolonjë, përfaqësuar nga E. I. dhe Operatorit Ekonomik "L." shpk, përfaqësuar nga administratori A. K., me nr. License MK. Akti i Dorëzimit të sheshit të ndërtimit është dorëzuar më datë 27.07.2022. Njoftimi i fillimit të punimeve është realizuar nga kontraktori me anë të shkresës nr. 82/1 prot., datë 27.07.2022 dhe procesverbali i fillimit të punimeve të realizuar nga palët më datë 27.07.2022. Me procesverbalin datë 28.10.2022 miratohet

nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi (por jo nga titullari i AK) rakordimet e volumeve brenda preventivit duke realizuar korigjime në projektim, materiale dhe në sasi. Bashkëlidhur procesverbalit ndodhet edhe tabela e negocimit dhe cmimeve të reja për zërat e rinj të punimeve të pamiratuara nga AK. Kërkesat për përdorimin e fondit rezervë janë realizuar nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve me shkresat nr. 99 prot. Datë 03.11.2022 dhe nr. 254 prot. Datë 03.19.2022, të pa protokolluara në Bashki dhe nuk janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë, duke neglizhuar korrespondencat e palëve dhe miratimeve të ndryshimeve të projektit për përdorimin e fondeve kontraktuale. Preventivi i rishikuar tabela e lëvizjes së volumeve nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, duke mos miratuar edhe përdorimin e fondit rezervë apo zërave të rinj, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. **Ndërkohë** pagesat, miratimet për pagesë dhe likuidimet e kontraktorit, janë miratuar plotësisht me Urdhër Xhirimet përkatëse në financën e Bashkisë, duke miratuar të gjitha ndryshimet preventivit dhe të pagesave. Njoftimi i përfundimit të punimeve, janë realizuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi më datë 25.11.2022 të cilat nuk janë protokolluar në Bashkinë Kolonjë. Procesverbali i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi janë realizuar më datë 25.11.2022. Akti i kolaudimit është realizuar datë 22.12.2022, nga operatori ekomomik “D.” shpk, me përfaqësues V. T., me numër license MK..... Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim nuk disponon datë dhe nuk miratuar nga titullari i AK.

-Nga verifikimi i situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe verifikimeve në terren 19.03.2024 nga grupi i auditimit, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin. Në situacionin përfundimtar, zëri "Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m³, në kanale gjerësi >2m, tokë zak, kategoria III, me shk në tokë", në situacionin përfundimtar dhe preventivin e rishikuar pasqyrohet sasia prej 566 m³. Libreza e masave paraqet gjithashtu sasinë prej 566 m³. Nga auditimi i projektit të azhurnuar konstatohet se nuk pasqyrohen sipërfaqet e gërmimit në rrugën tip 1 prej 2.97 m² dhe në rrugën tip 2 prej 1.98 m², llogaritur në librezën e masave. Gjithashtu në librezat e masave nuk argumentohet sasia prej 457 m³ e zërit “Rrafshim skarpatesh, me krahë...” pasi nuk pasqyrohen sipërfaqet e sheshit.

- Referuar preventivit të ndryshuar, tabelës së lëvizjes së volumeve, konstatohet se është hequr zëri i ofertuar i shtresës me pllaka guri (10 x 10) cm, t=6 cm dhe është vendosur zëri i punimi “Shtresë pllakë guri (kalldrëm < 20 cm) element ndihmës”. Zëri i ri ka ndryshuar komplet projektin fillestar dhe nga verifikimi në objekt u konstatua se cilësia e punimeve të kalldrëmit ishte shumë e dobët, ku guri kalldrëm nuk është ishte i përpunuar por i vendosur në mënyrë të çrregullt dhe i pasistemuar konform KTZ. Punimet për kalldrëmin kanë qenë shumë neglizhente dhe nuk i është kushtuar rëndësia e duhur as nga mbikëqyrësi i punimeve dhe as Bashkia Kolonjë, duke likuiduar plotësisht zërin e punimit në vlerën 3,249,000 lekë pa TVSH. **1.** Në kapitullin e punimeve të shtresave për shttrim me pllaka tipi 1, të rrugës është shtuar zëri i punimeve sipas nr. Analizës 3.211 “Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri” në çmimin prej 878.38 lek/m², duke u zbritur në **2.83 %** të çmimit sipas VKM nr. 629 datë 15.07.2015, prej 903.59 lek / m². Referuar ofertës së operatorit ekonomik për zërin nr. 3.21 “Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri” çmimi i ofertuar është 550 lek/m², ku referuar manualit çmimi për cakëll t=15 cm është 823 lekë/m², pra me një zbritje nga manuali prej **33.1%**. Referuar ofertës ekonomike dhe propozimit të kontraktorit, gjatë zbatimit të kontratës konstatohet se operatori ka mundur të përfitojë zëri të ri punimi me çmim më të lartë se ai i dhënë në ofertë. Bazuar zbritjes së shtresës cakëllit t=15cm prej 33.1 % edhe zbritja e zërit të ri të cakëllit t=20 cm duhej të ishte në të njëjtin nivel dhe çmimi do të rezultonte 604.7 lek/m² (904 lekë x 33.1%). Rrjeshimisht sipërmarrësi ka përfitur çmim më të lartë prej 273.53 lekë (878.23 lekë – 604.7 lekë) më tepër dhe me sasinë prej 790 m², rezulton vlera prej 216,088 lekë. **2.** Në kapitullin e punimeve për breza

dhe bordura zëri i ri punme “*Bordurë guri (8 x 15) cm*”, konstatohet përfitim i padrejtë i operatorit ekonomik, duke krijuar zë të ri punimi dhe duke rritur cmimin nga oferta e tij e kontratës. Referua kontratës dhe ofertës së kontraktorit në zërin 18, nr. Anal. 5 “*Bordurë guri (6 x 25) cm*”, sipërmarrësi ka ofertuar me cmimin 2,100 lekë/ml. Ndërkohë, sipas preventivit të rishikuar dhe propozimit për cmime të reja janë propozuar dhe miratuar 2 zëra të rinj punimesh. Sa më sipër konstatohet ndryshim i drejtëpërdrejtë i ofertës ekonomike nga operatori ekonomik, duke tjetërsuar çmimin e ofertës dhe favorizuar drejtëpërdjetë operatorin ekonomik me cmim më të lartë në përfitim të padrejtë dhe në kundërshtim me kontratën nenin 7 “*Cmimi i kontratës*” dhe neni 9 “*Lloji i kontratës*” me cmim njësie, ku cmimet janë të padryshueshme dhe kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Pra, nga palët janë ndryshuar bordurat me përmasa më të vogla dhe është rritur cmimi në mënyrë të pajustificuar. Bordura guri (6 x 25) cm me çmim të ofertuar 2,100 lekë/ml ndryshohet me zë të ri, me përmasë më të vogël Bordurë (6 x 15) cm me po të njëjtin çmim 2,100 lekë/ml. Gjithashtu shtohet zë i ri pune, me bordurë më të vogël se ajo e ofertuar (8 x 15) cm me cmim më shumë se dyfishi i ofertës prej 4,500 lekë/ml. Pra është miratuar përfitim i padrejtë me çmim më të lartë prej 2,400 lekë/ml, në kundërshtim me kushtet e kontratës, LPP dhe legjislacionin e disiplinimit të punimeve. Duke shumëzuar me sasinë e bordurës (8 x 15) cm prej 271 ml, rezulton vlerë prej 650,400 lekë (2,400 lekë më tepër x 271 ml). **3.** Në kapitullin e punimeve për brezat dhe bordurat zëri nr. 23, nr. Anal. 2.261 “*Shtresë rëre mbi dhe nën tub*”, është zë i mbivendosur në zërin nr. 22. nr. Anal. 3.An/1t “*FV tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm*”, pasi shtresa e rërës është përfshirë në vendosjen e tubit sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”. Sa më sipër, zë zëri nr. 23, nr. Anal. 2.261 “*Shtresë rëre mbi dhe nën tub*” në vlerën 10,000 lekë pa TVSH është i mbivendosur në punimet e vendosjes së tubit të brinjëzuar. **4.** Në kapitullin e pajisjeve “*F shtyllë cilindrike me lartësi 5.5 m, D1 -79 mm + ndricues led 60 WAT duke përfshirë të gjithë aksesoret*” në sasinë 14 copë dhe në vlerën 1,092,000 lekë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se shtylla cilindrike nuk janë në lartësinë 5.5 m por në lartësinë 4 m. Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht duke vendosur shtyllë më ekonomike. Në interpolim të vlerës totale të ofruar për 5.5 m = 1,092,000 lekë për 4 m gjatësi shtyllë rezulton vlera 794,182 lekë. Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht vlerën prej 297,818 lekë (1,092,000 lekë - 794,182 lekë). **5.** Në kapitullin e punimeve të infopointit zëri nr. 10 “*FV vetratë d/alumini plastike dopio xham*” në sasinë 24.65 m² në cmim oferte prej 12,000 lekë dhe në vlerën 295,800 lekë. Nga verifikimi në objekt u konstatua se vetrata d/alumini plastike është tek xham, ku sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht në dëm të Buxhetit Shtetit. Gjithashtu edhe zëri nr. 9 “*Derë druri rreshqitëse*”, u konstatua se ishte derë e thjeshtë d/alumini me tek xham pa rrëshqitëse në vlerën 45,000 lekë. Në total vlera e përfituar padrejtësisht është 340,800 lekë (295,800 + 45,000). Për këtë investim rezultoi se janë paguar më tepër punime në vlerën prej 1,515,106 lekë pa TVSH (340,800 lekë + 297,818 lekë + 10,000 lekë + 650,400 lekë + 216,088 lekë) ose **1,818,127 lekë me TVSH**, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve për shkak të diferencave të punimeve, të çmimeve në dëm të Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Kolonjë.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 02, datë 05.04.2024, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Kolonjë).

Në lidhje me observacionet e dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. K. i OE "L." shpk, të protokolluara në KLSH me nr. 186/3 prot. Datë 19.04.2024, mbi pretendimet e Akt konstatimit nr. 03 datë 05.04.2024.

Pretendimi i subjektit:

- Mbikëqyrësi i punimeve, sqaron se:
- Në lidhje me uljen e cmimit në raport me Manualin theksohet se ulja e cmimeve është e pavarur.
- Në lidhje ndryshimin e diferencës së cmimit sqarohet se cmimi i ri justifikohet me specififikimet teknike të gurit.
- Në lidhje me shtyllat, sqarohet se ato janë modifikuar gjatë marrjes në dorëzim.
- Në lidhje me vetratat sqarohet se ato janë me 2 shtresa xhami 5mm, pra xham me cilësi të lartë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga mbikëqyrësi në observacion, vihet re se nuk ka asnjë dokumentacion shtesë provues mbi pretendimet e shprehura, ato nuk kanë mbështetje teknike dhe ligjore, rrjedhimisht observacioni nuk merret në konsideratë.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: **“Rikualifikim i rrugës “Pali Prifti” Qyteti Ersekë, Bashkia Kolonjë”**, rezultoi se:

- Objekti i kontratës është **“Rikualifikim i rrugës “Pali Prifti”** me nr. REF-89977-03-15-2021, kontrata me nr.15 me nr.3420 prot., datë 12.07.2021, lidhur midis AK Bashkia Kolonjë, përfaqësuar nga titullari z. E. I. dhe Kontraktorit BOE “Z.” Shpk & “K.” shpk, përfaqësuar nga z. A. Z.. Vlera e kontratës bazë është 41,794,654 lekë me Tvsh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar 6 (gjashtë) muaj. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata me nr. 14 dhe nr.2614 prot., datë 31.05.2021, midis AK Bashkia Kolonjë dhe Mbikëqyrësit BOE “L.” Shpk & “K.” Shpk përfaqësuar nga z. A. K., me licensë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se njoftimi i fillimit të punimeve ishte kryer më datë 16.07.2021, por në dosje nuk ndodhej si dokument gjithashtu dhe akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit si dhe proceverbali i fillimit të punimeve nuk ndodhej në dosje. Për këtë objekt ka ndodhur një shtesë kontrate me nr. 1640 prot., datë 07.04.2022 me afat 45 ditë kalendarike dhe vlerë 8,108,163 lekë me Tvsh. Në dosjen tekniko-ligjore nuk kishte asnjë realcion shpjegues për rishikimin e preventivit ku të arsyetohej kryerja e kësaj shtese kontrate në masën 20% të kontratës. Njoftimi i përfundimit të punimeve në dosjen tekniko-ligjore ishte kryer me shkresën përcjellëse të Kontraktorit dhe të Mbikëqyrësit më datë 07.04.2022.

- Nga verifikimi i situacionit përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, rezultuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:

1. Gjatë inspektimit të punimeve të bulevardit rezultoi se zëri i punës **“FV Shtrim me gur vendas, spesori minimal 6 cm”** në disa pjesë të bulevardit shtrimi ishte kryer me gur me spesor 3-4 cm pra më të vogël se 6 cm të përcaktuar në zërin e preventivit fitues duke patur efektin ekonomik 780,135 lekë. 2. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se zëri i punës **“FV Bordura betoni 20x35 cm”** ishte kryer me bordura me përmasa 15x25 cm. Kjo diferencë në vendosjen e bordurave me përmasa të tjera përbën shkelje, të cilat kanë efektin ekonomik 240,748 lekë. 3. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se zëri i punës **“Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm Bikomponente (paste)”** ishte kryer me vijëzim me 12 cm; duke patur efektin ekonomik 97,670 lekë. 4. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se zëri i punës **“Pusetë shiu 40x60, h=100cm me kapak gize”** u vu re se ky zë pune ishte kryer jo me kapak gize por me kapak kompozit të cilat kanë efektin ekonomik 399,648 lekë. 5. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se në një pjesë të rrugës kishte çedime në rrugë 15m². Kjo gjë tregon për mos respektim të kushteve teknike të zbatimit si dhe mos respektim të detajeve teknike të projekt zbatimit. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera totale prej 1,574,784 lekë pa Tvsh (780,135+240,748+97,670+399,648+56,583 lekë), **ose 1,898,740.8 lekë me Tvsh** e përfituar

më tepër padrejtësisht nga Kontraktori BOE “Z.” Shpk & “K.” shpk, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 04, datë 05.04.2024, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Kolonjë).

Në lidhje me observacionet e dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve z. A. K. i BOE “L.” Shpk & “K.” Shpk, të protokolluara në KLSH me nr. 186/4 prot. Datë 19.04.2024, mbi pretendimet e Akt konstatimit nr. 04 datë 05.04.2024.

Pretendimi i subjektit:

- Mbikëqyrësi i punimeve, sqaron se:

-Në lidhje me shtrimin e bulevardit me gur me spesor 3-4 cm pra më të vogël se 6 cm të përcaktuar në preventiv “...referuar spesorit të gurit për shtrimin e bulevardit ju sqarojme se konstatimi i mesiperm është bazuar në matje të cilat janë realizuar vetëm në disa pika fundore (jo në brendesi të bulevardit) dhe rrjedhimisht nuk mund të përfshijë të gjithë sipërfaqen totale prej 1040.18 m²..”.

-Në lidhje me bordurat e vendosura me përmasa të ndryshme nga projekt/preventivi “referuar përmasave të bordurave, theksojme se konstatimi është i drejtë dhe nga ana jone do të meren masa që në përfundim të garancise se difekteve do të rekomandohet klientit që shuma prej 240,748 leke të zbritet nga pagesa e kontraktorit” - Në lidhje me vijëzimin me shirta me gjerësi 12cm të ndryshme nga përcaktimet në projekt/preventiv “... objekti ndodhet ende në periudhën e garancise dhe funksion të riparimit të disa difekteve që janë shfaqur në objekt gjatë periudhës së garancise se difekteve kontraktori është udhëzuar të marrë masa për rifreskimin e sinjalistikës horizontale...”

- Në lidhje me vendosjen e kapakëve të pusëve me material kompozit jo gize sipas preventivit “...duke marrë parasysh që objekti ndodhet ende në periudhën e garancise, do të urdherohet kontraktori i punimeve që të behet zëvendësimi i kapakeve të përdorur ..me kapake gize..”-Në lidhje me çëdimet që kanë ndodhur në një pjesë të rrugës “.Objekti është në periudhë garancie difektesh, dhe kontraktori ka për detyrë të riparojë çdo difekt të shfaqur gjatë periudhës së garancise se difekteve...”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga mbikëqyrësi në observacion, vihet re se nuk ka asnjë dokumentacion shtesë provues mbi pretendimet e shprehura, ato nuk kanë mbështetje teknike dhe ligjore, rrjedhimisht observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: **“Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë”**, rezultoi se:

- Objekti i kontratës është **“Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht”** sipas kontratës për punë publike nr. 4427 prot., datë 15.09.2022, me nr. REF-36436-07-15-2022, lidhur midis AK Bashkia Kolonjë, përfaqësuar nga titullari z. E. I. dhe Kontraktorit OE “Z.” Shpk, përfaqësuar nga z. A. Z.. Vlera e kontratës është 24,537,099 lekë me Tvsh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar 4 (katër) muaj. Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 4120 prot., datë 30.08.2022, me nr. REF-39606-08-24-2022 të lidhur midis AK Bashkisë Kolonjë, përfaqësuar nga z. E. I. dhe OE “S.” shpk, përfaqësuar nga administratori z. E. L., me nr. License MK. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se njoftimi i fillimit të punimeve ishte realizuar nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori më datë 15.09.2022, dhe ishin të pa protokolluar në Bashkinë Kolonjë. Akt dorëzimi i sheshit dhe procesverbali i fillimit të punimeve ishin realizuar nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori më datë 15.09.2022, dhe ishin të pa nënshkruar nga kryetari i

Bashkisë. Me anë të një procesverballi më datë 24.03.2023, miratohen nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori (por jo nga titullari i AK) rakordimet e volumeve brenda preventivit duke realizuar korigjime në projektim, materiale dhe në sasi. Kërkesat për përdorimin e fondit rezervë janë realizuar nga Mbikëqyrësi dhe Kontraktori i punimeve dhe ishin pa data dhe të pa protokolluara në Bashki, duke neglizhuar korrespondencat midis palëve dhe miratimet e ndryshimeve të projektit për përdorimin e fondeve kontraktuale. Për këtë objekt ka ndodhur një amendim i kontratës nr. 6036 prot. datë 16.12.2022, ku palët miratojnë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 75 ditë kalendarike dhe data e përfundimit të punimeve përcaktohet data 29.03.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve, ishte realizuar nga Kontraktori dhe Mbikëqyrësi më datë 29.03.2023, ato nuk ishin protokolluar në Bashkinë Kolonjë. Në periudhën e auditimit nuk ishte likuiduar ende situacioni përfundimtar.

- Nga verifikimi i situacionit përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, rezultuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:

1. Gjatë kontrollit të dosjes tekniko-ligjore pjesa e preventivit të rishikuar u vu re se disa zëra punimesh kishin pësuar rritje në mënyrë të pa logjikshme; zëri *“Transport materialesh me kafshë deri 3.0 km”* nga 69 ton ishte rritur në 93 ton ndërkohë volumet e tjera kanë pësuar ulje; duke patur efektin ekonomik 146,400 lekë. 2. Gjatë kontrollit të dosjes tekniko-ligjore në preventivin e rishikuar u vu re futja e një zëri të ri *“Mbushje me zhavorr pas mureve (kanali i tubave të çelikut)”*. Përdorimi i këtij zëri nuk është i argumentuar teknikisht dhe është i panevojshëm për mbulimin e tubave të çelikut pasi ato llogariten që të durojnë presionet e lëvizjes së ujit; duke patur efektin ekonomik 184,600 lekë. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera totale prej 331,000 lekë pa Tvsh (146,400 lekë + 184,600 lekë), **ose 397,200 me Tvsh** e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori OE “Z.” shpk, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimi nr. 03, datë 05.04.2024, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Kolonjë).

Në lidhje me observacionet e dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve z.E. L. i OE " S." Shpk, të protokolluara në KLSH me nr. 186/5 prot. Datë 19.04.2024, mbi pretendimet e Akt konstatimit nr. 03 datë 05.04.2024.

Pretendimi i subjektit:

- Mbikëqyrësi i punimeve, sqaron se:

-Në lidhje me rritjen e volumit të zërit të punës "Transport materialesh me kafshe deri 3.0 km" "... theksojme se konstatimi është i drejte dhe nga ana e mbikqyresit do te merren masa qe ne perfundim te garancise se defekteve do ti rekomandohet klientit qe shuma prej 146,400 leke te zbritet nga pagesa e kontraktorit "

-Në lidhje futjen e nje zeri te "Mbushje me zhavorr pas mureve kanali i tubave te çelikut)" thuhet "...argumenti teknik per perdorimin e ketij zeri konsiston ne fomimin e nje drenazhi i cili nuk do te lejoje akumulimin e ujrave dhe materialeve te sjella nga rryma (llumrave) pergjate gjatesise se tubit ne raste rreshjesh, duke krijuar nje mbrojte nga ngarkesat e shtuara ne pjesen e jashtme te tubit"

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Referuar argumentimeve dhe komenteve të bëra nga mbikëqyrësi në observacion, vihet re se nuk ka asnjë dokumentacion shtesë provues mbi pretendimet e shprehura, ato nuk kanë mbështetje teknike dhe ligjore, rrjedhimisht observacioni nuk merret në konsideratë.

5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Lejet e ndërtimit, zhvillimit dhe përdorimit për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2023

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Kolonjë, rezulton se për afatin e auditimit **01.10.2021 deri në 31.12.2023**, ka pasur **66 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklaratat për kryerje punimesh, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht: 15 aplikime për leje zhvillimi, 4 shtesa në objekte ekzistuese, 4 për leje ndërtimi, 3 çertifikata përdorimi, 21 deklaratat paraprake për kryerje punimesh, 5 ndryshim projekti gjatë zbatimit, 2 rikonstruksione, 2 shtyrje afati leje ndërtimi, 2 leje infrastrukture dhe 8 njoftim për fillim punimesh, të evidentuara në tabelat përmbledhëse në **Aneksin 1 dhe 2**.

Aneksi 1: 01.10.2021 – 31.12.2022

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar	Në proces
Leje zhvillimi	5	3	2	0
Leje ndërtimi mbi 250 m ²	2	2	0	0
Leje ndërtimi deri 250 m ²	1	0	1	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	11	7	2	2
Rikonstruksion pa ndryshim funksioni	1	1	0	0
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	2	1	0	1
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	5	4	1	0
Njoftim fillim punimesh	5	5	0	0
Shtyrje afati leje ndërtimi	1	0	0	1
Leje infrastrukture	1	1	0	0

Burimi: DPKZHT, Bashkia Kolonjë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Aneksi 2 – Viti 2023

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar	Në proces
Leje zhvillimi	10	7	2	1
Çertifikatë përdorimi	3	3	0	0
Leje ndërtimi deri 250 m ²	1	0	0	1
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	10	6	4	0
Rikonstruksion pa ndryshim funksioni	1	1	0	0
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	2	2	0	0
Njoftim fillim punimesh	3	3	0	0
Shtyrje afati leje ndërtimi	1	0	0	1
Leje infrastrukture	1	1	0	0

Burimi: DPKZHT, Bashkia Kolonjë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKZHT e Bashkisë Kolonjë, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **2 leje**, është miratuar **3 çertifikat përdorimi**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m², çertifikata përdorimi dhe leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim vëllimi:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi për "Ndërtim objekte ne funksion të agroturizmit " në pasurin me nr.348/29 ZK 3510 e llojit truall me sipërfaqe prej 1157 m ² me adresë ne Ersekë, Bashkia Kolonjë	z. A. T.	13.04.2022	48,183,808.42 lekë
2	Leje ndërtimi për "Hotel 2 kate,bodrum e çati e shfrytëzuar" në pasurin me nr.395/7 ZK 1948; 395/9 ZK 1948; 395/10 ZK 1948, e llojit truall me sipërfaqe prej 4020 m ² me adresë fshati Helmës, Bashkia Kolonjë	z. P. B.	12.05.2022	19,722,520 lekë
3	Çertifikatë përdorimi "ndërtim objekte në funksion të agroturizmit" , në pasurinë me nr. 348/29, ZK 3510 me sipërfaqe trualli 1157 m ² dhe sipërfaqe objekti 861 m ² , me zhvillues A. T., Ersekë, Bashkia Kolonjë	z. A. T.	30.11.2023	-
4	Çertifikatë përdorimi "Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar ", në pasurinë me nr. 395/7, 395/9, 395/10 ZK 1948 me sipërfaqe trualli 4020 m ² dhe sipërfaqe objekti 146.7 m ² , me zhvillues P. B., fshati Helmës, Bashkia Kolonjë	z. P. B.	09.10.2023	-
5	Çertifikatë përdorimi "Hotel 3 kate + 1 nëntok në kompleks agriturizëm K. ", në pasurinë me nr. 87, 94 ZK 3826 me sipërfaqe trualli 22648 m ² dhe sipërfaqe objekti 353.8 m ² , me zhvillues K., në fshatin Vrëpçkë, Leskovik, Bashkia Kolonjë	"K."	27.10.2023	-

1. Miratim i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit me Vendim Nr. ... Prot; datë 13.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Ndertim objekte në funksion të agroturizmit ", me adresë në Ersekë, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z. A. T..

, Nga auditimi i procedurës së miratimit të "Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe me të madhe se 250 m²", me nr. AN....., për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. ... Prot; datë 13.04.2022**, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për objektin "**Ndërtim objekte në funksion të agroturizmit**", me adresë në Ersekë, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z. A. T., u konstatua si më poshtë:

Parcela e marrë në studim bën pjesë në njësinë strukturore **KNJ_B_B2_193/5**, për të cilën nuk është parashikuar hartimi **Plani i Detajuar Vendor**. Sipas pasaportës së njësisë strukturore, marrim informacionin se:

Kjo leje është miratuar në kundërshtim me **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 02, datë 17.05.20219, në kundërshtim me **Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.5.2015**, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, **Ligjit Nr.111/2018**, "Për kadastrën".

1. Bashkia Kolonjë dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) nuk kanë

	KNJ_B_B2_195/5
Sistemi	B_ Bujqësor
Kategori 1	B.Toke Bujqësore 100 %
Lartësia në kate	-
Lartësia në metra	-
PDV	JO
Intensiteti	-
KSHT	-
KSHR	-
KSHP	-
Kufizime ligjore	-
Përdorime të lejuara	Neni 71
Përdorime të ndaluara	Neni 71

kërkuar dhe/ose respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen paraprakisht në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, konstatohet se:

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

2. Projekti ndërtimor nuk është i plotësuar me të gjithë dokumentacion shoqërues të nevojshëm, siç është:

- Polica e sigurimit për subjektin A., ka skaduar një muaj përpara aplikimit për leje ndërtimi;
- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësive profesionale për hartuesit e projekteve konstruktive, elektrik, hidraulik, të instalimeve të ngrohje – ftohje, AEE, MNZ.

Sa më sipër janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 15, pika 1, nën-pika e), ë), g).

3. Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Referuar Ligjit Nr.111/2018 “Për kadastrën”, neni 17 “Certifikatat”, pika 4 dhe 6, Vendimit Nr. 457, datë 29.6.2022, neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara tre muajt e fundit. Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartelat janë rifreskuar në datën 18/05/2020, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 28.02.2022.

Për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim nr. ... prot; datë 13.04.2022, si dhe vlerësimit pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. M. T., në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

Z. E. C., në cilësinë e specialistit pranë IMT;

Znj. A. D., në cilësinë e specialistit pranë DPKZHT;

Gjithashtu, në zbatim të **Ligjit 107/2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Kolonjë, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. E. I., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

2. Miratim i lejes së ndërtimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit me Vendim Nr. Prot; datë 12.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar", me adresë fshatin Helmës, Bashkia Kolonjë, me subjekt zhvillues z. P. B..

Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250m²”, me nr. AN....., për të cilën është marrë vendimi për miratim **Nr. Prot; datë 12.05.2022**, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për objektin “Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar” me adresë fshati Helmës, Bashkia Kolonjë, me subjekt zhvillues z. P. B., u konstatua si më poshtë:

Parcela e marrë në studim bën pjesë në njësinë strukturore **KNJ_B_EBE_3/1**, për të cilën nuk është parashikuar hartimi **Plani i Detajuar Vendor**. Sipas pasaportës së njërive strukturore, marrim informacionin se:

Kjo leje është miratuar në kundërshtim me **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 02, datë 17.05.2019, në kundërshtim me **Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408**,

datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 550, datë 15.07.2020, “Aplikim për përdorim burimi uJOR”.

1. Bashkia Kolonjë dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të (DPKZHT) nuk kanë kërkuar dhe/ose respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen paraprakisht në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, konstatohet se:

- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK);

- Nuk është respektuar mendimi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila shprehet se nëse subjekti nuk ka kontratë për furnizimin me ujë të pijshëm apo shkarkimin e ujërave të ndotura me Ujësjellës-Kanalizime të zonës, ai duhet të aplikojë nëpërmjet portalit *e-Albania*, për “Aplikim për përdorim burimi uJOR”, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 550, datë 15.07.2020. Për miratimin e lejes së ndërtimit me Vendim nr. prot.; datë 12.05.2022, si dhe vlerësimin pozitiv të praktikës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. M. T., në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

Z. E. C., në cilësinë specialit në sektorin e IMT;

Znj. A. D., në cilësinë e specialist pranë DPKZHT;

Gjithashtu, në zbatim të **Ligjit 107/2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Kolonjë, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. E. I., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

3. Miratim i çertifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit me Vendim Nr.... Prot; datë 30.11.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin “Ndërtim objekte në funksion të agroturizmit”, me adresë në Ersekë, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z.A. T..

Nga auditimi i procedurës së miratimit të çertifikatës së përdorimit me nr. aplikimi AN....., për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. ... prot; datë 30.11.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin “**Ndërtim objekte në funksion të agroturizmit**”, me adresë në Ersekë, **Bashkia Kolonjë**, paraqitur nga zhvilluesi A. T., u konstatua se:

1. Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se mungojnë të gjitha aktet e kontrollit.

2. Mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

3. Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika g). Projekti as-built, duhet të ngarkohet në çdo rast kur objekti nuk ka respektuar projektin arkitektonik të miratuar.

4. Mungon dokumentacioni i plotë i ngarkuar në sistemin e-leje tek i cili nuk u gjetën fotografi në të gjitha anët e fasadave, kjo në kundërshtim me VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së

zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 27/2, në pikën 1, gërma j, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë fotografi të objektit në të gjitha orientimet.

5. Mungojnë licencat profesionale të shoqërisë ndërtuese, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika k).

6. Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika l).

7. Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

8. Mungon certifikata përfundimtare e auditimit të efencës energjitime, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.124/2015 “Për efencën e energjisë”, pika 5, nënpika b).

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim nr. ... prot; datë 30/11/2023 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi

Z. M. T., në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

Z. E. C., në cilësinë specialist pranë IMT;

Znj. A. D., në cilësinë e specialist pranë DPKZHT;

Gjithashtu, në zbatim të **Ligjit 107/2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Kolonjë, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. E. I., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

4. Miratim i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit me Vendim Nr..... Prot; datë 09.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar ", me adresë në fshatin Helmës, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z.P. B..

Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit me nr. aplikimi AN..., për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. prot; datë 09.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin “**Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar**”, me adresë në fshatin Helmës, **Bashkia Kolonjë**, paraqitur nga zhvilluesi P. B., u konstatua se:

1. Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se mungojnë aktet e kontrollit për “1. Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues” dhe “6. Përfundimi i sistemit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese”

2. Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika g). Projekti as-built, duhet të ngarkohet në çdo rast kur objekti nuk ka respektuar projektin arkitektonik të miratuar.

3. Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

4. Mungon akti përkatës nga ujësjellës-kanalizime, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim nr. prot; datë 09/10/2023 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi

Z. M. T., në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

Z. G. E., në cilësinë përgjegjës i sektorit të bujqësis;

Znj. A. D., në cilësinë e specialist pranë DPKZHT;

Gjithashtu, në zbatim të **Ligjit 107/2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Kolonjë, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. E. I., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

5. Miratim i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për lejen e ndërtimit me Vendim Nr..... Prot; datë 27.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Hotel 3kt + 1kt nëntokë në kompleks agroturizmi K.", me adresë në fshatin Vrëpckë, Leskovik, Bashkia Kolonjë, me zhvillues K..

Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit me nr. aplikimi AN....., për të cilën është marrë vendimi për miratim me nr. prot; datë 27.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin “**Hotel 3kt + 1kt nëntokë në kompleks agroturizmi K.**”, me adresë në fshatin Vrëpckë, Leskovik Bashkia Kolonjë, paraqitur nga zhvilluesi K., u konstatua se:

1. Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1. Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar elektronikisht në sistemin *e-lejet* konstatohet se mungon një nga aktet e kontrollit më konkretisht “6. Përfundimi i sistemit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese”.

2. Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

3. Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika g). Projekti as-built, duhet të ngarkohet në çdo rast kur objekti nuk ka respektuar projektin arkitektonik të miratuar.

4. Mungon dokumentacioni i plotë i ngarkuar në sistemin e-leje tek i cili nuk u gjetën fotografi në të gjitha anët e fasadave, kjo në kundërshtim me VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 27/2, në pikën 1, gërma j, përcaktohet që në dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për pajisjen me certifikatë janë fotografi të objektit në të gjitha orientimet.

5. Mungon kontrata midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika l).

6. Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve, kjo në kundërshtim me **VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015**, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika gj).

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Vendim nr. prot; datë 27/10/2023 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi

Z. M. T., në cilësinë e drejtorit të DPKZHT;

Z. G. E., në cilësinë përgjegjës i sektorit të bujqësis;

Znj. A. D., në cilësinë e specialist pranë DPKZHT;

Gjithashtu, në zbatim të **Ligjit 107/2014**, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 29, pika a), për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Kolonjë, ngarkohet me përgjegjësi:

Z. E. I., në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Kolonjë.

6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore.

“Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV). Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV. Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kolonjë.

Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Kolonjë është i organizuar në nivel qendër dhe njësie administrative sipas tabelës së mëposhtëme;

Tabela nr.1

NR	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Emërimi	Larguar	Pezullim
1	P. C.	Specialist IMTV	Inxhinier Pyjesh	16.04.2020	05.03.2024	
2	P. L.	Specialist IMTV	Inxhinier Pyjesh	04.05.2022 (Kontratë) 06.07.2022 (Kontratë) 30.09.2022 (Akt- Emërimi)	15.09.2022	
3	E. C.	Specialist IMT	Inxhinieri Agromjedisi	12.11.2018		18.05.2022

Sa më sipër konstatohet se:

Arsimimi i kryeinspektorit të IMTV Bashkia Kolonjë, aktualisht është në përputhje me ligjin 9780. Ndërsa arsimi i inspektorit **P. L.** nuk është konform kërkesës së Nenit 11 të ligjit 9780 i- ndryshuar, ku përcaktohet se : Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

6.1. Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

Nga të dhënat e IMTV, vënë në dispozicion grupit të auditimit është konstatuar se: Për periudhën nën auditim 2022-2023, në total shuma e gjobave rezulton në vlerën 0 lekë.

Lidhur me praktikat ligjore të mbajtura nga IMTV, paraqiten rastet specifike të praktikave të (Proces –verbal konstatimi), Vendim i dënimit me gjobë -vendim i prishjes së objektit) dhe arsyet e mospërputhjes, dhe konkretisht:

Në bazë të process-verbaleve të kundravajtjes, vendimeve të gjobave, vendimeve të prishjeve të objekteve të kundraligjshëm, të vëna në dispozicion nga IMTV bashkia Kolonjë janë ilustruar në aneksin nr 6.1 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

Në PVK (process verbal I konstatimit të kundravajtjes) nr.3 datë 15.05.2022, nr.4 datë 23.05.2022, nr.8 datë 23.05.2022, nr.9 datë 25.05.2022, nr.10 datë 27.05.2022, nr.13 datë.09.08.2022 janë të firmosura vetëm nga një inspektor, përkatësisht **insp/P. L.**, veprime në kundërshtim me pikën c), të VKM 894 datë 04.11.2015, ku është përcaktuar se: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të

njësisë vendore realizon kontrole nëpërmjet: i) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë; e për pasojë ka lëshuar akte te pavlefshme të cilat nuk kanë forcë ligjore për sa kohë nuk janë në përputhje me kërkesat ve ligjit. Poashtu **Insp/P. C.** ne tre raste ka refuzuar firmosjen e aktit të konstatimit të kondravajtjes pa dokumentuar arsyet mbi këtë veprim.

6.2. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV. Vlerat e arkëtuara dhe ato të pa likuajuara, për të cilat janë bërë kërkesa në Gjykatën Administrative për lëshimin e titullit ekzekutiv me qëllim vjeljen e gjobave.

Është mbajtur proves-verbal konstatimi por për shkeljet e konstatuara nuk janë marra masa administrative (gjobë) për rastet e konstatuara në mospërputhje me ligjin 107/2014 për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit, Neni 52 Kundërvajtjet administrative gërma e) ku është e përcaktuar se: *kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;*

ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes:

i) *pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300 000 lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni;*

ii) *me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera pa leje.*

6.3 Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me DPKZHT (Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë).

Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve në territor nga ky inspektoriat dhe nuk ka evidence shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve.

7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1025/9, datë 22.05.2023 i ka dërguar Bashkinë Kolonjë, “**Raportin përfundimtar**”, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar zbatimin e masave të mëposhtme:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 29 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 8,211,344 lekë, deri me datë 05.04.2023, nuk është marrë asnjë masë si dhe nuk është arkëtuar asnjë 0 lekë.

b.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 1 masë në vlerën 1,239,977 lekë si dhe të arkëtohet vlera 78,212,989 lekë e pranuar dhe e pa zbatuar

e.Masa disiplinore KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 8 punonjës, masë e cila rezultoi e pa zbatuar.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezultoi se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kolonjë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 1025/9, datë 22.05.2023, ndërsa nga Bashkia Kolonjë për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje KLSH **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. E. I..

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezultoi se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kolonjë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. **1025/9, datë 22.05.2023**, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 21.11.2023.

Nga ana e Bashkisë Kolonjë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se*: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. E. I..

Pa zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Kolonjë nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1025/9, datë 22.05.2023 **dhe nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan

veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. E. I.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kolonjë nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1025/9, datë 22.05.2023 si dhe nuk ka ndërmar asnjë procedur për zbatimin e rekomandimeve me karakter organizativ, të ardhura të munguara, shpërblim dëmi dhe disiplinore, si vijon

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në Bashkinë Kolonjë nuk është hartuar “Harta e proçeseve të punës”.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Në Bashkinë Kolonjë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtorja e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 9-11, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të vlerësojë mundësinë e planifikimit dhe investimit për blerjen e programit kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

1.3.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për:

- Kryejën e ndryshimeve të nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune, si dhe hartimin e dokumentit “Harta e proçeseve të punës”.
- Hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proçeseve të punës në Bashkinë Kolonjë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kolonjë përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

Numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njëzia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë 2 punonjës të punësuar.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm (AB), nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Për periudhën 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

-Për vitin 2021 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 6 auditime dhe janë kryer 5 gjithësej.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Plotësimin e strukturës së NJAB Kolonjë;

-Ngritjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2023

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Përgjatë vitit 2023 dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Kolonjë për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 20,423,001 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën: -19,457,332 lekë detyrime të subjekteve për marrjen me qira të sipërfaqeve në fond pyjor/kullosor. -965,669 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes. Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” dhe pika 10 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes,

paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 9,33,364 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 ekskavator, 1 fadromë, 1 rul, 2 rimorkiator dhe 1 makineri, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.215 nuk është bërë shtesë vlere prej 425,000 lekë, për riparimin e makinës teknologjike modeli “Renault”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 214 dhe Shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 183,672,132 lekë, vlere e aksioneve në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë Sh.A” me NIPT K27517009O, si dhe vlere e aksioneve në shoqërinë “K” Sh.A me NIPT K84227001O. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 1,625,303 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse⁴. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për

⁴ Llogaria 466 për garancitë që i ka kaluar afati, pasqyrohet në Kapitullin “Aneksë” – “Aneksi nr.4” të raportit përfundimtar të auditimit.

disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, e cila përfaqëson shpenzime për investime në proces, u konstatua se kjo llogari, është mbivlerësuar për vlerën 70,993,843 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit të gabuar të:

-10,266,313 lekë (investime në ndërtesa), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.212 dhe 19,950,000 lekë (investime në ujësjellës), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.213, vlerë e cila përfaqëson shpenzime për investime të përfunduara, për të cilat është bërë kolaudimi/marrja në dorëzim (pra janë të shfrytëzueshme dhe në përdorim) por të pakapitalizuara në llogaritë e klasës 2 AAGJ.

-40,777,530 lekë (garanci punimesh), vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë nr.520, pasi janë disponibilitete në thesar. Gjithashtu konstatohet se llogaria nr.231 është nënvlerësuar për shumën 252,499,750 lekë, vlera e mbetur e investimit për ndërtimin e ujësjellësit të qytetit të Ersekës dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit. Në fund të vitit 2021, subjekti që ka kryer punimet e ndërtimit ka situacionuar të gjithë vlerën e punimeve, pra duke përfunduar punimet në terren, ndërkohë që nga vlera e plotë e investimit, deri në 31.12.2021, është likuiduar vlera prej 244,599,988 lekë. Pra në kushtet e mësipërme, vlera e mbetur debitohet në llogarinë nr.231, duke kredituar llogarinë nr.404 dhe debituar llogarinë nr.4342, pasi këto fonde priten të alokohen nga buxheti i shtetit dhe jo i Bashkisë Kolonjë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun 2, klasa 2 në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitetit afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete e vepra ujore”, u konstatua se janë kontabilizuar si AQT, objektet “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” për vlerën 99,965,404 lekë dhe “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave nga burimet e Kozelit”, për vlerën 94,619,989 lekë, të cilat në datë 31.12.2021 janë në statusin “investime në proces”, pasi akoma nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Kolonjë. Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.213, nuk është kapitalizuar edhe vlera e mbetur e investimit me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit”, për shumën 19,950,000 lekë, e cila qëndron e kontabilizuar në llogarinë nr.231, si investim në proces, ndërkohë që ky objekt është marrë në dorëzim për vlerën e plotë të tij më datë 13.10.2021, si dhe nuk është bërë shtesë vlera prej 925,000 lekë, investim për riparimin e sifonit në kanalin ujitës të fshatit Borovë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e

bëra në shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata”⁵ (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr.231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, u konstatua se nuk është bërë shtesë vlere prej 660,000 lekë, investim për riparimin e taracave në shkollat 9-vjeçare Barmash dhe Qinam. Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr.212, nuk është kapitalizuar edhe vlere e mbetur e investimit me objekt “Rikonstruksion banese sociale në Leskovik”, për shumën 7,827,049 lekë, e cila qëndron e kontabilizuar në llogarinë nr.231, si investim në proces, ndërkohë që ky objekt është marrë në dorëzim për vlerën e plotë të tij më datë 14.04.2021, si dhe vlere prej 2,439,264 lekë, për blerjen e materialeve të ndërtimit për rikonstruksionin e qendrës multifunkionale të qytetit Ersekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata”⁶ (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.212, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr.231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit, kontabilizimit dhe regjistrimit në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Kolonjë, të tokave, trojeve, terreneve, pyjeve, kullotave, ndërtesave dhe konstruksioneve, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se nuk është kryer inventarizimi i tyre; Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël; Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj; Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe ato të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Kolonjë, nëpërmjet akteve ligjore/nënligjore, si dhe për më tepër ato troje të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pronësie; Nga 3527 pasuri në pronësi të Bashkisë Kolonjë, rreth 28 prona ose 1% prej tyre janë regjistruar në kadastër dhe janë pajisur me certifikatë pronësie.

-Veç sa më sipër konstatohet se Bashkia Kolonjë nuk ka një punonjës/strukturë të posaçme për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në

⁵ Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivitet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

⁶ Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivitet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Nenin 62 në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 44-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar.

Në ndryshimet për buxhetin e vitit 2023

10.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të nxjerrë urdhër të brendshëm, për përcaktimin e afatit konkret si dhe ngritjen e një strukture të posaçme, me objekt vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

10.3.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.
- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 3 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj). Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Në procedurat e prokurimit për vitin 2023 dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, u konstatua se në 1 rast, OE është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, u konstatua se në:

- Në 14 raste nuk dokumentohet mënyra e përzgjedhur për përllogaritjen e fondit limit;
- Në 14 raste urdhri i prokurimit nuk ka nr., protokollin, si dhe në 11 raste nuk pasqyrohet sasia dhe njësia e mallrave që do të prokurohen;
- Në 14 raste ftesa për ofertë nuk ka nr., protokollin dhe datë;
- Në 14 raste rezulton se OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 14 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 12 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përllogaritur fondin limit;
- Në 7 raste afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla nuk është përllogaritur penalitet;
- Në 1 rast nuk dokumentohet procesverbali për tërheqjen e OE shpallur fitues dhe për kalimin tek OE i radhës;
- Në 1 rast nuk administrohet procesverbali i marrjes në dorëzim të projekt zbatimit për hartimin e planit të mbarë-shtrimit të fondit pyjor kullësor për vitin 2021. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “dh”, “e” dhe “ë” të pikës 2 në nenin 26, pikën 1 të nenit 27, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74, nenin 76, nenin 77 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar; Pikën 7, 8 dhe 17 në udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Pika 5 dhe pika 6 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Në vijimësi

13.2. Rekomandimi: Gjithashtu për 7 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përllogaritet penaliteti përkatës dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.07.2021-31.12.2021, u konstatua se:

-Në Bashkinë Kolonjë funksioni i kontrollit të territorit, kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Pra nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i bashkisë (pra Kryetari të Bashkisë Kolonjë);

-Numri i punonjësve në zyrën e kontrollit, nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit rregullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kjo strukturë, në fakt janë vetëm 2 punonjës, si dhe nga niveli drejtues i Bashkisë Kolonjë, nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës;

-Në strukturën e zyrës së kontrollit nuk ka punonjës me formimin profesional të fushës, si inxhinKolonjë ndërtimi, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë dhe hidrogeologjisë;

- Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve (Ngritja e kantKolonjëit të punimeve, përfshirë murin rrethues deri në përfundimin e sistemimit të jashtëm);

-Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – muhor për IKMT për masat e marra, gjatë ushtrimit të detyrave;

-Programi vjetor i punës për zyrën e kontrollit nuk është miratuar nga organi ekzekutiv i bashkisë (Kryetari i Bashkisë);

-Nuk dokumentohet kryerja e inspektimeve pranë subjekteve të cilët përgjatë vitit 2021 kanë kryer punime ndërtimi, me qëllim verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga zotëruesit e mbetjeve inerte, gjatë prodhimit, përpunimit dhe dorëzimit të tyre pranë subjekteve të cilat janë të pajisura me leje mjedisore;

-Ndërmjet zyrës së kontrollit dhe drejtorisë së urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit;

-Për 2 raste, bazuar në ankesat e administruara pranë Bashkisë Kolonjë, për ndërtime të paligjshme, nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e situatës sipas ankesës së dorëzuar pranë Bashkisë Kolonjë;

-Në 4 raste, në kryerjen e veprimeve inspektuese, për verifikimin e ankesave të administruara pranë Bashkisë Kolonjë, nuk janë përdorur formatet standarde të inspektimit, si procesverbal konstatimi, pezullimi, prishje ndërtimi, por veprimet inspektuese janë pasqyruar në letër formati A4 dhe me shkrim dore;

-Në 3 raste, konstatohet se nuk dokumentohet procedura e prishjes së punimeve pa leje, si dhe 1 prej këtyre rasteve, nga zyra e kontrollit nuk janë përllogaritur shpenzimet e prishjes së punimeve dhe rikthimin e territorit në gjëndjen e mëparshme, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me punime në hapësirë publike, ndërtimi i murit i cili ka prekur trupin e rrugës;

-Në 4 raste, edhe pse është lënë detyrë për prishjen e punimeve pa leje dhe/ose të dorëzimit të dokumentacionit, konstatohet se nuk administrohet dokumentacioni i dorëzuar nga palët, të cilat janë ngarkuar me detyrimin për të dorëzuar dokumentacionin përkatës, për efekt justifikimi ligjor të punimeve të ndërtimit, si dhe nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e plotësimin të detyrave të lëna, pra të prishjes së punimeve të ndërtimeve pa leje. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve

të ndërtimit”, i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat “a” dhe “c” në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 11 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën “b”, pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 98-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për:

-Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati dhe jo si zyrë kontrolli, për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

-Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023

14.2.Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, të marrë masat për kryerjen e inspektimit, për verifikimin e situatës së krijuar, bazuar në 2 ankesat e administruara në Bashkinë Kolonjë, konkretisht nga shtetasi V. K. me shkresën nr.4700 prot., datë 28.09.2021 dhe shtetase V. A. me shkresën nr.3639 prot., datë 27.07.2021, si dhe të denoncimeve të përcjella nëpërmjet shkresave nr.5179 prot., datë 28.10.2021 dhe nr.4871 prot., datë 07.10.2021 të administruar nga IKMT Drejtoria Rajonale Korçë.

Menjëherë

14.3.Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, për praktikat e inspektimeve të kryera bazuar në ankesat e administruara nga shtetasit M. I., A. M., S. V., K. P., A. J., të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimit pranë subjekteve përkatëse, me qëllim verifikimin e respektimit të detyrimit të lënë për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, si dhe dokumentimin e plotë të procedurës së ndjekur, deri në kthim-përgjigjen ndaj palëve të interesuara. Gjithashtu për rastin ku janë kryer punime ndërtimi të paligjshme në hapësirë publike, zyra e kontrollit të bëjë përlllogaritjen e shpenzimeve të rikthimit të territorit në gjëndjen e mëparshme, duke njoftuar subjektin për likuidimin e dëmit, në natyrë/vlerë monetare.

Menjëherë

14.4.Rekomandimi: Zyra e kontrollit Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, për kryerjen e inspektimeve duke përdorur dokumentet standard të procedurës së inspektimit. Gjithashtu të hartojë dhe përcjellë për miratim pranë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, planin vjetor të aktivitetit.

Në vijimësi

14.5.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Zyra e Kontrollit Bashkia Kolonjë të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe Zyra e Kontrollit, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Kolonjë.

Për lejet e miratuara përgjatë vitit 2022 dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023, u konstatua se:

- Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kolonjë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2021-2023, janë miratuar jashtë afateve;
- Në buxhetin vjetor të vitit 2021 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtorja e Financës, gjatë hartimit dhe miratimit të PBA-së, të marrin masat për:

- Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;
- Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;
- Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;
- Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kolonjë.

Në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2021 paraqitet masën 93%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kolonjë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1.Rekomandimi: Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 7 fatura për vlerën totale 5,281 mijë lekë, nga të cilat 5 fatura të palikujduara janë krijuar në vitin 2021 në vlerën totale 2,448 mijë lekë. Në fund të vitit 2021 të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 janë në vlerën 23,331 mijë lekë, ose detyrimet e prapambetura zënë 10% të tyre, ç’ka do të thotë se Bashkia Kolonjë mund të likujdojë detyrimet e prapambetura.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky kriter ligjor në 3 raste. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “gj” në nenin 12 të Ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pikat 8, 106 dhe 107 të

udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe likuidimin e tyre gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve në dispozicion.

Përgjatë vitit buxhetor 2023

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekuara nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kolonjë, për miratimin e lejeve të ndërtimit/deklarata paraprake për kryerjen e punimeve, u konstatua se në:

-3 raste subjektet janë pajisur me deklaratë paraprake për kryerje punimesh, ndërkohë që kanë qenë në kushtet e kryerjes së punimeve që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe jo deklaratë paraprake për kryerje punimesh.

-1 rast është miratuar leja e ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit të plotë në formë dhe përmbajtje, si dhe në kundërshtim me tipologjinë e ndërtimit që lejohet në njësinë strukturore përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 93-98, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejen e ndërtimit të miratuar përgjatë vitit 2021, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratave për punë publike, respektivisht:

-“Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”,
- “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë”, rezultoi se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, nuk është miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore, për projektin e zbatimit, veprim ky në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa që të pajisin me leje ndërtimi infrastrukturore për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Kolonjë në vlerën **8,211,344 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut”, me vlerë 274,456,182.47 lekë me TVSH, fituar nga BOE “A. “& “A.”

Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi të pakryera, në vlerën **5,333,249 lekë pa TVSH, përkatësisht:**

- Vlera **942,303 lekë**, përfaqëson dëm ekonomik për punime ndërtimi të pakryera në vepër, për zërat “(2.373) Vetrato xhami i temperuar brenda godinës” dhe “(3.An/56) F. Montim shtyllë konike 9 ml, LED me dy krahë çdo 30 ml përfshirë të gjithë aksesorët e nevojshëm”.

- Vlera **4,390,946 lekë**, përfaqëson dëm ekonomik për diferenca në volume punime ndërtimi, për pajisje hidraulike dhe mosfunksionim të Scadës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe BOE “A. “& “A.” Sh.P.K. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **942,303 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “A. “& “A.” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolauditimit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

-Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e pajisjeve dhe funksionimin e scadës, në të kundërt arkëtimin e vlerës **4,390,946 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, Bashkia Kolonjë”, me vlerë 75,131,311 lekë me TVSH, fituar nga BOE “K.“ & “A.” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi, në vlerën **1,264,272 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7207/13 prot., datë 13.09.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe BOE “K. “& “A.” Sh.P.K. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera, me qëllim arkëtimin e vlerës **1,264,272 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës”, me vlerë 391,298,650 lekë me TVSH, fituar nga OE “A.” SHPK, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi të pakryera, në vlerën **1,323,023 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 1022 Prot., datë 25.02.202, lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor (Bashkisë Kolonjë) dhe sipërmarrësit të punimeve, shoqërisë “A.” Sh.P.K. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **1,323,023 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022 Prot., datë 25.02.2021 me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës” Bashkia Kolonjë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim i ujësjetllësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e

Kozelit” Bashkia Kolonjë, me vlerë 497,280,095 lekë me TVSH, fituar nga OE “A.” Sh.P.K, rezultuan diferenca në volume dhe punime ndërtimi, në vlerën **290,800 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5151 prot., datë 29.10.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe OE “A.” Sh.P.K. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 54-93, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **290,800 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151 Prot., datë 29.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë.

Menjëherë

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Kolonjë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 1,239,977 lekë, për 4 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për praktika likuidimi të vendimeve gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se janë kryer likuidime pjesore, megjithëse Bashkia Kolonjë ka pasur disponibilitete në thesar. Gjithashtu në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Kolonjë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2023 dhe në vijimësi

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Brenda vitit 2023

C.1 MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore

për vitin 2021, u konstatua se në fillim të vitit 2021 kanë qenë debitor 28 subjekte të biznesit të madh në vlerën 4,622,879 lekë, 67 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 3,436,058 lekë dhe 1 institucion në vlerën 661,339 lekë. Në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive rezultojnë debitor, 31 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,935,411 lekë, 85 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 4,369,959 lekë, 1 institucion në vlerën 754,139 lekë dhe 1 subjekt (NIPT sekondar) për tarifave vendore sipas kohëzgjatjes së kantKolonjëit në vlerën 130,794 lekë, pra gjithësej **11,190,303 lekë** për **118** subjekte, pra **gjatë vitit 2021 janë krijuar 38 subjekte debitorë** për vlerën **2,246,433 lekë**, nga të cilët **21 subjekte** rezultojnë debitor për herë të parë, ndërkohë që **17 subjekte** të tjerë janë debitor edhe në vitet e mëparshme, veç debisë së krijuar në vitin 2021. Për debitorët të krijuar brenda vitit 2021 nuk është përlllogaritur rast pas rasti kamatvonesë për subjektet debitore. Gjithashtu për subjektet nuk janë marrë masa shtrënguese, bllokim të llogarisë bankare, kufizim të pasurisë së paluajtshme, aktivitetit etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, nenin 114 dhe nenin 117 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, neni 26, neni 34 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Nenin 64 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Paketën fiskale të vitit 2020 të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **11,190,303 lekë** për **118** subjekte (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DATT Bashkia Kolonjë, regjistrin të taksave dhe tarifave vendore për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2021 në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, si dhe kryqëzimi i informacionit me databasën e DRT Korçë për subjektet me statusin “aktiv” për vitin 2021, u konstatuan mangësi në informacionin e administruar nga DATT Bashkia Kolonjë. Konkretisht mangësitë u konstatuan mosadministrimin e informacionit për **11** subjekte që kanë ushtruar aktivitet në Bashkinë Kolonjë, si dhe për disa subjekte të cilat janë biznes i madh, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore administrohen si biznes i vogël⁷.

-Sa më sipër konstatohet se për vitin 2021, në 11 raste subjekte të kategorisë “biznes i madh” dhe “biznes i vogël” në Bashkinë Kolonjë dhe NJA, nuk janë taksuar saktë/aspak, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 329,666 lekë.

-Veç sa më sipër regjistri i taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “biznes” sa i përket taksës së ndërtesës, duke patur në konsideratë përcaktimet e bëra në VKM nr. 132, datë 7.3.2018⁸, e ndryshuar, ka mangësi në gjeneralitetet si, sipërfaqen dhe katet e objektit, nëse ka raste ku objekti është mbi një kat dhe njëri prej kateve shfrytëzohet për banim ndërkohë kati tjetër për veprimtari ekonomike etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20-25 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe Kreun II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të marrë masat e nevojshme, për saktësimin e informacionit për subjektet e mësipërme, në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore,

⁷ Pasqyruar lista e subjekteve në Kapitullin “Anekse” – “Aneksi nr.3” të raportit përfundimtar të auditimit.

⁸ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

me qëllim taksimin e drejtë dhe të plotë të tyre, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 329,666 lekë ndaj 11 subjekteve.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2021, u konstatua se në fund të vitit 2020 në mënyrë progresive janë 4396 familje debitorë për vlerën 26,424,512 lekë dhe në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive janë **3653** familje debitorë për vlerën **33,065,205 lekë**, nga të cilat, në vitin 2021 është krijuar **6,640,693 lekë debi**. Pra në krahasim me vitin 2020, në fund të vitit 2021 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifave për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Kolonjë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme. Sa i përket familjeve debitorë, rezulton se nuk janë marrë masa (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 3, pikat 1 dhe 2 në nenin 4, nenet 20-24 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 në nenin 6, nenin 76, pikën 2 në nenin 89, neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 33,065,205 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Kolonjë dhe NJA për vitin 2021 janë taksuar 5922 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2021 janë taksuar 585 familje më pak.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Kolonjë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, ndriçimit, dhe turizmit (duke aplikuar tarifave më të ulëta në vlerë dhe mesatarizuar tarifën), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 900 lekë * 585 familje mesatarisht taksuar më pak = 526,500 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DATT Bashkia Kolonjë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM nr. 132, datë 7.3.2018⁹, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve Bashkia Kolonjë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A Ersekë, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Kolonjë. Grupi i auditimit bëri kërkesë për numrin e familjeve, të cilat janë të pajisura me matës (pra kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë) ku rezultoi se 1861 familje nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë, ç’ka do të thotë se taksat dhe tarifave vendore për këtë numër

⁹ Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

familjesh arkëtohen vetëm kur familjet marrin shërbime të ndryshme, si vërtetime etj, të paguajnë taksat dhe tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kreun II.1 dhe II.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë dhe nenin 62 dhe 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkisë Kolonjë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të marrë masat e nevojshme, për arkëtimin e taksave për 1861 familje, të cilat nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë dhe për rrjedhojë nga agjenti tatimor Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A Ersekë, nuk mundësohet arkëtimi i tyre.

4.2.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Administratorët e Njësisë Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të patakshara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 526,500 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave për planifikimin e taksës për tokën bujqësore, rezultoi se taksa e tokës bujqësore është planifikuar 4,659,000 lekë për vitin 2021. Nga përlllogaritjet e kryera, bazuar në kategorinë e bonitetit, sipërfaqen e tokës bujqësore, u konstatua se planifikimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2021 është bërë për 466,794 lekë më pak. Pra për 7215 Ha tokë bujqësore e ndarë me AMTP, planifikimi i taksës së tokës bujqësore duhet të ishte 5,050,500 lekë.

-Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrotjes së Konsumatorit, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 466,794 lekë.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Kolonjë (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Kolonjë) u konstatua se nga DATT, Bashkia Kolonjë, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se për vitin 2021 në 6 raste, subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe turizmit në vlerën 265,527 lekë gjithësej, si dhe 130,794 lekë 1 subjekt që nuk ka kryer likuidimin e tarifës së kantKolonjëit, gjithësej 396,321 lekë vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Kolonjë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun II.1 dhe II.2

në Paketën Fiskale të Bashkisë Kolonjë të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 15-42, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 396,321 lekë, ndaj 6 subjekteve.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Kolonjë me palët e treta, konkretisht të respektimit të detyrimit kontraktor për pagesën e qirasë (për vitin 2021), përlllogaritjen e kamat-vonesave, si dhe marrjen e masave për arkëtimin e këtyre detyrimeve, u konstatua se në vitin 2021, janë krijuar 14 subjekte debitorë për vlerën 3,297,780 lekë, si dhe progresivisht në fund të vitit 2021 janë 23 subjekte për vlerën 32,522,494 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e këtyre subjekteve, konstatohet se nuk janë njoftuar subjektet për zgjidhje të njëanshme të kontratës së qirasë, si dhe nuk është hapur proces gjyqësor, me qëllim mbledhjen e detyrimeve me forcë nëpërmjet shërbimit të përmbarrimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 296 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 13 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Nenin 63 në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Kolonjë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave Bashkia Kolonjë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore 32,522,494 lekë (principal dhe kamatë vonesë).

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kolonjë në vlerën 182,500 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë 24 gjoba në vlerën 126,500 lekë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse¹⁰. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me sektorin e policisë bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 182,500 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Brenda 6-mujorit të dytë të vitit 2023

¹⁰ Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuajor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Kolonjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për:

z. S. L., Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave nga Tatim-Taksat, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (20-43) të Raportit të Auditimit)*

z. M. T., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (93-98) të Raportit të Auditimit)*

z. A. J., Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, për mangësitë e konstatuara në arkëtimin e të ardhurave nga qiratë e tokave pyjore dhe bujqësore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (20-43) të Raportit të Auditimit)*

zj. G. D., Drejtor i Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (44-54) të Raportit të Auditimit)*

z. E. Z., Drejtor i Shërbimeve Publike, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit të Auditimit)*

z. P. C., Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (98-105) të Raportit të Auditimit)*

z.A. T., Specialist pranë Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit në 3 procedura prokurimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit të Auditimit)*

z. E. C., Specialist për mjedisin në zyrën e kontrollit, në rolin e kontrolluesit në sistemin e-lejet, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (93-98) të Raportit të Auditimit)*

E.NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Kolonjë, Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

F. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

F.1.MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se janë lënë 25 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 3 janë zbatuar, 4 zbatuar pjesërisht, 6 janë në proces zbatimi dhe 12 nuk janë zbatuar. Pra janë zbatuar 12% e masave organizative dhe 48% nuk janë zbatuar.

-Për shpërblimin e dëmit janë lënë 9 rekomandime për 23 subjekte në vlerën 23,275,791 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat nuk janë zbatuar 5 rekomandime për 8 subjekte në vlerën 21,360,219 lekë, ose 91%, si dhe 4 rekomandime janë në proces zbatimi për 10 subjekte në vlerën 1,915,572 lekë, ose 8%. Për eliminimin e efekteve negative financiare janë lënë 3 rekomandime në vlerën 716,692,744 lekë dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat 2 nuk janë zbatuar për vlerën 714,692,744 lekë, ose 99% dhe 1 masë është zbatuar për vlerën 2,000,000 lekë. Për eliminimin e borxhit tatimor është lënë 1 rekomandim në vlerën 49,966,840 lekë, i cili është pranuar dhe nuk është zbatuar. Konkretisht rekomandimet e pazbatuara dhe zbatuar pjesërisht, **për të cilat rikërkohet zbatimi i tyre**, janë si më poshtë vijon: (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 105-112, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

-Në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë Kolonjë të krijojë si strukturë me vetë Inspektorati Vendorë i Mbrojtjes së Territorit e pavarur nga Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, strukturë e cila të miratohet dhe në Këshillin Bashkiak.

-Të plotësohet struktura e Auditit të Brendshëm me 3 punonjës, sipas strukturës së miratuar të Bashkisë Kolonjë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1 Rekomandimi: Sektori i Njësisë së Auditit të Brendshëm (NJAB), të marrë masa që:

- Të kryhet monitorimi i zbatimit rekomandimeve i cili kërkon që në zbatim rekomandimeve, drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB.

- Të marrë masa për plotësimin e dosjeve sipas Manualit të AB, duke plotësuar dokumentet si “planifikim angazhimi për auditim”, “takimi i hapur prezantues”, “letrat e punës” si dhe “vlerësimin e brendshëm të cilësisë”.

- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë të Bashkisë Kolonjë.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB në përputhje me organikën e miratuar, e cila ndikon në rritjen e kapaciteteve audituese.

Në vijimësi

7.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që deklarojnë mbyllje aktivitet nëse deklarimi është i saktë si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të peregjistruar në QKB. Bashkia Kolonjë duhet të marrë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar numrin e subjekteve fizik/juridik si dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara të bëhet aplikimi i taksave dhe tarifave vendore.

Menjëherë dhe vijimësi

8.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa që në të ardhmen të kryejë një proces planifikimi sa më real si dhe më kryesorja të ketë rritje të nivelit të të ardhurave dhe arkëtimit të tyre duke kryer periodikisht analiza për ecurinë duke nxjerrë objektivat përkatëse, në mënyrë të tillë që në fund të periudhave ushtrimore të ulet gjendja e faturave të palikuiduara dhe borxhi.

Menjëherë dhe vijimësi

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kolonjë të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agjentët tatimorë, sipas llojit të taksës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë si dhe të fillojë procedurat për penalizimin e agjentëve tatimorë. Të krijohet baza e të dhënave për subjektet, tarifatat dhe taksat të cilat mbledhen nga agjentët tatimorë, të kryqëzohet informacionet me institucionet e tjera dhe rakordimet të bëhen çdo fund muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe vijimësi

10.1 Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie

Menjëherë dhe vijimësi

12.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivitet afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të sistemohet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën 17,822,316 lekë.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

13.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të SHA Ujësjellës Kanalizime me vlerë kontabël 183,473,532 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm

14.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Kolonjë, të analizojë situatën e të nxjerrë përgjegjësitë për përcaktimet e gabuara të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe të marrë masa që përcaktimi e kriterëve për kualifikim të jetë në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.

Në vijimësi

16.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1337/44 prot., datë 01.07.2019, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për **rizbatimin** e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për **6** masa organizative në proces zbatimi dhe nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës **1,583,700 lekë**, konkretisht për pikën **3.7.1**;

b-Për **7 persona** masa administrative për arkëtimin e vlerës **290,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur dokumentacioni të jetë qartazi i plotë dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e agroturizmit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.1 Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendore të shqyrtojë mangësitë në dosjet e lejeve të ndërtimit duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe të marrë masa për krijimin e dosjeve për secilin subjekt ndërtues të pajisur me leje ndërtimi për periudhën 2018-2021 dhe për periudhën në vazhdim, në zbatim të kërkesave të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Të programohen planet e punës javore, mujore dhe vjetore dhe të miratohen nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë. Për ndërtimet e kundërligjshme me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor në proces verbalet e konstatimit të vendoset edhe sipërfaqja në (m²) dhe vlerën e preventivit të punimeve, duke e shumëzuar me koston e Entit Kombëtar të Banesave për qytetin e Ersekës, siç përcaktohet në ligjin nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017 neni 52 “Kundërvajtjet administrative”, pika 2.

Menjëherë

19.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, Njësia e Prokurimit në lidhje me vendosjen e kritereve për kategoritë e nevojshme të punimeve për zbatimin e kontratës në DST, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Në vijimësi

21.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, të marrin masat e duhura që:

- Për prokurimet publike llogaritja e fondit limit dhe nevojave të bëhet bazuar në të dhëna të dokumentuara dhe analiza, me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve publike.
- Në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.
- Në ngritjen e komisioneve për kryerjen e procedurave të prokurimit, të ketë persona me njohuri në fushën e objektit të prokurimit, me qëllim vendimmarrje, menaxhim dhe vlerësim objektiv të procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

22.1 Rekomandimi: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë procedurës së vlerësimit duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme, duke shpallur fituese ofertën me çmimin më të ulët, kur ky i fundit është kriteri përcaktues.

Menjëherë

23.1 Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë të merren masa të menjëhershme për të mos dhënë autorizime për kryerje punimesh në objekte të cilat nuk kanë leje ndërtimi dhe nuk kanë certifikatë pronësie. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Bashkisë të komunikohet menjëherë me Inspektoratin Kombëtar Mbrojtjes së Territorit Dega Korçë si dhe të vihet për dijeni Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për asistencë dhe marrje masash në lidhje me 3 objektet e sipërcituara.

Menjëherë

F.2. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit të vlerës së qirave të përdorimit të fondit pyjor dhe kullësor prej **19,457,332** lekë, për Hec-et që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Kolonjë, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti “C.” shpk, për vlerën prej 10,096,720 lekë.
- Subjekti HEC “Q. & K.” shpk, për vlerën prej 936,780 lekë.
- Subjekti “B.” shpk, për vlerën prej 132,000 lekë.
- Subjekti “E.” shpk, për vlerën prej 8,291,832 lekë.

Menjëherë

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **732,989** lekë pa tvsh nga BOE “A.” Shpk & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2626 Prot, datë 07.08.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,243** lekë pa tvsh nga BOE “Z.” Shpk & “K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5318 Prot, datë 05.11.2020, me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Ersekë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4.1 Rekomandimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kolonjë të marren masa të menjëhershme për vendosjen e masës së gjobës si dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total **523,391** lekësh.

Menjëherë

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit që ka lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **428,264** lekësh ndaj subjektit me NIPT K...K “A.”.

Menjëherë

F.3. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

(1-10) Rekomandimi:

- Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve Standarde të Tenderit, me pasojë përdorimin pa efektivitet dhe eficientë të fondeve publike për vlerën **713,328,744** lekë pa TVSh.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë procedurës së vlerësimit duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme, duke shpallur fituese ofertën me çmimin më të ulët, kur ky i fundit është kriteri përcaktues.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

F.4. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE ME EFEKTE NË TË ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË KOLONJË.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej **1,364,000 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

Menjëherë

F.5. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kolonjë të marrë masat për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 130 subjekte për vlerën **9,229,703 lekë** dhe abonentë familjarë për vlerën gjithsej **40,737,137 lekë**, bazuar në neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor” ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare;
- T'i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

V- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1025/9, datë 22.05.2023 në bashkinë Kolonjë, konstatohet se nga kryetari i bashkisë nuk është ndërmar asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve si vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 29 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar. Nga 29 masa organizative të cilësuar si të pa zbatuara 29 prej tyre nuk rikërkohen pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet:

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 8,211,344 lekë, deri me datë 05.04.2023, nuk është marrë asnjë mas si dhe nuk është arkëtuar asnjë 0 lekë

b.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 2 masë në vlerën 1,239,977 lekë si dhe të arkëtohet vlera 78,212,989 lekë e pranuar dhe e pa zbatuar. Nga 9 masa organizative për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 78,212,989 lekë të cilësuar të pa zbatuara 9 prej tyre nuk rikërkohen pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet:

e.Masa disiplinore KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 8 punonjës, masë e cila rezultoi e pa zbatuar.

Në menyrë të detajuar masat që rikërkohen paraqiten si vijon:

Për 5 masë shpërblim dëmi në vlerën 8,211,344 lekë si vijon:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **942,303 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “A. “& “A.” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolaudimit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime Sh.A Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

-Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e pajisjeve dhe funksionimin e scadës, në të kundërt arkëtimin e vlerës **4,390,946 lekë**.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera, me qëllim arkëtimin e vlerës **1,264,272 lekë**.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **1,323,023 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022 Prot., datë 25.02.2021 me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës” Bashkia Kolonjë.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **290,800 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.” Sh.P.K, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151 Prot., datë 29.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë.

Menjëherë

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 2 masë në vlerën 1,239,977 lekë si vijon:

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Menjëherë

Për masat disiplinore KLSH i rikërkon Kryetarit të Bashkisë Kolonjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 8 punonjës si vijon:

1. z. S. L., Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave nga Tatim-Taksat, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (20-43) të Raportit të Auditimit)*

2. z. M. T., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (93-98) të Raportit të Auditimit)*
3. z. A. J., Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, për mangësitë e konstatuara në arkëtimin e të ardhurave nga qiratë e tokave pyjore dhe bujqësore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (20-43) të Raportit të Auditimit)*
4. zj. G. D., Drejtor i Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (44-54) të Raportit të Auditimit)*
5. z. E. Z., Drejtor i Shërbimeve Publike, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit të Auditimit)*
6. z. P. C., Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (98-105) të Raportit të Auditimit)*
7. z.A. T., Specialist pranë Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit në 3 procedura prokurimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit të Auditimit)*
8. z. E. C., Specialist për mjedisin në zyrën e kontrollit, në rolin e kontrolluesit në sistemin e-lejet, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (93-98) të Raportit të Auditimit)*

F. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

Për 5 masë shpërblim dëmi në vlerën 21,360,346 lekë si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit të vlerës së qirave të përdorimit të fondit pyjor dhe kullor prej **19,457,332** lekë, për Hec-et që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Kolonjë, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti “C.” shpk, për vlerën prej 10,096,720 lekë.
- Subjekti HEC “Q. & K.” shpk, për vlerën prej 936,780 lekë.
- Subjekti “B.” shpk, për vlerën prej 132,000 lekë.
- Subjekti “E.” shpk, për vlerën prej 8,291,832 lekë.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **732,989** lekë pa tvsh nga BOE “A.” Shpk & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2626 Prot, datë 07.08.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,243** lekë pa tvsh nga BOE “Z.” Shpk & “K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5318 Prot, datë 05.11.2020, me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Ersekë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4.1 Rekomandimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kolonjë të marren masa të menjëhershme për vendosjen e masës së gjobës si dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total **523,391** lekësh.

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit që ka lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **428,264** lekësh ndaj subjektit me NIPT K....K “A.”.

Menjëherë

Sa më sipër referuar Bashkia Kolonjë nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1025/9, datë 22.05.2023, nuk ka ndërmar asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve në kundërshtim me nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2 të nenit 30 nenin të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. E. I..

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A- MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Në Bashkinë Kolonjë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Në Bashkinë Kolonjë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën .1, faqe 13-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrin të Riskut (iii) si dhe të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën organizative, duke paraqitur në mënyrë të plotë e të saktë detyrat specifike të punonjësve, duke bërë edhe përditësimet të vijueshme në rastet e ndryshimit të strukturës

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kolonjë përgjatë vitit 2022-2023, u konstatua se:

Numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës,

ndërkohë kanë qenë 2 punonjës të punësuar si dhe nuk është hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

-Për periudhën 2022-2023, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kolonjë, të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektori Juridik dhe Prokurimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

-Për vitin 2023 nuk është realizuar numri i auditimeve të planifikuara, konkretisht janë planifikuar për tu kryer 4 auditime dhe janë kryer 2 gjithsej.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën .1, faqe 13-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë, sipas strukturës së miratuar me 3 punonjës.

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj., në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i treguesve të buxhetit për vitet 2022 – 2023, rezulton se: Për vitin 2022, planifikimi i buxhetit fillestar dhe të rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken është realizuar në masën 95%, ku nga vlera e parashikuar prej 930,124 mijë lekë është realizuar vlera 853,195 mijë lekë. Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit fillestar dhe të rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken është realizuar në masën 96%, ku nga vlera e parashikuar prej 716,023 mijë lekë është realizuar vlera 643,952 mijë lekë. Për të dy vitet objekt auditimi, asnjë nga zërat e shpenzimeve nuk është me realizim, ku për vitin 2022, Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 506,085 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 464,535 mijë lekë ose në masën 92 %. Ndërsa për vitin 2023, Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 250,962 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 217,753 mijë lekë ose në masën 87 %.

Mos realizimi i këtyre treguesve, vjen pasi nga bashkia nuk është mundësuar realizimi i të ardhurave të parashikuara mbi bazën e së cilës janë planifikuar këto shpenzime në vite.

Përgjatë viteve 2022-2023 Bashkia Kolonjë nuk ka bërë rishikimin e zbatimit të buxhetit në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet: “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe.22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Bashkisë Kolonjë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Tatim Taksave në Bashkinë Kolonjë, rezulton se nuk është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”. Sipas gjendjes civile në Bashkinë Kolonjë dhe NJA janë 6,507 familje, ndërkohë për dy vitet së bashku, 2022-2023 janë taksuar gjithsej 8,206 familje. Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojë Bashkia Kolonjë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, ndriçimit, dhe turizmit (duke aplikuar tarifën më të ulët në vlerë dhe mesatarizuar tarifën), për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim **900 lekë * 4,808 familje mesatarisht taksuar më pak = 4,327,200 lekë** planifikuar dhe më pak. Gjithashtu situata e mësipërme tregon se DATT Bashkia Kolonjë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 7.3.2018ⁱⁱ, e ndryshuar, detyrim për t'u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

- Administrimi i taksave/tarifave nga familjarët, realizohej në bashkëpunim me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A Ersekë, sipas vkb nr. 13 datë 31.03.2008 dhe akt-marrëveshjes së lidhur me datë 02.06.2008, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Kolonjë. Sipas të dhënave 1861 familje nuk kanë kontratë për shërbimin e furnizimit me ujë, ç'ka do të thotë se taksat dhe tarifave vendore për këtë numër familjesh arkëtohen vetëm kur familjet marrin shërbime të ndryshme, pasi janë jashtë skemës së taksimit, duke mos **marrë masat e duhura për** të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimi”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe.22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Bashkia Kolonjë, Drejtoria të Ardhurave dhe Tatim Taksave, të marrë masa për hartimin e një regjistri të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë të dhënat zyrtare edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin). Gjithashtu të përdorë çdo rrugë zyrtare për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimi”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimet e krijuara dhe ato korente.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vitin 2023 rezulton në vlerën 12,863,221 lekë e analizuar në raportin përfundimtar të auditimit. Vlëra e raportuar në MFE në lidhje me detyrimet e prapambetura është në shumën 303,130 lekë dhe përbëhet nga 3 fatura. Nga krahasimi i vlerës së raportuar në MFE dhe faturave të cilave ju ka kaluar afati 60 ditore rezultojnë me diferencë në vlerën 12,560,091 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61 dhe neni 54, “Kryerja e pagesave”, dhe nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pikën 164, Udhëzimin Nr.37 datë 06.10.2020. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe.22-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Bashkia Kolonjë të marrë masa për hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve duke hartuar grafikun për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” kjo llogari është rregjistruar në datë 31.12.2022 për vlerën 2,783,085,420 lekë. Referuar udhëzimit nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, llogaria 101 fondi bazë funksion duke u kredituar nga shuma e aktiveve të blera ose të krijuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2023 shtesat e AAM janë në vlerën 190,009,843 lekë, ndryshimi i gjendjes së inventarëve sipas pasqyrës së pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën 2,712,442 lekë. Llogaria 101 fondi bazë debitohet për nxjerrjet jashtë përdorimit të AAM për vitin 2023 rezultojnë në shumën 4,500 lekë dhe amortizim i vitit 2023 për AAM ku sipas pasqyrës së gjendjes dhe ndryshimeve të AAM është rregjistruar në vlerën 87,807,843 lekë. Nga analizimi i të dhënave për vitin 2023 për llogarinë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” rezulton se vlera e raportuar në bilanc është mbivlerësuar në vlerën 29,357,127 lekë, si rezultat i moszbatimit udhëzimit nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

7.Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” përbëhet nga gjendja e llogarisë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 36,069,298 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 69,921,682 lekë. Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në bilanc e regjistruar në shumën 103,278,538 lekë dhe nuk kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje". Referuar aktrakordimit me thesarin për fondet e papërdorura gjatë vitit 2023 rezultojnë fonde të papërdorura në shumën 33,356,856 lekë. Sipas pasqyrës së performancës financiare llogaria 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” është rregjistruar në vlerën 36,069,298 lekë, kjo llogari është mbivlerësuar për vlerën 2,712,442 lekë. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. I ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

8.Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 32 “Inventar i imët” nuk është e kuadruar me gjendjen e inventarëve sipas ditarit të magazinës e cila në fund të vitit paraqitet në vlerën 50,791,866 lekë. Sipas pasqyrave financiare kjo llogari është paraqitur në klasën 3 të aktivitetit për vlerën 52,334,720 lekë me diferencë në vlerën 1,542,854 lekë. Diferenca midis vlerës së raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe vlera e verifikuar nga komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit është diferencë e trashëguar gjatë tre periudhave të fundit të raportuara, për të cilën komisioni i

inventarizimit nuk ka evidentuar përgjegjësitë. Veprimet dhe mësipërmet janë në kundërshtim me udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, dhe udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të analizojë diferencat e krijuara, të ngarkoj me përgjegjësi personat përgjegjës sipas secilit rast si dhe kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 32 “Inventar i imët”.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

9.Gjetje nga auditimi: Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është regjistruar në kundërshtim me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (detyrime) paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Në rubrikën 2.3 “Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik, paragrafi 21, shtohet pika c me përmbajtjes: c)Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t’u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16, administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njërive si më poshtë:

-Për konstatimin paraprak të të drejtave për t’u arkëtuar debitorët llogaritet përkatëse të klasës 4 (411/468) “Debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje të ardhura për tu marrë”. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” për të dhënë informacion kontabël të saktë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

10.Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” sipas regjistrimit analitik është në vlerën 17,848,750 lekë e cila nuk kuadron me vlerën e regjistruar në bilanc 17,964,613 lekë si dhe nuk është e analizuar sipas projekteve specifike për të cilat është kryer investimi nga Bashkia Kolonjë. Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” nuk është mbajtur në mënyrë analitike për çdo projekt sipas vitit të hyrjes, vlerës së blerjes por projektet e çdo viti janë bashkuar në një zë. Regjistri i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” nuk është mbajtur në mënyrë analitike për çdo projekt sipas vitit të hyrjes, vlerës së blerjes por projektet e çdo viti janë bashkuar në 1 zë e cila është në kundërshtim me Udhëzimin Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata jo materiale sipas udhëzimeve përkatëse dhe të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” për të dhënë informacion kontabël të saktë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezulton se:

- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” është paraqitur në bilanc në vlerën 3,330,850 lekë në fund të vitit 2022.Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2023 dhe është regjistruar në bilanc në

vlerën 3,330,850 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar analitikisht por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite.

- Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është paraqitur në bilanc në vlerën 25,909,872 lekë në fund të vitit 2022. Kjo llogari nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2023 dhe është regjistruar në bilanc në vlerën 25,909,872 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik. Vlera e paraqitur në bilanc nuk është e analizuar analitikisht por mbartet vetëm si vlerë e trashëguar ndër vite.

- Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” sipas regjistrimit analitik është në vlerën 549,456,627 lekë e cila nuk kuadron me vlerën e regjistruar në bilanc 558,009,429 lekë. Kjo llogari është mbivlerësuar për vlerën 8,552,802 lekë. Gjithashtu në këtë llogari janë kontabilizuar 4 procedura mbikëqyrje punimesh me vlerë 1,452,419 lekë të cilat janë regjistruar në llogari analitike të ndara dhe jo duke ju bashkuar objektit të investimit. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me SKK 5 (i përditësuar), Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale, SKK 1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa si vijon:

- Të hartojë regjistrin e aktiveve afatgjata materiale sipas udhëzimeve përkatëse dhe të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” dhe të llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” për të dhënë informacion kontabël të saktë.

- Të kryhet kontabilizimi i plotë dhe i saktë i llog. 212 “Ndërtesa e Konstruksione

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se sipas të dhënave të QKB Bashkia Kolonjë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 7% të aksioneve të “KRËM” SH.A me NUIS“K84227001O” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Mbledhja, transporti, administrimi, depozitimi i mbetjeve bashkiake dhe komunale.”. Numri i aksioneve është 226 me vlerë nominale 16,550 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,740,300 lekë. Nga këto Bashkisë Kolonjë i përkasin 15.82 aksione me kapital në vlerë monetare 261,821 lekë

Bashkia Kolonjë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 3.64% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë” sha me NUIS“M24431001N” e cila është shoqëri aksionare me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(ve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 3,638 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 363,800 lekë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne pjesëmarrje me vlerë kontabël 625,621 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Kolonjë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiar viti 2023, rezulton se llog. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” me datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 61,111,260 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 69,921,682 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Në lidhje me shtesat apo pakësimin për këtë llogari, Drejtoria e Financës nuk disponon informacion.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, bashkia disponon të dhënave vetëm për ngurtësimet e garancive, ndërsa për ç’ngurtësimet dhe për vlerën reale të kësaj llogarie nuk ka informacion. Gjithashtu nuk ka informacion për garanci përpara vitit 2020 të cilat ju ka kaluar afati dhe mund të jene akoma të ngurtësuar.

Nga Drejtoria e Çështjeve Juridike Prokurimeve dhe Aseteve dhe Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e garancive të bllokuara. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit (Sektori i Menaxhimit të Kontratave), Bashkia Kolonjë, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2022 e më parë, për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Kolonjë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës rezulton se Bashkia Kolonjë ka miratuar listën përfundimtare me vendim Nr.366, datë 13.05.2011, me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe përfundon me numrin rendor 497 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë). -Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Qendër Ersekë e miratuar me listë përfundimtare me vendim Nr.247, datë 27.03.2013. Lista e inventarit me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 496 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë), përmban 380 prona. -Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Leskovik/Qendër Leskovik, të transferuara me VKM nr. 379, datë 08.04.20009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim. Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë përfundon me numrin rendor 420 (katërqind e njëzet), e cila përmban 420 prona. -Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Novoselë/Barmash e miratuar me listë me vendim Nr.482, datë 16.04.2008, Nr.368, datë 01.04.2009, përmban 912 prona. -Lista e pronave të paluajtshme të NJ/A Mollas/ Çlirim e miratuar me listë me vendim Nr.1087, datë 23.07.2008, me vendim Nr.253 përmban 1157 prona. -Lista e pyjeve dhe kullotave është transferuara me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” ku numri i pronave pyje dhe kullota që ka Bashkia Kolonjë është 1739, me sipërfaqe totale **46,942.97 ha**. Bashkia Kolonjë gjatë viteve 2022-2023 nuk ka ngritur grupe pune për të bashkëpunuar me DVASHK Korçë, në lidhje me regjistrimin e pronave sipas listës së asetëve të miratuara me VKM, për Bashkinë dhe Nj/Administrative si dhe nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuar dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin

e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020 nenin 37, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.10296 datë 07.08.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3, faqe 41-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të marrë të gjitha masat e menjëhershme për të kryer procesin e plotë të inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon:

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për emërimin e një personi ekspert të fushës, që të merret me Menaxhimin e Aseteve, verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM, duke përcaktuar dhe detyrat konkrete në rregulloren e brendshme të Bashkisë Kolonjë, për të bërë të mundur miradministrimin e pronave.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga informacioni i marrë nga Drejtoria Pyjeve dhe Kullotave janë miratuar 37 kontrata sezonale për vitin 2022 dhe 47 për vitin 2023, me afat 6 mujor, me objekt “Kullota” dhe “Kositje bari”, duke gjeneruar të ardhura në vlerën 3,325,180 lekë. Nga auditimi i këtyre kontratave rezultoi se nuk është zbatuar procedura e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit Nr.4, datë 10.04.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, pasi të gjitha dosjet e subjekteve qiramarrës të kullotave nuk janë plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar sipas Udhëzimit të sipërpërmendur, ku mungon procesverbali i dorëzimit të parcelave të marra me qira. Nga të dhënat e mara nga DBZHR rezultoi se të ardhurat nga kullotat për vitin 2022 janë realizuar në masën 40.45%, nga 3,700,000 lekë të planifikuara janë realizuar 1,496,970 lekë, të ardhurat nga kullotat për vitin 2023 janë realizuar në masën 49.4%, nga 3,700,000 lekë të planifikuara janë realizuar 1,828,210 lekë. Mosarritja e objektivave vjen si rezultat i disa problematikave që DPK ka, që janë: -Mungesa e manaxhimit të zonave kadastrale; -Vështirësi në përcaktimin e kufijve. Referuar të dhënave që administron Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (DBZHR), Bashkia Kolonjë ka gjithsej 11,210 ha tokë bujqësore, nga të cilat 7,220 ha është marrë nga banorët me AMTP dhe 3,990 ha është tokë e pa ndarë në pronësi të bashkisë. Gjithashtu rezultoi se DBZHR gjatë vitit 2022-2023 ka lidhur vetëm 1 kontratë me afat 99 vjeçar për dhënie me qira të tokës bujqësore. Kjo tokë do të përdoret nga qiramarrësi për mbjellje kulturore arvore. Referuar sipërfaqes totale të pandarë në tabelën e mësipërme rezultoi se; nuk është bërë menaxhimi me efikasitet, ekonomikitet dhe efektivitet i kësaj sipërfaqe, duke sjellë mungesë të ardhurash për bashkinë Kolonjë. Veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 36, pika a). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4, faqe 45-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, si dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të marrë masa:

- për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë.
- për një administrim më efektiv të tokave bujqësore të lira duke bërë njoftime periodike për dhënien e tyre me qira.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat konstatohet se për periudhën objekt auditimi (01.01.2022 – 31.12.2023), janë realizuar gjithsej **29** procedura me vlerë të lartë me fond limit 279,487 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur pa TVSh 228,094 mijë lekë, me një diferencë prej 51,392 mijë lekë ose 18%.

Nga grupi mbi bazën e materialitetit janë vlerësuar për auditim **7** procedura nga 26 të realizuara me vlerë të fondit limit 144,256 mijë lekë ose 52 % e fondit të prokuruar.

Nga auditimi i 7 procedurave janë konstatuar në shkelje të dispozitave të LPP, 7 procedura me fond limit prej 144,256 mijë lekë, konkretisht parregullsi në hartimin e kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- “Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022”,
- “Blerje materiale për ndriçimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022”
- “Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”
- “Rivitalizimin e Qendrës Multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë”.
- “Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qendër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë
- “ Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023”
- “Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas, viti 2023,FAZA I”.
- Në 6 procedura nga 7 të audituara, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kolonjë, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT, si vijon:
 - “Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022”,
 - “Blerje materiale për ndriçimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022”
 - “Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”
 - “Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qendër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë”
 - “Rikonstruksion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023”
 - “Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas, viti 2023,FAZA I”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; neni 2, neni 3, pika 2, neni 35, neni 39, pika 2, neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 2, pika 2, shkronja “c”, neni 15, pika 3, shkronja “b”, neni 39, pika 4, neni 40, pika 1, neni 43, pika 2, shkronja ”c”, neni 44, pika 1, neni 55, pika 4, neni 78, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 59-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve të përfshirë në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim argumentimin e kriterëve të vendosura për çdo procedurë të jetë në përputhje me tipologjinë e procedurës dhe që gjatë vlerësimit të ofertave të mbajnë në konsideratë garantimin e Autoritetit kontraktor në realizimin në afat dhe me cilësi të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Në 4 (katër) raste, nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatuan se dosjet e zbatimit të kontratave janë të pa inventarizuar dhe të pa arkivuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë, konkretisht për investimet:

(Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë”, "Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës" “Rikualifikim i rrugës “Pali Prifti” Qyteti Ersekë, Bashkia Kolonjë”, "Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë”), veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4. faqe 133-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me zyrën e protokollit dhe të arkivës, të marrë masa që të plotësoj me dokumentacion të plotë tekniko-ligjor për investimin e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Kolonjë, për të inventarizuar dhe arkivuar dosjet e zbatimit të kontratave, në zbatim të kuadrit ligjor “Për Arkivat”.

Menjëherë

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit u konstatua se në **2 (dy) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë ose i saktë, sipas përcaktimeve në ligj dhe rregullore, nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), mungon polica sigurimit të përgjegjesisë profesionale për hartuesit e projekteve konstruktiv, elektrik, hidraulik, të instalimeve të ngrohje – ftohje, AEE, MNZ, kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

- leja e ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 154 Prot; datë 13.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Ndërtim objekte në funksion të argotizmit ", me adresë në Ersekë, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z. A. T..

- leja e ndërtimit miratuar me Vendim Nr. Prot; datë 12.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar", me adresë fshatin Helmës, Bashkia Kolonjë, me subjekt zhvillues z. P. B.. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 02, datë 17.05.2019, Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 550, datë 15.07.2020, "Aplikim për përdorim burimi ujor". (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 143-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi ose përdorimi me mangësi të tilla. Në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi, DPKZHT duhet të kërkojë nga aplikanti dokumentat e pronësisë së rifuaskuara, jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatës së përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, është miratuar jo në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi konkretisht:

- Miratim i certifikatës së përdorimit për lejen e ndërtimit me Vendim Nr..... Prot; datë 09.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Hotel 2 kate, bodrum e çati e shfrytëzuar ", me adresë në fshatin Helmës, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z.P. B..

- Miratim i certifikatës së përdorimit për lejen e ndërtimit me Vendim Nr.... Prot; datë 30.11.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Ndërtim objekte në funksion të argotizmit ", me adresë në Ersekë, Bashkia Kolonjë, me zhvillues z.A. T..

- Miratim i certifikatës së përdorimit për lejen e ndërtimit me Vendim Nr..... Prot; datë 27.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë për objektin "Hotel 3kt + 1kt nëntokë në kompleks agroturizmi K.", me adresë në fshatin Vrëpckë, Leskovik, Bashkia Kolonjë, me zhvillues K., me problematika si më poshtë vijon:

-Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 27/1, pika 1.

-Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika (ë).

- Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika g). Projekti as-built, duhet të ngarkohet në çdo rast kur objekti nuk ka respektuar projektin arkitektonik të miratuar.

- Mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

- Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë). *Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 143-150 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të territorit të merren të gjitha masat për të rritur dhe përmirësuar bashkëpunimin ndër-strukturor, me qëllim rritjen e cilësisë dhe shpeshësisë së kontrolleve dhe inspektimeve në territorin e Bashkisë Kolonjë, me qëllim evidentimin e kundërvajtjeve dhe reduktimin e shmangieve nga projektet e miratuara. Gjithashtu, DPKKZHU të marrë masa për të mos miratuar asnjë çertifikatë përdorimi kur konstatohen shmangie nga projekti i miratuar, deri në kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për të arritur përputhshmërinë midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit rezulton se për vitin 2022 struktura organizative është miratuar me Urdhrin nr.13, datë 12.01.2022 të titullarit të bashkisë. Në strukturën e zyrës së kontrollit nuk ka punonjës me formimin profesional të fushës, si ng ndërtimi, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë dhe hidrogeologjisë;

- Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve (Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues deri në përfundimin e sistemimit të jashtëm);

-Për periudhën nën auditim 2022-2023, rezulton se nuk ka vendosur masa administrative me gjobë për 9 subjekte sipas procesverbaleve të kontaktimit pasqyruar në aneksin 6.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Gjithashtu rezulton se PVK (proces verbal i konstatimit të kundërvajtjes) nr.3 datë 15.05.2022, nr.4 datë 23.05.2022, nr.8 datë 23.05.2022, nr.9 datë 25.05.2022, nr.10 datë 27.05.2022, nr.13 datë.09.08.2022 janë të nënshkuara vetëm nga një inspektor, përkatësisht **Insp/P. L.**, veprime në kundërshtim me pikën (c), të VKM 894 datë 04.11.2015, ku është përcaktuar se: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore realizon kontrole nëpërmjet: i) një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë; e për pasojë ka lëshuar akte te pavlefshme të cilat nuk kanë forcë ligjore për sa kohë nuk janë në përputhje me kërkesat ve ligjit. Po ashtu **Insp/P. C.** në tre raste ka refuzuar nënshkrimin e aktit të konstatimit të kundërvajtjes pa dokumentuar arsyet. *Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për:

-Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati, për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

-Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

20.2.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes dhe Territorit të vendos masa administrative me gjobë për 9 subjekte sipas procesverbaleve të kontaktimit pasqyruar në aneksin 6.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit

Menjëherë dhe në vijimësi

A.1. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

21.Gjetje nga auditimi Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1025/9, datë 22.05.2023 në Bashkinë Kolonjë, konstatohet se nga Kryetari i Bashkisë nuk është ndërmarr asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve si vijon:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 29 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe nuk janë zbatuar. Nga 29 masa organizative të cilësuar si të pa zbatuara 29 prej tyre nuk rikërkohen pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet:

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 8,211,344 lekë, deri me datë 05.04.2023, nuk është marrë asnjë masë si dhe nuk është arkëtuar asnjë 0 lekë

b.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 2 masë në vlerën 1,239,977 lekë si dhe të arkëtohet vlera 78,212,989 lekë e pranuar dhe e pa zbatuar. Nga 9 masa organizative për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 78,212,989 lekë të cilësuar të pa zbatuara 9 prej tyre nuk rikërkohen pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet:

e.Masa disiplinore KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 8 punonjës, masë e cila rezultoi e pa zbatuar.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.1 faqe 152-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Për 5 masë shpërblim dëmi në vlerën 8,211,344 lekë si vijon:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **942,303 lekë pa TVSH** nga shoqëria BOE “A. “& “A.” ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 2104 Prot., datë 08.06.2020 me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut” Bashkia Kolonjë.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe grupin e kolaudimit të punimeve si dhe Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizime Sh.A Kolonjë në cilësinë e administrimit të investimit, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan pajisje të pa vendosura në objekt.

-Gjithashtu të marrë masa për vendosjen e pajisjeve dhe funksionimin e scadës, në të kundërt arkëtimin e vlerës **4,390,946 lekë.**

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, të marrë masa për të ngritur një grup pune të veçantë me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, ku rezultuan punime të pakryera, me qëllim arkëtimin e vlerës **1,264,272 lekë.**

3.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **1,323,023 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.” ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 1022 Prot., datë 25.02.2021 me objekt “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë në 14 fshatrat e Kolonjës” Bashkia Kolonjë.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të arkëtojë vlerën prej **290,800 lekë pa TVSH** nga shoqëria OE “A.” ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me Nr. 5151 Prot., datë 29.10.2020 me objekt “Ndërtim i ujësjellësit Ersekë dhe të disa fshatrave Faza e Dytë nga burimet e Kozelit” Bashkia Kolonjë.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet në 2 masë në vlerën 1,239,977 lekë si vijon:

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kolonjë dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Për masat disiplinore KLSH i rikërkon Kryetarit të Bashkisë Kolonjë vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për 8 punonjës si vijon:

1. z. S. L., Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave nga Tatim-Taksat, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (20-43) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
2. z. M. T., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (93-98) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
3. z. A. J., Drejtor i Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, për mangësitë e konstatuara në arkëtimin e të ardhurave nga qiratë e tokave pyjore dhe bujqësore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (20-43) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
4. zj. G. D., Drejtor i Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (44-54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
5. z. E. Z., Drejtor i Shërbimeve Publike, për mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
6. z. P. C., Kryeinspektor i Zyrës së Kontrollit pranë Bashkisë Kolonjë, për mangësitë e konstatuara në kontrollin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (98-105) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
7. z.A. T., Specialist pranë Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit në 3 procedura prokurimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (54-93) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
8. z. E. C., Specialist për mjedisin në zyrën e kontrollit, në rolin e kontrolluesit në sistemin e-lejet, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe zhvillimin e territorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (93-98) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

A.2. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.

Për 5 masë shpërblim dëmi në vlerën 21,360,346 lekë si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit të vlerës së qirave të përdorimit të fondit pyjor dhe kullësor prej **19,457,332** lekë, për Hec-et që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Kolonjë, respektivisht për subjektet si më poshtë:

- Subjekti “C.” SHPK, për vlerën prej 10,096,720 lekë.
- Subjekti HEC “Q. & K.” SHPK, për vlerën prej 936,780 lekë.
- Subjekti “B.” SHPK, për vlerën prej 132,000 lekë.
- Subjekti “E.” SHPK, për vlerën prej 8,291,832 lekë.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **732,989** lekë pa TVSh nga BOE “A.” SHPK & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2626 Prot, datë 07.08.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi”, Ersekë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kolonjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **218,243** lekë pa TVSh nga BOE “Z.” SHPK & “K.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5318 Prot, datë 05.11.2020, me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm i godinës së Bashkisë Ersekë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

4.1 Rekomandimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kolonjë të marren masa të menjëhershme për vendosjen e masës së gjobës si dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme duke nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total **523,391** lekësh.

5.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për vjeljen e detyrimit që ka lindur nga keq llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **428,264** lekësh ndaj subjektit me NIPT K....K “A.”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja “b” dhe “c)”-Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30/4/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Kolonjë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **20,969,993** lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë*" me nr. 5885 prot., datë 06.12.2023, me nr. REF-81298-09-26-2023, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kolonjë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik BOE "R." & "B.". Vlera e kontratës është 23,097,273 lekë me TVSH. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion referuar Urdhër shpenzimit nr. 1117 datë 27.12.2023, konstatohet se deri më datë 05.04.2024, referuar protokollit të Bashkisë Kolonjë për muajin Dhjetor 2023 të administruar nga grupi i auditimit, nuk disponohet Akti Dorëzimit të sheshit të ndërtimit i cili duhet të mbahej midis palëve. Nuk disponohet asnjë dokument në lidhje me "Njoftimin për fillimin e punimeve në objekt", por disponohet vetëm Vendimi i Kryetarit të Bashkisë E. I., Nr. 51 datë 27.12.2023 "*Për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh*". Në vendimin Nr. 51 datë 27.12.2023, miratohet deklarata e kryerjeve të punimeve të riparimit, mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes, për objektin e rezervuarit të Gjonçit dhe mbrojtje lumore. Referuar Urdhrit të Xhirimit nr. 1117 datë 27.12.2023, dokumentet bashkëlidhur shpenzimit janë: Urdhri i Prokurimit nr. 4468 prot. Datë 22.09.2023; Kontrata nr. 5885 prot., datë 06.12.2023; Likuidimi i faturës nr. 7/2023 prot., datë 27.12.2023; Kërkesë për pagesë nr. 6183 prot., datë 27.12.2023; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 698 datë 27.12.2023. Me shkresën e sipërmarrësit "R." SHPK nr. 15 prot., datë 27.12.2023, protokolluar në Bashkinë Kolonjë nr. 6183 prot., datë 27.12.2023 (*21 ditë pas lidhjes së kontratës*), drejtuar vetëm mbikëqyrësit të punimeve, por jo për dijeni Bashkisë Kolonjë, kërkohet likuidimi i situacionit nr. 1 i punimeve datë 27.12.2023 në vlerën prej 22,167,288 lekë me TVSH. Duke zbritur 5 % garancinë e punimeve në masën 1,108,364 lekë, vlera për tu likuiduar është 21,058,924 lekë me TVSH. Situacioni pjesor nr. 1 është nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve M. S. si përfaqësues i shoqërisë "V." SHPK, kontraktorit dhe Kryetarit të Bashkisë Kolonjë E. I. Situacionit pjesor nr. 1, në masën 96 % të punimeve, ku nuk disponohet asnjë relacion bashkëlidhur apo raport mbi ecurinë e punimeve pas 21 ditësh nga lidhja e kontratës dhe në të njëjtën ditë për lejimin e kryerjes së punimeve sipas vendimin Nr. 51 datë 27.12.2023 të Bashkisë. Vlera e situacionit të mësipërm ishte e pamundur të realizohej në masën 96 % të kontratës dhe kjo dëshmon për një fiktivitet pagesash. Gjithashtu me Urdhërin nr. 698 datë 27.12.2023 të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë E. I., urdhërohet të bëhet pagesa e situacionit nr. 1 në masën 96 % të punimeve në vlerën 22,167,288 lekë me TVSH, ku ngarkohet Drejtoria e Financës për zbatimin e urdhërit. Nga verifikimi i situacionit nr. 1, (*ku nuk disponohet asnjë librezë masash por vetëm situacioni me vlerat përkatëse*) dhe verifikimit në terren datë 03.04.2024 nga grupi i auditimit të KLSH-së, në prezencë të Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit rural dhe Drejtorit të Urbanistikës në Bashkinë Kolonjë në rezervuarin e Gjonçit dhe pritave malore, u konstatua se nuk ishte realizuar asnjë punim. Me observacionet e dërguara nga sipërmarrësi i punimeve me nr. 5 prot., datë 12.04.2024, të protokolluara në KLSH me nr. 186/12 prot. Datë 22.04.2024, mbi pretendimet e Akt konstatimit nr. 01 datë 05.04.2024 janë bashkëlidhur foto të realizimit të punimeve pas Akt Konstatimit. Më datë 06.04.2024, referuar kontratës së zbatimit, përfundon edhe afati i zbatimit të kontratës dhe nga ana e BOE "R." & "B." SHPK, nuk është realizuar asnjë zë pune duke mos ngritur as kantierin e punimeve. Pra, pas 4 muajsh nga nënshkrimi i kontratës, nuk ishte realizuar asnjë punim dhe nuk ishte marrë asnjë masë nga Bashkia Kolonjë, kjo gjë ka çuar në përfitim të padrejtë të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën **17,549,103 lekë pa Tvsh**, e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe është shkelur Ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" si dhe vetë kontrata e punimeve nr. 5885 prot., datë 06.12.2023, me nr. REF-81298-

09-26-2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4. faqe 133-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Kolonjë të marrë masa të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të kontratës të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **17,549,103 lekë pa Tvsh**, nga sipërmarrësi i punimeve, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare. Gjithashtu të analizohet e të vlerësohet vonesa në zbatimin e punimeve referuar kushteve kontraktuale dhe të merren masat e nevojshme për përfundimin e punimeve në kohën e përcaktuar nga AK.

Brenda datës 30.10.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion n për zbatimin e kontratës me objekt: "*Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë "Porta e Rehovës"*, me nr. 3650 prot., datë 27.07.2022, me Nr. REF-27924-05-09-2022, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Kolonjë, dhe Operatorit Ekonomik "Z." SHPK. Vlera e kontratës është 19,927,289 lekë me TVSH. Nga verifikimi i situacionit përfundimtar, tabelës së lëvizjes së volumeve, librezës së masave dhe verifikimeve në terren 19.03.2024 nga grupi i auditimit, u konstatua parregullsi në deklarime të punime të realizuara me faktin. Për këtë investim rezultoi se janë paguar më tepër punime në vlerën prej **1,515,106 lekë pa TVSH**, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve për shkak të diferencave të punimeve, të çmimeve në dëm të Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Kolonjë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4. faqe 133-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **1,515,106 lekë pa TVSH** nga kontraktori OE "Z.", për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 30.10.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Rikualifikim i rrugës "Pali Prifti" Qyteti Ersekë"* me REF-89977-03-15-2021, me nr.15 me nr.3420 prot., datë 12.07.2021, lidhur midis AK Bashkia Kolonjë, dhe Kontraktorit BOE "Z." SHPK & "K." SHPK. Vlera e kontratës bazë është 41,794,654 lekë me Tvsh dhe vlera e kontratës shtesë është 8,108,163 lekë me Tvsh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. 1. Gjatë inspektimit të punimeve të bulevardit rezultoi se zëri i punës "*FV Shtrim me gur vendas, spesori minimal 6 cm*" në disa pjesë të bulevardit shtrimi ishte kryer me gur me spesor 3-4 cm pra më të vogël se 6 cm të përcaktuar në zërin e preventivit fitues duke patur efektin ekonomik 780,135 lekë. 2. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se zëri i punës "*FV Bordura betoni 20x35 cm*" ishte kryer me bordura me përmasa 15x25 cm. Kjo diferencë në vendosjen e bordurave me përmasa të tjera përbën shkelje, të cilat kanë efektin ekonomik 240,748 lekë. 3. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se zëri i punës "*Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm Bikomponente (paste)*" ishte kryer me vijëzim me 12 cm; duke patur efektin ekonomik 97,670 lekë. 4. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se zëri i punës "*Pusetë shiu 40x60, h=100cm me kapak gize*" u vu re se ky zë pune ishte kryer jo me kapak gize por me kapak kompozit të cilat kanë efektin ekonomik 399,648 lekë. 5. Gjatë inspektimit të punimeve në objekt rezultoi se në një pjesë të rrugës kishte çedime në rrugë 15m². Kjo gjë tregon për mos respektim të kushteve teknike të zbatimit si dhe mos respektim të detajeve teknike të projekt zbatimit. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera totale prej 1,574,784 lekë pa Tvsh (780,135+240,748+97,670+399,648+56,583 lekë), ose **1,898,740 lekë me Tvsh** e përfituar

më tepër padrejtësisht nga Kontraktori BOE “Z.” SHPK & “K.” SHPK, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4. faqe 133-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **1,574,784 lekë pa TVSh** nga kontraktori BOE “Z.” & “K.”, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 30.10.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: *“Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë”* me nr. REF-36436-07-15-2022, nr. 4427 prot., datë 15.09.2022, lidhur midis AK Bashkia Kolonjë, dhe Kontraktorit OE “Z.” SHPK. Vlera e kontratës është 24,537,099 lekë me Tvsh. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. 1. Gjatë kontrollit të dosjes tekniko-ligjore pjesa e preventivit të rishikuar u vu re se disa zëra punimesh kishin pësuar rritje në mënyrë të pa logjikshme; zëri *“Transport materialesh me kafshë deri 3.0 km”* nga 69 ton ishte rritur në 93 ton ndërkohë volumet e tjera kanë pësuar ulje; duke patur efektin ekonomik 146,400 lekë. 2. Gjatë kontrollit të dosjes tekniko-ligjore në preventivin e rishikuar u vu re futja e një zëri të ri *“Mbushje me zhavorr pas mureve(kanali i tubave të çelikut)”*. Përdorimi i këtij zëri nuk është i argumentuar teknikisht dhe është i panevojshëm për mbulimin e tubave të çelikut pasi ato llogariten që të durojnë presionet e lëvizjes së ujit; duke patur efektin ekonomik 184,600 lekë.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera totale prej 331,000 lekë pa Tvsh (146,400 lekë + 184,600 lekë), **ose 397,200 lekë me Tvsh** e përfituar më tepër padrejtësisht nga Kontraktori OE “Z.” SHPK, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4. faqe 133-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë/Sektorin Juridik, Bashkia Kolonjë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **331,000 lekë pa TVSh** nga kontraktori OE “Z.”, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 30.10.2024

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifavat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor e periudhës 2022-2023 në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 paraqitet në shumën prej **79,424 mijë lekë**, vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022-2023 është 10,000 mijë lekë**

Debitorët përbëhen nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave të familjarëve, përfshirë tokën bujqësore në vlerën **62,657 mijë lekë**.

- Detyrimet nga taksat dhe tarifavat e Biznesit në shumën **11,391 mijë lekë**;

- Detyrime nga qiramarrës në shumën **4,615** mijë lekë.

- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” në vlerën prej **759 mijë** lekë, që i përkasin subjekteve të mbartura që nga viti 2016.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181. me VKB nr. 93, datë 24.12.2021 “Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kolonjë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022-2023 në vlerën progresive **79,424 mijë lekë**, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Kolonjë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen saktë vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e planifikimit zhvillimit dhe kontrollit të territorit, Bashkia Kolonjë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ish ZVRPP, sot (ASHK) Korçë.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **759,486 lekë** për 31 persona. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Kolonjë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksë e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 32-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Kolonjë, Drejtoria e planifikimit zhvillimit dhe kontrollit të territorit, të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI) për **31 persona** me vlerë **759,486 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kolonjë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Kolonjë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

b- “Vërejtje”, sipas germës “a” të nenit 58 për 5 (pesë) punonjës

1. Znj. G. D. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, për moskuadrimet e llogarive të pasqyrave financiare llogaria 101 “Teprica (Fond i akumulua)/Deficit i akumuluar), llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”, llogaria 4341 “Operacione me shtetin”. Për mungesën e regjistrit të aktiveve afatgjata. Moskuadrimi i llogarisë 32”Inventar i imët” me gjenden e inventarëve. Mungesa e listës analitike për llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” dhe udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (29-72) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Z. G. E., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për mangësitë e konstatuara në dhënien me qira të tokave bujqësore.

3. Z. E. A. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave, për mangësitë e konstatuara në arkëtimin e të ardhurave nga qiratë e tokave pyjore dhe bujqësore.

F. PËR MASA ADMINISTRATIVE.

F/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- “Parimet e përzgjedhjeje”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim” dhe 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” dhe 83- “Njoftimi i fituesit” të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

a- anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41

-Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, për procedurat si vijon:

- “Rikonstrukcion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022”,
- “Blerje materiale për ndricimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022”
- “Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”
- “Rivitalizimin e Qendrës Multifunkionale të qytetit Ersekë, Bashkia Kolonjë”.
- “*Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qëndër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë*
- “Rikonstrukcion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023”
- “*Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas, viti 2023,FAZA I*”.

b- anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “*Çmimi më i leverdishëm*”, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeje*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 67, “*Klasifikimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*” për procedurat si vijon:

- “Rikonstrukcion i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë viti 2022”,
- “Blerje materiale për ndricimin LED qyteti Ersekë dhe Leskovik, Bashkia Kolonjë viti 2022”
- “Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehove "Porta e Rehovës",viti 2022”
- “Ndërtim palestre për kompleksin “Shkolla Qëndër Komunitare” për shkollën 9 vjeçare Petro Nini Luarasi dhe Papa Kristo Negovani, Ersekë”
- “Rikonstrukcion i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtim prita Malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë viti 2023”
- “Rikualifikimi i qendrës fshati Mollas, viti 2023,FAZA I”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.3, faqe 65-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

F/2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit, (IMT), Bashkia Kolonjë

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7/1 dhe 12, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar dhe UKM nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, pika 1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2014 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i rekomandojmë Titullarit të Bashkisë Kolonjë, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, sipas kontratave respektive, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nxjerrë vendime për marrjen e masave përkatëse dhe sanksioneve administrative:

- 1. Subjekti OE V.” shpk**, përfaqësuar nga administrator z. M. S., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: *“Rikonstruksioni i digës së Rezervuarit të Gjonçit dhe ndërtimi prita malore në fshatrat e Bashkisë Kolonjë”*, datë 06.12.2023, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **21,058,924 lekë me TVSH**.
- 2. Subjekti OE “T.” shpk**, përfaqësuar nga administrator z. E. C., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: *“Rehabilitimi i sheshit hyrës në Rehovë “Porta e Rehovës”*, datë 27.07.2022, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **1,818,127 lekë me TVSH**.
- 3. Subjekti OE “L.” Shpk**, përfaqësuar nga administrator z. A. K., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: *“Rikualifikim i rrugës “Pali Prifti” Qyteti Ersekë”*, datë 12.07.2021, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **1,898,740 lekë me TVSH**.
- 4. Subjekti OE “S.” shpk**, përfaqësuar nga administrator z. E. L., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për shkeljet e konstatuara si vijon:
- Në kontratën me objekt: *“Rikonstruksioni i kanalit vaditës fshati Gostivisht, Bashkia Kolonjë”*, datë 15.09.2022, për punimeve të cilat rezultuan të likuiduara por jo të zbatuara në vlerën **397,200 lekë me TVSH**.

Menjëherë dhe në vijimësi

ANEKSET

Aneksi 2.1 ndryshimet e buxhetit sipas periudhave përkatëse për vitin 2022-2023

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)				
					Shtesa art.	Shuma	Paksime art.	Shuma	
Viti 2022	Nr.130 dt.30.12.2021	540,113	Nr.130,dt 30.12.2021	540,113	600+601, paga dhe sigurime	179,593			
			602-609 ShP. te tjera		102,214				
			230+231, investime		258,306				
			Nr.38 ,dt 29.03.2022	108	606, ShP. Per situata te veshtira	108		609, FR	108
			Nr.44,dt 29.04.2022	900	231, ShP. investime	900	230, studime ose kerkime		900
			Nr.71, dt 28.06.2022	9,600	602, ShP. Operative	9,400	600, FP		7,100
			Nr.85 ,dt 26.08.2022	900	231,Shp.Investime	200	231, FI		2,500
					602, ShP. operative	900	609, FR		900
			Nr.112,dt 22.09.2022	6,619	602, ShP. Operative	5,619	609, FR		1,100
					231,Investime	1,000	600,FP		5,400
			Nr.119,dt 14.10.2022	800	602, ShP. operative	800	231,FI		119
			Nr.122,dt 14.10.2022	13,295	231 ,investime	10,573	(5,721shtese nga projekt me financim te huaj dhe shtesa e arsimit per paga)		7,574
					602,Shp.operative	2,000			
		600,Shp.pagat	722						
Nr.48 ,dt 17.05.2022	7,622	604 ,Transferime korente	7,622						
Nr.50,dt 17.05.2022	23,006	602, ShP. Operative	998						
(Shtesë Buxheti nga 2021)		606,Transf per buxhete familjare	100						
Nr.147,dt 22.12.2022		231,Investime	21,908						
		540,113							

Viti 2023

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					Shtesa art.	Shuma	Paksime art.	Shuma
			Nr.18, dt.27.02.2023	540,113	600+601, paga dhe sigurime	198,857		
		Nr.24,dt27.02.2023(Shtese nga 2022)	602-609 ShP. te tjera		101,591			
		Nr .35,dt 23.03.2023	230+231, investime		43,580			
		Nr.66, dt 30.05.2023	1,376	602, ShP. operative	1,376	609, FR	1,376	
		Nr.67,dt 09.06.2023	27,881	602, ShP. Operative	7,887			
		Nr.77, date 06.07.2023	1500	231,Investime	19,994			
		Nr.98 ,dt 31.08.2023	3,531	602,Shp.Operative	1500	609,FR	1,500	
		Nr.107,dt 29.09.2023	2,370	600, Fond Page	3,531			
		Nr.107,dt 29.09.2023	2,370	602, ShP. Operative	1180			
		Nr.108 dt 29.09.2023	1,374	231,Investime	1190	600,FP	2,370	
				231, Investime	1,374	602, Shp.op	638	
				602, ShP. Operative	756	231,Invest	736	
			Nr.119,dt 30.10.2023	1,500	602, ShP. Operative	756		
			Nr.121,dt 30.10.2023	200	231,investime	744	600, FP	1,500
					602, ShP. operative	200		
					602, ShP. Operative	4,200	600+601,F.P	4,700
			Nr.167 ,dt 20.12.2023	8,680	600+601,Shp.Paga	500	231, FI	3,980
				78	231,Investime	3,980		
					602, ShP. operative	78	609 ,FR	78
					602, ShP. Operative	8,000		
				10,000	231,Investime	2,000		

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					Shtesa art.	Shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2023	Nr.147,dt 22.12.2022	344,028		17,402	602, ShP. Operative 230+231, investime	11,766 5,636		

Burimi i të dhënave: Bashkia Kolonjë

Aneksi 2.2 Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe 2023 me të ardhurat e veta të Bashkisë Kolonjë dhe transfertën e pakushtëzuar.

Njësia Bashkia Kolonjë+ Ndërmarrjet e vartësisë viti 2022

në 000/Lek

Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	6=(5-4)
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	Realizimi
600	Paga	143,030	143,254	137,287	143,254	5,967	96%
601	Sigurime Shoqërore	23,620	24,814	22,872	24,814	1,942	92%
600+601	Paga +Sigurime	166,650	168,068	160,159	168,068	7,909	95%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	98,491	120,301	98,006	120,301	22,295	81%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	1,296	7,297	7,297	7,297	0	100%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	114,652	128,373	123,198	128,373	5,175	96%
602-606	Shpenzime operative	214,439	255,971	228,501	255,971	27,470	89%
Shpenzime Korrente		381,089	278,307	424,039	388,660	35,379	92%
230	Kapitale të Patrupëzuara	2,557	1,869	943	1,869	926	50%
231	Kapitale të Trupëzuara	613,644	504,216	463,592	504,216	40,624	92%
Totali	Shpenzime Kapitale	616,201	506,085	464,535	506,085	41,550	92%
Totali (korrente + kapitale)		997,290	320,294	930,124	853,195	78,321	92%

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 me të ardhurat e veta të Bashkisë Kolonjë dhe transfertën e pakushtëzuar.

Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	6 = (5-4)
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	143,030	171,182	172,589	165,643	6,946	96%
601	Sigurime Shoqërore	23,620	27,675	28,644	27,246	1,398	95%
600+601	Paga +Sigurime	166,650	198,857	201,233	192,889	8,344	96%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	98,491	98,391	137,378	113,344	24,034	83%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	1,296	200	3,599	3,187	412	89%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	114,652	0	122,851	117,279	5,572	95%
602-606	Shpenzime operative	214,439	98,591	263,828	233,810	30,018	89%
Shpenzime Korrente		381,089	297,448	465,061	426,699	-38,362	92%
230	Kapitale të Patrupëzuara	2,557	3,900	5,005	5,005	0	100%
231	Kapitale të Trupëzuara	613,644	39,680	245,957	212,248	-33,709	86%
Totali	Shpenzime Kapitale	616,201	43,580	250,962	217,253	33,709	87%
Totali (korrente + kapitale)		853,195	341,028	716,023	643,952	-72,071	90%

Aneksin 2.3 Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit për virin 2022 dhe 2023.

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Kolonjë, për vitin 2022. Në 000/Lekë			
Plani	Fakti	Burimi i financimit të shpenzimit	
			Nga Granti Qeveritar

Përshkrimi Shpenzimeve			Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta e kushtëzuar specifike	Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transferta e kushtëzuar për investimet
Paga 600	143,254	137,287	19,234	14%	54,415	60,227	3,411	
Sigurime shoqërore 601	24,814	22,872			12,286	10,024	562	
ShP. Operat 602+ F. Rezervë	121,693	98,006	31,686	32%	38,565	27,700	55	
K. Q Emergj Civile 604	7,297	7,297					7,297	
Nd/Ekonomik 606	128,373	123,198					123,198	
Mjete ne ruajtje 466	3,666	3,666			3,666			
Investime 230-231	506,085	464,535	8,905	1.9%	20,550	13,439		421,641
Totali	935,182	856,861	59,825		129,482	111,357	134,523	421,641

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Kolonjë, për vitin 2023. Në lekë								
Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Burimi i financimit të shpenzimit					
			Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
					Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta e kushtëzuar specifike	Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transferta e kushtëzuar për investimet
Paga 600	172,589	165,643	20,192	12%	69,506	70,348	5,597	
Sigurime shoqërore 601	28,643	27,247			14,914	11,807	526	
ShP. Operat 602+ F. Rezervë	137,425	113,344	32,767	29%	52,986	27,326	265	
K. Q Emergj Civile 604	3,599	3,186					3,186	
Nd/Ekonomik invalid 606	122,850	117,279					117,279	
Mjete ne ruajtje 466	1,202	1,202			1,202			
Investime 230-231	250,962	217,253	12,887	5.9%	22,715	19,802		161,849
Totali	717,270	645,154	65,846		161,323	129,283	126,853	161,849

Aneksi nr. 2.4 planifikimin dhe realizimin i të ardhurave në mijë lekë, për vitin 2022-2023,

EVIDENCA E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE 12 MUJORI 2022 -2023							Në 000/lekë
Nr.	EMERTIMI	12-mujori 2022		Realizim%	12-mujori 2023		Realizim%
		PLAN	FAKT		PLAN	FAKT	
A	TAKSA VENDORE	17,556	21,282	121.2%	17,556	16,792	102.4%
1	Takse Pasurie	3,369	4,134	122.7%	3,369	4,114	122.1%
1/1	Subjekte Fizik	1,000	2,169	216.9%	1,000	490	49.0%
1/2	Subjekte juridike	465	403	86.7%	707	742	105.0%
1/3	Institucione	10	90	900.0%	10	91	910.0%
1/4	Për ndertesa Banimi	1,894	1,472	77.7%	1,894	3001	158.4%
2	Taksë mbi Truallin	58	0	0.0%	58	0	0.0%
3	T. vendore, biznesi I vogël	280	122	43.6%	280	23	8.2%
4	Tak. Regjistrim Automjete	3,800	4,618	121.5%	3,800	5,130	135.0%
5	Taksë Nd. Ne infra. (Nd te reja)	3,200	949	29.7%	3,200	1,288	40.3%
6	Të ardh nga hotele	135	11	8.1%	135	32	23.7%
7	Taksë e Kalimit të pronesisë	-	48		0	0	
8	Taksë për Tabele dhe Reklame	360	595	165.3%	360	531	147.5%
9	Taksë Kontrolli Veterinar	4	2	50.0%	4	0	0.0%

10	Tap	900	8575	952.8%	900	4609	512.1%
11	Renta Minerare	50	0	0.0%	50	1	2.0%
12	Taksa mbi tokën bujqesore	5,400	2228	41.3%	5,400	2,270	42.0%
B	TARIFAT VENDORE	61,907	40,995	66.2%	58,992	40,067	67.9%
1	Tarife Pastrimi	9,262	9,701	104.7%	9,962	9,594	96.3%
1/1	Subjekete Fizik	3,650	3215	88.1%	3650	1,925	52.7%
1/2	Subjekte juridike	2,282	2578	113.0%	2282	3,490	152.9%
1/3	Institucione	830	905	109.0%	830	1,000	120.5%
1/4	Tarifë për ndertesa Familjare	2,500	3003	120.1%	3200	3179	99.3%
2	Tar. Nd. Urban e mirembajtje	5,614	5,467	97.4%	5,814	4,362	75.0%
2/1	Subjekete Fizik	2,000	1912	95.6%	2000	492	24.6%
2/2	Subjekete juridike	800	816	102.0%	800	1042	130.3%
2/3	Institucione	514	484	94.2%	514	464	90.3%
2/4	Tarifë për Familje	2,300	2,255	98.0%	2,500	2,364	94.6%
3	Tar.Zenie Hap Publike	390	360	92.3%	390	353	90.5%
4	Tregu	700	416	59.4%	700	387	55.3%
5	Tarife Parkim automjete	220	109	49.5%	220	116	52.7%
6	Tarife regjstrim biznesi	50	50	100.0%	50	140	280.0%
7	Tarife per leje a certifikate	160	98	61.3%	160	248	155.0%
8	Tarife Sherb. Administ Gj.civil	1,200	3,926	327.2%	1200	869	72.4%
9	Tarifë kullote + pyjore	3,700	1,950	52.7%	3,700	2,070	55.9%
10	Tarifë dru zjarri	22,824	5,600	24.5%	18,924	7,304	38.6%
11	Ujitje dhe Kullim	300	320	106.7%	300	278	92.7%
12	Tarifë peshkimi	100	0	0.0%	100	0	0.0%
13	Hece	4,000	24,37	60.9%	4,000	3,447	86.2%
14	Qera Antene	7,000	4,314	61.6%	7,000	5,400	77.1%
15	Toka me Qera	3,600	4,132	114.8%	5,752	5,288	91.9%
16	Fond pyjor me qera	100	0	0.0%	100	0	0.0%
17	Prodhime te dyta pyjore	100	0	0.0%	100	0	0.0%
18	Tarifë shërbim për Qytetaret mjete	20	0	0.0%	20	0	0.0%
19	Tarifë E përkohshme Turizmi	2,067	1,642	79.4%	0	0	0.0%
20	Tarifë per Linja Nëntokesore Ajrore	100	0	0.0%	100	0	0.0%
21	Taksë Prone Private Pyll.kullote	400	473	118.3%	370	216	58.4%
C	Gjoha dhe Mosshlyerje në Afat të detyrimit	200	84	42.0%	800	202	25.3%
1	Mosshlyerje të detyrimeve Tataimore	-	-	-	600	161	26.8%
2	Gjoha nga kontrolli dhe inspektimeosshlyerje në Afat të detyrimit	200	84	42.0%	200	41	20.5%
D	Të ardhura jo tatimore	72	473	656.9%	462	808	174.9%
1	Të ardhura nga dhenia me qera e asetëve të bashkisë	72	230	319.4%	-	-	0
2	Të Ardhura nga sekuestrimet dhe zhvendimet	-	-	-	0	0	0%
3	Të Ardhura nga Shitja e mallrave dhe shërbimeve,asetëve të bashkisë	-	0	200.0%	0	0	0%
4	Të ardhura nga Çerdhja	-	360	-	400	486	121.5%
E	Detyrime të pa mbledhura në vite	1,000	3,139	313.9%	4,000	4,805	120.1%
F	Shuma (A+B+C+D+E)	80,735	65,973	81.7%	81,810	63,942	78.1%
G	Të ardhura kultura ,muze,biblotekë	180	116	64.4%	190	76	40.0%
1	Biblotekë muze	60	91	151.7%	60	0	0.0%
2	Të Ardhura Kultura	120	20	16.7%	130	76	58.5%
	Shuma totale (F+G)	80,915	66,089	81.7%	82,000	63,942	78.1%

Burimi: *DATT Bashkia Kolonjë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës “Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
531	Mjete Monetare në arkë			
512	Mjete monetare në bankë			
520	Disponibilitete në thesar	103,278,538	27,881,027	75,397,511
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera	521,640	568,490	(46,850)
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë			
	Totali	103,800,178	28,449,517	75,350,661

Burimi: Bashkia Kolonjë

Pasqyra PF4: Detajet e nënrubrikës “Gjendje inventari qarkullues”.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
31	Materiale	7,584,755	6,340,667	1,244,088
32	Inventar i imët	52,334,720	50,866,366	1,468,354
33	Prodhim në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarëve			
	Totali	59,919,475	57,207,033	2,712,442

Burimi: Bashkia Kolonjë

Pasqyra PF7: Detajet e nënrubrikës “Asetet e dëmtuara ose të amortizuara”.

Nr	Emertimi i institucionit	Llogaria 218+214	Llogaria 327	Llog 215	Llogaria 311	Totali
1	Magazina nr 2				432	432
2	Magazina nr 3	732,490	161,978		67,600	962,068
3	Magazina nr 1				30,390	30,390
4	Njesia administrative Barmash	150,698	12,876			163,574
5	Njesia administrative Novosele		33,269			33,269
6	Shkolla 9-vjecare	203,340	128,182			331,522
7	Njesia administrative Mollas	1,148,790	2,278,362			3,427,152
8	Njesia administrative Çlirim	517,215	32,802			550,017
9	Njesia administrative Leskovik	4,609,106	1,190,373	1,985,000		7,784,479
10	Rruget rurale	69,400				69,400
11	Qendra sociale		6,066			6,066
12	Zbukurimi i qytetit		1,149,240			1,149,240
13	Repertitori					0
14	Antena					0
15	Bordi i kullimit	8,607	4,560			13,167
16	Oficina		19,080			19,080
17	Cerdhja	3,924	600			4,524
18	Ndertim		5,280			5,280
19	Rruget rurale					0
20	Inventari i mirembajtjes		260,780			260,780
21	Inventari pastrim gjelberimit	2,131,577	248,826			2,380,403
22	Qendra kulturore e femijeve		4,134			4,134
23	Konvikti	147,058	58,069			205,127
24	Kopeshti nr. 2	56,339	52,488			108,827
25	Kopeshti nr. 1	142,992	13,420			156,412
26	Zyrat e pyjores te vjetra	1,197,216	115,314			1,312,530
27	Zyrat e pyjores te reja	903,040	57,597			960,637
28	Njesia qender leskovik	290,760	58,092			348,852
29	P.m.n.zh.	187,500	1,768,913			1,956,413
30	Njesia administrative qender	716,708	795,744			1,512,452
31	Zyrat e bashkise	2,395,444	155,047			2,550,491
32	Shkolla e mesme "gjimnazi"					0
33	Tregu	10	2,664			2,674
34	Sporti	79,000	125,880			204,880
35	Kultura	353,064	151,623			504,687
	Shuma	16,044,278	8,891,259	1,985,000	98,422	27,018,959

Burimi: Bashkia Kolonjë

Pasqyra PF8: Detajet e nënrubrikës “Llogari të arkëtueshme”.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka			
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			
44	Institucione te tjera publike			
466	Kreditore per mjete ne ruajtje			
468	Debitorë te ndryshëm	63,308,707	62,094,115	1,214,592
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	31,281,127	34,456,022	(3,174,895)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)			
	Totali			
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
	Totali	94,589,834	96,550,137	(1,960,303)

Burimi: Bashkia Kolonjë

Pasqyra PF15: Detajet e nënrubrikës “Ndërtesa Konstruksione”.

Nr	Ndërtime, Konstruksione	Vlera Neto 31.12.2022	Shtesa	Amortizimi	Vlera neto 31.12.2023
1	Zyrat e Bashkisë	120,843	-	6,042	114,801
2	Zyrat e Bashkisë	1,520,033	-	76,002	1,444,032
3	Zyrat e Bashkisë	3,905,630	-	195,282	3,710,349
4	Zyrat e Bashkisë	107,325	-	5,366	101,959
5	Tregu	153,642	-	7,682	145,960
6	Tregu	13,483,781	-	674,189	12,809,592
7	Vila	91,431	-	4,572	86,860
8	Zdruktari	8,960	-	448	8,512
9	Çerdhe	250,203	-	12,510	237,692
10	Çerdhe	675,848	-	33,792	642,056
11	Konvikti	955,255	-	47,763	907,492
12	Konvikti	247,980	-	12,399	235,581
13	Konvikti	5,531,193	-	276,560	5,254,633
14	Kopshti Nr.1	58,858	-	2,943	55,915
15	Kopshti Nr.1	2,937,612	-	146,881	2,790,731
16	Kopshti Nr.2	200,617	-	10,031	190,586
17	Shkolla 9-vjeçare	247,644	-	12,382	235,262
18	Shkolla 9-vjeçare	3,666,282	-	183,314	3,482,968
19	Shkolla 9-vjeçare	4,170,263	-	208,513	3,961,749
20	Ëc Publike	4,265	-	213	4,052
21	Magazinë Dekori	3,849	-	192	3,656
22	Shkolla e Mesme	3,068,169	-	153,408	2,914,760
23	Shkolla e Mesme	17,725,576	-	886,279	16,839,297
24	Muzeu	1,838,223	-	91,911	1,746,312
25	Fasadat	839,258	-	41,963	797,295
26	Muzeu Borovë	952,139	-	47,607	904,532
27	Qendra Kulturore e fëmijëve	4,805,402	-	240,270	4,565,132
28	Bashkefinancim Fusha	758,305	-	37,915	720,390
29	Gjelberimi Ambjenteve	30,081,819	-	1,504,091	28,577,728
30	Shpz objekte me vlere historike	606,706	-	30,335	576,371
31	Bashkefinancim Mbjellje	2,669,544	-	133,477	2,536,067
32	5% Punime Gjelberimi Ambjenteve	1,573,636	-	78,682	1,494,954
33	Rikonstruksion Cerdhja	124,424	-	6,221	118,203

34	Zyrat e Bashkisë	1,226,736	-	61,337	1,165,400
35	Konvikti Erseke	1,528,418	-	76,421	1,451,997
36	Shkolla 9-vjeçare P.K.N	23,511,789	-	1,175,589	22,336,200
37	Konvikti Erseke	1,450,288	-	15,107	1,435,181
38	Shkolla 9-vjeçare P.K.N	49,417,098	-	2,470,855	46,946,243
39	Reparti Mekanik	522,864	-	5,447	517,418
40	Shkolla MB Jani Vreto Leskovik	20,334,963	-	1,016,748	19,318,215
41	Shkolla MB Jani Vreto Leskovik	39,828,983	-	410,608	39,418,375
42	Shkolla M P.N.Luarasi Erseke	20,739,355	-	213,808	20,525,547
43	Rik.i pjesshem I catise se bash	1,396,500	-	14,250	1,382,250
44	Ndertim Lera	43,120	-	440	42,680
45	Shkolla MB Jani Vreto Leskovik	3,563,309	-	36,360	3,526,949
46	Rikonstruksion I pjssh.Godines se Bashkise	1,862,000	-	19,000	1,843,000
47	Ndertim prita	327,046	-	3,337	323,708
48	Ndertim Lera	392,000	-	4,000	388,000
49	Mbikqyrje+kolaudim projek	853,990	-	8,714	845,275
50	Rikonstruksion tortuare	1,531,916	-	15,632	1,516,285
51	Rikons.cerdhja njerës ne nevoj	3,345,210	-	34,100	3,311,110
52	Rik.banese sociale leskovik	7,827,049	-	78,270	7,748,779
53	Shkolla PN Luarasi Erseke	40,763,534	-	415,312	40,348,222
54	Prita	533,685	-	5,391	528,294
55	Lera	534,615	-	5,400	529,215
56	Banesa Sociale Leskovik	2,379,312	-	24,033	2,355,278
57	Mbikqyrje+kolaudim punimesh	400,950	-	4,050	396,900
58	Rikonstruksion Catia	6,361,849	487,309	59,339	6,789,819
59	Lera	297,000	-	3,000	294,000
60	Blerje materiale per ndertim pasare	912,384	-	9,216	903,168
61	Banesa Sociale Leskovik	3,725,411	714,992	30,408	4,409,994
62	Banesa Sociale Leskovik	313,623	-	3,136	310,487
63	Permiresim I banesave ekzistuse B.Kolonje	4,250,591	2,145,079	21,055	6,374,615
64	Mbikqyrje punimesh	196,230	196,230	-	392,460
65	Riparim fasada shkolla 9-vjeçare	838,800	838,800	-	1,677,600
66	Mbikqyrje punimesh	52,200	52,200	-	104,400
67	Mbikqyrje punimesh	835,844	835,844	-	1,671,688
68	Mbikqyrje punimesh	368,145	368,145	-	736,290
70	Materiale Qendra Multifunkionale	3,501,168	2,301,168	12,000	5,790,336
71	Shkolla PN Luarasi Erseke	6,643,497	-	69,932	6,573,565
72	Pallati kulture Selenice	1,683,578	-	84,179	1,599,399
73	Shkolla e re Selenice 96	12,461,778	-	623,089	11,838,689
74	Qendra shend Selenice 05	486,854	-	24,343	462,511
75	Shkolla fillore Kreshove	729,977	-	36,499	693,478
76	Pallati + shkolla Starje 99	3,493,220	-	174,661	3,318,559
77	Shkolla fillore Psarr 96	2,146,599	-	107,330	2,039,270
78	Shkolla Bejkove	915,896	-	45,795	870,101
79	Ambulanca Psarr 2007	583,475	-	29,174	554,301
80	Shkolla fillore e vjeter Kask	369,140	-	18,457	350,683
81	Shkolla e re Kaskollare	2,497,653	-	124,883	2,372,770
82	Shko 9-vjeçare Taç Qend 99	9,585,899	-	479,295	9,106,604
83	Ambulanca Taç-Qender	511,311	-	25,566	485,745
84	Shkolla fillore Taç-Poshte 04	2,138,654	-	106,933	2,031,721
85	Shkolla fillore Kodras 96	2,146,599	-	107,330	2,039,270
86	Shkolla fillore Prodan	91,997	-	4,600	87,397
87	Shkolla fillore Gjonç	693,510	-	34,676	658,835
88	Shkolla 8-vjeçare Rehove	3,084,614	-	154,231	2,930,383
89	Kopsht.ambul.pleqesi Reho	164,058	-	8,203	155,855
90	Shkolla fillore Taç-Lart 96	2,146,599	-	107,330	2,039,270
91	Shkolla fillore Borove	874,341	-	43,717	830,624
92	Shkolla 9-vjeçare Gostivisht	16,323,067	-	816,153	15,506,914
93	Pallati +kopshti Gostivisht	458,537	-	22,927	435,610
94	Ambulanca Gostivisht	858,640	-	42,932	815,708
95	Sholla fillore Lengez	575,860	-	28,793	547,067

96	Shkolla fillore Kabash	367,989	18,399	349,589
97	Zyrat e Komunes rik dritare	285,885	14,294	271,591
98	Magazina	36,799	1,840	34,959
99	Banjot	9,200	460	8,740
100	Abulanca e re Starje2007	899,001	44,950	854,051
101	Abulanac e re Tac lart2007	607,720	30,386	577,334
102	Abulanca e re Bejkove 2007	347,415	17,371	330,044
103	Financim Muzeu Rehove	267,756	13,388	254,368
104	Rik i Zyres se Gj.civile	267,454	13,373	254,081
105	Qendra Shend.Borove	1,694,650	84,733	1,609,918
106	Ambulance Tac posht 2011	953,092	47,655	905,438
107	Shkolla Kaltanj	27,239	1,362	25,877
108	Shkolla Qesarakë	24,397	1,220	23,177
109	Shkolla Radovickë	3,946	197	3,749
110	Shkolla Qinam - Radovickë	31,772	1,589	30,183
111	Shkolla Lënckë	54,018	2,701	51,317
112	Shkolla Kurtes	6,956	348	6,608
113	Shkolla Luaras	4,087,605	204,380	3,883,225
114	Shkolla Çlirim	109,873	5,494	104,379
115	Ura Orgockë	5,058,812	252,941	4,805,871
116	Ambulanca Kaltanj	355,187	17,759	337,428
117	Ambulanca Luaras	680,232	34,012	646,220
118	Spitali Çlirim	2,542,861	127,143	2,415,718
119	Ndërtesat Mollas	21,304,012	1,065,201	20,238,811
120	Menca Kati i Dytë	4,642	232	4,410
121	Shkolla Novoselë	131,869	6,593	125,275
122	Shkolla Mësiçkë	194,123	9,706	184,417
123	Infermjeria Novoselë	2,303	115	2,188
124	Infermjeria Zharkanj	20,230	1,011	19,218
125	Zyrat e Komunës	7,419	371	7,048
126	Shkolla Kagjinas	8,953	448	8,505
127	Shkolla Kaduç	17,861	893	16,968
128	Shkolla Piskal	26,230	1,311	24,918
129	Shkolla Dërmarr	18,432	922	17,510
130	Shkolla Mbreshtan	15,798	790	15,008
131	Qendra Shëndetsore Novoselë	14,095	705	13,390
132	Shkolla 9- vjeçare Barmash	6,360,057	318,003	6,042,055
133	Shkolla Fillore Kamnik	639,121	31,956	607,165
134	Shkolla Fillore Shalës	611,480	30,574	580,906
135	Shkolla Fillore Leshnjë	356,525	17,826	338,699
136	Shkolla Fillore Sanjollas	222,453	11,123	211,330
137	Shkolla fillore Gozhdarazhde	240,840	12,042	228,798
138	Shkolla Fillore Bënjëz	5,308	265	5,043
139	Shkolla Fillore Rajan	306	15	291
140	Shkolla Fillore Radimisht	2,304	115	2,189
141	Zyrat e Komunës Barmash	1,910,426	95,521	1,814,905
142	Ish Zyra e Gjëndjes Civile	4,361	218	4,143
143	Banjot e Komunës	70,465	3,523	66,942
144	Garazhi i makinës së Komunës	5,639	282	5,357
145	Shkolla 9- vjeçare Radanj	112,534	5,627	106,907
146	Shkolla 9- vjeçare Vrëpckë	57,669	2,883	54,785
147	Shkolla Fillore Peshtan	31,368	1,568	29,800
148	Shkolla Fillore Radanj	19,321	966	18,355
149	Shkolla Fillore Cerckë	28,086	1,404	26,682
150	Shkolla fillore Radovë	45,366	2,268	43,098
151	Shkolla Fillore Postenan	10,811	541	10,271
152	Shkolla Fillore Gjirakarë	7,583	379	7,204
153	Shkolla Fillore Lashovë	19,621	981	18,640
154	Shkolla Fillore Gërmënj	7,333	367	6,966
155	Shkolla Fillore Podë	1,949,378	97,469	1,851,909
156	Shkolla Fillore Radat	66,932	3,347	63,585
157	Shkolla Fillore Shelegur	248,598	12,430	236,169
158	Zyrat e vjetra të Bashkisë	2,863,397	143,170	2,720,227
159	Zyrat e Reja të Bashkisë	6,592,549	329,627	6,262,922
160	Kopshti i Fëmijëve Dy Katësh	5,080,507	254,025	4,826,481
161	Kopshti i Fëmijëve	7,656,794	382,840	7,273,954
162	Kopshti i Fëmijëve Shkolla	7,760,047	388,002	7,372,045
163	Shkolla e Mesme	4,302,241	215,112	4,087,129
164	Konvikti	12,138,359	606,918	11,531,441

165	Shtepi Kulture e Kinema	784,171		39,209	744,962
166	Muzeumi	331,364		16,568	314,796
167	Muzeumi Ersekë	996,715		49,836	946,879
168	Muzeumi Borovë	527,942		26,397	501,544
169	Biblioteka	16,921,404		846,070	16,075,334
170	Pallati i Kulturës	10,039,654		501,983	9,537,671
171	Pallati i Kulturës	10,695,354		534,768	10,160,587
172	Stadiumi	1,731,724		86,586	1,645,138
173	Objekti N.SH.N	91,394		4,570	86,824
174	Ndertesa PMNZH	123,805		6,190	117,615
175	Zyra Rr.Rurale	202,284		10,114	192,170
176	Zyrat Leskovik Pyjorja	1,638,227			
177	Zyrat Erseke Pyjorja	5,005,468			
178	Zyrat Çlirim Pyjorja	1,191,818			
179	Zyrat Mollas Pyjorja	457,453			
	Total	571,670,422	7,939,767	21,860,596	549,456,627

Burimi:Bashkia Kolonjë

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF16** më poshtë.

Pasqyra PF16: Detajet e nënrubrikës “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

Nr	Rrugë,Rrjete,Vepra ujore	Vlera Neto 31.12.2022	Shtesa	Amortizimi	Vlera neto 31.12.2023
1	Rruge e Rrjete	-	-	-	-
2	Rruge e Rrjete	-	-	-	-
3	Rruge e Rrjete	-	-	-	-
4	Rruge e Rrjete	-	-	-	-
5	Rruge e Rrjete	-	-	-	-
6	Rruge e Rrjete	-	-	-	-
7	Rruge e Rrjete	391,644	-	19,582	372,062
8	Rruge e Rrjete	1,056,883	-	52,844	1,004,039
9	Rruge e Rrjete	811,939	-	40,597	771,342
10	Rruge e Rrjete	2,105,352	-	105,268	2,000,084
11	Rruge e Rrjete	4,960,085	-	248,004	4,712,081
12	Rruge e Rrjete	63,024	-	3,151	59,873
13	Bashkefinancim fushë futbollit	588,141	-	29,407	558,734
14	Sheshi Rilindja	27,275,918	-	1,363,796	25,912,122
15	Sheshi Rilindja	15,695,126	-	784,756	14,910,370
16	Rikualifikimi i Sheshit Rilindja	41,115,532	-	2,055,777	39,059,756
17	Rikonst Rrugeve dhe Fasadave	16,883,591	-	844,180	16,039,411
18	Sheshi Rilindja	3,347,422	-	167,371	3,180,051
19	Rikonst Rrugeve dhe Fasadave	15,895,230	-	794,762	15,100,469
20	Rikonst Rruga 20 Maji	17,386,155	-	869,308	16,516,848
21	Investimet	115,157,309	-	1,199,555	113,957,754
22	Cngurtesime	2,668,224	-	27,794	2,640,430
23	Dhurime ushtria	2,713,920	-	28,270	2,685,650
24	Mbikqyrje konvikt	18,406	-	190	18,216
25	Kanalet Kullues Bashkia	89,350	-	921	88,428
26	Blerje Materialesh Asfaltike	2,156,000	-	22,000	2,134,000
27	Ndertimi I ujesjellesit erseke	94,619,989	-	946,200	93,673,789
37	Ndertimi I ujesjellesit erseke	137,750,000	-	1,377,500	136,372,500
29	Ndertimi I ujesjellesit erseke	239,855,761	-	2,398,558	237,457,203
30	Supervizim I ujesjellesit Er	200,000	-	2,000	198,000
31	Rikonstruksion tortuaresh	3,038,013	-	30,687	3,007,326
32	Ujesjellesi Leskovik	99,965,404	-	999,654	98,965,750
33	Rik.Rrjeti I Brendshem dhe I jashtem	142,500,000	-	1,425,000	141,075,000
34	Rik.Rrjeti I Brendshem dhe I jashtem	18,267,969	-	182,680	18,085,289
35	Supervizim I rrjetit te Brend dhe J	2,311,315	-	23,113	2,288,202
36	Blerje Materialesh Asfaltike	5,360,952	-	53,610	5,307,342
37	Rikonstruksion tortuaresh	492,001	-	4,920	487,081
38	Rrjeti I shperdarjes te furnizimit me uje	74,146,131	-	741,461	73,404,670
39	Rrjeti I shperdarjes te furnizimit me uje	297,186,029	139,486,029	1,577,000	435,095,058
40	Mbikqyrje punimesh Rrjeti I furnizimit me uje	400,000	-	4,000	396,000
41	Kolaudim punimesh rrjeti I furnizimit	591,401	-	5,914	585,487
42	Rikualifikim Pali Prifti	28,812,596	14,905,500	139,071	43,579,025

43	Rikualifikim Pali Prifti	6,175,109		61,751	6,113,358
44	Prita	536,682		5,367	531,315
45	Lera	538,518		5,385	533,133
46	Blerje Materialesh Lulishtja I Maji	957,600		9,576	948,024
47	Supervizim I rrjetit te Brend dhe J	990,000		10,000	980,000
48	Kolaudim punimesh ujsellsi Leskoik	486,595		4,866	481,729
49	Supervizim punimesh per ujsjellesin	693,000		7,000	686,000
50	Shtim I siperfaqeve te gjelbra	714,680		7,147	707,533
51	Rikonstruksion I ambjenteve sportive	1,918,560		19,186	1,899,374
52	Rikonstruksion tortuaresh	2,344,440		23,444	2,320,996
53	Rehabilitimi sheshit hyres te Rehoves	11,068,992	3,186,206	78,828	14,176,370
54	Blerje Materiale asfaltike	2,880,840		28,808	2,852,032
55	Blerje materialesh shtrim pllaka guri leskovik	4,729,122	2,696,960	20,322	7,405,760
56	Prita		553,100		553,100
57	Lera		524,500		524,500
58	Shtim I siperfaqeve te gjelbra		453,600		453,600
59	Blerje materialesh shtrim pllaka guri		1,176,000		1,176,000
60	Rikonstruksion tortuaresh		2,499,120		2,499,120
61	Rikonstruksion tortuaresh		2,980,000		2,980,000
62	Materiale rruga e llixhave sarandapor leskovik	-			-
63	Vend depozitimi I kafsheve te ngordhura		594,000		594,000
64	Supervizion Punimesh 14 fshatrat	912,653		9,219	903,435
65	Supervizim I ujesjellesit Er	998,530		10,189	988,341
66	Rruga Vishanj - Taç- Poshtë	835,649		41,782	793,867
67	Rruga Bejkovë	392,546		19,627	372,918
68	Rruga Lëngëz	218,445		10,922	207,523
69	Rruga Taç -Lartë	506,437		25,322	481,115
70	Rruga Ersekë - Kodras	24,571		1,229	23,342
71	Rruga Gostivisht	4,704,469		235,223	4,469,245
72	Sistemim Rruga Rehovë	13,509,026		675,451	12,833,575
73	Sistemim Rruga Kreshovë	17,426,108		871,305	16,554,803
74	Sistemim Rruga Starje	19,409,847		970,492	18,439,354
75	Rik Kanal Vaditës Fshati Kreshovë	13,512,024		675,601	12,836,423
76	Rikonst Kanali Ujëmbledhësi Fshati Gjonç	13,264,328		663,216	12,601,111
77	Ndërtim Ura Bejl	3,434,693		171,735	3,262,958
78	Rruga Starje ,Selenice,Tac-Larte	30,537,305		1,526,865	29,010,440
79	Ndërtim Ura Bejl	816,260		40,813	775,447
80	Kanali I Gjoncit	48,853,509		2,442,675	46,410,833
81	Rikonst Kanali i Fshati Gjonç	18,952,500		947,625	18,004,875
82	Kolaudim punimesh Rezervuari I Gjoncit	212,155		10,608	201,547
83	Mbikqyrje punim.rez.Gjoncit	384,750		19,238	365,513
84	Mbikqyrje punim.rez.Gjoncit	1,029,614		51,481	978,133
85	Rruga Luaras	2,728,290		136,414	2,591,875
86	Rruga Qafzes-Çlirim	39,409,097		1,970,455	37,438,642
87	Rruga Soropole-Psari i Zi	15,134,636		756,732	14,377,904
88	Rruga Qafzes-Çlirim 5%	417,537		20,877	396,660
89	Rrugë, Rrjete dhe vepra ujore Mollas	52,372,063		2,618,603	49,753,459
90	Depo Prodhimi Kagjinas	201,981		10,099	191,882
91	Ndriçim rrugor Mësiçkë	216,928		10,846	206,081
92	KUZ Kagjinas	293,648		14,682	278,966
93	KUZ Kagjinas	142,437		7,122	135,315
94	KUZ Kagjinas	98,774		4,939	93,835
95	KUZ Kagjinas	93,149		4,657	88,491
96	KUZ Novoselë	594,560		29,728	564,832
97	KUZ Novoselë	594,283		29,714	564,568
98	Rruga Novoselë	1,659,407		82,970	1,576,437
99	Rruga auto Sanjollas	1,423,377		71,169	1,352,208
100	Rruga auto Barmash	10,950,449		547,522	10,402,927
101	Rruga auto Radat	31,489,489		1,574,474	29,915,015
102	Rruga auto Podë	228,093		11,405	216,688
103	Rruga auto Cerckë	1,198,981		59,949	1,139,032
104	Rruga auto e vreshtave	1,107,254		55,363	1,051,891
105	Kanali Vadites Kabash	13,701,082		685,054	13,016,028
106	Mbikq Ujesjellesi LLesk	53,953		2,698	51,255
107	Kanali Vadites Kabash F II	7,737,810		386,891	7,350,920
108	Mbikqyrje kanali Kabash	374,000		18,700	355,300
109	Rezervuari I Kabashit	4,694,368		234,718	4,459,650

110	Ndriçim Rrugor	691,552		34,578	656,974
111	Rruga e Qytetit	13,085,663		654,283	12,431,380
112	Rruga e rrezës	6,765,021		338,251	6,426,770
113	Rruga e varezave	11,204,205		560,210	10,643,995
114	Rruga e Spitalit + Bllok pallate	16,783,241		839,162	15,944,079
115	Rruga Blloku nr.1.2.3.4	24,319,194		1,215,960	23,103,234
116	Blloku i Pallateve në Hyrje	7,563,793		378,190	7,185,603
117	Rikons Sistemi Ngrohës i Shkollës	1,252,050		62,603	1,189,448
118	Tregu Leskovik	3,049,566		152,478	2,897,088
119	Ujesjellesi I jashtëm Leskovik	1,984,903		99,245	1,885,658
120	PUS UJI Leskovik	3,270,075		163,504	3,106,572
121	Rikualif Qendra Leskovik	26,859,638		1,342,982	25,516,656
122	Ujesjellesi brendshëm Leskovik (mallra)	1,528,307		76,415	1,451,892
123	Vepra Ujore	35,830,090		1,791,504	34,038,585
124	Rruga auto Radat	3,443,130			3,443,130
	Total	1,984,392,441	169,055,015	45,326,346	2,108,121,110

Burimi:Bashkia Kolonjë

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto” që ka të bëjë me amortizimin vjetor 2022.

Pasqyra PF19: Detajet e nënrubrikës “Aktivet afatgjata me vlerë neto”.

Nr.Referen ce Lloga rije	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakësimet gjtë vitit	Teprica në fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Kosto Historike	A.akumuluar	Teprica neto
	1	2	3	4	5	6	8	9	10
20	28,922,806	12,813,213	16,109,593	5,004,800	3,149,780	0	33,927,606	15,962,993	17,964,613
202	28,922,806	12,813,213	16,109,593	5,004,800	3,149,780	0	3,464,088	15,962,993	17,964,613
21-28	3,591,612,774	878,603,336	2,713,009,438	185,005,043	84,657,965	4,500	3,776,613,317	963,261,301	2,813,352,016
210	3,330,850	0	3,330,850	0	0	0	3,330,850	0	3,330,850
211	25,909,872	0	25,909,872	0	0	0	25,909,872	0	25,909,872
212	750,547,084	192,537,655	558,009,429	7,939,767	23,959,917	0	758,486,851	216,497,572	541,989,279
213	2,478,039,069	432,567,606	2,045,471,463	169,055,015	45,326,346	0	2,647,094,084	477,893,952	2,169,200,132
214	138,772,005	95,125,491	43,646,514	4,405,101	8,045,850	4,500	143,172,606	103,171,341	40,001,265
215	130,480,547	109,830,173	20,650,374	3,060,000	2,997,602	0	133,540,547	112,827,775	20,712,772
218	64,533,347	48,542,411	15,990,936	545,160	4,328,250	0	65,078,507	52,870,661	12,207,846
Shum a	3,620,535,580	891,416,549	2,729,119,031	190,009,843	87,807,745	4,500	3,810,540,923	979,224,294	2,831,316,629

Burimi:Bashkia Kolonjë

Aneksi nr. 6.1 process-verbaleve të kundravajtjes, vendimeve të gjobave, vendimeve të prishjeve të objekteve të kundraligjshëm, të vëna në dispozicion nga IMTV bashkia Kolonjë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT